Behgjet Pacolli reagoi ndaj deklaratave të Vuk Jeremicit se Uganda nuk e ka njohur Kosovën. Zëvendëskryeministri i Parë tha se njohja nga ky shtet është punë e kryer, derisa ironizoi me Shefin e...

75

15 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

March 1, 2012 ·

Postuar nga Admin.

GHANAWEB.COM

### Ghana and Serbia in diplomatic row | General News 2012-02-29

Serbia has booted Samuel Valis-Akyianu, Ghana's Ambassador to Serbia, out of the country after a major diplomatic row. The Foreign Affairs Minister, Alhaji Mohammed Mumuni, told Parliament on Wednesday the hitherto...

33

4 Shares



Behgjet Pacolli

March 1, 2012 ·

Postuar nga Admin.

INFO-KOSOVA.NET

### Efekt i Kosovë: Serbia dëbon ambasadorin e Ganës


Lajme nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bota, Ekonomia, Sporti, Teknologjia, Shendetesia, ShowBiz e shumë lajme tjera.

35

3 Comments 1 Share


 **Behgjet Pacolli** ✓  
March 1, 2012 · 🌐


Zëvendëskryeministri Pacolli merr pjesë në konferencën e SADC në Angola; admin

BEHGJETPACOLLI.COM 




**Zëvendëskryeministri Pacolli merr pjesë në konferencën e SADC në Angola**

Zëvendëskryeministri Pacolli merr pjesë në konferencën e SADC në Angola 1 mars 2012 Në kuadër të angazhimeve shtetërore për njohjen e Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka udhëtu...

 62  6 Comments  3 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
March 7, 2012 · 🌐

Te gjithë mesimdhenseve ju urojme Diten e mesuesit.  
admin

 54  1 Comment  2 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
March 7, 2012 · 🌐

<http://gazetaexpress.com/?cid=1,13,75598>

GAZETAEXPRESS.COM 

**Pacolli: Familjen Jashari e konsideroj si familjen time - Politika - Gazeta Express**

Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli ka qëndruar në Prekaz, në ditën e tretë të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai është pritur në kullën e...

 59  7 Comments  6 Shares



Behgjet Pacolli

March 11, 2012

<http://www.zeri.info/.../pacolli-njohjet-i-solla-me.../>

admin

ZERI.INFO

**Zëri • INFO - Ditari - Politikë - Pacolli: Njohjet i solla me paratë e mia**

Duke e falënderuar gazetën Zëri, por dhe të gjitha mediet tjera për vëmendjen që po i japin procesit të njohjeve të Kosovës, Zyra e zëvendëskryeministrit të parë të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka reaguar në...

85

9 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

March 12, 2012

<http://1deputyprimeminister-ks.net/index.php?page=1,6,1122>

1DEPUTYPRIMEMINISTER-KS.NET

**Reagim në lidhje me shkrimin botuar në gazetën Zëri, «Një milion, Një njohje», me datë 10 mars 201..**

25

4 Comments



Behgjet Pacolli

March 19, 2012

Interviste per te perditshmen "GazetaExpress"

<http://gazetaexpress.com/?cid=1%2C13%2C76534> admin

GAZETAEXPRESS.COM

**I mërztur me politikë - Politika - Gazeta Express**

Behgjet Pacolli është lodhur nga skena politike e Kosovës. Lideri i AKRsë thotë se nuk është i interesuar ti hyjë garës për postin e Presidentit të Republikës në këto rrethana të...

38

9 Comments



Behgjet Pacolli

March 28, 2012

Ne takim me presidenten Jahjaga dhe zotit Pacolli u bisedua për çështjen e shpalljes së zgjedhjeve për kryetar të komunës së Ferizajt, pas dorëheqjes së kryetarit të kësaj komune.admin



115

8 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

April 3, 2012

Zv.Kryeministri Behgjet Pacolli ,mysafir ne KTV Rubikon.  
admin

54

7 Comments



Behgjet Pacolli

April 4, 2012

Postuar nga Admin.

KOHAVISION.NET

Behgjet Pacolli - Rubikon - Kohavision

Zv kryeministër Kosovës

61

3 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

April 6, 2012 · 🌐

...

Në emrin tim te gjithë besimtarve katolike ju shpreh urimet më të përzemërta me rastin e Festës së Pashkëve, uroj që këtë festë ta kaloni me gëzime e begati të gjithë së bashku me më të afërmit dhe me më të dashurit tuaj.

👍 41

2 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

April 7, 2012 · 🌐

...

## Puna lobuese dhe hamamet; Ky shkrim ripublikohet per here te dyte me kerkese te perkrahseve. admin



Behgjet Pacolli

Puna lobuese dhe hamamet

Nga:Behgjet Pacolli

Shpesh herë rreth njeriut që punon, sipas një tradite të mirë ballkanase, mbledhen në tavolina, apo në ndeje të ndryshme njerëz që e soditin punën, komentojnë si të bëhet më mirë, përgëzojnë punëkryesin, apo e shajnë atë. Disa soditës të sodit të mbledhur në tavolina, janë dembelët e djeshëm. E them këtë pse termi "i plogësht", që dikushka përdorur për të përkufizuar punën e diplomacisë sonë lobuese më sjell në mend pozitën e kritikëvenë të vërtetë. Dhe po ju sjell mu për këtë, një histori pleqsh të kohës së Turqisë që më ka treguar dikush kohët e fundit. Pleqtë minin me këmbët në ujëtë ngrohtë të hamameve, dhe tregonin e tregonin histori. Dikur historitë që tregonin për të vranë kohën mbaruan. Njeri prej tyre, prekur nga koha që nuk mridhte, e s'mridhte, ofroi zgjidhjen më origjinale, në formën e një lutjeje: Ah, si nuk po bën një luftë kjo Turqi, që të çajmë diçka të re, të re, të re, dhe të llojmë këmbët në ujëtë.

[See More](#)

👍 15

8 Comments



Behgjet Pacolli

April 8, 2012 · 🌐

...

z.Behgjet Pacolli mysafir javen e kaluar ne SUBVENCION RTK,per me shume shikojeni videolinkun...[http://rtklive.com/s\\_video/subvencion.aspx](http://rtklive.com/s_video/subvencion.aspx)

👍 17

2 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

April 8, 2012 · 🌐

...

Shprehu ngushllimet me te sinqerta nga zemra per familjen e te ndjerit Selver Haradinaj ne Mitrovice, te lenuarve ju deshirojme sherim te shpejte,organeve te rendit ju bejme apel qe vandalet qe e kryen kete akt vandal te dalin para organeve te drejtesise.

👍 87

10 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli ✓

April 20, 2012 · 🌐

...

Angazhimi i fuqishëm diplomatik i zëvendëskryeministrit të parë të Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli do të vazhdojë në të ardhmen e afërt, të japë sukseset e veta në fushën e njohjeve...

<http://www.zeri.info/.../pacolli-njohjet-e-reja-ceshtje.../>

ZERI.INFO

<http://www.zeri.info/artikulli/1/1/47906/pacolli-njohjet-e-reja-ceshtje-ditesh/>



41



Behgjet Pacolli ✓

April 23, 2012 · 🌐

...

"Unë jam duke e shtyrë përpara një mision të rëndësishëm, jam duke u munduar që t'ia siguroj Kosovës atë që kam premtuar - mbi njëqind e më tepër njohje, çka po më duket se shumë shpejt do ta kryej këtë punë" .(nga intervista dhene per kohaditore 23prill) admin



120

19 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli ✓

April 23, 2012 · 🌐

...

E perkrahim fuqimisht kandidatin e AKR-se per kryetar te Ferizajit z.Ramadan Hasani

<http://kosovapress.com/?cid=1,86,146362>

KOSOVAPRESS.COM

**AKR e do Ferizajn si modelin e tyre për Kosovën**

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli ka qëndruar sot në komunën e Ferizajt për të përkrahur k...



32

1 Share

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

April 25, 2012 · 🌐



E përkrahim fuqimisht z.Ramadan Hasani për kryetar të Ferizajit



👍 75

5 Comments 2 Shares





Behgjet Pacolli

April 27, 2012 ·

Ne Ferizaj me kandidatin e AKR-se per kryetar te Ferizajit z.Ramadan Hasani



115

10 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli   
May 5, 2012 · 

...

## Sqarim: "KOSOVA SOT" keqinformoi për shpenzimet e Pacollit



Behgjet Pacolli

E vërteta rreth shpenzimeve të zotit Behgjet Pacolli, për një vit si zëvendëskryeministër I Kosovës.

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, nuk I ka shpenzuar 140 mijë euro ashtu sic, keqinformon gazeta "Kosova Sot".

Për një vit, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, nga buxheti I

Kosovës ka shpenzuar 17.966.33. euro.

Vetëm gjatë vitit 2011, prej kur është pjesë e Qeverisë, zoti Behgjet Pacolli nga buxheti privat, për lobim për njohjen e Republikës së Kosovës ka shpenzuar rreth 1.6 milion euro (të gjitha janë të dokumentuara).

Cikë më tej për vitin 2012, nga buxheti privat, zëvendëskryeministri Pacolli ka shpenzuar 640 mijë euro.

[See More](#)

 16


4 Shares



Behgjet Pacolli   
May 9, 2012 · 

...

<http://kosovaitimes.net/?page=1,17,6374>

KOSOVATIMES.NET 

### Qeveria: Pacolli shpenzoi vetëm 17 mijë euro për një vit - Lajme - KosovaTimes

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, për një vit pune, përfshirë lobimin për njohjet dhe gjitha vizitat e tij, sipas Qeverisë, i ka shpenzuar vetëm 17 mijë euro të buxhetit të Kosovës. Gjitha shpenzimet e tjera Qeveria thotë se...

 100

15 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

May 12, 2012 ·

<http://www.zeri.info/.../pacolli-1-6-milion-i-harxhova.../>

ZERI.INFO

**Zëri • INFO - Ditari - Politikë - Pacolli: 1.6 milion i harxhova për lobim!**

Është e vërtetë që kam kërkuar nga qeveria që ti mbulojë shpenzimet e stafit tim në lobim, por jo edhe ato të miat. Kështu ka thënë zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli në një intervistë të shkurtër për Zëri të realizuar...

67

25 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

May 13, 2012 ·

Postuar nga Admin.

TRIBUNASHQIPTARE.INFO

**Pacolli: Nuk më ndalin dot**

Gazeta e perditshme Tribuna Shqiptare

100

7 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

May 22, 2012 ·

Me rastin e fatkeqsise ne komunikacion ne afersi te Himares ku humben jeten dhjetra njez e te tjere u lendum shume,ju shprehim ngushllimet me te sinqerta familjarve te viktimave,ndersa te lendumarve ju urojme sherim te shpejte.

133

10 Comments 3 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
May 28, 2012 · 🌐

postuar nga Admin

<http://www.zeri.info/.../vlera-zero-e-sulmeve-ndaj-pacollit/>

ZERI.INFO  
**Zëri • INFO - Opinions - Komente - Vlera zero e sulmeve ndaj Pacollit**  
(Sqarim për të përfunduarit) Jetlir Zyberaj E kam shumë të vështirë që çdo ditë ti tregoj Behgjet Pacollit, njeriut që prej Qeverisë së Kosovës është mandatar të sjellë njohje të reja, që endet nëpër vendet e largëta të Afrikë...


👍 38 9 Comments 3 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
May 29, 2012 · 🌐

U konfirmua qe Zv.Kryeministri Pacolli nuk kishte konflikt interesi;"<http://www.zeri.info/.../akk-mbyll-rastin-ndaj-pacollit.../>"... admin

ZERI.INFO  
**Zëri • INFO - Ditari - Politikë - AKK mbyll rastin ndaj Pacollit, s'ka konflikt interesi**  
Agjencia Kundër Korrupsionit ka mbyllur rastin pa konflikt interesi për Behgjet Pacollin, Zv/Kryeministër në Qeverinë e Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë dyshimin e bazuar për ekzistimin e...

👍 30 3 Comments

 **Behgjet Pacolli** ✓  
June 1, 2012 · 🌐

Perkrahim aksionin e KFOR-it per largimin e barrikadave ne veri te vendit ndersa ushtarve te plagosur ju deshirojme sherim te shpejte.

👍 71 4 Comments



Behgjet Pacolli

June 2, 2012 · 🌐

Interviste e Zv.Kryeministrit Pacolli per agjensine "Presheva Jone";<http://www.preshevajone.com/pacolli-pak-shume46-njohje.../>



PRESHEVAJONE.COM

**PACOLLI : Pak, shumë...46 njohje të shtetit të Kosovës, vinë nga ana ime**

Agjencia informative Presheva Jonë

👍 82

19 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

June 4, 2012 · 🌐

Z.Behgjet Pacolli dhuroj 100000 Franga Zvicerane ne RTK ne programin "NDIHMO EDHE TI" e qe i dedikohen Mitrovices.Keto mjete si dhe ndihmat tjera i beri ne emer te familjes se tij. admin



👍 412

57 Comments 16 Shares



Behgjet Pacolli

June 11, 2012 · 🌐

Qytetarve te Prishtines ,urime 11 Qershori Dita e Prishtines. admin



👍 43

5 Comments



Behgjet Pacolli

June 12, 2012

Urime dita e clirimit te Kosoves. admin

92

9 Comments



Behgjet Pacolli

June 12, 2012

"Çdo figurë politike që është paraqitur para qytetarëve për votë, ka përgjegjësi për të respektuar marrëveshjet dhe premtimet. Rasti me Presidenten, jo që është premtim, por është një marrëveshje e shkruar, e miratuar edhe në kuvend përmes një rezolute, përndryshe para qytetarëve do të dalim qesharakë dhe do të humbim besimin", ka thënë Pacolli, të hënën, për Express.admin

59

8 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

June 15, 2012

Zv.kryeministri Pacolli pjese e delegacionit te qeverise se Republikes se Kosoves ne vizite shtetore ne Arabine Saudite.admin



300

21 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

June 16, 2012



Ne kete foto te periudhes se luftes clirimtare eshte z.Selim Pacolli, vellau i z.Behgjet Pacolli.foto eshte postuar nga admin i faqes



4.2K

132 Comments 49 Shares



Behgjet Pacolli

June 16, 2012



Zv.kryeministri Pacolli pjese e delegacionit te qeverise se Republikes se Kosoves te prire nga kryeministri Thaqi ne vizite shtetore ne Arabine Saudite ne takim me Saud Bin Fejsal dhe zëvendësministrin e Jashtëm Abdulaziz Ibn Abdullah Abdulaziz.admin



222

17 Comments 10 Shares





Behgjet Pacolli

June 18, 2012



Zv.kryeministri Pacolli pjese e delegacionit te qeverise se Republikes se Kosoves te prire nga kryeministri Thaqi ne vizite shtetore ne Bullgari. admin



95

6 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

June 26, 2012



Turneu lobues vazhdon.Takime ne Pariz me perfaqesues te shteteve te Amerikes Jugore,vizite ne Baku Azarbeixhan takim me presidentin Ilham Aliyev...<http://www.zeri.info/.../pacolli-kerkon-njohjen-e.../>

ZERI.INFO

**Zëri • INFO - Ditari - Politikë - Pacolli kërkon njohjen e Kosovës nga Amerika Jugore**

Në kuadër të përgjegjësive shtetërore për sjelljen e njohjeve të reja për Kosovën, zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka zhvilluar në Paris të Francës, një drekë pune me përfaqësues të lartë të...



44

8 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

June 29, 2012



Vizita ne Azerbeixhan.Takime me zyrtaret me te larte te ketij shteti <http://www.kosovaitimes.net/?page=1,17,8362>

KOSOVATIMES.NET

**Azerbajxhani shumë shpejt do të shqyrtojë njohjen e Kosovës - Lajme - KosovaTimes**



26

6 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

July 2, 2012 · 🌐

...

Pershendesim vendimin e Grupit Drejtues Ndërkombëtar (GDN) për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë për Republikën e Kosovës. admin

👍 33



**Behgjet Pacolli** ✓

July 3, 2012 · 🌐

...

E pergezojme popullin amerikanë me rastin e shënimit të 236 vjetorit të pavarësisë së SHBA-ve. admin

👍 58

2 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

July 7, 2012 · 🌐

...

"Nuk mund ta them se kush ka bërë gabim. Unë dua të them se marrëveshjet duhet të respektohen" Admin

INFOKOSOVA.NET

**Pacolli: Nuk është dashur të pyetet Gjykata Kushtetuese**

Lexo më shumë...



👍 39

7 Comments

 **Behgjet Pacolli** ✓  
July 12, 2012 · 🌐


Postuar nga Admin.

---


INFOKOSOVA.NET 

**Pacolli: Deklarata e Jeremiqit i ngjan nacionalizmit hitlerian**  
Lexo më shumë...

 24 6 Comments 2 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
July 13, 2012 · 🌐

Në kuadër të përgjegjësiave shtetërore për lobim, zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli është duke qëndruar në Adis Abeba të Etiopisë, ku po ndjek nga afër punimet e konferencës së Unionit të Vendeve Afrikane. admin  
<http://www.kosovaitimes.net/?page=1,17,9556>

 25 2 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

July 16, 2012 · 🌐



Postuar nga Admin

See Translation

INFOKOSOVA.NET

**Pacolli takoj lider Afrikan në samitin që po mbahej në Adis Abeba**

Lexo më shumë...



👍 41

6 Comments



Behgjet Pacolli

July 17, 2012 · 🌐



Njoftim: Zëvendëskryeministri Pacolli ka takuar kryeministrin e Kenias, z.Raila Odinga

Të nderuar

Në vazhdim të turneut lobues të zëvendëskryeministrit të parë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Behgjet Pacolli, të hënën në mbrëmje ka qëndruar në Kenia ku është pritur në një darkë zyrtare nga kryeministri i këtij shteti, z. Raila Odinga.

Zëvendëskryeministri Pacolli, ka diskutuar me z.Odinga për zhvillimet politikë në Kosovë dhe procesin e njohjes së Republikës së Kosovës nga vendet Afrikane. Zoti Pacolli, ka kërkuar nga kryeministri Odinga shqyrtimin e njohjes së Republikës së Kosovoës, nga Kenia, në një periudhë sa më të shpejtë.

Sipas agjendës, turneu lobues i zëvendëskryeministrit Pacolli, sot në mëngjes ka vazhduar në shtetin e Togos, ku do të zhvillojë takime me autoritetet e larta të këtij vendi, ndërsa pasdite, zëvendëskryeministri Pacolli do të udhëtojë në Mali.

Zëvendëskryeministri Pacolli, ka uruar zonjën Dlamini-Zuma për zgjedhjen në krye të Unionit të vendeve Afrikane

Zëvendëskryeministri Pacolli, gjatë qëndrimit në Adis Abeba të Etiopisë, ku është mbajtur mbledhja e Unionit të vendeve Afrikane, ka shfrytëzuar rastin që të urrejë zonjën Nkosazana Dlamini- Zuma për zgjedhjen në krye të Unionit të Vendeve Afrikane.

Gjithashtu, nëpërmjet një letre zyrtare dërguar asaj, zëvendëskryeministri Pacolli, ka shprehur bindjen e tij se me ardhjen e zonjës Zuma në krye të Unionit të vendeve Afrikane, Republikës së Kosovës ti ofrohet bashkëpunim, në përkushtimin për të ndërtuar raporte diplomatike me vendet anëtare të kësaj organizate.

Më poshtë mund të gjeni tekstin e letrës që zëvendëskryeministri Pacolli i ka dërguar zonjës Nkosazana Dlamini- Zuma

E nderuar zonja, Nkosazana Dlamini- Zuma

Kam ndjekur nga afër votimin, në të cilin ju u zgjedhët në mënyrë demokratike për të udhëhequr Unionin e vendeve Afrikane, andaj më lejoni që në emër të popullit të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim personal, të ju shpreh urimet më të sinqerta për Ju, duke ju dëshiruar punë të mbarë në këtë mision tejet fisnik.

Zgjedhja juaj, në krye të këtij Unioni, ka një domethënie të veçantë jo vetëm për kontinentin afrikan. Me energjinë dhe

Jam i bindur se me zgjedhjen tuaj, me punën dhe energjinë tuaj në krye të këtij Unioni, do të fillojë një etapë e re, edhe për Republikën e Kosovës. Një periudhë, ku do të kemi një qasje konstruktive nga të gjitha vendet afrikane në raport me të drejtën historike të qytetarëve të Kosovës, për të konsoliduar shtetin në të gjitha aspektet. Republika e Kosovës, shtet i shpallur me 17 shkurt 2008 në koordinim të plotë me bashkësinë ndërkombëtare, është e përkushtuar që të fillojë marrëdhënie diplomatike me të gjitha vendet e Unionit Afrikan dhe gjithë botës. Republika e Kosovës deri më tani është njohur nga 91 shtete të botës, ndërsa edhe gjykata ndërkombëtare e Drejtësisë i ka dhënë legjitimitet shtetit tonë të ri.

Zonja Dlamini-Zuma

Me Ju personalisht dhe me shtetet e Unionit që Ju pëfaqësoni, shpresoj të kemi bashkëpunim në të gjitha fushat, për qka Kosova është shumë e përkushtuar.

Duke ju uruar shëndet dhe punë të mbarë

Sinqerisht

Behgjet Pacolli

Ish president i Kosovës,

Zëvendëskryeministër i parë i Qeverisë së Kosovës

admin.



38

7 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

July 18, 2012 · 🌐



Me rastin e afrimit dhe fillimit te muajit te shenjte;Te gjithë besimtarve myslimane ua uroj fillimin e muajit te shenjte te Ramazanit,paqeja,meshira dhe begatia qofte me ju dhe familjet tuaja. Paqi agjerim te kendshem.

👍 246

17 Comments 1 Share



**Behgjet Pacolli** ✓

July 22, 2012 · 🌐



Ngushllimet me te sinqerta per familjen dhe miqte e te ndjerit Ali Podrimja.

👍 70

1 Share







**Behgjet Pacolli** ✓

July 23, 2012 · 🌐



Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET

**Ideja ime për Veriun**

Lexo më shumë...



33

4 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

July 26, 2012 · 🌐



Agjenda per ditën e enjte, 26 korrik 2012;

Zëvendëksryeministri i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Behgjet Pacolli pret në një takim ministrin e jashtëm të Shqipërisë, z.Edmond Panariti. admin



17

1 Comment



**Behgjet Pacolli** ✓

July 28, 2012 · 🌐



Ju urojme shume suksese sportisteve shqiptare ne Lojerat Olimprike " Londra 2012".



109

8 Comments 1 Share



**Behgjet Pacolli** ✓

August 15, 2012 · 🌐

...

Ngushllimet me te sinqerta familjes dhe miqve me rastin e vdekjes se z.Arber Xhaferi. admin

👍 85

5 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

August 18, 2012 · 🌐

...

Me rastin e perfundimit te muajit të shenjtë të Ramazanit i përgëzoj të gjithë besimtarët muslimanë ,ndërsa atyre që agjëruan Zoti ua pranofte agjërimitin , poashtu ju urojë festën e Fitër – Bajramit.

👍 171

14 Comments 1 Share




**Behgjet Pacolli** ✓

August 22, 2012 · 🌐

...

interviste per RTV21(18.08.2012) <http://rtv21.tv/home/?p=93610> admin



👍 21

2 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

August 27, 2012 · 🌐

...

Të nderuar miq

Para disa ditësh, arriti nota verbale e njohjes nga Republika e Malit, e nënshkruar dhe e vulosur nga Presidenca e këtij shteti. Mali, siç e dini ka një qeveri kalimtare, dhe një president kalimtar, ndërkaq autoritet në këtë shtet është edhe ushtria që praktikisht kontrollon pushtetin brenda vendit dhe nuk ka kooperim në lidhje me Kosovën. Unë personalisht Malin e kam vizituar pesë herë prej ku kam marrë premtimin për njohjen e Kosovës. Problemet e brendshme që ka kjo Republikë kanë krijuar situata të paqarta pas arritjes së notës verbale të njohjes. Në këto momente unë gjindem në rajonin e Afrikës nga ku, kam kuptuar se situata ka ndryshuar pas intervenimit të ushtrisë së Malit në proces. Ne kemi pranuar notën verbale të njohjes dhe si të tillë e kemi publikuar, ndërsa çështjet e brendshme të këtij shteti apo të shteteve të tjera nuk na interesojnë.

Si rrjedhojë ne nuk jemi përgjegjës as nëse këto shtete ndryshojnë qëndrimet e tyre, si rezultat i problemeve të brendshme. Në Afrikë procesi i lobimit po vazhdon, ndërkaq rezultatet e afirmimit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare do të vazhdojnë të vijnë.

👍 197

44 Comments 2 Shares





Behgjet Pacolli

August 31, 2012

Vazhdon fushata lobuese ne Afrike.

<http://www.zeri.info/.../pacolli-ne-afrike-pritet.../>

ZERI.INFO

**Zëri • INFO - Ditari - Politikë - Pacolli në Afrikë, pritet rikonfirmimi i njohjes nga Mali**

Në kuadër të turneut të tij lobues në kontinentin e Afrikës, zëvendëskryeministri, Behgjet Pacolli ka vizituar disa shtete në rajonin e Afrikës perëndimore dhe verilindore. Sipas një njoftimi për media, thuhet s...

56

5 Comments



Behgjet Pacolli

September 8, 2012

Interviste per Interaktiv-KTV nga Z.Behgjet Pacolli

<http://www.kohavision.net/video/interaktiv/4655/>

KOHAVISION.NET

**BEHGJET PACOLLI - Zv. kryeministër i Kosovës - Interaktiv - Kohavision**

(Mos) njohja nga Mali

75

5 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

September 10, 2012

Përgëzoj të gjithë qytetaret e Republikës së Kosovës me rastin e përfundimit të mbikqyrjes ndërkombtare të pavarësisë së Kosovës, na mbetet ende shumë punë për të bërë na presin sfida te mëdha ne te ardhmen.

157

11 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

September 11, 2012

Solidarizohemi me popullin mik amerikan në kujtim të 11 shtatorit, urojmë që akte të tilla mos të ndodhin më.

85

2 Comments



Behgjet Pacolli

September 13, 2012

<http://www.zeri.info/.../pacolli-haraqija-me-kerkoi-3-6.../>

ZERI.INFO

### Zëri • INFO - Ditari - Politikë - Pacolli: Haraqija më kërkoi 3.6 milionë euro

Përmes një deklaratë për media Behgjet Pacolli ka shprehur indinjatën e tij për qarkullimin e dokumentit zyrtar e që sipas tij do të duhej të jetë i rezervuar. Ky reagim i Pacollit ka ardhur pas publikimit në media të lajmit...

38

7 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

September 14, 2012

Zv.Kryeministri Pacolli takoj presidentin e Irakut z Xhalal Talabani

<http://infokosova.net/.../7486-pacolli-kerkon-njohjen-e...>

INFOKOSOVA.NET

### Pacolli kërkon njohjen e Kosovës nga Iraku

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë një takimi me presidentin e Irakut, Xhalal...

40

9 Comments



Behgjet Pacolli

September 20, 2012 · 🌐

...

Zv.kryeministri Pacolli fillon takimet në New York

<http://www.botasot.info/.../pacolli-fillon-takimet-ne.../>



BOTASOT.INFO

### Pacolli fillon takimet në New York - Lajme - Bota Sot

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli është duke qëndruar në New York, për ti përcjellë nga afër punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, njofton zyra e tij për informim. Sipas kësaj komunikate, në ditën e parë të qëndrimit...

👍 45

2 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

September 20, 2012 · 🌐

...

Postuar nga Admin.



INFOKOSOVA.NET

### Butani mendon ta njohë Kosovën

Zëvendëskryeministri i parë i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, është duke qëndruar në N...

👍 24

4 Comments 2 Shares





Behgjet Pacolli

September 21, 2012 · 🌐



Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli ka takuar përfaqësuesin e përhershëm të Madagaskarit në OKB, z. Zina Andrianarivelo-Razafy.

Në vazhdim të qëndrimit të tij në Nju Jork, zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli ka takuar përfaqësuesin e përhershëm të Madagaskarit në OKB, z. Zina Andrianarivelo-Razafy

Zëvendëskryeministri Pacolli, njoftoi përfaqësuesin e Madagaskarit, me proceset në të cilat ka kaluar Kosova, që nga periudha e fillimit të viteve 90-ta, dhe evoluimproceseve të cilat rezultuan me shpalljen e pavarësisë me 2008.

"Ne jemi ballafaqur me gjenocid, që Serbia ka ushtruar ndaj nesh. Në Kosovë, shteti serb përveç krimeve të rënda që ka kryer, gjithashtu ka dhunuar gratë dhe vajzat tona, deri në momentin e intervenimit të botës demokratike. Kosova konform udhëzimeve të bashkësisë ndërkombëtare, ka ardhur deri tek shpallja e pavarësisë. Gjithashtu, konform planit të të dërguarit të OKB-së, z. Ahtisari ne kemi shpallur pavarësinë duke garantuar respektim të plotë të të drejtave të minoriteve. Vendimin tonë për shpalljen e pavarësisë, edhe GjND-ja e vlerësoi se Kosova se nuk ka rënë ndesh me të drejtën ndërkombëtare", ka thënë zëvendëskryeministri Pacolli.

Në anën tjetër përfaqësuesi i përhershëm i Madagaskarit z. Zina Andrianarivelo-Razafy, i konfirmoi zëvendëskryeministrit Pacolli se do të përpilojë një raport të studiuar mirë, që ndërlidhet me procesin e njohjes së Kosovës, dhe të njëjtin do ta përcjellë në kryeqytetin e shtetit të tij.

z. Zina Andrianarivelo-Razafy, dhe zëvendëskryeministri Pacolli u dakorduan edhe për takimin me presidentin e Madagaskarit që do të zhvillohet në ditët e ardhshme në Nju Jork. admin



👍 213

12 Comments 4 Shares





Behgjet Pacolli

September 22, 2012 · 🌐



Zv.Kryeministri Pacolli ka takuar përfaqësuesen e Singaporit në OKB

Në kuadër të angazhimeve shtetërore për lobim për shtimin e njohjeve të reja për Republikën e Kosovës, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, i shoqëruar nga konsullja e nderit e Kosovës në Tajlandë, Mom Luang Rajadarasri, ka takuar konsullen e Singaporit në Nju-Jork, Yuin-Lyn NG.

Gjatë këtij takimi, zëvendëskryeministri Pacolli informoi konsullen Lyn me zhvillimet aktuale politike në Kosovë, dhe proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë, veçanërisht në dhjetëvjeçarin e fundit të pasluftës.

“Ne sapo kemi përmbyllur procesin e pavarësisë së mbikëqyrur, që nënkupton që në përpikëri kemi respektuar zotimet para faktorit ndërkombëtar. Kemi respektuar plotësisht pakon e të të dërguarit të OKB-së, Marti Ahtisari, dhe i kemi treguar botës demokratike, se Kosova është e përkushtuar seriozisht të avancojë përpara”, ka thënë Pacolli.

Nga ana tjetër, konsullja Lyn është shprehur se shteti që përfaqëson ajo, ka përcjellë në vazhdimësi zhvillimet politike rreth Kosovës. Ajo ka shtuar se Singapori do të studiojë në mënyrë të detajzuar vendimin rreth njohjes së Kosovës. admin



👍 261

15 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

September 23, 2012



Priten lajme te rëndësishme nga Pacolli

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmiID=30231>



INDEKSONLINE.NET

### Priten lajme të rëndësishme nga Pacolli

Në vazhdim të qëndrimit të tij në Nju Jork zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli ka zhvilluar disa takime të rëndësishme nga Amerika Qendrore dhe Caricomi. Siç njofton zyra e...

60

2 Shares



Behgjet Pacolli is with Remzi Pacolli and Bekim Sejdiu.

September 24, 2012



Delegacioni i Kosoves ne takim me Ban Ki Moon



211

9 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

September 24, 2012

Zv.Kryeministri Pacolli pati takime me perfaqesuesit e shteteve nga Amerika qendrore dhe Caricomi

<http://botasot.info/.../pacolli-kerkon-njohjen-e-kosoves.../> admin

BOTASOT.INFO

### Pacolli kërkon njohjen e Kosovës nga tri shtete të reja - Kosova - Bota Sot

Pacolli është takuar me përfaqësues të Meksikës, Domenikas dhe Suriname. Në takime të ndara, zëvendëskryeministri Pacolli ka njoftuar gjërisht përfaqësuesit e këtyre tri vendeve për situatën aktuale politike në Kosovë,...

19



Behgjet Pacolli

September 24, 2012



268

10 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli  
September 24, 2012 ·



82

3 Comments 1 Share

 **Behgjet Pacolli** ✓  
September 24, 2012 · 🌐



136 3 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

September 24, 2012 · 🌐



NJOFTIM:Zv.Kryeministri Pacolli vazhdon aktivitetet në Nju Jork.

Të nderuar

Në vazhdim të qëndrimit të tij në Nju Jork të SHBA-ve, zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka marrë pjesë në mbrëmjen gala të organizuar nga OKB, "South to South".

Në këtë eveniment, kanë marrë pjesë më shumë se 100 përfaqësues të lartë nga shtete të ndryshme të botës, ndërsa fjalën kryesore e ka mbajtur sekretari i përgjithshëm I OKB-së, z.Ban Ki Moon.

Zëvendëskryeministri Pacolli i cili ishte i ftuar nderi në këtë ceremoni gala, gjatë fjalës së sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, u nderua me një vend në lozhën e nderit në mesin e dhjetëra presidentëve dhe kryeministrave.

Gjatë kësaj ceremonie, zëvendëskryeministri Pacolli shfrytëzoi rastin për të zhvilluar takime të drejtpërdrejta me udhëheqës shtetesh, si, me ministrin e punëve të jashtme të Cejlonit, Sudanit të Jugut, Mozambikut etj.

Gjithashtu, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli dha edhe një intervistë direkte me televizionin amerikan CNBC ku foli gjerësisht për proceset e rëndësishme nëpër të cilat po kalon Republika e Kosovës, pas përfundimit të pavarësisë së mbikqyrur. Pacolli ritheksoi edhe njëherë përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, për të ecur përpara në afirmimin dhe konsolidimin e shtetësisë së vendit tonë në arenën ndërkombëtare.

Sipas agjendës, zv.kryeministri Pacolli sot(e hënë) vazhdon takimet e parapara me kryeministrin e Antigua Barbudas dhe Lesothos.  
admin



179

9 Comments 7 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

September 26, 2012 · 🌐



Kryeministri Thaqi dhe Zvkryeministri Pacolli i Kosoves ne takim me Presidentin e Guinesë Ekuatoriale, Teodoro Obiang Nguema Mbasogo .



👍 224

18 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

September 26, 2012 · 🌐



Kryeministri Thaqi dhe Zv-kryeministri Pacolli kanë takuar ministrin e punëve të jashtme të Tanzanisë, Bernard Membe.



👍 154

9 Comments 4 Shares





Behgjet Pacolli

September 27, 2012 · 🌐



Zv-Kryeministri Pacolli vazhdon aktivitetet lobuese.

Në vazhdim të aktiviteteve lobuese për shtimin e njohjeve të reja për Kosovën, zv/kryeministri Pacolli ka takuar kryeministrin e Antigua Barbudas, Baldwin Spencer. të cilin e informoi hollësisht me zhvillimet aktuale politike në Kosovë, për procesin e përfundimit të suksesshëm të pavarësisë së mbikëqyrur dhe respektimin e plotë të planit të presidentit Ahtisari. Pacolli kërkoi nga kryeministri Spencer njohjen sa më të shpejtë të Kosovës, si hap me rëndësi drejt fillimit të ndërtimit të marrëdhënieve ndërshtetërore. Në anën tjetër, kryeministri Spencer, ka thënë se njohja e Kosovës, është në agjendën e shtetit të tij.



👍 172

12 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

September 27, 2012 ·

...

Zëvendës-kryeminsitri Pacolli takoi ministrin e punëve të jashtme të Seychelles z. Jean-Paul ADAM

Në vazhdim të aktiviteteve lobuese në Nju Jork, zëvendëskryeministri I parë I Qeverisë së Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka takuar ministrin e punëve të jashtme të Seychelles, z. Jean-Paul ADAM

Gjatë këtij takimi, zëvendëskryeministri Pacolli informoi ministrin Adam me zhvillimet aktuale politike në Kosovë, për procesin e përfundimit të suksesshëm të pavarësisë së mbikqyrur dhe procesin e njhjeve të Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Pacolli kërkoi nga ministri Adam njohjen sa më të shpejtë të Republikës së Kosovës, dhe fillimin e ndërtimit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet të dyja vendeve.

Në anën tjetër, kryeministri Spencer, ka thënë se vendi I tij nuk është kundër pavarësisë së Kosovës, ndërsaq njohja formale do të ndodhë shumë shpejt.

Zëvendëskryeministri Pacolli njoftoi ministrin Adam, se në kuadër të turneut të tij të ardhshëm në shtetet afrikane, në muajin tetor, do të zhvillojë edhe një vizitë në shtetin e Seychelles.admin



157

3 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

September 28, 2012 · 🌐




Zëvendëskryeministri Pacolli takoi presidentin e Beninit Yayi Boni

Në vazhdim të qëndrimit në Nju Jork, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli ka takuar presidentin e Beninit, z.Yayi Boni, njëherësh kryesues i Unionit Afrikan.

Gjatë bisedës shumë miqësore, zëvendëskryeministri Pacolli falenderoi presidentin Boni për angazhimin e tij personal dhe të shtetit të tij në drejtim të njohjeve të reja për Republikën e Kosovës.

Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Pacolli, mori premtimin nga presidenti Boni për vazhdim të përkrahjes deri në përmbylljen e procesit të njohjes së Kosovës nga të gjitha vendet afrikane. Sipas agjendës, zëvendëskryeministri Pacolli do të zhvillojë takime me delegacionet e Ganës, Domenicas, Lesothos etj.



👍 211

6 Comments 3 Shares

Behgjet Pacolli



**Behgjet Pacolli** ✓

September 28, 2012 · 🌐



Postuar nga Admin

See Translation

INFOKOSOVA.NET

**Zëvendëskryeministri Pacolli takoi presidentin e Beninit Yayi Boni**

Lexo më shumë ...



👍 29

2 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

September 30, 2012 · 🌐



Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli takoi ministrin e punëve të jashtme të Zambisë Në vazhdim të qëndrimit në Nju Jork, zëvendëskryeministri I parë I Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka takuar ministrin e punëve të jashtme të Zambisë z. Given Lubinda. Zëvendëskryeministri Pacolli njoftoi ministrin Lubinda me proceset politike nëpër të cilat ka kaluar Kosova veqanërisht pas shpalljes së pavarësisë me 2008. Gjithashtu, zëvendëskryeministri Pacolli njoftoi ministrin Lubinda edhe me vendimin e GjND-së dhe përfundimin e suksesshëm të pavarësisë së mbikqyrrur. Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Pacolli, kërkoi nga ministri Lubinda njohjen e shpejtë të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, ministri Lubinda tha se shteti I tij, nuk ka ndonjë arsye për të mos e njohur Republikën e Kosovës. Zoti Lubinda, ftoi zëvendëskryeministrin pacolli në një vizitë zyrtare në shtetin e tij, gjatë muajit tetor.

admin



143


2 Comments 3 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli ✓  
October 1, 2012 · 🌐

...

INFOKOSOVA.NET 

**Zambia s'ka përse të mos e njohë Kosovën**  
Lexo më shumë ...

 19

3 Comments



Behgjet Pacolli ✓  
October 3, 2012 · 🌐

...

Postuar nga admin.

INFOKOSOVA.NET 

**Gjyqësor po dështon duke punuar për "qejfin e politikës!"**  
Lexo më shumë ...

 28

7 Comments 6 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

October 8, 2012 · 🌐



Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET

**Zëvendëskryeministri Pacolli ftohet në Ugand për në përvjetorin e pavarësisë së këtij shteti**



 36

5 Comments



Behgjet Pacolli

October 10, 2012


Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli takoi kryeministrin e Kenyas, z.Raila Odinga

Në kuadër të vizitave në disa shtete të kontinentit të Afrikës, zëvendëskryeministri I Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka vizituar Kenyan, ku është pritur ng kryeministri I këtij shteti z.Raila Odinga.

Zëvendëskryeministri Pacolli informoi kryeministrin Odinga me proceset politike në Kosovë, me theks të veçantë për proceset e përmbyllura suksesshëm, përmbylljen e plotë të pakos së Antisarit, që rezultoi me përmbylljen e suksesshme të pavarësisë së mbikqyrur.

Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Pacolli, tha se njohja e shtetit të Kosovës nga të gjitha shtetet e botës, është vendim që respekton plotësisht të drejtën ndërkombëtare dhe vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, kryeministri Odinga, i konfirmoi zëvendëskryeministrin Pacolli se shteti i tij është duke e trajtuar me seriozitet njohjen e Kosovës, dhe në këtë drejtim rezultati do të bëhet public në të ardhmen e afërt.



260

21 Comments 11 Shares





Behgjet Pacolli

October 12, 2012 · 🌐

...

## Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli është takuar me kryeministrin e Ugandës, z.Amama Mbabazi



Behgjet Pacolli

Në vazhdim të vizitës në Ugandë, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli

është pritur nga kryeministri i këtij shteti, z.Amama Mbabazi.

Zëvendëskryeministri Pacolli dhe kryeministri Mbabazi kanë diskutuar

për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, nëpërmjet

intensifikimit të kontakteve ndërshtetërore.

Gjithashtu, zëvendëskryeministri Pacolli falenderoi kryeministrin

[See More](#)



38

11 Comments



Behgjet Pacolli

October 12, 2012 · 🌐

...

## Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli ftohet në vizitë zyrtare në Sudanin e Jugut dhe Burundi



Behgjet Pacolli

Me ftesë të presidentit të Sudanit Jugor, z. Salva Kiir Mayardit, zëvendëskryeministri i Kosovës, z.Behgjet Pacolli do të vizitojë këtë shtet, ditën e shtunë (me 13 tetor).

Zëvendëskryeministri Pacolli do të zhvillojë një takim me presidentin Mayardit dhe autoritetet më të larta të këtij shteti.

Kjo do të jetë vizita e dytë e zëvendëskryeministrit Pacolli në kryeqytetin Djuba, pas pjesëmarrjes në ceremoninë e shpalljes së pavarësisë së këtij shteti në vitin e kaluar. Gjithashtu, një takim me

autoritetet më të larta të këtij vendi, zëvendëskryeministri Pacolli bashkë me kryeministrin Hashim Thaqi patën zhvilluar në Nju Jork gjatë punimeve të asamblesë së përgjithshme të OKB-së.

Zëvendëskryeministri Pacolli ftohet në vizitë zyrtare në Burundi

[See More](#)



34

7 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

October 16, 2012 · 🌐

...

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli vizitoi Republikën e Burundit

Në vazhdim të turneut lobues në Afrikë, zëvendëskryeministri i Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka qëndruar në Republikën e Burundit, ku ka zhvilluar takime me autoritetet më të larta udhëheqëse të këtij vendi, presidentin, kryeministrin dhe ministrin e punëve të jashtme.

Gjatë këtyre takimeve, zëvendëskryeministri Pacolli edhe njëherë diskutoi për format e bashkëpunimit me shtetin e Burundit. Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Pacolli, kërkoi nga udhëheqësit më të lartë të Burundit marrjen e shpejtë të një vendimi për njohjen e Kosovës dhe fillimin e ndërtimit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve, edhe pse në këtë shtet lobi serb është shumë aktiv.

Ndërkaq, sot në mbrëmje(e martë), zëvendëskryeministri Pacolli do të udhëtojë për një vizitë të shkurtër në Kenya ku do të zhvillojë një darkë pune me autoritetet e larta të ministrisë së Punëve të jashtme. Kjo do të jetë vizita e dytë e zëvendëskryeministrit Pacolli në Kenya gjatë këtij turneu(pas vizitës me 10 tetor 2012).

Menjëherë pas kësaj darke, zëvendëskryeministri Pacolli do të udhëtojë në vendet e Afrikës Perendimore, ku fillimisht do të vizitojë shtetin e Kamerunit shtet ky l cili deri më tani ka mbajtur një qëndrim shumë refuzues ndaj Republikës së Kosovës.  
admin.

👍 72

12 Comments 1 Share



**Behgjet Pacolli** ✓

October 24, 2012 · 🌐

...

Zv.kryeministri vazhdon takimet neper Afrike <http://m.telegrafi.com/.../pacolli-takoi-presidentin-e...> admin.

M.TELEGRAFI.COM

### Pacolli takoi presidentin e Sudanit Jugor - Telegrafi Mobile

Pacolli ka diskutuar me presidentin Mayardit,për çështjet që kanë të bëjnë rreth lidhjes së marrëdhënieve ndërshtetërore në një periudhë sa më të shpejtë.

👍 65

4 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

October 25, 2012 · 🌐

...

Me fat Kurban Bajrami te gjithë besimtarve te fese islame.Paqja dhe meshira e Allahut qofshin me ju.

👍 964

56 Comments 1 Share

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli added a new photo — in Bujumbura, Burundi.

October 28, 2012 · 🌐

...

Nota verbale e njohjes nga Burundi



76

17 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli added a new photo — in Bujumbura, Burundi.

October 28, 2012 · 🌐



Nota verbale e njohjes nga Burundi

REPUBLIC OF BURUNDI

Bujumbura, 16th of October, 2012



MINISTRY OF EXTERNAL RELATIONS AND  
INTERNATIONAL RELATIONS

204.01/1331/RE/2012

To H.E Mr. Behgjet PACOLLI, Former  
President of the Republic of Kosovo and  
1<sup>st</sup> Deputy Prime Minister

IN PRISTINA

Subject: Recognition of the Republic of Kosovo

**Excellency First Deputy Prime Minister,**

I have the honour, on behalf of the Government of Burundi, to inform you that the Republic of Burundi has decided this Tuesday 17th of October 2012 to recognize the Republic of Kosovo as a sovereign and independent Country. The government of Burundi is looking forward to enhance the friendship relations and cooperation between our two Countries. The act of this recognition is herewith attached.

In this regard, please, First Deputy Prime Minister, accept my highest consideration.

THE MINISTER OF EXTERNAL RELATIONS AND  
INTERNATIONAL RELATIONS

Laurent KAVAKURE



👍 43

1 Comment 1 Share




Behgjet Pacolli added a new photo — in Bujumbura, Burundi.

October 28, 2012 · 🌐



Pranimi i Notes Verbale nga ministri i jashtem i Burundit ,Lauren Kavakure.



👍 135

4 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli  
October 31, 2012 ·

...

Interviste e zv.kryeministrit Pacolli ne RUBIKON  
KTV;<http://www.kohavision.net/video/rubikon/4911/>

KOHAVISION.NET  
BEHGJET PACOLLI - Rubikon - Kohavision



35

8 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli  
November 2, 2012 ·

...

Zv.kryeministri Pacolli vazhdon aktivitetet lobuese <http://www.zeri.info/.../pacolli-kerkon-njohjen-e.../> admin

ZERI.INFO  
Zëri • INFO - Ditari - Politikë - Pacolli kërkon njohjen e Indonezisë dhe Egjiptit  
Në kuadër të angazhimeve shtetërore për sjelljen e njohjeve të reja, zëvendëskryeministri i Kos...



91

9 Shares



Behgjet Pacolli  
November 7, 2012 ·

...

Fjala e zotit Behgjet Pacolli në konferencën Kosovë Shqipëri –Ku mbeti Ekonomia?



214

16 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

November 7, 2012 ·

Fjala e zotit Behgjet Pacolli në konferencën Kosovë Shqipëri –Ku mbeti Ekonomia?



243

17 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

November 20, 2012 ·

Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET

**Pacolli merr premtimin për njohjen nga Lesoto**

Gjatë këtyre takimeve, zëvendëskryeministri Pacolli ka informuar zyrtarët e Lesotos me progres...

77

6 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

November 23, 2012 · 🌐

...

Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET

**Behgjet Pacolli nderohet me titullin qytetar nderi i Korqës**

Në amfiteatrin e Universitetit "Fan Noli" mbushur me autoritete akademike, të zgjedhur lokalë,...



👍 74

9 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

November 23, 2012 · 🌐

...

Z.Behgjet Pacolli ne interviste live ne ORA News.

👍 95

11 Comments



**Behgjet Pacolli** ✓

November 23, 2012 · 🌐

...

Interviste e Zv.Kryeministrit Pacolli ne ORANEWS <http://oranews.tv/>



ORANEWS.TV

**Ora News - Te paret per lajmin e fundit**

Te paret per lajmin e fundit

👍 32

1 Comment 4 Shares





Behgjet Pacolli ✓

November 24, 2012 · 🌐



Intervista e plote e Zv.Kryeministrit Pacolli <http://botasot.info/.../pacolli-shqiptaret-de-jure-dy.../>

BOTASOT.INFO

**Pacolli: Shqiptarët de jure dy shtete, një de facto - Intervista - Bota Sot**

Numri dy i qeverisë së Kosovës ka hedhur idenë e bashkimit të shqiptarëve në të gjitha trojet e tyre përmes bashkimit ekonomik. Në një intervistë ekskluzive në RTV Ora News, në Tonight Ilva Tare, Behgjet Pacolli deklaroi s...



👍 43

5 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli ✓

November 25, 2012 · 🌐



Z.Behgjet Pacolli zgjidhet figure e ndritur e diasporës <http://www.botasot.info/.../pacolli-zgjidhet-figure-e-.../> admin

BOTASOT.INFO

**Pacolli zgjidhet figurë e ndritur e diasporës - Diaspora - Bota Sot**

Në mesin e 100 figurave të ndritura shqiptare nga diaspora, Behgjet Pacolli është zgjedhur një...



👍 109

3 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli ✓

November 27, 2012 · 🌐



Ndihem i nderuar te uroj te gjithë shqiptaret kudo qe jane me rastin e 28 nentorit : <http://www.zeri.info/.../pacolli-uron-shqiptaret-me.../>

👍 269

18 Comments 2 Shares

 Behgjet Pacolli is with Gëzim Zenel Millaku.  
November 28, 2012 · 🌐

28 Nentor 2012 Vlore Tirane



 542

13 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

November 29, 2012 · 🌐

Presidenti i AKR-së, z.Behgjet Pacolli përshëndet vendimin e Tribunalit të Hagës për lirimin e z. Ramush Haradinaj. Më poshtë mund ta lexoni të plotë deklaratën e AKR-së dhe presidentit z.Behgjet Pacolli

Aleanca Kosova e Re dhe Presidenti i saj z. Behgjet Pacolli, përshëndesin dhe urojnë lirimin e ish-Kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe bashkeluftetareve të tij z.Brahimaj dhe z.Balaj. Aleanca Kosova e Re, përshëndetë faktin se edhe nje here u rikonfirmuan vlerat e UÇK-së dhe u konfirmua se lufta e Kosovës, ishte luftë për liri dhe barazi për të gjithë qytetarët e saj. Drejtësia ndërkombëtare e tha fjalën e vet edhe një herë duke mbështetur aspiratat e popullit tonë për liri.

Urojmë familjen Haradinaj, Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës për kthimin triumfant të djalit, burrit dhe liderit të saj.

Z. Haradinaj ka qenë dhe do të jetë pjesë e rëndësishme e zhvillimeve në Kosovë dhe AKR përshendet kthimin e tij në kohën kur Kosova po kalon në periudha të rëndësishme të saj.

Nga:Admin



324

11 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

December 8, 2012 · 🌐

Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET

### Pacolli: Dominika do ta njoh Kosovën

Sipas një komunikate, konfirmimi ka ardhur gjatë darkës zyrtare që Pacolli ka zhvilluar me krye...



96

8 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

December 11, 2012 · 🌐

Të nderuar miqtë në mi në Facebook

Ashtu siq jeni të informuar vazhdimisht, unë jam duke vazhduar angazhimet e mija lobuese për shtimin e numrit të njohjëve për shtetin tonë të ri. Pas takimit të premtën me kryeministrin e Dominicas, mikun tim Roosevelt Skerrit, arriti edhe nota verbale e njohjes. Kryeministri Skerrit, e ka kuptuar drejtë qështjen e Kosovës, dhe në këtë drejtim ai, do ta vizitojë së shpejti zyrtarisht Kosovën.


Jam shumë i kënaqur me dinamikën e këtij procesi, dhe kam besim të madh që shpejt do ta arrijmë numrin prej 100 njohjeve. Dëshiroj gjithashtu, të shpreh një falenderim të veçantë edhe për miqtë tanë ndërkombëtarë, për ndihmën e pakursyer që janë duke na e dhënë.

Ju faleminderit për mbështetjen tuaj.



1K


107 Comments 21 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
December 17, 2012 · 🌐

Njoftim;  
<http://botasot.info/.../eulex-i-hedhe-poshte-kallezimin.../> admin

**BOTASOT.INFO**  
**EULEX-i hedhë poshtë Kallëzimin penal kundër Pacollit - Kosova - Bota Sot**  
Misioni i EULEX-it ka hedhur poshtë Kallëzimin penal të Agjencionit Kundër Korrupsionit e kishte depozituar kundër zëvendëskryeministrit të parë Behxhet Pacolli, dhe është mbyllur përfundimisht lënda e regjistruar si...

👍 129 13 Comments 3 Shares


 **Behgjet Pacolli** ✓  
December 17, 2012 · 🌐

Postuar nga Admin.

**INFOKOSOVA.NET**  
**Pacolli: lu kam thënë, jam i pastër**  
"Siç e kam thënë edhe atëherë ai kallzim penal ishte bërë për shkak të njëanshmërisë, mos pro..."

👍 149 9 Comments 10 Shares

*Viti 2013*







Behgjet Pacolli ✓

January 1, 2013 · 🌐

...

Gezuar 2013, shoket e mi ne facebook dhe twiter

BP



1.3K

94 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli ✓

January 6, 2013 · 🌐

...

Besimtarve te krishtere-ortodoks ju uroj kershendellat.BP



40

7 Comments



Behgjet Pacolli ✓

January 6, 2013 · 🌐

...

Intervistë e z.Behgjet Pacolli për portalin SwissInfo.ch

Zvicra është një shembull që duhet ndjekur

Zëvendës kryeministër i Kosovës prej prillit 2011, Behgjet Pacolli nuk i kursen energjitë për të arritur njohjen e pavarësisë së vendit të tij. Këtë hap e kanë kryer plot 98 kombe. Ai kërkon që Zvicrën, vendin e tij të dytë, ta kthejë në shembull për vendin e tij të origjinës.

Behgjet Pacolli, në formë të plotë dhe i rrezitur nën diellin afrikan, na priti në Swiss Diamond Hotel në Vico Morcote Lugano, hotel me pesë yje nën pronësinë e tij buzë liqenit të Luganos, pranë shtëpisë së tij.

Familja e zëvendës kryeministrit të Kosovës, gruaja e tij dhe katër fëmijët e tyre (i fundit, Armani, lindi para disa ditësh) jetojnë në Melide.

Swissinfo.ch: A mund të bëni një bilanc të 20 muajve tuaj të parë si I ngarkuar me lidhjet me jashtë të qeverisë tuaj? Si po ecin procedurat për njohjen e Kosovës?

Behgjet Pacolli: Deri më tash janë 98 shtete, prej të cilave 25 në Afrikë, të cilat e kanë njohur zyrtarisht Republikën tonë. Unë merrem personalisht me kontaktet me Afrikën, ku gjatë këtij një viti e gjysmë të fundit kam vizituar 48 shtete. Jam dashuruar në këtë kontinent, i cili jam i bindur se përfaqëson të ardhmen.

Megjithatë, deri më tash nuk kam arritur t'i bind qeveritë e vendeve të Afrikës së Veriut, ndërkohë që kam fituar pranimin e pjesës më të madhe të shteteve të Afrikës Lindore dhe të disa shteteve të Afrikës Qendrore. Po bëhem gati për një turne të ri që do të më çojë në Kenia, ku kam qenë më parë, në Tanzani, në Zambia dhe në Uganda. Kemi për të marrë edhe pranimin zyrtar të Afrikës së Jugut, ku jam pritur kohët e fundit nga kryeministri.

Në Evropë, vetëm Spanja – që përballet me kërkesat për pavarësi të Katalonjës – Sllovakia, Rumania, Greqia, Qipro dhe, merret me mend, Serbia dhe Rusia nuk na kanë njohur ende zyrtarisht. Në Azi ekzistojmë si shtet i pavarur për Malajzinë, Timorin Lindor, Japoninë, Korenë e Jugut, Papua Guinenë e Re, Zelandën e Re, Australinë dhe shumë shtete të tjera të Oqeanisë. Jemi në pritje të vendimit të Indonezisë dhe Tailandës, ku sidoqoftë kemi hapur një përfaqësi. swissinfo.ch: Në një intervistë që na dhatë në shkurt 2011, menjëherë pasi u zgjodhët president, ju thatë se donit “të forcohen lidhjet me Zvicrën”, vendin që ju ka adoptuar prej viteve 80-të dhe qytetar i të cilit jeni. Si do t’i quanit këto lidhje sot?

B.P: Janë solide. Të dy vendet e “mia” kanë raporte shumë të mira. Bashkëpunimi është shumë i mirë, dhe falë punës së shkëlqyer të ambasadores zvicerane Krystyna Marty Lang, Zvicra sot e kupton më mirë Kosovën. Vendi që më ka adoptuar duhet të shërbejë si shembull për ne. Do të uroja për një rritje të sektorit të shërbimeve sipas modelit zviceran. Megjithë një situatë ekonomike ende të vështirë – vlerësohet se përqindja e papunësisë lëkundet mes 30% dhe 40% - ne kemi një rini bukur të përgatitur, të gatshme të përballojë çdo sfidë për ta çuar vendin përpara.

Nuk e mohoj që mbetet shumë për t’u bërë. Mbi të gjitha, duhet nxitur ekonomia, duhen krijuar 35 mijë vende pune në vit. Duhet ta nënvizoj se jemi përmirësuar për sa i përket investimeve, dhe qeveria ime parashikon një ligj për të mbështetur investitorët në fushën minerare – mineralet janë një pasuri e madhe e Kosovës – nëpërmjet lehtësirave fiskale, si ulja e tarifave doganore dhe shtyrja e pagimit të taksave.

BOX

Hetimi mbi trafikun e organeve

Në librin e saj “Gjahu, unë dhe kriminelët e luftës” (2008), ish prokurorja e Gjykatës Ndërkombëtare Penale të Hagës, Karla Del Ponte deklaroi se ka mbledhur disa indicie në lidhje me një trafik organesh që duhet të ketë ndodhur në veri të Shqipërisë nga grupe kriminale që i përkisnin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Hetimi u bllokua për shkak të mungesës së bashkëpunimit të autoriteteve shqiptare dhe për një problem kompetencash territoriale të Gjykatës Ndërkombëtare Penale.

Pohimi ngriti shumë zëra. Këshilli i Evropës ngarkoi tiçinezin Dick Marty me detyrën për të përpiluar një raport mbi çështjen.

Ish parlamentari zviceran, i cili më parë ka qenë prokuror në Tiçino, heton në Beograd, Tiranë dhe Prishtinë. Në raportin e tij, të pranuar në Janar 2011 nga Këshilli i Evropës, Marty del në përfundimin se ka shumë indicie që duket se pohojnë denoncimin e Karla del Ponte. Marty akuzon kryeministrin kosovar Hashim Thaçi si një nga përgjegjësit kryesorë të trafikut të organeve. Viktimat duhet të kenë qenë kryesisht të burgosur luftë serbë.

Më 9 shtator 2012, prokurori serb për krime lufte Vladimir Vukçević shpalli se një ish luftëtar i UÇK-së kishte pranuar se kishte marrë pjesë në trafik, dhe se personalisht ka marrë pjesë në një operacion nxjerrje organesh.



Vetëm se raporti i Dick Marty nuk ka prova. Vetë Marty pohon se është bazuar mbi dëshmi dhe raporte me prejardhje nga shërbimet perëndimore të informimit. Ish parlamentari zviceran mundi të vizitojë vetëm dy prej vendeve të identifikuara si qendra burgosje të UÇK-së në Shqipëri. Hetimi i EULEX është ende në zhvillim.

E kontaktuar nga swissinfo.ch, Karla Del Ponte nuk reagoi ndaj akuzave të hedhura kundër saj prej Behgjet Pacollit në lidhje me hetimin e trafikut të organeve. Sa për Dick Marty, po ashtu i kritikuar ashpër, ai nuk ju përgjigj mesazheve të dërguara nga gazetari i swissinfo.ch.

swissinfo.ch: Më 2 dhjetorin e kaluar, qeveria juaj – e pasuar nga ajo shqiptare – kërkoi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale dhe në OKB hapjen e një hetimi kundër veprimtarisë së Karla Del Ponte gjatë kohës që ishte prokurore për krimet e luftës në ish Jugosllavi. Ajo qortohet se sajoi një akuzë të pabazë kundër ish kryeministrit kosovar Ramush Haradinaj, i gjykuar për krime kundër serbëve gjatë luftës, por i liruar nga secila akuzë kohët e fundit. Mos do ketë një ndeshje të re mes Behgjet Pacollit dhe Karla Del Pontes?

B.P: Si anëtar i qeverisë së Kosovës nuk mund të shprehem mbi këtë kërkesë. Ma merr mendja se prokuroja del Ponte gëzon imunitet për punën e saj në GNP, dhe ndoshta ka mundësi që kërkesa jonë për hetim, së bashku me atë të Tiranës, të mos ketë asnjë vijë mësi. Thënë kjo, duhet shtuar se shfaqësimi i shqiptuar nga GNP është një akt drejtësie. Ish kryeministri jonë ka luftuar për nëntë vjet kundër këtyre akuzave, vite gjatë të cilave është burgosur edhe pse i pafajshëm. Për qeverinë tonë ka rëndësi që opinioni publik ta dijë më në fund se si kanë rrjedhur ngjarjet.

Përballja ime me Karla del Ponten ka ndodhur rreth 15 vjet më parë, kur kishte hapur një hetim kundër meje me kërkesë të prokurorit të Moskës Yuri Skuratov, i cili po hetonte mbi ish presidentin Boris Jeltsin, i dyshuar për shpëlarje parash. Do të doja që një ditë të mund të flisja sy më sy me zonzjën del Ponte për këtë, por edhe që ta pyesja nga i erdhi ndër mend që të akuzonte kryeministrin tonë Hashim Thaçi për trafik organesh. Kjo është një akuzë shpifëse për popullin tim, e cila u rihodh në qarkullim nga Dick Marty, anëtar i Këshillit të Evropës, autor i një raporti mbi këtë çështje.

Po e përsëris, për popullin kosovar vetëm aludimi për trafik organesh është një fyerje e madhe. Para se të shqiptonte akuzat e saja, Karla del Ponte duhet të kishte verifikuar burimet e saja, të cilat në bazë të vëzhgimeve të kryera në vendndodhjet e përmendura duken se janë të pabesueshëm. Hetimi i hapur pas vendimit të asamblesë parlamentare të Strasburgut është ende në zhvillim e sipër, por jam i bindur se do vijë një ditë kur Dick Marty dhe Karla del Ponte do duhet t'u kërkojnë falje kosovarëve.

swissinfo.ch: Kohët e fundit ka pasur manifestime proteste nga ana e nacionalistëve serbë në vendkalimet kufitare mes Kosovës dhe Serbisë. Çfarë ere fryn mes dy shteteve?

B.P: Këto manifestime janë vepër e grupeve ekstremiste, dhe situata nuk është kaq dramatike sa e bëjnë mediet. Qeveria jonë ka kryer hapa gjigantë. Serbia

duhet tash ta rregullojë pozicionin e saj ndaj Kosovës, dhe tetë marrëveshje janë nënshkruar mes dy shteteve.

Dua edhe të nënvizoj se jo të gjithë serbët që jetojnë në veri të Kosovës janë kundër pavarësisë tonë. Kosovarët kanë nevojë për hapje ndaj botës, pra edhe ndaj Serbisë, dhe ne jemi duke punuar në këtë drejtim, për shembull nëpërmjet përmirësimit të rrugëve hyrëse. Kohët e fundit u hap autostrada që na lidh si me Shqipërinë ashtu edhe me Serbinë.

swissinfo.ch: Si përfundim, si e shihni të ardhmen politike të Kosovës?

B.P: Në bazë të Kushtetutës, presidentja Atifete Jahjaga mund të rrijë pesë vjet në detyrë. Por, në momentin e emërimit të saj, ajo kishte pranuar një marrëveshje me Partinë Demokratike të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe partinë time, në bazë të së cilës ajo do të tërhiqej nga detyra sapo të ishin përfunduar reformat kushtetuese. Tash i takon parlamentit të vendosë nëse presidentja duhet të japë dorëheqjen. Sidoqoftë, ajo duhet ta bëjë këtë kur reformat të zbatohen. Atëherë Kosova do thirret të votojë, dhe unë do jem atje.

SWISSINFO.CH

«La Suisse est un exemple à suivre»

Vice-Premier ministre du Kosovo depuis le mois d'avril 2011, Behgjet Pacolli n'épargne pas ses efforts pour obtenir la reconnaissance de son pays. Ce qu'ont déjà fait 98 états. Il souhaiterait que la Suisse, son pays d'adoption,...

80 9 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

January 11, 2013

Njohja nga Sao Tome dhe Principe, ka ardhur nga institucionet demokratike dhe legjitime të këtij vendi. Kryeministri i këtij vendi, z.Trovoada vitin e kaluar ka dërguar notën verbale, nëpërmjet të cilës shteti i tij, na informoi për njohjen. Njohja nga Sao Tome për ne është temë e mbyllur. Ne e kemi notën verbale që qeveria e këtij shteti ka marr vendim për njohjen e Kosovës. Dhe ne nuk komentojmë për gjendjen brenda këtij shteti.

272

30 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli is with Ismet Mulaj.

January 19, 2013 · 🌐



Ne Mitrovicë, me degën e AKR-së



👍 287

7 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

January 19, 2013 ·



Takimi me degën e AKR në Mitrovicë



188

4 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli is with Sylzen Muqaj.

January 19, 2013 ·



151

1 Comment 1 Share



Behgjet Pacolli is with Gëzim Zenel Millaku.

January 19, 2013 · 🌐



👍 447

17 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli ✓

January 21, 2013 · 🌐



Deklaratë e AKR-së lidhur me heqjen e lapidarit të UÇPMB-së në Preshevë.

Aleanca Kosova e Re, shpreh indinjatën dhe keqardhjen më të thellë ndaj veprimit të dhunshëm dhe të egër të qeverisë së Serbisë, të heqjes së memorialit të dëshmorëve të UÇPMB-së në Preshevë.

AKR vlerëson se me këtë akt jo human, shteti serb edhe njëherë tregoi se ndaj shqiptarëve të luginës së Preshevës vazhdon të përdorë mjetet e dhunës dhe diskriminimit, mjete këto të cilat i njeh më së miri.

Ky memorial, përmbante vetëm emrat e dëshmorëve të cilët u flijuan për lirinë dhe demokracinë e vet, vlerë të cilën e kërkojnë dhe ushqejnë shoqëritë e civilizuar. Shqiptarët kudo që janë, do të ruajnë respektin e përjetshëm për këta dëshmorë.

AKR e dënon fuqishëm këtë akt barbar.

Jemi të bindur se qytetarët shqiptarë të Luginës së Preshevës do të menaxhojnë në mënyrën më të mirë këtë situatë me pjekuri dhe do të vazhdojnë të mbajnë parimet e demokracisë si parime udhëheqëse për qytetarët dhe jetën më të mirë të tyre. AKR thërret bashkombasit e Luginës së Preshevës të mos bijnë pre e politikave shoviniste, të shtetit serb se këto politika i kanë ditët e numëruara dhe nuk sjellin asnjë të mirë as për popullin serb.

👍 266

37 Comments 9 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

January 30, 2013 ·

...

Të dashur miq, ju ftoj të jeni pjesë e këtij tubimi të përbashkët për vazhdim të rrugës sonë liberal-demokrate, për promovim dhe ngritje të vlerave të cilat ende të plota nuk i kemi në Kosovë. Zëri juaj dhe idetë tuaja janë dhe do të vazhdojnë të ngriten si pjesë e programit dhe punës së AKR-së. Ju që jeni pjesë e AKR-së, të vazhdojmë së bashku, ndërsa ju që do na bashkangjiteni, mirë se vini dhe ardhshi me këmbë të mbarë! Ju mirëpresim! BP

**AKR**  
ALEANCA KOSOVA E RE  
NEW KOSOVA ALLIANCE

**TAKIM ME TË RINJËT  
E PRISHTINËS**

**SALLA E KUQË**

**E SHTUNË 02.02.2013**

**ORA 13.00**

Forum Rinor-AKR

276

29 Comments 22 Shares



Behgjet Pacolli

January 31, 2013



Foto gjatë ceremonisë së shpalljes "Qytetar nderi" I Korçës



522

14 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

February 2, 2013



Ne zgjedhjet e forumit rinor te AKR-se ne Kamenice



505

9 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

February 2, 2013



U ndjeva shumë mirë në mesin e të rinjëve dhe të rejave të Kamenicës. Rinia është pjesë e rëndësishme e vizionit tim politik. Energjia e tyre po i jep hov zhvillimit dhe forcimit të AKR-së. BP

384

20 Comments 4 Shares





Behgjet Pacolli is with Gëzim Zenel Millaku.

February 3, 2013 · 🌐



Ne zgjedhjet e forumit rinor te AKR-se ne Kamenice



👍 505

9 Comments 6 Shares

# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli added 10 new photos.

February 5, 2013 · 🌐



👍 413

13 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

February 7, 2013

Vazhdon fushata lobuese per te sjelle njohje te reja e Zv.Kryemnistrit Pacolli.7 shkurt 2012

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli takoi kryeministrin e Cape Verdes José Maria Neves. Merr premtim për njohje të shpejtë

Të nderuar përfaqësues të medieve

Në kuadër të angazhimit lobues për shtimin e njohjeve për Republikën e Kosovës, zëvendëskryeministri z.Behgjet Pacolli, ka vizituar shtetin e Cape Verdes.

Zëvendëskryeministri Pacolli është pritur në një takim nga kryeministri i këtij shteti z. José Maria Neves me të cilin ka diskutuar për fillimin e ndërtimit të marëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet dy vendeve

Zëvendëskryeministri Pacolli ka njoftuar kryeministrin Neves me progresin demokratik të shënuar në Kosovë, që nga shpallja e pavarësisë me 2008 dhe në veçanti për procesin e dialogut Kosovë-Serbi, që po zhvillohet me ndërmjetësimin e BE-së.

Sipas z.Pacolli, fakti që Kosova dhe Serbia janë duke zhvilluar dialog për normalizimin e marëdhënieve, nënkupton pranimin e realitetit të ri dhe fillimin e një faze të re të raporteve ndërfqinjësore në rajonin e ballkanit.

Në këtë kontekst, z.Pacolli ka kërkuar nga autoritetet e Cape Verdes që të procedojnë me njohjen formale të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, kryeministri Neves ka vlerësuar angazhimin e zëvendëskryeministrit të Kosovës dhe ka premtuar se shteti i tij, shumë shpejt do të rreshtohet në radhën e vendeve që kanë njohur shtetin e Kosovës, duke pasuar me lidhjen e marëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve...



Jeton Shkodra and 402 others

26 Comments 17 Shares

# Behgjet Pacolli



**Behgjet Pacolli** ✓

February 16, 2013 · 🌐



Te gjithë qytetarve të Republikës së Kosovës kudo që jeni, urime 5 vjetori i lindjes së shtetit të pavarur.

👍 797

50 Comments 10 Shares



**Behgjet Pacolli** added 5 new photos.

February 17, 2013 · 🌐



Prishtine Sheshi "Zahir Pajaziti"



👍 557

18 Comments 19 Shares



5 vjet pas shpalljes së pavarësisë

100 vjet më parë, Konferenca e Ambasadorëve të fuqive të mëdha në Londër vendosi copëtimin e Shqipërisë. 5 vjet më parë, Kosova shpalli pavarësinë. Nuk janë lajme krejt pa lidhje me njeri tjetrin. Ka një tjetër konferencë të madhe ndërkombëtare, ajo e Parisit 1919, e cila konfirmoi vendimet e 1913. Duke ju referuar kësaj konference ku u diskutua gjithashtu për fatet e Shqipërisë dhe të Ballkanit, një nga arkitektët e paqes së sotme në Ballkan, ambasadori i ndjerë Riçard Hollbruk, shkroi diçka që i vendos në një farë lidhjeje këto dy ngjarje. Me fjalë të tjera ai tha se sikur vendimmarrësit e saj të dinin më shumë fakte për Ballkanin, mund të mos kishin ndodhur shumë luftëra dhe s'do ishte derdhur aq gjak.

Por historia është histori dhe ne politikanët duhet të shohim nga e ardhmja, pa e harruar atë. 5 vjet që nga shpallja i pavarësisë nuk janë vetëm moment festimi. Ato janë një moment shumë i mirë reflektimi për këtë etapë historike kur u vu në vend një padrejtësi e madhe në kurriz të kombit shqiptar që e kishte zanafillën 100 vjet më parë.

Meritat për pavarësinë.

Në reflektimet e mia për pavarësinë, veçanërisht në librin tim « Nga sfida në sfidë », konsideroj se dy janë protagonistët kryesorë të arritjen e saj :lëvizja paqësore e Presidentit Rugova, dhe vepra heroike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk ka në këtë vlerësim kurrfarë përpjekje për të pajtuar të papajtueshmen. Përkundrazi. Fakti që populli shqiptar i Kosovës, administrata shtetërore e tij i konsideron njëloj protagonistët e tyre, Presidentin Rugova dhe Adem Jasharin, ashtu si dhe datat që lidhen me këto dy Lëvizje të mëdha kombëtare, është tregues se brenda popullit tonë është arritur pajtueshmëri për kontributet gjegjëse të tyre.

Pse e kam arritur këtë përfundim ? Sepse në gjykimin tim, Lëvizja paqësore e Presidentit Rugova, ishte thelbësore në arritjen e një objektivi : ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Kjo mund të duket një fjalë goje sot, diçka shumë e thjeshtë, por bashkëkohësit e dinë se me sa shumë sakrifica u arrit ky ndërkombëtarizim, ndërsa regjimi i Milosheviqit e quante Kosovën si çështje të brendshme të Serbisë. Presidenti Rugova nuk e përfshiu Kosovën në aventura bashkë me republika të tjera të ish Jugosllavisë, sepse ai interpretonte në mënyrën më të zgjuar qasjen perëndimore ndaj krizës së ish Jugosllavisë. Edhe ngritja e një sistemi paralel vetëqeverisës si ide e tij ishte gjithashtu dëshmi e aftësive të shqiptarëve për të jetuar në mëvetësi. Erdhi një moment kur kjo Lëvizje paqësore nuk mund të çonte në pavarësim, nuk mund të ndalte genocidin, dhe lufta e UÇK-së, e përshpejtoi kohën, e rriti ndërgjegjësimin ndërkombëtar në nevojën e zgjidhjes së shpejtë të çështjes së Kosovës. Kjo luftë solli ndërhyrjen e NATO-s, së udhëhequr nga SHBA-të, pa të cilën s'do të ishim ku jemi. Sakrificat e kësaj ushtrie, të mbarë popullit shqiptar të Kosovës, reagimi ynë si komb ndaj genocidit, ku duhet të përmendim mikpritjen vëllazërore të

Shqipërisë, e shpëtuan Kosovën nga zhdukja dhe e vendosën zgjidhjen e çështjes së saj si prioritet absolut ndërkombëtar.

Mbi të gjitha, qoftë Rugova, qoftë drejtuesit e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës nuk ju shmangën një boshti strategjik : aleancës me perëndimin, që me miqësinë me Presidentin Uilson në 1919, pati një provë të fortë. Ishte kjo aleancë që e shpëtoi Kosovën, dhe që mbetet dhe sot garanci për forcimin e saj.

Proceset pas pavarësimit

Shpallja e pavarësisë së një shteti është si firmosja e certifikatës së lindjes. Atë duhet ta firmosësh në vendin e duhur që lindja të quhet e vlefshme botërisht. Prej vlefshmërisë së asaj certifikate vijon rritja, konsolidimi dhe pranimi i një shteti në familjen globale të tyre. Kështu ndodhi në 17 shkurt 2008 sërish me kshillimin e miqve tanë perëndimorë dhe drejtësia e shpalljes së 17 shkurtit u provua me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës. Prej asaj shpalljeje, prej rezolutës së Asamblesë së OKB-së, në 2010, është vënë në lëvizje një proces i pandalshëm i themelimit, konsolidimit dhe njohjes të shtetësisë së Kosovës. Në planin e brendshëm janë krijuar institucione shtetërore që funksionojnë normalisht ; po krijohet një sistem ekonomik i vetëmjaftueshëm pavarësisht sfidave që mbeten. Në planin ndërkombëtar, Kosova po arrin përkundër obstrukcionit serb dhe të ndonjë Fuqie të madhe, të sigurojë njohjen e saj në familjen e shteteve që do të kulmojë me anëtarësimin në OKB. Edhe negociatat që po zhvillohen në Bruksel, gjithmonë në këshillim me sponsorët ndërkombëtarë të pavarësisë sonë, janë njëlloj parathënie e këtij anëtarësimi. Nuk është e rastit që për herë të parë absolutisht, Serbia në gojën e krerëve më të lartë të saj po pranon mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në OKB, megjithëse ata shpallin publikisht kushtëzime. Pritet të shkrihen institucionet paralele të Serbisë në territorin e pandalshëm të Kosovës, dhe kjo nuk është një arritje e vogël në fare kaq pak kohë. Është pikërisht qasja udhërrëfyese e Rilindasve tanë, e Presidentit Rugova, e udhëheqësisë së Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, ruajtja me çdo kusht e aleancës me Perëndimin, ajo që na garantoj këto të arritura.

Pavarësia pa liri nuk funksionon

5 vjet pas shpalljes së pavarësisë në planin e brendshëm Kosova ka sfida të mëdha. Është treguar pjekuri e madhe me ruajtjen e njëmendësisë sonë, nëpërmjet shmangies së çdo konflikti të brendshëm ndëretnik, apo politik. Kjo duket qartë nga fakti se sot brezat e rinj të Kosovës konsiderojnë njëjtë si baballarë të pavarësisë, Ibrahim Rugovën dhe Adem Jasharin. Por këta breza duan jetë në mirëqenie dhe në paqe dhe ne ia kemi borxh atyre. Ka ardhur koha për një doktrinë të re të lirisë, të funksionimit të saj, sepse vetëm pavarësia pa liri, nuk çon në përparim.

Kjo doktrinë e re duhet të mbështetet mbi një strategji mbarëkombëtare zhvillimi. Kjo do të thotë se vendi ynë, Kosova duhet të ndërtojë prioritete zhvillimore në pajtim me ato të Shqipërisë, apo të kombit shqiptar kudo që jeton dhe të Bashkimit Europian ku duam të integrohemi. Vërtet Konferenca e Londrës 100 vjet më parë na ndau, por sot kur padrejtësia e saj është restauruar, ne na duhet të mendojmë për mirëqenien dhe përparimin tonë. Brenda modelit

të Bashkimit European ne duhet të krijojmë realitete ekonomike përplotësuese, hapësirë kulturore, akademike, tregëtare të përbashkët. Ne s'kemi ndërmend të ndryshojmë kufijtë jashtë qasjes perëndimore, SHBA-ve dhe Bashkimit European për rajonin. Por askush s'na pengon, madje na inkurajon për të krijuar një Hapësirë ekonomike të përbashkët, që do të funksionojë pse jo mbi bazë institucionale të fortë.

Një doktrinë e re zhvillimore, kërkon njerëz të rinj. Eksperiencia e çlirimit, dhe e këtyre 5 vjetëve ka konsumuar figura të caktuara që i janë referuar qoftë lëvizjes rugoviste, qoftë asaj çlirimtare për t'u provuar në pushtet. Qeverisja është diçka e komplikuar që nuk zhvillohet mbi bazë biografie, por mbi bazë aftësish teknike, të njohjes dhe zbatimit të ligjit, aftësish manaxheriale, etj. Ka ardhur koha që më të mirët e këtyre dy periudhave historike, të asaj të rugovizmit dhe asaj të luftës çlirimtare të thërrasin në skenë, djem dhe vajza të reja të mësuar bukur mirë në perëndim apo dhe brenda Kosovës. Ne duhet të justifikojmë angazhimin perëndimor në favor të pavarësimit të Kosovës duke treguar se Kosova mund të mbijetojë ekonomikisht, brenda suazave të shtetit ligjor, si një hapësirë ku respektohet ligji, luftohet krimi i organizuar. Ne i kemi aftësitë si popull, si komb, që t'ja shpërblejmë perëndimit dhe brezave të rinj, duke ndërtuar një Kosovë të re, të vetëmajftueshme, ku « dielli lind, atje ku perëndon », siç thoshin rilindasit tanë.BP

 221

9 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

February 19, 2013 · 🌐



Sonte në ora 20.15, presidenti i AKR Behgjet Pacolli, mysafir në emisionin "Target" në RTK nga admin.

 186

3 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
February 19, 2013 · 🌐



👍 466

21 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
February 20, 2013 · 🌐



## **NJOFTIM: Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli takon z.Fred de Graaf – Kryetar i Senatit të Mbretërisë së Holandës**



Behgjet Pacolli

Të nderuar

Sot në orën 11.00, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli pret në takim S.H.T.Z. Fred de Graaf – Kryetar i Senatit të Mbretërisë së Holandës

Takimi mbahet në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës, salla nr P35

*Nga ky takim, mediet mund të marrin vetëm pamje.*

[See More](#)

👍 45

3 Comments 2 Shares





Behgjet Pacolli added 4 new photos — with Jetlir Zyberaj in Prishtinë, Kosovë.

February 20, 2013 · 🌐



👍 393

10 Comments 14 Shares



Behgjet Pacolli ✓

February 20, 2013 · 🌐



Intervista e dates 19.02.2013 ne RTK TARGET

[http://www.youtube.com/watch?feature=player\\_embedded...](http://www.youtube.com/watch?feature=player_embedded...)



YOUTUBE.COM

Target-RTK: Behgjet Pacolli 19.02.2013

Target-RTK: Behgjet Pacolli 19.02.2013 <http://www.target.zemra.de>



👍 87

4 Comments 4 Shares



Të nderuar miq

Duke shfletuar shtypin në mbrëmje, meqë tërë ditën nuk pata mundësi ta bëja, e lexova lajmin se në renditjen botërore Kosova rangohet në mesin e 10 vendeve më të varfra të globit. Një gjë mjaft zhgënjyese. Zhgënjyese sidomos me ata që kanë udhëhequr këtë vend gjithë këto vite, që e udhëheqin Kosovën edhe sot, duke mos përjashtuar as veten time nga ky mes. U ndjeva vërtet keq. Në gjeografinë e Kosovës sime unë ecë shumë lirshëm dhe në të gjitha vendet publike ku jam prezent ndjej energjinë e rinisë tonë, rinisë së shkathët, pasionante dhe me shumë ëndërra të Kosovës. E shoh me admirim dhe thellë në vete e krahasoj atë me rininë e vendeve anë e kënd botës, atje ku unë shpesh udhëtoj.

Sinqerisht ju them se brengosem dëshpërimisht, sidomos kur sjell në mend faktin se është po kjo rini jona aq aktive e po aq shumë sfiduese. Sjell në mendje faktin se sa pak shtyerje i nevojitet që ata djem e vajza gjeneroze të vendit tim ta sfidojnë jetën, të krijojnë perspektivë dhe të ardhme për veten dhe familje e tyre. Sa e lehtë është ajo prekje, që i shtyen ata para, drejt horizonteve të jetës.

Në fakt, meqë jemi këtu dua të ndaj me ju edhe një detaj. Ajo që më së shumti më ka shtyrë që të bëj diçka kundër dëshirës time (është fjala për hyrjen time në politikë), ka qenë pikërisht kjo rini e jona. Unë edhe sot nuk mund të shikoj ardhmëri të sigurt për një vend si ky i yni, pa qenë e qartësuar, e sigurt dhe e qëndrueshme e ardhmja e rinisë së vet.

Statistikat thonë që nga bankat e shkollës çdo vit dalin 35-40 mijë të rinj të kualifikuar dhe të gatshëm për tregun e punës. Kjo është shifër e ëndrrave të shumë vendeve të botës. Kanceri modern i shoqërisë përëndimore sot konsiderohet plakja e përgjithshme e shoqërisë botërore. Paramendojeni cili do të ishte niveli i përkushtimit dhe kujdesit të tyre ndaj një rinie si kjo jona. Ndërsa Kosova, pavarësisht këtij thesari, problemin e të rinjëve që do të duhej të ishte prioritet i prioriteteve e ka shëndërruar në çështje të dorës së tretë, ndoshta edhe më larg. Është mëkat i madh, që interesi i cdo qeverie në Kosovë është përqendruar në interesin personal, klanor e partiak të subjekteve të ndryshme politike, dhe asnjëher tek komuniteti, tek të rinjët tanë. Interesat e komunitetit, përfshirë edhe rininë, janë lënë thjesht anash. Të harruar, larg nga prioritetet e kujdesit.

Siç ju thash, unë udhëtoj shumë dhe njerëzit me të cilët kontaktoj, më asociojnë kryesisht me biznesin dhe flasin për të duke shprehur të gjitha privilegjet dhe mundësitë e mira që një investitorë do të gëzonte nëpër vendet e tyre. E tek ne qfarë ndodhë...? Nuk duhet shumë mend për ta kuptuar. Thjesht më kujtohen gjithë ai kapital, ajo industri, ato objekte që me aq mundë e sakrificë u ndërtuan, ruajtën, e u kultivuan me djersën, mundin e sakrificën e veteranëve tonë, e të cilat ne sot i kemi shndërruar pa kurrfarë respekti në gërmadha të frikshme. A thua nga moskujdesi, mosdija apo mungesa e sinqeritetit? Çdo ditë që jam në Prishtinë, e shoh atë gërmadhë të Hotelit Grand, atë të Pallatit të Rinisë dhe

shumë hapësirave të tjera publike, edhe jashtë Prishtinës që sot janë, e i takojnë jo zhvillimit, por harresës sonë. Dikur ishin sinonime të mirëqenies dhe krenarisë së qytetarëve, sot objekte të frikshme që më shumë ngjajnë në fantazma.

Fabrika e sheqerit në Pejë, Kombinati "Emin Duraku", Metaliku, etj. në Gjakovë, Fabrika e radiatorëve, fabrika e Duhanit, e tekstilit në Gjilan, mos të flasim për gërmadhat e Trepçës, Brezovicës etj.

Unë shpesh druaj që edhe fiziku i tyre si objekte të jetë i kobshëm për jetën e vet qytetarëve. Paradoksale apo jo...? ato objekte mund të shndërrohen në strehë për tu droguar, prostituuar etj...pra te rrezikshme edhe për jetërat e fëmijëve tanë! Siç mund ta keni përcjellë, qështja e ketyre objekteve mbetet një RAST TIPIK i drejtësisë së politizuar dhe sinonim i interesave private të "fuqishmëve"ose inateve e xhelozisë apo fetishizmit për të grabitur. Cka ndodhë? Komunitetit i lihet një imazh i keq e qytetarët privohen nga e drejta e tyre për vende pune, e përfitime të tjera ekonomike ku këta të fundit do të përfitonin nga funksionalizimi i këtyre objekteve. Absurde,absurde! Edhe pse vonë, të vetmen rrugë dhe zgjidhje që sot ka qeverija e Kosovës është fillimi i menjëhershëm i reformave ekonomike,ta lër të qet në punën e vet e mos ta politizoj apo ta përdori si instrument gjyqësinë dhe të u hapet fusheveprimi njerëzve profesionistë që t'ia fillojnë punës për interesat e qytetarit. Apeloj tek njerëzit e "fortë"që vendosin për fatin e qytetarëve që të mendojnë në të ardhmen e të rinjëve tanë.Do të jemi më të dashur e më të respektuar për të tjerët vetëm nëse ngritemi ekonomikisht me punë të sinqert.Ky apel vlen edhe për gjithë ata që manipulojnë me qytetarin dhe të drejten e tyre legjitime për të vepruar me qëllim të sigurimit të mundësisë për jetë më të mirë dhe atyre që abuzojnë me detyrën e shenjtë zyrtare dhe me funksionin publik. Do të doja shumë që këto ditë të mbetura për qeverinë për të cilën unë punoj, të shërbejnë mbi të gjitha për implementimin e reformave të thella ekonomike dhe përfundimisht të jepen sinjale të shpresës për këta të rinjë dhe këtë shoqëri ndaj të cilës un jam përkushtuar seriozisht të cilës un i falem dhe të cilën unë shumë e dua.



Përgjigje e shkurtër për miqtë të Fb dhe komentuesit e shkrimit tim të mëparshëm.

Po mendohem të bëjë një përmbledhje në komentet e miqve në këtë kontekst. Ishte vonë, kur I lexova gati të gjitha, ishte ora 01.00 e mëngjesit. Unë kam aq respekt për të gjithë, sa që shkrimet ti bëjë vet e jo ndonjë këshilltar siç dikush aludon. Më tutje, më brengos situata e krijuar se në mbledhjet e qeverisë vendimet merren me miratimet e ministrave. Ne të Akr-së jemi shumë pak për të marrë ndonjë vendim në favor të programit tonë ekonomik i cili është i vetmi që do ti garantonte Kosovës rritje ekonomike mbi 8 përqind. Programi i akr-së është program për komunitetin (qytetarin) e jo për përfitime personale, klanore, partiake etj. Ne të Akr-së e kemi të pamundur të shtyejm përpara idenë dhe programin tonë pasi që neve na mungon forca politike. Këtu qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm që me votën e tyre të bëjnë zgjedhjen e duhur për vetën dhe fëmijët e tyre. Pse ne në qeveri;

Ju e dini si u nëpërkëmbë sinqeriteti im në rastin e presidencës. Mbas largimit tim nga ai post, pata kushtëzuar reforma zgjedhore dhe ligjin e Presidentit. Edhe kjo iniciativë tani po nëpërkëmbet nga njerëzit e "fortë". Unë u bëra viktimë, bashkë me bashkëpartiakët e mi dhe hyra ne qeveri vetëm e vetëm që Kosova mos të humb kohe në zgjedhje të tjera që prapë do të ishin maratonike dhe do të pengonin shtetndertimin. Vazhdimi i shtetndertimit ishte shumë me rëndësi në atë kohë duke parë obstrukcionet që i bënte Serbia. Punët specifike duhet të kryhen në kohë të duhur. Nëse dëshirojmë që ato të jenë të suksesshme. Unë poashtu kam qenë i bindur se kur është në pyetje interesi i qytetarit të gjithë (qeveria) do të jenë unanim. Edhe kjo nuk ndodhi. Doja shumë që të ndërmarim disa reforma si; ndërrimin e ligjit për privatizimit, funksionalizimin e "fast track-ut" në të gjitha instancat gjyqësore, për kontestet ekonomike (reformë e cila do të tërhiqte shumë investitorë të huaj), formimin e agjencionit kombëtar të participimeve ku në vend që të s' stërshiten asetet e Kosovës për shumë shumë të vogla, ato të shfrytëzohen si instrumente për krijimin e partneriteteve private publike, të krijohet agjensioni për gjeneratat e reja nga vetëm një përqindje e vogël nga të ardhurat e ndërmarrjeve të PPP. Programi i ynë do të lironte nga pagesa e doganave, lëndët e para dhe teknologjinë (ekonomike) duke kompenzuar me të hyrat nga taksat që derivojnë nga rritja ekonomike. TVSh do të paguhej vetëm pas realizimit e kurrësi përpara (pushim të taksave). Prioritar ishte edhe reformimi i agjencionit të promovimit të Investimeve. Programi i AKR parasheh jo shitjen e minierave por krijimin e kompanive të përbashkëta me investitorët e huaj (përmes PPP dhe agjencionit të participimeve) deri në zhvillimin e tyre (rritjen e vlerës në maksimum) e pastaj shitjen e tyre, duke mbajtur një pjesë (aksionet e arta-fuqinë rregullative).

Shikoni qka po ndodh me CEZ-in në Shqipëri!!!!. Përfundimisht, krijimi i ashtuquajtur i qarkut në bujqesi (Platformat agroekonomike). Shansi i kësaj të fundit është enorm i madh duke pas parasysh qka sot Kosova importon nga

vendet ku fuqia puntore, kapitali, transporti, taksat e lëndëve të para kushtojne deri tri herë më tepër se në Kosovë. Këtu, në bashkepunim me fermerët vendor(edhe të vegjëlit) do të fitonim primatin e prodhuesit dhe do të krijojmë shumë vende pune. Programi i AKR-së poashtu parasheh ofertën kosovare të shërbimeve jashtë Kosovës tek vendet në zhvillim siq është Afrika.

Afrika do të jetë destinacioni dhe përqëndrimi i zhvillimit ekonomik ku kosovarët do të gjenin veten, përmes ndermarrjeve të tyre. Dikush në Kosovë një iniciativë të tillë (ku ndermarrjeve kosovare u ishte krijuar mundësia të participojnë me shërbimet e tyre deri në 500 milion Euro) e denoncon (ju kujtohet Hasan Preteni)!!!!

Në rrafshin lokal komunat e Kosovës duhet të shndërrohen në shumë komuna të vogla ku administrata e njeh qytetarin e vet, ja njeh hallet e tij dhe qytetari aty realizon synimet e veta demokratike.

Nëse AKR do të fitonte në zgjedhje, do të krijojmë në qdo fshat që ka më tepër se 3000 banorë, një mini komunë me një staf të reduktuar por dinamike. Këtu shërbyesi është afër qytetarit. Kam punuar me një Fakultet të adm. publike në Zvicër(aty ku komuna është qeliza kryesore demokratike)dhe këtë eksperience do ta aplikojmë në Kosovë.

Kosova është ranguar për 28 vende në ranglistën e Bankës Botërore më mirë se kurrë më parë duke iu falënderuar programit të AKR ku ministrja Kusari (edhe pse me vështirësi) ka arritur ta implementoj pjesërisht. Ministri Makolli nga zeroja ka arritur të ndërlihdë në mënyrë dinjitoze Kosovën me Diasporën tonë shumë të vlefshme. Sa më përket mua, kam dhënë cdo gjë nga vetja ime për ti sjellur Kosovës njohjet që dikur ishin të paarrtshme. Cka është me rëndësi që ne, të AKR ecim kryelarte se kemi punuar me dinjitet, sinqeritet dhe pa lodhje. Si dhe sa është bërë ajo punë, qytetari i Kosovës do ta kuptojë. AKR është e gatshme të rrugëtoj edhe më tutje me partnerin e koalicionit por tani, sigurisht vetëm me një kusht; **AKR-së TI GARANTOHET FUSHËVEPRIMI DHE IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT TË VET EKONOMIK.** Dhashtë ZOTI kjo të ndodh, rezultatet do të jenë evidente.

Dikush komenton se unë harxhoj para të buxhetit të Kosovës. Jo,unë personalisht nuk marr madje as pagë nga qeveria. Financoj vet udhëtimet e mija, përdori makinën time private, bashkë me harxhimet dhe paguaj nga buxheti i im privat koston e lobimit.

Ju uroj qdo të mirë, secilit prej jush. B.P



Të nderuar miq

A e dini se për kompjuterat, për produktet e teknologjisë së informacionit dhe te komunikimit barra tatimore dhe doganore në Kosovë, ndryshe nga vende fqinjë, është më e larta ?

Kompjuterët trajtohen si mallrat e tjerë, pa dallim.

Unë do të luftojë tani që kjo të ndryshojë në Kosovë.

Sot Kompjuteri, laptopi e disa mjete tjera te komunikimit nuk janë vetëm instrument që shërben vetëm për formim profesional, por dhe kulturor, arsimor, teknologjik etj.

Kompjuteri, laptopi i shërben shumë të rinjve, në një vend si Kosova që ka papunësi të lartë. I shërben jo thjesht pse ai është mjet pune, por pse është kulturë, zhvillim, përparim.

A e dini se ne disa vende te rajonit bile nuk ka fare dogane , dhe TVSH -ja është shumë e ulët ? Kështu është. Çka i bën më dramatike këto fakte është diçka tjetër me karakter historik. Në kohën e ish Jugosllavisë për çdo gjë me karakter arsimor, kulturor, akademik, nuk paguhej doganë fare, ndaj aq më tepër në Kosovën tonë të pavarur nuk duhet të ketë masa doganore për këto produkte.

Kjo vetëm për të motivuar dhe për të nxitë edukimin dhe aftësimin e rinisë, që është resursi më i madh joni.

Të rinjtë tanë shumë të talentuar në Teknologjinë Informativë i blejnë kompjuterët në tregun e zi ose i blejnë në vendet fqinje, Maqedoni dhe Serbi. Pra ne, në një farë mënyre po e subvencionojmë tregun joformal. Pse mos ti lejojmë mjetet e komunikimit dhe të informatikës, të hyjnë e të qarkullojnë në Kosovë, pa doganë, pa TVSH. Do të ishte mirë se kjo shkon në favor edhe të edukimit më kualitativ të rinisë dhe do të shkonte edhe në favor të rritjes ekonomike. Do te krijonim mundësi që rinia te pasurohet me këto mjete që janë vitale për pregaditjen e tyre për sfidat e jetës moderne dhe të punësimit. Nëse ka oferte te kualifikuar të fuqisë intelektuale të punës, ka edhe oferte të shërbimeve që dmth ka veprimtari ekonomike nga të cilat përfitojnë të gjithë por edhe buxheti i Kosovës do të kompensonte, minimum të hyrat qe eventualisht humb për shkak të liberalizimit të importit të këtyre instrumenteve të dijës dhe të punës.

Sot për shkak të doganës së lartë dhe TVSH te pafavorshme, përfaqësitë e firmave prodhuese të kompjuterëve dhe mjeteve tjera të informatikës e komunikimit, kanë krijuar përfaqësitë e veta në vendet fqinje(jo në Kosovë)dhe nga aty punojnë dhe shesin mallrat e tyre të shumta në rajon por edhe në Kosovë. Kosovën e shfrytëzojnë vetëm si treg, e në anën tjetër Kosova nuk përfiton asgjë. A ju duket normale kjo?

A nuk është kjo diçka jashtë kohës, për një rini si e jona, që e do kompjuterin, i do teknologjitë e reja, dizajnin, internetin?

A do të vazhdojmë të veçohemi nga fqinjët që kanë ecur para nesh, dhe të jemi në shërbim të tyre dhe jo të vetes sonë siç ndodh me energjinë, me produktet bujqësore etj që dikur ne i prodhonim vetë dhe furnizonim të tjerët ?

Unë them JO dhe kam vendosur të propozoj ndryshime në kuadrin ligjor për këtë treg. E imagjinoj se kur janë vendosur këto kritere nuk është menduar aspak. Ka patur iniciativa të Odës amerikane të tregtisë, por zërin e saj nuk e ka dëgjuar askush.

Sot gjendja duhet të ndryshojë.

Me kompjuterë, me teknologjitë e reja, një i ri, administrata jonë, populli jonë fiton në kohë. Ecë shpejt drejt përparimit.

Shumë shpejt unë do t'i propozoj qeverisë liberalizim tërësor të tregut të teknologjisë së informacionit.

Ne e dimë se si pasojë e përfshirjes sonë në një sistem tjetër politik dhe shoqëror, jo të gjithë do të merren me prodhimtari, me bujqësi e blegtori. Do të merren dhe me ofrimin e shërbimeve. Per të bërë këtë duhet pregaditje, për këtë nevojiten mjete moderne te mësimi gjegjësishte të punës. Puna në sektorin e IT është punë në sektorin e shërbimeve. Sa më e madhe të jetë pjesa e shërbimeve aq më modern është një shtet.

Por nuk janë vetëm këto masa që do të propozoj të lirohen nga detyrimet tatimore por edhe tregun informatik në tërësi (softverin dhe hardverin) të cilat shërbejnë për ngritjen kulturore, arsimore dhe profesionale të rinisë sonë.

Unë pas kontakteve me grupet e interesit do të propozoj dhe masa kundër tregut të zi.

Dikush mund të thotë se ku do t'i gjejë qeveria paratë që do të humben nga mostatimi i këtij sektori ?

Unë them se do t'i gjenerojë nga zhvillimi që do të prodhohet, nga rritja e peshës së IT në ekonominë tonë. A e keni dëgjuar iniciativën e fundit të Microsoft-it, Youthspark, drejtori i të cilit për Europën u takua dhe me kryeministrin e Shqipërisë ? Të punësohen 300 milionë të rinj nëpërmjet ICT, (teknologjive te informacionit dhe telekomunikimit)

Ne duhet të bëhemi pjesë e këtyre iniciativave globale. Por më së pari duhet të miratojmë këto hapa që nënvizova më lartë.

Liberalizimi i tregut duhet të ndodhë dhe në dobi të institucioneve publike. Pjesa më e madhe këtij tregu sot është joformal. Institucionet tona sot shërbehen nga tregu joformal. S' duhet të ndodhë më si sot, kur prokurimi për shkak të administrimit jo të mirëfilltë, në fillim të çdo vitit kontraktin blerjen e kompjuterëve e shërbimeve tjera nga nje firme e caktuar pa kritere, nga firmat e ekonomisë joformale dhe te pa licencuara nga prodhuesit e prodhimeve qe trajtojnë ato. Shkurt, nga firmat qe mallin e tyre e sjellin pa dogane e TVSh dhe duke i anashkaluar ato me licence te rregullt, Institucionet tona paguajnë çmime shumë më të larta sesa ato të tregut. Paramendoni, derisa në gjithë botën (shembull) dyqanet e Apple janë përplot me klienta, në Prishtinë në të njëjtin dyqan pothuajse askush nuk shkon por në anën tjetër tek shitësit tjerë të palicencuar ka shumë tollovi. Madje edhe institucionet tona publike janë klient t rregullt të këtyre "tregëtareve" joformal. Të ashtuquajturit auditorët e këtyre fenomeneve nuk reagojnë fare.

E njëjta gjë ndodh edhe me biletat e udhëtimit të zyrtarëve tanë .Unë pata rastin ta kuptoja vetë këtë, kur një bashkëpunëtor imi- jo unë, sepse unë i paguaj vetë

biletat e mia, - iu desh ta blinte atë në treg. Ishte shumë më e lirë sesa bileta e blerë sipas formës standarte që përdorin institucionet.

Si përfundim : koha, rinia jonë s'na e fal që të mos hedhim hapa revolucionarë në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Kemi një rini të mrekullueshme, plot pasion për to, që mjerisht është në masë të madhe e papunë. Jemi një vend i varfër, por në qendër të Europës. Nese duam zhvillim ekonomik duhet te kemi njerëz të pregaditur. Pregaditja akademike e rinisë kosovare varet nga mundësitë reale që qeveritë krijojnë .

Pra të krijojmë mundësi sa më shpejtë për rinin tonë,të ja mundësojmë asaj bile ate që është e drejtë e tyre legjitime (edukim e pregaditje dinjitoze për sfidat e jetës).

 236

33 Comments 17 Shares



# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

March 1, 2013 ·



Vizite tek teqja e sheh Xhaferit ne Junik



695

43 Comments 14 Shares



Behgjet Pacolli

March 1, 2013



Sapo u ktheva nga teqja e sheh Xhaferit të ndjerë në Junik. Ishim për të pame me mikun tim të mire Naim Malokun që ne kto ane ka bërë histori si komandant i UÇK-se. Djemtë e sheh Xhaferit, shehlerë na treguan veprën e fundit të babës së vet: teqen e re! Një kryeveper ndërtimore, shpirtërore, me e madhja, më e bukura në Ballkan! Nesër vend kulturi për besimtarët dhe vizitash për turistët.

223

16 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

March 6, 2013



Filloi përkujtimi i Epopesë së UÇK-së, një nga dy shtyllat ku mbahet shtetësia e Kosovës së bashku me veprën e Presidentit tonë Rugova.

Çdo komb, çdo shtet themelohet mbi sakrificë. Është momenti të nderojmë familjen Jashari, që i dha shumë lirisë dhe pavarësisë sonë. Sakrificë e tyre me në krye Adem Jasharin, ka përcaktuar shumë në jetën time, në jetën tuaj, në jetën e të gjithëve ne. Kjo familje dhe sot mbetet një pikë referimi për shoqërinë tonë. Shtëpia e tyre në Prekaz është vend pelegrinazhi kombëtar, ku në çdo vizitë jam ndjerë i respektuar, por ne duhet t'u ofrojmë dhe diçka tjetër. Ndaj që herët kam propozuar që në Prishtinë, kjo familje, si dhe familjet e tjera të heronjve të kenë një shtëpi të tyre, ku të gjithë brezat të marrin mësimet e lirisë.

Tash që e arritëm lirinë dhe pavarësinë, na duhet ta përkryejmë atë me zhvillim ekonomik, me mirëqenie. Kështu nderojmë më mirë kujtimin e heronjve.

245

18 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli ✓

March 7, 2013 · 🌐



Të nderuar miq

Unë l lexoj me vëmendje komentet e miqve në facebook,

Për ata që kritikojnë dhe thonë se jam në qeveri, dhe pse se bëj këtë ose atë gjë,- përshembull heqjen e barrës tatimore mbi kompjuterat, për mallrat ushqimore, etj -, dëshiroj në detaje të ju them diçka

Së pari, unë kam një bilanc aktivitetesh të suksesshme në qeverisje- numri i njohjeve që l kanë ardhur Kosovës( gjë e cila ka ardhur edhe para se të jem në qeveri)

Së dyti, ka një fillim për çdo gjë, dhe unë s'mund të bëj menjëherë gjithçka, apo të jem në të njëjtën kohë, kudo, në Afrikë, Azi, Prishtinë, etj.

Së treti, unë s'jam kryeministri dhe nuk e përfaqësoj forcën më të madhe politike që të mund të bëj çfarë të dua . Nëse do ti kishim mundësi që të vepronim sipas programit politik dhe ekonomik që kemi ne, atëherë edhe mund të isha kritikuar me të drejtë, pse nuk i kthej premtimet në realitet.

Për kritikët dashamirës do të thoja: unë përfaqësoj një forcë politike që s'mund të vendosë shumëçka.

Unë jam në pushtet, por nuk kam gjithë pushtetin.

Unë do të bëj maksimumin që të realizoj ato që zotohem, të bind kolegët e mi. Nëse nuk i bëj, nëse nuk i bind, kjo s'varet tërësisht prej meje.

Nëse ju sot prisni më shumë prej meje, tash për tash më jepni më shumë mbështetje. Shkruani, ngritni zërin tuaj dhe bashkojuni publikisht iniciativave të mia !

Nesër me votën tuaj, më jepni më shumë mbështetje politike dhe le të shohim, a mund të realizoj ato që premtoj apo jo kur të kem më shumë pushtet, më shumë përfaqsim? Unë di ta mbaj fjalën dhe këtë e kam provuar !

Për kritikët e paarsyeshëm do të thoja, të mos bëhen si në atë meselen, çfarë uji i ke dhënë gomarit? Unë s'mund të jem i keq gjithmonë, pra dhe kur bëj vepra të mira, dhe kur s'më lënë të bëj vepra të mira ; dhe kur bëj thirrje për vepra të mira!

Unë nuk po them : më futni edhe njëherë në punë, se di unë si punoj ! Mua nuk më lanë të punoj sepse une dija të punoja. Për 35 ditë si President bëra shumëçka, dhe kjo ishte arsyeja pse nuk më lanë të vazhdoja akoma !

👍 412

90 Comments 12 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

March 9, 2013



Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET



### Pacolli: Deklaratat e Hysenit si të Jeremiqit

Lideri i AKR-së, Behxhet Pacolli i'u është përgjigjur akuzave të ish-Ministrit Hyseni për blerjen e...

121

13 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

March 15, 2013



Interviste dhene ne Rubikon me 14 mars

<http://www.kohavision.net/video/rubikon/5619/>

93

13 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

March 19, 2013 · 🌐



Të nderuar miq,

Gjatë fundjavës pata nderin të vizitorëve kantonin e Juras në Zvicërr, ku mu organizua një pritje shumë e ngrohtë nga kryetari i Komunës së Delemontit z.Pier Kohler, me të cilin bisedova konkretisht për mundësitë e zhvillimit të bashkëpunimit me komunitet e Kosovës.

Gjithashtu, në këtë qytet zvicëran pata rastin të takohem edhe me komunitetin shqiptar atje, me z.Xhevxhedin Ahmeti, z. Afrim Ramabaja dhe z.Luan Hajradinaj, të cilët i falenderoj shumë për mikpritjen.

<http://www.albinfo.ch/sq/node/22454>

ALBINFO.CH



### **B. Pacolli në vizitë në kantonin Jura**

Të premten në mbrëmje më 15 mars 2013 « Bashkësia Shqiptare », në restorantin « NEWBOR...



208

13 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

March 20, 2013



Zëvendëskryeministri z.Behgjet Pacolli ka takuar kryetarin e Asamblesë së Madhe të Turqisë, z.Cemil Çiçek  
Të nderuar

Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, z.Behgjet Pacolli ka pritur në një takim kryetarin e Asamblesë së Madhe të Turqisë, z.Cemil Çiçek.

Gjatë kësij takimi, zëvendëskryeministri Pacolli ka shprehur falenderimet e Qeverisë dhe popullit të Kosovës për rolin thelbësor që Turqia është duke luajtur në konsolidimin e shtetit tonë.

Gjithashtu, zëvendëskryeministri Pacolli ka bërë thirrje edhe për intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik, duke inkurruar ardhjen e sa më shumë investitorëve nga Turqia në Kosovë.

"Ne jemi mirënjohës për kontributin që keni dhënë për njohjet e Kosovës. Gjithashtu e vlerësojmë lartë interesimin e investitorëve turq për të investuar në Kosovë, dhe ne duhet të thellojmë edhe tutje këtë bashkëpunim. Kosova është vend i cili është shumë i përshtatshëm për investime dhe ne jemi të gatshëm për të përmirësuar edhe më tej kushtet", ka thënë Pacolli.

Zëvendëskryeministri Pacolli gjithashtu njoftoi kryetarin Çiçek për përkushtimin dhe gatishmërinë e institucioneve dhe spektrit politik kosovar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si alternativë e vetme që të dy vendet të ecin përpara në proceset integruese.

Në anën tjetër, kryetari Çiçek ka ripërsëritur qëndrimin e shtetit të tij, për të vazhduar bashkëpunimin dhe ndihmën për shtetin dhe popullin e Kosovës.



142

3 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

March 20, 2013



Marketingu diplomatik

Ligjërime e zotit Behgjet Pacollit në Kolegjin Pjetër Budi,  
Prishtinë, 20 mars 2013

Në jetën e një njeriu, në sjelljen e tij pavarësisht detyrës, angazhimit, privat, publik, ka disa fije të përbashkëta.

Ka disa çelësa që zërthejnë natyrën njerëzore, psikologjinë e njeriut. që e përbëjnë thelbin e saj,

dhe që nëse njihen, përmirësojnë marrëdhëniet ndërnjerëzore.

Kështu duke përmirësuar marrëdhëniet ndërnjerëzore, krijohen premisa që të shërbejnë për të përmirësuar marrëdhëniet mes shteteve dhe kombeve.

Kjo është lidhja kryesore që unë shoh ndërmjet diplomacisë dhe njeriut.

Gjatë këtij bashkëbisedimi me ju, unë do merrem pikërisht me këtë lidhje. Po e nis nga vetja, duke nisur nga eksperiencia ime personale.

Siç e dini unë kam udhëtuar shumë prej gati 40 vjetësh.

Kam mësuar shumë.

Kam negociuar shumë.

Kam negociuar në biznes. Kam negociuar shumë suksesshëm në biznes.

Kam negociuar në politikë. Kam negociuar shumë suksesshëm në politikën ndërkombëtare.

S'po dua të hyj në polemikë, me ata kritizerë qesharakë të aktivitetit tim lobues, të cilët kërkojnë gjoja të ndajnë të kaluarën time si ndërmarrës I suksesshëm, me atë si lobues I suksesshëm. Është qesharake, të ndash diçka që është thelbi I suksesit tim.

FJALA KYÇE është NEGOCIATË.

UNë di të negocioj.

Po për NEGOCIATA të suksesshme, cila është fjala kyçe, apo fjalët kyçe?

Janë disa koncepte, që janë në themel të teorisë së marketingut. Që unë i kam mësuar në

Universitetin e Hamburgut në vitin 1976 ku kam studiuar marketing ndërkombëtar dhe që I zbatoj shumë mirë në praktikë, prej më shumë se 40 vjetësh.

Kur unë negocioja suksesshëm në biznes, unë mundohesha të vihesh në lartësinë e bashkëbiseduesit tim. As me ndjenjë inferioriteti, as me ndjenjë superioriteti.

Koncepti i paritetit është i rëndësishëm. Nuk duhet ta shikosh bashkëbiseduesin me ndjenjën e inferioritetit, apo të superioritetit.

Unë krijoja empati me ta. Ndihesha si ata. Mundohesha të përjetoja ato që ata kishin përjetuar.

Njihja historinë e vendit të tij, shumë momente nga vendi i tij.

Isha i përqëndruar në bisedë.

Përqëndrimi është padyshim momenti im kryesor në negociatë, por dhe në marrëdhëniet njerëzore.

Kur unë kam qenë në shkollë të mesme, kisha vetëm një fletore ku mbaja shënime.

S'kisha mundësi të blija libra si shokët e mi, por isha shumë i përqëndruar. Arrija të kuptoja shumë që në klasë dhe ky ishte thelbi i suksesit tim në mësim.

Përqëndrimi im gjatë ligjëratës ka qenë momenti më crucial, unë i kam përjetuar leksionet në mënyrë logjike, si një përallë.

Pse nuk harrohen përrallat ? Sepse përjetohej. Ti fut shqisat në punë.

Pra, unë kuptoja më shumë nëse arrija të përjetoja atë që më komunikoj.

Kuptoja më shumë, nëse profesori që shpjegonte, më bënte të përjetoja temën që shpjegonte.

Pse ?

Ti mund të përqëndrohesh, por shumë varet dhe nga aftësitë komunikative të tjetrit.

Leonardo da Vinci ka qenë arkitekt i madh. Si i ka zhvilluar idetë e tij ? Duke përjetuar ! (rasti i dritës që bien në pasqyrë dhe reflektohet.)

Prej një përjetimi ai krijoi vepra të mëdha..

Të bësh të tjerët që të përjetojnë, është veti pedagogjike. Ke patur profesorë melankolikë, që s'kanë buzëqeshur, ti s e ke dashë atë dhe nuk e ke kuptuar.

Ti s ke mundur ta deshifrosh atë.

Ke një tip sanguinik, emocional. Ai profesor i fut gjithcka në funksion të suksesit të leksionit ; lëvizjen e duarve, zërin, buzëqeshjen. Janë instrumente për të zgjuar interes.

Profesor Faruku në histori e shpjegonte si notat e muzikës, me ulje ngritje.

Ai i matematikës s kishte psikologji.

Në psikologjinë industriale, kur flitet për prokurimin- rrethin e parë të marketingut, janë bërë studime mbi kriteret që të ketë një menaxher. Shumë prej këtyre kriterëve ndërtohen mbi ato që sapo thashë.

Gjithçka që po them lidhet me komunikimin njerëzor.

Negociatat apo bisedat diplomatike s'janë gjë tjetër veçse komunikim- kështu thonë dhe studiuesit e diplomacisë.

Marketingu diplomatik është marketing ndërkombëtar dhe në këtë kuptim, ti duhet të njohësh karakterin psikologjik të njerëzve që ke përballë, duhet të njohësh shoqërinë që ai i përket.

Janë disa mësimë që duhet të kesh parasysh gjatë një negociate diplomatike.

Të duhet pak kohë, për të ndërtuar një bisedë të suksesshme, gjatë të cilës ti duhet ta njohësh më mirë bashkëbiseduesin. Mundësisht duhet të lexosh rreth tij, përndryshe të përqëndrohesh shumë që ta njohësh në aq pak kohë sa të jepet mundësia.

Nëse ti ke kohë me e identifikuar se çfarë ënjeriu është, se cilës kategori psikologjike : Ti Di si ta ndërtosh bisedën ;

Mbi të gjitha, duhet të gesh atë temë, që e përfshin atë në bisedë.

Nëse ti ja arrin ta futësh tjetrin në bisedë, ke arritur gjysmën e suksesit.

Nëse ke një bashkëbisedues pragmatik, njeri që vjen në politikë prej biznesit, atëherë e fillon bisedën prej këndit të biznesit;

për ta futur tjetrin në bisedë, zgjedh temë nga biznesi.

Nëse ti e di që ky shtet ka resurset kryesore energjinë, ose naftën, atëherë bisedën e ndërton mbi atë temë. Duhet ta përfshish në bisedë ;

Nëse ai është i dhënë pas sportit, atëherë e fillon bisedën mbi bazë të sportit ;

Duhet ta sjellësh bisedën që ai të ketë nevojë ta vazhdojë bisedën me ty ;

Nëse ai e sheh se ai është lidhur me Kinën, ose me një vend tjetër, atëherë ti do zgjedhësh emrin e një miku që vjen prej atij vendi, që ta ndikosh atë ;

Pse ke shkuar ti në Afrikë ? për të siguruar njohje ?

Ti duhet ta trajtosh problemin tënd nga këndvështrimi i nevojave të tij ;

Nëse flasim për Kosovën, çfarë mund t'i shërbejë Kosova këtij vendi ? Mund t'i shërbejë Me rininë e talentuar, të përkushtuar ndaj informatikës, dizajnit informatik, gjuhëve të huaja ?

Ky është marketingu diplomatik ;

Ky është marketing i ndërtuar rreth njeriut ;

Marketingu ndërkombëtar duhet të ndërtohet mbi nevojat e palës tjetër.

Ky marketing ndërtohet mbi besimin.

Negociatat diplomatike ndërtohen mbi besimin.

Nëse ai nuk është, ai duhet të ndërtohet. Nëse ai nuk ndërtohet, atëherë nuk ka sukses diplomatik.

Ka dhe plot këshilla të tjera sesi duhet të silltet një diplomat gjatë negociatave :

Si duhet të qëndrojë trupi i tij ;

Sa larg bashkëbiseduesit ;

A duhet ta shikojë drejt në sy ?Po, por jo ama nëse kultura e vendit tjetër nuk e lejon.

Atëherë duhet treguar vëmendje.

Duhet ruajtur njëllloj distance, edhe nëse afrohet tjetri, nuk duhet të tërhiqesh ;

Duhet përdorur teoria e pasqyimit ; kopjimit të sinjaleve gjuhësore, të gjuhës së trupit, etj ;

Duhet të dish kur tundet koka ;

Gjeste jo të papritura,

Duhet përmbajtje në lëvizje të gjymtyrëve, etj.



Fola për nevojën e krijimit të ndjenjës së barazisë në negociatë. Si e realizoj këtë ?  
Shumë herët duhet ta përdor kartëvizitën e ish presidentit të shtetit. Për tu vendosur në pozita të barabartë me një president ;

Diku ku vlen si çelës për të ndërtuar një bisedë të mirë dhe rezultative, e kaluara ime si ndërmarrës i suksesshëm, do të përdor atë kartvizitë virtuale. Dikush thotë, mos e përdor.

A janë në rregull këta njerëz që gjoja kuptojnë konfliktin e interesit ?

Me një kryeministër përdor kartvizitën e zëvendëskryeministrit.

Le të bëhem praktik dhe t'ju ilustroj me shembuj këtë që sapo thashë.

Presidenti i Beninit një vend që e ka njohur Kosovën më foli për nevojën e dëshpëruar që ata kishin për të siguruar përfshirjen në Programin e Sfidave të mijëvjeçarit që organizojnë SHBA-të.

I thashë se ne kemi marrëdhënie të mira me SHBA-të. I thashë se SHBA-të do të bënin diçka.

Komunikova me Sekretaren e Shtetit të SHBA-ve. Ajo i shkroi Presidentit të Beninit, dhe më në fund Benini u përfshi në atë program.

Kjo ishte një ndihmë që Kosova ja dha një shteti afrikan.

Ne kemi emëruar një konsull nderi në Benin.

Të njëjtën gjë kemi bërë dhe në Ganë.

Dhe çfarë kemi marrë në këmbim ?

Konsulli i nderit ja dedikon Kosovës një ndërtesë në Benin E njëjta gjë ka ndodhur dhe në Tajlandë.

Afrikanët janë të kufizuar për udhëtim. Ata kërkojnë privilegje. Unë në emër të Kosovës mundohem t'ja siguroj.

Shikoni unë nuk jam diplomat profesionist, por kjo s' do të thotë se nuk kam arritur suksese.

Nga leximet e mia, nga marrëdhëniet e mia me Akademinë Diplomatike të Londrës, kam kuptuar shumë rreth diplomacisë britanike.

Diplomacia britanike nuk është e njëjta si në Indi, si në Indonezi, si në Namibi.

Diplomatët britanikë adaptohen sipas modelit shoqëror dhe politik të vendit ku punojnë, kushteve të vendit.

Ata e njohin mirë psikologjinë e vendit ku punojnë

Pse Komunuelthi ka patur suksese ? ; sepse ka patur shumë njerëz që kanë punuar për një kohë të gjatë në vende të ngjashme ;

Dikë që ka punuar në Australi nuk e çojnë në Afrikë ;

Diplomacia britanike është e sofistikuar.

Ajo ndërtohet mbi psikologjinë e vendit ku operon.

Diplomatët duhet patjetër të studiojnë dhe psikologji, ose të marrin kurse psikologjie.

Këshilltarët e mi, më sollën shembullin e dështimit të negociatave të paqes së Kemp Dejvidit në SHBA midis Izraelit dhe Palestinës në vitin 2000.

Pse dështuan ato ? Sepse ai model zgjidhjeje që i dukej shumë i mirë diplomatëve në zyrat e tyre, nuk ngjau i tillë për dy palët në konflikt, nuk respektoi ndjeshmëritë e tyre psikologjike.

Pse në pajtimin e konflikteve shpesh ndikon shumë kërkesa e faljes ? Edhe ky është një moment psikologjik shumë i rëndësishëm jo thjesht individual, por kolektiv. Ja pse Serbia duhet të kërkojë falje si parakusht për pajtim me Kosovën.

Në fund të ligjërimit bashkë, do t'ju jap disa linke të lidhjes së momentit psikologjik me diplomacinë. Janë shumë artikuj që do ju ndihmojnë.

Diçka mbi llojin e diplomacisë që unë bëj.

Do flas shkurtimisht dhe për diçka tjetër. Siç dihet unë merrem kryesisht me lobimin për njohje.

Më saktë kjo është ajo që dihet, pse unë s'kam mundur, ose s'kam ditur të shes shumë mirë atë çka unë bëj.

A e dini përshembull se aktualisht në Prishtinë, ka delegacione të pafundme nga Nigeria ?

Unë po përpiqem të fuqizoj marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve.

Nigeria është një vend shumë i madh në Afrikë, i cili ofron oportunitete të jashtëzakonshme për disa prej ndërmarrësve tanë.

Afrika sot është kontinenti i të ardhmes së ekonomisë botërore.

Jap se atje ka gjithmonë udhëtime, të ndërmarrësve të mëdhenj botërorë.

Dhe unë nuk e kam parë lobimin thjesht si sigurim të njohjes.

Shumë prej atyre që lexojnë lajmet për lobimin, mendojnë se lobimi është thjesht marrje e një trofeje- nota verbale dhe kaq.

Kjo është dritëshkurtër.

Nesër një vend që të ka dhënë një notë verbale, dhe ti s'ke marrë asnjë kontakt tjetër, mund dhe të mos votojë pro teje për anëtarësimin në OKB.

Unë po bëj diçka shumë të madhe në lobimin tim.

Unë po bëj atë që një studiues e ka quajtur « nation branding ». Po citoj një studiues i cili thotë se ndërsa në globalizëm kemi një prirje të përgjithshme që të ngushtohen dallimet midis vendeve, vende të caktuara mundohen të theksojnë, të marketojnë diferencat e tyre.

Nation branding është të vlerësosh, të ndërtosh, dhe të manaxhosh reputacionin e një vendi.

Unë mundohem ta bëj këtë për Kosovën.

Unë po krijoj markën e Kosovës në botë. A mund të imagjinonte dikush se Kosova, ndërmarrësit e saj, të rinjtë e saj mund të vendosin një lidhje të caktuar biznesi, me një vend afrikan ?

A mund të imagjinojnë përshembull studiuesit e kafeneve në Kosovë, këtë aktivitet timin, për të cilin nëse nuk pres dot falënderime, të paktën të mos marr kritika ?

Këtë unë bëra në Nigeri, dhe mora shumë kritika qesharake.

Nga forcimi i marrëdhënieve ekonomike, apo në fusha të tjera, edhe vota pro nesër, në OKB, është e sigurt. Trofeja-nota verbale sot nuk është garanci gjithmonë për votën nesër. Madje dikush dhe mund ta mohojë dhe vetë notën siç ka ndodhur në ndonjë rast dhe kjo nuk është dramatike.

Dikur kam thënë se stili im i lobimit, do të studiohet në universitete. Ngjan mungesë modestie, por ka shumë elementë origjinalë që janë në bazë të suksesit tim, gjegjësisht të Kosovës.

Është përzierja e këtyre cilësive, diçka që është origjinale.

Diçka origjinale, është diçka që prej perëndisë, prej vetes, nuk e kanë shumë njerëz.

Ja një pasqyrë e këtyre cilësive :

Është e kaluara ime si ndërmarrës i suksesshëm në një pjesë të rëndësishme të botës ;

Janë cilësitë e mia karakteriale- besimi që di të imponoj tek bashkëbiseduesit;

Shpirti që investoj në to ;

Ndërtimi i negociatave sipas nevojave të tjetrit ;

Krijimi i empatisë me tjetrin ;

Ndjenja e barazisë me bashkëbiseduesin ;

Investimi i burimeve të mia materiale, ekonomike, njerëzore në favor të Kosovës.

Etj.

Në përfundim.

Do ju lutesha të shikonit sesi sillen miqtë e mi afrikanë me mua. Do ju ftoj ndonjëherë të asistoni.

Më duan shumë, sepse thonë : nga lëkura jam i bardhë, zemrën e kam si të tyre.

Kjo në fakt nuk është shumë e vërtetë :

unë mundohem t'i kuptoj mirë të gjithë bashkëbiseduesit e mi, pavarësisht ngjyrës së lëkurës.

Ky është kyçi i suksesit tim.

Unë di të komunikoj shumë mirë. Unë i njoh mirë bashkëbiseduesit e mi.



167

11 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

March 21, 2013



Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli merr pjesë në mbledhjen e këshillit të Sigurimit të OKB-së. Zëvendëskryeministri i Kosovës z.Behgjet Pacolli ka udhëtuar për në Nju Jork të SHBA-së, ku së bashku me kryeministrin Hashim Thaçi do të marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Gjithashtu, gjatë qëndrimit në SHBA, zëvendëskryeministri Pacolli do të zhvillojë një numër takimesh në funksion të shtimit të numrit të njohjeve për Republikën e Kosovës.

admin

210

7 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

March 23, 2013



Perkrahim iniciativen e forumit rinor te AKR-se per te dhuruar gjak per ti ndihmuar ata qe kane nevojë.

<http://www.botasot.info/.../shtate-vjetori-i-themelimit.../> admin

BOTASOT.INFO



**Shtatë vjetori i themelimit, AKR e shënon duke dhuruar gjakë - Kosova - Bota Sot**

Me rastin e 7-të vjetorit të themelimit të Aleancës Kosova e Re dhe me rastin e 14 vjetorit të fil...

128

4 Comments 4 Shares



Nga Behgjet Pacolli

President i AKR-së

Sot isha në Mitrovicë dhe përveq objekteve kapitale që janë duke u ndërtuar në atë pjesë, bashkë me kryeministrin vizitua edhe familjen e Ali Kadriut në pjesën veriore të qytetit.

Përveq të tjerash qytetarët tanë atje i mundon gjendja e rëndë ekonomike dhe për këtë dua të shpreh shqetësimet e mija të thella. Qeveria e Kosovës tani është duke përfunduar proceset e rëndësishme për ardhmërinë e Kosovës, në veçanti për ardhmërinë e qytetarëve të Mitrovicës. Mitrovica ka ardhmëri vetëm si tërësi, pa kufizime dhe kërkon perspektivë për një jetë më të mirë.

Ashtu siq e thash më lartë Kosova është duke përfunduar një proces shumë të rëndësishëm të normalizimit të marrëdhënieve me shtetin serb. ky proces, gjithashtu do të hap rrugë edhe për zgjidhjen e një numri problemesh të mëdha që rëndojnë tash e sa vjet qytetarin tonë.

Si do të zgjidhen me Serbinë problemet e të zhdukurve, pensioneve, pasurive të përbashkëta, çështjet e, rrymës, telefonisë, njohjes së diplomave, patentave, etj? Me luftë ? Jo, për fat, koha e luftës ka mbaruar. Armët kanë heshtur dhe bisedimet mbeten rruga e vetme. Ballë për ballë dhe vetëm ne me ta? Jo, sepse s'do të arrinim sukses, por me praninë e miqve apo të një ndërmjetësi të ndershëm. Do e kisha lutur këdo të mos imagjinojë një europian apo një amerikan si shërbyesin tonë duke na i zgjidhur këto çështje dhe duke biseduar me Serbinë.

Është kjo arsyeja kryesore pse unë sot jam pro bisedimeve. Punët tona duhet t'i zgjidhim vetë dhe jo të tjerët. Kur na ndihmojnë është shumë mirë, por dhe vetë duhet të bëjmë diçka. Ndaj në 2 prill kryeministri i Kosovës, gjegjësisht Kosova po shkon në raundin e fundit të bisedimeve me Serbinë, ku tema kryesore do të jetë arritja e një marrëveshjeje. E bëj këtë saktësim, sepse siç po provohet se në Bruksel nuk po flitet për një status për veriun, nuk ka autonomi, nuk ka Republika Srpska në Kosovë. Pra nuk ka një marrëveshje mbi baza territoriale, por një marrëveshje mbi bazë individësh, qytetarësh : ajo do të vlejë për qytetarët serbë të Kosovës.

Unë jam zëvendëskryeministër i parë i qeverisë së Kosovës, dhe jam informuar rregullisht për këto bisedime, megjithë do përralla që janë thurur për të kundërtën. Kam marrë pjesë dhe në një seancë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ballëpërballë me delegacionin serb të nivelit të lartë, dhe kemi shkëmbyer dhe disa fjalë me zyrtarët e lartë të këtij vendi, pa ndërmjetësinë e dikujt.

Parashikimi im për bisedimet me Serbinë

Këtu mbërritëm tek një tezë e paradokohshme e imja. Ndoshta ishte dhe e parakohshme, por koha mua më dha të drejtë. Thashë asokohe në 2007-ën se ne do të bisedonim me Serbinë sërish, dhe në vendet tona, me ose pa ndërmjetsimin ndërkombëtar. Asokohe dikush ma mori për të madhe, por më duket se koha i dha të drejtë kësaj teze time. Unë nuk bëra ndonjë shpikje, por thjesht u

mbështeta mbi disa gjëra që duhet të diheshin dhe nga ata që më kundërshtuan. Bisedime kanë bërë gjithmonë shtetet apo kombet që kanë qenë në luftë me njeri tjetrin. Mes tyre lufta ka lënë gjithmonë probleme për t'u zgjidhur, që lidhen me qytetarët, me të vrarët, të humburit, me pronat, me ndarjen e pasurisë së përbashkët, etj.. Nëse s'kanë shanse për sukses nga negociata dypalëshe, atëherë thirren në ndihmë miqtë, apo ndërmjetës të paanshëm. Por dikur dhe ndërmjetësit lodhen, dhe ne duhet t'i zgjidhim disa sende vetë.

Në këtë parashikim timin nuk kishte kurrfarë profecie. Nuk kishte sjellje pragmatike partiake. Si pragmatik dhe i pasinqertë do duhej të thoja se « nuk do duhej të bënim kurrë bisedime me Serbinë », dhe mbase askush s'do të ma merrte për të madhe, por do të më duartrokisnin. Unë thjesht thashë me zë të lartë, diçka që të tjerët mbase e mendonin. Nuk e bëra këtë parashikim për kurrfarë ndjenje të veçantë ndaj serbëve : 14 pjesëtarë të rrethit tim të afërt janë vrarë prej tyre, dhe njëri vëlla imi ishte në radhët e UÇK-së, etj. Thjesht nuk fola si një politikan, por si njeri realist. Dhe ja ku mbërritëm sot kur krerët e institucioneve i zënë vendin njeri tjetrit për të bërë bisedime me serbët.

Janë dhe disa arsye të tjera pse unë jam për bisedimet. Por dhe kam disa ide plotësuese rreth tyre.

Disa ide rreth bisedimeve dhe disa sugjerime.

1. Ne po bisedojmë me Serbinë sepse ne kemi probleme me të. Po të mos kishim probleme, nuk do bisedonim. Nuk mund të shkojnë të bisedojnë të tjerët, me Serbinë, miqtë tanë përshembull të cilët s'kanë problemet tona me ta. Është pak mburravecëri që të mendojmë që hallet tona për të zhdukurit, për krimet e luftës, për pasuritë tona, për pensionet, për kadastrat, etj, t'i diskutojë me Serbinë, një mik yni amerikan, apo anglez, apo francez. Ne nuk jemi qendra e botës, që hallet tona të na i zgjidhin të tjerët. Për më shumë pse duhet t'i shmangemi këtyre bisedimeve kur në krahun tonë qartë dhe hapur janë miqtë tanë ?

2. Bisedimet janë dëshmi e rritjes së forcës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një shtet i dobët ka frikë nga bisedimet. Bisedimet janë afirmim i mëtejshëm i shtetësisë sonë. Ato po provohen si dëshmi e kësaj force dhe prej gojës së vetë politikanëve serbë. Kryeministri Daçiq, ka thënë ditët e fundit se faktorët ndërkombëtarë me peshë nuk janë në krahun e Serbisë ; se ne po diskutojmë me gjithë bashkësinë ndërkombëtare dhe jo me Kosovën, etj, etj. Me përfundimin e tyre, bisedimet politike të nivelit të lartë, do të ndihmojnë dhe njohjet.

3. Bisedimet janë parathënia e integritit të Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare, gjegjësisht në OKB, sipas Kartës së të cilës, problemet zgjidhen me bisedime. Ne po zbatojmë një rezolutë të OKB-së duke hyrë në bisedime. Fundi do jetë me siguri, anëtarësimi në OKB.

4. Bisedimet janë mundësi që Kosova të harxhojë tash e tutje më shumë energji tek probleme reale dhe të rëndësishme brenda vendit dhe jashtë tij, dhe jo tek marrëdhëniet me Serbinë. Këtë gjë dua t'ja them dhe opozitës, e cila gjithqysh e ndihmon qeverinë me rolin e saj kritik për bisedimet. Ne të gjithë, pra dhe opozita duhet të merremi dhe me problemet e tjera të Kosovës, me papunësinë

e të rinjve, me zhvillimin ekonomik, me spitalet tona, me bujqësinë, blegtorinë, dhe jo të improvizohemi të gjithë diplomatë. Pse ? Kosova ka jo vetëm një qeveri të përgjegjshme në këto bisedime, por dhe miq të sigurt. Le t'i lemë improvizimet, se miqtë që na ndihmuan për arritjen e lirisë, do na mbështesin dhe tash. Le t'a lemë përsëritjen e vazhdueshme të fjalisë se « marrëveshja duhet të respektojë Kushtetutën e Kosovës ». Harrohet se Kushtetuta e Kosovës është Kushtetuta që ka brenda të gjithë konventat dhe traktatet ndërkombëtare më të rëndësishme, si ato për liritë dhe të drejtat themelore, për autonominë lokale, etj. Çfarë marrëveshje do kishte nëse dy palët do thonin se marrëveshja duhet të respektojë Kushtetutën tonë ? Për fat Kushtetuta jonë nuk do ndërrojë, por do ndërrojë Kushtetuta e Serbisë. Por dhe nëse ndërronte e jona, nëse ne fitonim shumë prej marrëveshjes pse të mos e ndryshonim ? Mjaft që ndryshimet të ishin sipas Konventave ndërkombëtare.

Pas këtyre gjykimeve mbi dobinë e bisedimeve, do shtoja disa propozime të miat.

Çfarë forme do të ketë Marrëveshja përfundimtare ? Është folur për një traktat paqeje, por dyshoj se Serbia do të pranojë një formë të tillë. Kësisoj Serbia do të na pranonte zëshëm dhe që sot se jemi shtete të barabartë. Për më shumë traktatet e paqes zgjidhin si rregull probleme kufitare, dhe ne s'kemi asnjë problem kufitar që duam ta diskutojmë me Serbinë .

Miqtë tanë ndërkombëtare sugjeruan në fillim të bisedimeve modelin e marrëveshjes midis dy Gjermanive. Dy shtetet e dikurshme në vitin 1972 kapërcyen problemet kryesore mes tyre, ndërsa Gjermania Lindore u bë anëtare e OKB-së në 1973 me nënshkrimin e këtij Traktati . Megjithëse dy shtetet nuk e njihnin formalisht njeri tjetrin si të tillë, dhe as nuk e pranonin me shkrim këtë gjë, prapëseprapë ata nënshkruan një dokument që ishte traktat i vërtetë. Disa prej kolegëve tanë e refuzuan një propozim si ky, që vinte prej miqve tanë gjermanë, mbështetësve tanë më të angazhuar në këtë proces mes vendeve të BE, duke keqkuptuar ngjashmëritë e dy situatave. Unë jam thujse i sigurt se asnjeri prej tyre nuk e ka lexuar kurrë këtë marrëveshje. Në mënyrë krejt populiste ata gjoja u shqetësuan nga paralelizma në situatat gjegjëse : asaj ndërgjermane dhe asaj mes nesh dhe Serbisë. Ne s'duam t'i ngjajmë atyre në asnjë rrethanë dhe madje as nuk i ngjajmë në shumë rrethana. Ne thjesht na duhet që Serbia të heqë dorë paqësisht nga pengesat që na vendos në rrugën tonë të zhvillimit dhe të integritimit ndërkombëtar. Marrëveshja midis dy Gjermanive jep saktësisht këtë zgjidhje duke qenë kështu një model i mirë dhe megjithëse miqtë tanë ndërkombëtarë nuk po e quajnë kështu çka po arrihet në Bruksel, po shkohet mesa duket tek një tekst i ngjashëm.

Problemi kryesor i kësaj marrëveshje kryesore politike, ashtu si dhe marrëveshjeve të tjera miratuar në Bruksel siç duket do jetë zbatueshmëria e tyre. Që një marrëveshje të zbatohet, do duhet të miratohet nga kuvendet gjegjëse një Tekst kuadër (Traktat në të vërtetë) e cila të përmbajë referenca për të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani. Në të, do duhet të parashikohen si zgjidhen konfliktet e keqinterpretimit të tekstit, arbitrimi, ankimimet në rast mosrepektimi të saj, etj, etj.

Dhe më në fund, që kjo marrëveshje të gjejë zbatim do duhet të parashikohet dhe diçka tjetër, që lidhet me një propozim tjetër të kahershëm timin : duhet miratuar shpallja e një zone të lirë ekonomike për regjionin e Mitrovicës, që do duhej të përfshinte dhe Vushtrinë, apo ndonjë regjion tjetër me shumicë shqiptare. Kjo zonë e lirë ekonomike do prodhonte shumë interesa ekonomike të ligjshme mes qytetarëve të dy etnive, dhe do të forconte lidhjen e qytetarëve serbë të Veriut me shtetin e Kosovës.

Dhashë disa konsiderata për bisedimet me statusin e kryetarit të Aleancës për Kosovë të re, por pse jo dhe të qytetarit. Kjo që po ndodh sot është historike, dhe ne duhet të lemë gjurmë me mendimin tonë për këtë proces.

 125

20 Comments 8 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

March 30, 2013 · 🌐



Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET



### Behgjet Pacolli uron besimtarët të Krishterë për festën e Pashkëve

Në emër të partisë që unë drejtoj dhe në emrin Tim personal, kam knaqësinë që të gjithë besi...

 78

5 Comments 2 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

March 31, 2013 · 🌐



Të gjithë besimtarëve katolikë ju uroj festën e Pashkëve.

Paqja, dashuria dhe begatia të ju përcjell juve dhe familjeve tuaja. bp

 146

7 Comments 3 Shares





Behgjet Pacolli

March 31, 2013 ·



AKR në Mitrovicë



311

8 Comments 7 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

April 2, 2013

Postuar nga Admin.



INFOKOSOVA.NET

**Pacolli: Aty ku ka pasur dorë AKR-ja, qeverisja më e dinjitetshme**

Kryetari i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli ka kërkuar më shumë fushëveprim nga Partia D...

116

2 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

April 7, 2013

AKR nominon z.Ismet Ibishi kandidat për Kryetar Komune në Podujevë

<http://www.akr-ks.eu/articles/393>



AKR-KS.EU

**AKR**

Në takim morën pjesë Presidenti i AKR-së, z.Behgjet Pacolli, zv/Presidentja znj. Mimoza Kusari Lila si dhe anëtarë të kryesisë nga qendra.

56

2 Comments



Behgjet Pacolli ✓

April 7, 2013 · 🌐



Shaban Ademi zgjedhet Kryetar të Degës së Fushë Kosovës

<http://www.akr-ks.eu/articles/394>



AKR-KS.EU

**AKR**

Aleanca Kosova e Re, sot mbajti Kuvendin Zgjedhor të Degës së Fushë Kosovës, ku të pranishëm ishin edhe Presidenti i partisë, z.Behgjet Pacolli, si dhe anëtarë të tjerë të Kryesisë nga qendra.

👍 49

3 Comments



Behgjet Pacolli ✓

April 8, 2013 · 🌐



Gjate nominimit te z.Ismet Ibishi kandidat për Kryetar Komune në Podujevë



👍 203

7 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli ✓

April 9, 2013 · 🌐



<http://gazetaexpress.com/?cid=1,13,108415>

admin

GAZETAEXPRESS.COM



### Presidenti për shantazhe - Politika - Gazeta Express

Vendimi i PDK'së, AAK'së dhe Vetëvendosjes për të vazhduar zgjedhjen e Presidentit përmes K...

👍 92

1 Comment 3 Shares



Behgjet Pacolli ✓

April 11, 2013 · 🌐



Pse dua që Presidenti të zgjidhet nga populli ?

Nga Behgjet Pacolli

Ditët e fundit, në formën e një prove, dhe kurrfarë iniciative të rregullt legale, është lëshuar ideja për t'u rikthyer në zgjedhjen e presidentit nga parlamenti.

S'dua të merrem me ata që e mbështesin këtë ide, por me vetë idenë, me pasojat e saj.

Dua të tregoj pse unë vazhdoj t'i mbetem fuqishëm prapa idesë së zgjedhjes së presidentit nga populli.

Iniciativa që presidenti të vazhdojë të zgjidhet nga parlamenti është një provokim serioz, ndaj dua të reagoj, duke i paralajmëruar autorët kësaj iniciative për aventurën ku duan të fusin Kosovën.

Arsyet pse unë e kundërshtoj këtë iniciativë, që të rikthehem tek zgjedhja e presidentit nga parlamenti, do t'i ndaja në 4 grupe.

## Arsyet morale

A i duket dikujt e moralshme që në mënyrë të njëanshme të hamë fjalët, të mohojmë një marrëveshje kaq të rëndësishme dhe legale, në pikat e saj themelore duke menduar që populli nuk e kupton dhe nuk shqetësohet për këtë ? A nuk ju kujtohet sesa mirë e priti populli i Kosovës marrëveshjen mes tre liderëve politikë me ndërmjetësimin e miqve tanë amerikanë ? Pse duhet ta neglizhojmë vullnetin popullor, në një gjë kaq të rëndësishme ? Pse duhet të heqim dorë nga kjo marrëveshje e cila është legjitimuar nga parlamenti i Kosovës, marrëveshje që zgjidhi një ngërç politik dhe ishte premtuese që presidenti asnjëherë nuk do të jetë instrument i pazareve dhe skenareve politik. Po atëherë pse e bëmë atë marrëveshje ? Për të hequr Behgjet Pacollin? Po, mu për këtë, nuk ja vllente kurrfarë marrëveshjeje, që nëse nuk do ta respektojmë sot, do ngjante si një komedi me disa akte.

A beson kush se pas këtyre tentativave të pamoralshme, do kishte më hapësirë për marrëveshje në jetën tonë politike ? Kur shkelen marrëveshjet, bile ato me ndërmjetësimin e miqve tanë amerikanë, pse vallë do respektoheshin marrëveshjet pa ndërmjetës ?

Dhe më në fund, një konsideratë për miqtë tanë ndërmjetësues. Ambasadori amerikan Dell, nuk u bë palë e saj në cilësinë personale. Ai ishte përfaqësues i SHBA-ve.

Gjykata Kushtetuese e dha një interpretim në lidhje me mandatin e presidentes. Për mua, interpretimi i këtij vendimi nga ana e presidentes është vërtet i pakuptueshëm, tendencioz bile edhe i pamoralshëm.

Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese ka dhënë një interpretim të bazuar vetëm në nenet e Kushtetutës, pa marrë parasysh rrethanat dhe faktorët që kanë shtyrë që presidentja të zgjidhet ashtu siq ndodhi. Nuk dua të hyj në komentimin e këtij vendimi, por një e di, që edhe kësaj radhe, anëtarët e huaj të jurisë, kanë pasur opinion të ndryshëm prej gjykatësve vendorë, sikurse në rastin tim... interesante... ! Në këtë vendim po ashtu nuk janë marrë për bazë rrethanat, se si presidentja është zgjedhur, që për mendimin tim është dashur të mirren parasysh.

Rrethanat kanë qenë shumë të arsyeshme, pse ? : Presidentes i është thënë edhe në rezidencën e ambasadorit amerikan në Prishtinë, kur i është komunikuar lajmi, por edhe në rezidencën time në Hajvali se ajo është kandidate si rezultat i një marrëveshje politike të nënshkruar nga liderët e PDK-së LDK-së dhe AKR-së (shumica absolute parlamentare). Presidentja e ka konfirmuar këtë edhe gjatë fjalës së saj në Kuvend pas zgjedhjes, kur ka deklaruar se; ``është këtu si rezultat i një marrëveshje politike, e shëndërruar në rezolutë të parlamentit të Kosovës``. Ishte joetike, jo fer që tani presidentja thirret se gëzon të drejtën kushtetuese dhe duhet të rrijë deri në fund të mandatit. Këtë qytetarët e Kosovës e dinë, se janë të mashtruar nga presidentja. Tani me iniciativën e disa liderëve tjerë, qytetari shumë mirë e ka kuptuar se edhe në këtë rast mungon gatishmëria për ta mbajtur fjalën...

Në këto rrethana, unë mundem vetëm tu rekomandoj kolegëve të mi, që ta kuptojnë se edhe në politike duhet të ketë sinqeritet. E një politikan i mirë, një

politikan dinjitoz nuk duhet të gënjej, nuk duhet të mashtrojë, por duhet ta mbajë fjalën.

Arsyet kushtetuese.

Çfarë kuptimi ka rezoluta që ne miratuam në Kuvendin e Kosovës-rezoluta që e mbështeti marrëveshjen e tre liderëve. Si mund të zhbëhet një akt politik kaq i rëndësishëm kushtetues i parlamentit? Si mund të zhbëhet kaq kollaj puna e Komisionit për reformën kushtetuese? Me çfarë akti do shfuqizohet puna e tij? Si mund të tallemi vazhdimisht me Kushtetutën tonë në vitet e para të ekzistencës si shtet? E di se me Kushtetutën është tallur shumë deri tani. Janë shpikur madje interpretime origjinale "made in Kosova", me të cilat asnjëherë s'kanë qenë dakord ekspertët e huaj. Ndoshta unë e kam gabim por me këtë po i bie që ekspertët e huaj nuk janë di djshëm.

Kjo iniciativë (që zgjedhja e presidentit të vazhdojë të bëhet nga Kuvendi), ashtu siq e paralajmëruan edhe disa njohës të së drejtës kushtetuese, provokon në vazhdimësi kriza institucionale. Ç'ndodh nëse opozita bojkoton prap seancat e zgjedhjes së presidentit? Do mbetemi pa president? A mundet kush të detyrojë të rrijë në seancë opozitën apo këdo që don të bojkotojë? A mendon kush se fatmirësisht u morëm vesh ta zgjedhim presidentin nga populli, se përndryshe mund të mos kishim president kurrë. E dimë që dikush mbase s'do që Kosova të ketë president, por "mbretërit" e kohës moderne nuk quhen domosdoshmërisht presidentë, ata quhen dhe kryeministra. I paralajmëroj ata që duan ta bëjnë këtë aventurë që të mos i hyjnë sepse kur të dështojnë në zgjedhjen e presidentit në parlament, s'mund të kthehen sërish mbrapa duke kërkuar president nga populli. Do ishte tepër qesharake, por dhe dramatike një lojë e tillë me dinjitetin e shtetit.

Dikush thotë se ne jemi republikë parlamentare dhe jo presidenciale. Me një fjalë zgjedhja e presidentit nga populli do ta bënte automatikisht Kosovën republikë presidenciale. Ky është një gabim i madh dhe është thjesht propagandë. Le të marrim Francën. A është Franca një Republikë presidenciale, pse presidenti zgjidhet nga populli dhe madje nenet e presidentit janë që në krye të Kushtetutës? Jo, Franca quhet gjysmë presidenciale, sepse Presidenti atje mund të drejtojë dhe qeverinë, por karakteri i Republikës Franceze varet në praktikë nga përkatësitë politike të presidentit dhe kryeministrit. Kur presidenti dhe kryeministri kanë qenë të partive të ndryshme (cohabitation), eksperienca ka treguar se Republika franceze ka anuar më shumë nga ajo parlamentare. A është presidenciale Republika maqedonase, ose kroate, apo ajo malaziase, meqënëse presidenti zgjidhet nga populli? Jo, aq më shumë kur qeveria është e një shumice parlamentare të ndryshme nga partia nga vjen presidenti. Kujtoni vuajtjet e Presidentit Trajkovski të ndërë me një qeveri të drejtuar nga një parti kundërshtarë, apo dhe pasardhësin e tij, për të kuptuar se ky pretendim është thjesht propagandistik.

Arsyet politike.

Kosovës i duhet një ekuilibër në drejtimin e shtetit dhe jo të gjithë pushtetet në një dorë, megjithëse me emra të ndryshëm drejtuesish të këtyre pushteteve. Qfar shembulli sot jep Kosova, kur për presidentja është qind për qind në

dispozicion të partisë në pushtet dhe as pas dy vjetësh presidentja nuk ka arritur të bëjë asnjë veprim që shkon në favor të qytetarit të Kosovës? Ekuilibri krijohet kur në krye të këtyre dy institucioneve me mandate të ndryshme, vijnë dy figura politike, e pse jo dhe shoqërore, të cilat janë shprehje e dy realiteteve të ndryshme shoqërore dhe politike, e dy shumicave të ndryshme, e dy partive të ndryshme, etj që detyrohen të bashkëjetojnë. Kosovës i duhet të paktën një institucion të ketë qëndrueshmëri, pavarësisht krizave, sepse ai garanton pavarësinë e gjykatave dhe institucioneve të pavarura, respektimin e minoriteteve, vazhdimësinë e shtetit. E dimë që sot, megjithëse shumica nuk ka numra të konsiderueshëm në parlament, kemi qëndrueshmëri qeveritare. Kjo është arritur falë pjekurisë së opozitës e cila kur ne s'kemi konsoliduar akoma shtetësinë, nuk provokon kriza. Por ç'do të ndodhë nesër ? A mund të ketë një qeveri garanci se do ta plotësojë mandatin kur skena jonë politike përbëhet nga 4-5 forca me peshë të konsiderueshme, dhe përfaqësues minoritetesh, të cilët mund të provokojnë shumë lehtë kriza qeveritare ? Me zgjedhjen e presidentit nga parlamenti do të kemi ose konfliktualitet të vazhdueshëm (vitet 1999-2009), ose kontroll të presidencës nga qeveria si sot. Kjo situatë mund të ngjajë komode deri diku dhe për bashkësinë ndërkombëtare, të cilës kur ne s'kemi konsoliduar shtetësinë, i nevojitet vetëm një bashkëbisedues i fortë. Po nesër ? Po sikur ky bashkëbisedues të ketë oreks të madh për pushtet, siç ka ngjarë shpesh në historinë e Ballkanit, me kë do flasim ? Sa do luftojnë që ta heqin ?

Arsye personale

Dhe i lashë krejt për në fund arsyet personale.

Unë jam dikush që kam pas vetes një histori personale suksesi. Kam ardhur në Kosovë për të ndihmuar vendin tim : një amanet ndaj të parëve të mi. Jam modest, jam i duruar, sepse unë nuk kam ethe pushteti si dikush që s'mund të bëjë diçka tjetër në jetë, nëse nuk është në politikë. Kam fuqi të madhe ekonomike, por kurrë nuk kam blerë vota as për partinë time, as në parlament për t'u bërë president. Nëse do kisha blerë vota dhe njerëz, sot do isha president. Kam toleruar shumë lojërat e pushtetit, lojrat e Gjykatës Kushtetuese, sepse s'doja t'i sillja Kosovës krizë. I kam kuptuar këto lojra, por s'kam ngritur kurrë zërin, sepse Kosovës nuk i duhet kriza. Kam toleruar grabitjen e votës në dëm të subjektit im; kam lejuar ikje deputetësh, sepse as nuk i kam blerë, dhe as kam dashur të blej të tjerë. E kam dashur postin e Presidentit jo pse jam pa punë, por sepse aty mund të punoja më shumë, më mirë për Kosovën. E kam treguar këtë në aq pak kohë sa më lanë të rrija në detyrën e lartë : me lobimin e suksesshëm, me vizitat në Veri, me idenë për Hapësirën mbarëkombëtare në Parlamentin e Shqipërisë që u duartrokoi nga dy krahët e politikës së Tiranës, etj, etj. E dua zgjedhjen e presidentit nga populli, sepse më pëlqejnë sfidat. A tha dikush se zgjedhja ime ishte pazar ? Shumë bukur, u dorëhoqa dhe i hodha dorëzën e sfidës kujtdo që ishte i interesuar. Le të zgjidhemi nga populli. Me autoritet më të madh do t'i shërbej më shumë popullit tim. Unë s'kam frikë nga një sfidë e tillë. Nëse unë do isha i interesuar të blija vota për t'u bërë president, do ishte më lehtë dhe më lirë në parlament sesa në popull. Për mua ishte fyese mënyra se si u organizua zgjedhja ime dhe me këtë unë nuk ndihem keq. Le të ndihen keq, ata

që e udhëhoqën atë Kuvend ku u bë zgjedhja ime. Le të ndihen keq sepse për shkak të inateve ata thyen qdo ligj dhe nuk patën respekt për shtetin e Kosovës. Zgjedhja nga populli sipas marrëveshjes, ma lehtësoi dhimbjen e krijuar nga manovrat e shëmtuara për të më larguar nga detyra e presidentit. Përndryshe, pse do pranoja të ikja pa imponuar rizgjedhjen time siç ma kërkonte dinjiteti im qoftë dhe duke kërcënuar me krizë parlamentare ? Mos dikush mendon se unë duhet të paguaj sërish lojërat e tyre ? Herën e parë unë kam besuar, besimi është parim human dhe janë të marruar ata që më tradhtuan. Herën tjetër nëse do ju besoj, marrja do të bie tek unë, por këtë nuk do ta lejoj. Unë jam ai që jam, pse unë vlej shumë, pse unë di shumë, se unë punoj shumë, se unë i dua shumë njerëzit e Kosovës dhe të gjithë botës, se mua, njerëzit më duan shumë. Kush mendon të kundërtën e kësaj që them, e ftoj ta provojmë sa vlejme në garën popullore.

Ky editorial i z.Behgjet Pacolli është botuar në të përditshmet "Bota Sot", "Tribuna", "Epoka e Re" dhe "Zëri" postuar nga Admin.

181

15 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

April 13, 2013

Një reflektim praktik...

Nga Behgjet Pacolli

Sot u bë publike oferta për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, prej 277 milion eurosh. Një "sukses", ky që rezulton me shitjen e 75 për qind të aksioneve të kompanisë publike më profitabile në vend.

Për të ju drejtuar juve, më shtyu nostalgjia dhe keqardhja për mungesën e mundësive për implementimin e disa propozimeve të mija që ishin pjesë edhe e programit të AKR-së të vitit 2007.

Sigurisht ju kujtohet një propozim që në vitin 2010, ne, AKR-ja edhe pse në opozitë, patëm bërë pas konsultave direkte me disa investitorë të mëdhenj britanikë. Ai propozim, nuk parashihte shitjen e këtij aset të madh dhe të suksesshëm. Sipas atij propozimi konkret edhe me shkrim (shikojeni linkun <http://xn--cdaaa.akr-ks.eu/articles/75>), qeverisë së Kosovës i ofrohej mundësia që të jepte në menaxhim PTK-në në një periudhë 6 vjeçare, duke përfituar një kredi nga 300 deri në 500 milion euro. Gjatë kësaj periudhe, PTK-ja do të modernizohej si kompani, do të rikonsolidohej ndërsa në përfundim të marrëveshjes 6 vjeçare, qeveria e Kosovës do të rikthehej si pronare e të gjitha aseteve të saj. Si rezultat i kësaj, vlera e PTK-së pas kësaj periudhe do të katërfishohej dhe qytetarët e Kosovës, shteti i Kosovës do të përfitonin në çdo aspekt. Pas kësaj periudhe, Qeveria e Kosovës, kishte mundësi ta shiste PTK (sigurisht tani me një vlerë shumë të shtuar), ose prapë të lidhte edhe një



kontratë për menaxhim për një periudhë tjetër, sigurisht kundër një shume tjetër financiare. (shiko linqet poshtë)

Ishte ky atëherë një propozim alternativ, për dallim prej të gjithë atyre që si zgjidhje e shihnin dhe e shohin edhe tani, vetëm shitjen e asetëve publike.

Unë, atëherë pata mbështetje nga disa dashamirës të Kosovës, por nga pjesa dërmuese e spektrit politik u kritikova pa masë. Ata më akuzonin se gjoja kjo ishte një tentativë ku unë doja të përfitoja. Ajo që mua më dëshpëronte edhe më shumë, ishte se mu këta kritikë, ishin dikur drejtues të dikastereve financiare të Kosovës.

Kritika të tilla pata edhe më vonë tek një iniciativë e imja, që të bënim një ndryshim të ligji i Privatizimit, në mënyrë që Asetet publike, mos të shiten nga AKP-ja por të përdoren si instrumente për krijimin e Partneritetit Publiko Privat(PPP). Madje edhe kësaj iniciative në qarqet parlamentare, iu dha një drejtim tjetër, gjoja prapë “për përfitime personale”! Sa dëshpëruese dhe naive janë këto akuza.

Aq më tepër, janë dëshpëruese tani, kur koha po e dëshmon se unë kam pasur të drejtë në propozimet e mia ekonomike. O ju kritikë dhe akuzues. A e kuptoni se ju flisni vetëm nga ato që keni mësuar sipërfaqësisht nëpër banka shkollore, dhe asnjëherë deri më tani nuk keni dëshmuar se dini të krijoni dhe drejtoni ekonomi. Nëse unë guxoj të ju përgjigjem, atëherë ju them se nuk dini. Po të dinit diçka, do të kishit krijuar diçka për veten tuaj(nga puna), e lëre më për një shoqëri të tërë. Krejt inteligenca juaj koncentrohet në inatet dhe frustrimet e juaja. Ju, për të krijuar diçka për shoqërinë, së pari duhet të krijoni diçka për veten tuaj. Ama ta krijoni ndershëm, me punë. Mua, për të krijuar diçka për veten dhe familjen time, që mua sot ma garanton liri dhe pavarësi materiale, më është dashur një kohë e gjatë, rreth katër dekada, e jo brenda natës...

Qytetarët e Kosovës, tani le ta gjykojnë vet, në qfarë shtate e ka sjellur ekonominë e Kosovës kjo formë e drejtimit të Ekonomisë, nga të gjitha Qeveritw, që nga paslufta e këndeje. Kjo formë e privatizimit dhe kjo qasje e këtyre njerëzve të frustruar e ka degraduar ekonominë e Kosovës, kanë ofenduar djersën e veteranëve tanë. Secili njeri normal në Kosovë duhet ta dijë se Unë, nuk kam ardhur në Kosovë për ti marrë Kosovës diçka, por për të dhënë kontributin tim në ngritjen dhe fuqizimin e këtij vendi. Edhe njëherë, dua të ju them fuqishëm se me inate, me fjalë boshe dhe me shpirtngushtësi(që të përfitosh vetëm nga posti politik, dhe atë vetëm për vete), nuk i kontribuohet ngritjes së këtij vendi, dhe mirëqenies së qytetarit. Unë nuk kam nevojë ti marr Kosovës asgjë. Nëse është në pyetje një biznes që do të sillte përfitime, kompania e familjes time, të cilën e kam krijuar unë me djersë dhe dinjitet, me punë, e ka mundësinë që ta bëjë këtë në 195 vende tjera jashtë Kosovës, atë që është duke e bërë edhe sot.

Në fakt, kompania e familjes time nuk është përfshirë në procesin e privatizimit në Kosovë. Ato asete që i ka në Kosovë, i ka blerë në treg të lirë, me çmime shumëfish më të mëdha se sa që ishin privatizuar nga blerësit e parë. Edhe hoteli Grand ishte një aset publik, i cili ishte blerë nga dikush tjetër, dhe ai i kishte ofruar firmës së familjes time, shumicën e aksioneve, të cilat firma i kishte blerë. Ky hotel, padrejtësisht është uzurpuar nga njerëzit e “fortë”, por mos keni frikë

se drejtësia edhe në Kosovë do të vihet në vend, edhe pse ndoshta me vonesë. Ky është një proces natyror. Ajo që nuk është e jotja, asnjëherë nuk do të bëhet. Një veprim avangardist që tentova ta implementoj në kontinentin e Afrikës, (që për mua është kontinenti i një perspektive të ndritshme ekonomike), ku krijohej mundësia për ndërmarrësit kosovarë, të ofrojnë shërbimet e tyre, në kuadër të një konsorciumi perëndimor, deri në 500 milion euro vetëm në dy projekte, në Kosovë nga njerëzit e padijshëm, dhe njerëzit destruktivë pa kokërr vizioni për të ardhmen, u kritikua dhe u shfrytëzua si armë për të më luftuar pamoralshëm. U desh që një organ i lartë i drejtësisë tu tregoj këtyre njerëzve se sa gabim ishin ata. Këtyre njerëzve tani u them që do të kalojë koha prapë dhe juve do të ju vrajë ndërgjegja. Jo që më luftuat mua, por ju mbeteni fajtor që privuat një perspektivë praktike zhvillimore të Kosovës. Gjeneratat e ardhshme për këtë akt do të ju gjykojnë.

Vizioni im në programin e AKR-së të vitit 2007-të për shkak të inateve, asnjëherë nuk është marrë parasysh dhe është kritikuar se gjoja sjell praktika dhe imponime nga lindja. Ndodhi kështu kur ishte në pyetje krijimi i platformave agroekonomike që krijonin mijëra vende pune dhe do ta pavarsonin vendin nga importet banale. Ju kujtohet se pikërisht disa faqezinj thonin se unë po ju imponoj metoda komuniste.

Po të analizojmë sot, nëse në vend që të shisim nga 500 hektar tokë bujqësore me nga 50-100 mijë euro, (bile këto para u dërguan jashtë Kosovës,) të ishin përdorur si instrument për krijimin e PPP. Sa vende pune do të krijoheshin? Prej sa produkteve Kosova do të pavarësohej nga importi?

Jam kritikuar po ashtu edhe te propozimi që presidenti të zgjidhet nga populli. Edhe sot ju them se kundërshtarët e kësaj ideje nuk kanë të drejtë dhe kurdoherë Kosovës do ti nevojitet një president që nuk do të jetë subjekt i pazareve dhe shantazheve, por të jetë i zgjedhur direkt nga qytetarët.

Do ju flisja edhe më shumë për vizionin tim, që Kosovës i propozova para gjashtë vjetësh. (shikojeni programin e AKR-së të vitit 2007 dhe qdo gjë do ta keni të qartë) <http://xn--cdaaa.akr-ks.eu/pages/44>.

Shembull praktik është edhe KEK-u. Para gjashtë vjetësh më është dukur banale që ka ende njerëz që projektojnë ngritjen e një Termocentrali 2000 megavatësh. Sa qesharake është edhe sot të mendosh që dikush në Kosovë ka besuar se do të ketë investitorë që do të vijnë tek ne dhe do ti investojnë 5 miliardë euro.! Pata propozuar që të tërhiqen prej kësaj ideje të perealizueshme dhe të punohet në renovimin sistematik të kësaj që posedojmë dhe të fillohet krijimi i PPP me investitorët, me njësi prej 150-200 megavatësh (250-300 milionësh), për të cilat kishin gatishmëri investitorët. Sot 3-4 blloqe do të ishin të përfunduara që do të furnizonin Kosovën dhe rajonin me energji elektrike. Me këtë do të distancoheshim nga blerja e energjisë, kamuflimet e keqpërdorimet, që i kanë kushtuar Kosovës shumë më tepër.

Ta dijnë qytetarët e Kosovës edhe njëherë arsyen pse jam bërë pjesë e Qeverisë së Kosovës. Kam besuar shumë në implementimin e programit tonë ekonomik, por fatkeqësisht edhe përkundër përpjekjeve, ne arritëm shumë pak ta implementojmë atë, përveç disa reformave të rëndësishme në Ministrinë e

Tregtisë dhe Industrisë që përmirësuan imazhin e Kosovës, që arritëm ta lidhim në masë të madhe diasporën me vendin dhe ta promovojmë Kosovën ndërkombëtarisht. Sado qofshin të rëndësishme këto, janë vetëm një pikë uji në oqean, në atë se sa ka për tu bërë në këtë vend.

Asnjëherë nuk më ka munguar as energjia, as dituria, e as vullneti për të bërë këtë. Ka munguar fuqia politike që nuk varet nga unë. Privatist, familja ime në Kosovë vazhdon të garanton mbi 2000 vende të punës në Kosovë dhe diku mbi 6000 vende të punës për kosovarët jashtë Kosovës. Vazhdoj të ndihmoj qdokund ku mundem por edhe kjo është shumë pak në krahasim me atë se sa i nevojitet Kosovës.

Me kryeministrin Thaçi tani jemi në proces të transferit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe qytetarët e Kosovës do ta ndiejnë efektin e menjëhershëm të reformave, pasi që jam i bindur se nuk do të mungojë edhe vullneti i partnerit tim të koalicionit. Edhe këtu kam një koment. Në disa të ashtuquajtura gazeta bulevardeske e lexova se insistimi im për të marrë MZHE-në ishte prap interesi im personal. A thua ata njerëz që nxjerin një përfundim të tillë, kanë dinjitet dhe a kanë gjak në trupin e tyre? Do të ishte mirë ti pyesnim ata se a kanë bërë diçka humane për dikënd në Kosovë? Jam i sigurt se mirë nuk dinë të bëjnë, por e bëjnë të kundërtën dhe mu këta e infektojnë këtë shoqëri. Një fjalë e urtë thotë “nëse s`mund ti bësh mirë dikujt, së paku keq mos i bëj”. Krejt qka ka ndodhur deri më tani në Kosovë, e ka edhe anën pozitive. Jam krenar që jam nënshkruar i deklaratës së pavarësisë së Kosovës. Jam krenar që kam marrë pjesë intensivisht në ndërtimin e institucioneve të këtij shteti dhe po ashtu jam krenar që Kosova sot njihet si shtet nga më teper se gjysma e botës. Jam krenar po ashtu se që nga fillimi kam qenë mbështetës i flaktë i dialogut, për arsye se me dialog bota moderne zgjidh problemet.

 144

34 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli is with Mida Kçiku Kurti and Ronit Abdullahu.

April 13, 2013 · 🌐



Sot mora pjesë në zgjedhjen e strukturave drejtuese të Forunit Rinor në Ferizaj. Vertetë ishte një organizim i mirë dhe më shumë kandidatura për kryetar të Forunit.

Është hera e parë që këto zgjedhje të Forunit, kryetari zgjidhet me sistemin një anëtar një votë. Kandidatet paraqiten ekspozetë e tyre para të delegatëve dhe me votim të fshehtë u zgjodh kryetari.

Urime Rini e AKR, ju jeni e tashmja e prosperitet të Kosovës. Keni mbeshtetjen time të sinqertë dhe kurdoherë për iniciativat tuaja.

Ju me keto zgjedhje do të jeni me të fortë dhe mbi të gjitha me struktura drejtuese që ju përgjigjen intersave të Rinisë së Kosovës. Urime!



👍 270

6 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

April 17, 2013



Të nderuar miq

Të mërkurën pata mundësinë, të raportoja për punën time në Kuvendin e Kosovës, në Komisionin e jashtëm.

Në bazë të rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, komisionet parlamentare ftojnë në raportim vetëm ministrat, por gjithsesi për mua ishte një mundësi e mirë që dy institucionet tona të kenë bashkëpunim reciprok.

Pata mund sinë të vlersoja drejtimin profesional të kreut të këtij Komisioni, zotëri Albin Kurtit, qëndrimin korrekt të profesor Sabri Hamitit, të deputetit Hidajet Hyseni, të deputetes bosnjake Emilia Rexhepi dhe me përjashtim të provokimeve të znj Kada Bujupi, apo të ndonjë ndërhyrjeje tendencioze të ish kryediplomatit Skënder Hyseni, u ndieva mirë. Doja t'i ktheja përgjigje të drejtëpërdrejtë do gënjeshtrove dhe relativizimeve që qarkullojnë rreth një pune gjigande, që është krenaria ime. Dëgjova për habi se njohjet nuk kanë ndonjë rëndësi, se ato thuhetse vijnë vetëvetiu, etj, etj. Çudi të dëgjoja nga opozita shprehje të tilla ndërsa kur unë isha në opozitë i solla drejtëpërdrejt falë kontributit tim 11 njohje. Ndërsa sot si zëvendëskryeministër kam sjellë drejtëpërdrejt 13 njohje, pa përmendur kontributin e rëndësishëm në akoma më shumë njohje që kanë ardhur dhe priten të vijnë. U shpjegova deputetët si qëndron puna me njohjet e Nigerisë, Malin dhe Ugandën.

U shpjegova deputetëve se punën e kam nisur mbi bazën e një plani pune të detajizuar për Lobim dhe Investime, i cili kishte për qëllim ngritjen e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, respektivisht, promovimin e vendit tim me qëllim të rritjes së njohjeve për Kosovën dhe rritjes së investimeve të huaja.



270

24 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

April 17, 2013



## Ja çfarë kam bërë për lobimin



Behgjet Pacolli

Të mërkurën pata mundësinë, të raportoja për punën time në Kuvendin e Kosovës, në Komisionin e jashtëm.

Në bazë të rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, komisionet parlamentare ftojnë në raportim vetëm ministrat, por gjithsesi për mua ishte një mundësi e mirë që dy institucionet tona të kenë bashkëpunim reciprok.

*Nga Behgjet Pacolli*

Detajet mund t'i gjeni këtu: [Detajet për punën time në Komisionin e jashtëm të Kuvendit të Kosovës, në Komisionin e jashtëm të Kuvendit të Kosovës](#)

[See More](#)



63

2 Comments 5 Shares

# Behgjet Pacolli



**Behgjet Pacolli** ✓

April 20, 2013 · 🌐



Gjate takimit me forumin e Gruas se AKR-së  
Nenat dhe motrat tona kane sakrifikuar shume per kete vend.



234

5 Comments 6 Shares

# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

April 20, 2013



161

2 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli ✓

April 20, 2013 · 🌐



Pjesmarrje masive e grave ne Tubimin e forumit te gruas se AKR-së.  
AKR po rritet.  
ad.



👍 184

1 Comment 3 Shares





Behgjet Pacolli is with Dëshira Blakqori Abdullahu.

April 21, 2013 · 🌐



foto nga takimi me forumin e gruas se AKR-së



👍 335

6 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli ✓

April 23, 2013 · 🌐



Tash t'i përkushtohemi ekonomisë

Që nga shpallja e pavarësisë e këtij Kosova është përballur me sfida të mëdha për të shtrirë sovranitetin e vet në të gjitha pjesët e territorit dhe për të mbrojtur integritetin dhe kushtetutshmërinë e vendit.

Nga ana tjetër me shumë kujdes dhe mençuri Kosova u mor me implementimin e ligjeve dhe obligimeve që dilnin nga Pakoja e Ahtisaarit. Këto ishin obligime që bashkësia ndërkombëtare dhe miqtë e Kosovës i kishin parashtruar, ne i kishim pranuar në Vjenë, dhe në formë të këshillave ata kërkonin çdo ditë nga institucionet e vendit që ato të zbatohen. Prej këtyre obligimeve Kosova krijonte kushte dhe standarde për qytetarët e vet, prestare të kombësive joshqiptare duke u krijuar atyre standarde të larta sikurse ne të gjitha vendet evropiane aty ku ne synojmë të arrijmë.

Krejt kjo nuk ishte e lehte, duke marrë parasysh luftën e sapo përfunduar, dhimbjet që kjo luftë shkaktoi tek populli shqiptar i Kosovës. Qe te krijoje kushte te barabarta bashkëjetese në Kosovën multietnike, ishte një prej sfidave më të mëdha dhe me te vështira te institucioneve të Kosovës! Krijimi i kushteve për një jete te sigurt, pa diskriminime për të gjithë qytetaret e Kosovës ishte pra një sfidë tejet serioze për të gjithë njerëzit konstruktiv, njerëzit e civilizuar, njerëzit që donë paqen, ne rrethanat që vendi ndërtohej. Nga ana tjetër, ne synojmë bashkëjetesën me shoqëritë e civilizuar, ne synojmë anëtarësimin në familjen e kombeve dhe duhet të këshilloheshim dhe të mbështeteshim tek miqtë tanë perëndimorë, duke ruajtur aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Europian dhe miqtë e tjerë.

Mu kjo që thashë detyroi institucionet e Kosovës që për 14 vjet me radhe mos te shtrijnë sovranitetin edhe në veri të vendit. Kosova si një shtet i ri në konsolidim e sipër duhej te rrugëtohte me kujdes, që mos te lejonte gabime te cilat mundnin te ktheheshin ne veprime që do ta dëmtonin shtet-ndërtimin tonë.

Nuk dua të hyjë në trajtimin e shkaqeve pse pjesa veriore mbeti jashtë kontrollit institucional. Ama isha dhe mbetem besnik në bindjet e mia se kurrsezi Kosova nuk ka mundur te shtrije sovranitetin në veri në një forme tjetër pos dialogut, sado i mundimshëm do te ishte ai. Dhe kështu ndodhi. Sot me këtë Marrëveshje, Serbia tërhiqet zyrtarisht nga kontrolli policor, administrativ, etj, në këtë pjesë të territorit tonë. Janë fuqitë perëndimore që e garantojnë këtë tërheqje. Kjo është arritja më e madhe e kësaj marrëveshjeje !Kosova është një dhe e pandarë !

Është e fuqishme ideja, dita e se cilës i ka ardhur. Në këtë rast edhe idesë se fillimit dhe vazhdimit te dialogut sot dhe nesër, i erdhi dita. Modestisht, unë e kisha paralajmëruar këtë shumë kohë më parë, dhe kësaj ideje i erdhi dita sot.

Kjo ide e kthyer ne realitet, është aq e fuqishme sa që dita e firmosjes së kësaj marrëveshjeje, do të jetë një nder datat historike me rëndësi për shtetin e Kosovës dhe të ardhmen evropiane te tij. Kosovës, vendit tonë, sipas Marrëveshjes, iu hoqën pengesat për të ardhmen evropiane, për anëtarësimin në BE. Shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën brenda Bashkimit Europian, kanë rënë dakord me këtë pjesë të marrëveshjes. Ata me siguri do ta rishikojnë qëndrimin e tyre pro njohjes së Kosovës. Pas vendimit të tyre, rruga për anëtarësimin në OKB, është gjithmonë e më e hapur.

Kjo pikë e marrëveshjes është veçanërisht e rëndësishme, pse shteti ynë eshte në kërkim te sa më tepër miqve, për rruge që përshpejtojnë integrimin ne organizatat globale. Këto janë rruge që e përshpejtojnë krijimin e kushteve dinjitoze për qytetarët për një jetë më të mirë, me zhvillim ekonomik. Në fund të fundit ky është qëllimi i politikës : të ofrojë mundësi për zhvillim, për jetë më të mirë për qytetarët.

Unë personalisht në emër të partisë politike që e përfaqësoj, dhe mbështetësve te saj e përgëzoj kryeministrin e Kosovës për kurajon dhe guximin që pati për t'i hyrë këtij procesi të vështirë, por shumë të rëndësishëm për faktorizimin e shtetit tonë.

Unë i falënderoj të gjithë ata që ju mbështetën dhe prapë po e them: dua të mbes besnik bindjeve të mijs, që qytetarët e Kosovës do ta vlerësojnë këtë që është arritur sot, sepse do shohin efektet e saj pozitive.

Sot mbetet sfida e madhe zbatimi i marrëveshjes, sepse një e di, se implementimi i saj është i vështirë për shkak të pengesave nga brenda dhe jashtë. Për fat të mirë miqtë tanë do ta mbikëqyrin këtë zbatim. Ndërkohë duhet ta dini se çdo gjë e fituar lehtë, e humb vlerën shpejtë ; çdo gjë e arritur me sfida, ka vlerë dhe kjo marrëveshje ka një vlerë të madhe dhe ia vlen që të sfidohemi në implementimin e saj.

Unë vazhdoj t'i mbetem dhe një pikëpamjeje të mëhershme: për të patur një implementim të suksesshëm ne duhet të kemi edhe një ofertë ekonomike integruese për Veriun e Kosovës, një zonë të lirë ekonomike që qytetarët e asaj pjese të territorit tonë të prodhojnë interesa të përbashkët, pavarësisht etnisë së tyre. Vetëm zhvillimi ekonomik, mirëqenia i garanton të arriturat politike. Më vjen mirë që në marrëveshje është vënë theksi dhe tek energjia dhe tek telekomunikacioni, pse ne duhet të fitojmë pavarësinë e plotë dhe në këto sektorë, duke i hequr pengesat artificiale që na pengojnë zhvillimin..

Ne besojmë që në këtë rrugë do të kemi mbështetjen e gjithanshme të bashkësisë ndërkombëtare, SHBA-ve, dhe Bashkimit Europian për çka dua ti falënderoj thellësisht. Zonja Ashton, që përkundër problemeve dhe angazhimeve ditore me përkushtim e përkreu misionin e saj meriton respekt shumë të veçantë. Gjermania, një aleatja jonë e fortë, gjithashtu meriton respekt të veçantë. duke ratifikuar këtë marrëveshje, parlamenti kontribuon për të ardhmen e fëmijëve tanë të cilët kanë të drejtë legjitime të jetojnë në paqe, të lëvizin lirshëm, pa probleme dhe të krijojnë perspektiven e tyre jetësore ashtu siq ata dëshirojnë.

Ne kemi humbur shume kohe duke u marrë me probleme politike duke renduar jetën e qytetarit me informata brengosëse, duke renduar punën e institucioneve, e shumë here duke ndryshuar edhe mënyrën e te menduarit deri të gjuha e egër në mes njerëzve përgjegjës për mbarëvajtjen e proceseve dhe pjesës tjetër destruktive. Nuk duhet humbur më kohë e vlefshme duke u marrë me gjëra të cilat pas pak vitesh do të duken aq banale, e për të cilat nuk ia vlen të humbet kohë. E kujtoni sesa shumë polemika janë bërë për të ashtuquajturën çështje të 6 pikëshit, apo të fusnotës. Koha, kjo marrëveshje si shenjë e kohës, i kapërceu të gjitha dhe i zhvlerësoi të gjithë ato polemika.

Pas firmosjes së kësaj marrëveshje, ne tani duhet te përqendrohemi me plot energji ne rrafshin e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit te jetës se qytetareve. Këto janë sfida reale, për të cilat, megjithëse me vizione të ndryshme si qeveri dhe opozitë, duhet t'i zgjidhim. Kosova duhet të jetë e jetueshme për të gjithë brezat. Kosova e ka potencialin për jetë më të mirë se është vend i bekuar nga perëndia, me burime të shumta natyrore dhe njerëzore, me një rini të mrekullueshme.

Pjese nga fjala e z.Behgjet Pacolli në Kuvendin e Kosovës



Behgjet Pacolli ✓

April 23, 2013 · 🌐



Në familjen e dëshmorit të kombit Elton Zherka në Gjakovë. Nderim dhe respekte për këtë familje dhe për të gjithë ata që sakrifkuan për Kosovën



👍 1K

22 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

April 24, 2013 · 🌐



Në njërën nga nëndegët e AKR-së në Gjilan. Zgjedhjet e brendshme të AKR-së në këtë qytet janë duke u përcjell me një interes të jashtëzakonshëm nga qytetarët gjilanas. Ardhjet e reja gjithashtu janë në numernshumë të madh. Më shumë se 2600 delegatë janë përfshirë në zgjedhjet e degës. Ky është një treguesni qartënkë AKR po dominon qdo ditë e më shumë në Anamoravë.

I përgëzoj strukturat e AKR-së. Urime



👍 145

11 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

April 27, 2013



Në degën e AKR-së në Ferizaj



200

3 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

April 29, 2013

Gjate punimeve te Kuvendit te Trete Zgjedhor me c'rast kjo dege e Aleancës Kosova e Re në Gjakovë zgjodhi Mimoza Kusari-Lila si kryetare te deges se AKR-se ne Gjakove. admin

Mimoza Kusari Lila zgjedhet Kryetare e AKR-së në



352

8 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

May 2, 2013

Ne takime me delegacionet pjesemarrrese te Konferencës së Tretë Vjetore për Investime të organizuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Tregtisë e Emirateve të Bashkuara Arabe në Dubai <http://www.rtklive.com/new/?cid=1&newsId=74787...>

RTKLIVE.COM

**Pacolli e Kusari-Lila në Dubai për investime**

Delegacioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës i kryesuar nga Zv/ryeministri Behgjet Pacolli dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Mimoza Kusari-Lila po merr pjesë në punimet e Konferencës së Tretë Vjetore për...

140

2 Comments 3 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli ✓

May 4, 2013 · 🌐



Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET



**Pacolli: AKR e përgatitur për qeverisje të re**

Në Kuvendin e tretë zgjedhor të degës së AKR-së në Gjiilan ka marrë pjesë të shtunën edhe lid...

👍 95

2 Comments 3 Shares





Behgjet Pacolli is with Vjollca Gagica-Matoshi.

May 5, 2013 · 🌐



Në zgjedhjet e degës së AKR në Gjilan. Ky proces zgjedhor në këtë qytet, në të cilin janë përfshirë më shumë se 2600 delegatë nëpër nëndegë, është një ringjallje e fuqishme e AKR-së. AKR po shtrin dominimin në komunat Anamoravës.



👍 499

15 Comments 7 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓  
May 5, 2013 · 🌐



👍 600

23 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓  
May 5, 2013 · 🌐



👍 352

7 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 5, 2013 · 🌐

...

Një darkë spontane me përfaqësuesit e degës së AKR në Prishtinë



👍 349

14 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 9, 2013 · 🌐

...

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmiID=7548> admin



GAZETATRIBUNA.COM

### Pacolli mohon se ka blerë tokë në Vojvodinë

Zv/kryeministri Behgjet Pacolli e ka përgënjeshtuar shkrimin e një gazete serbe, në të cilin është thënë se ai bashkë me një sheik arab kanë blerë 10 mijë hektarë tokë në Vojvodinë. Në një prononcim

👍 103

25 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

May 13, 2013 ·



Punimet e Kuvendit te Forunit te Gruas Dega ne Gjakove  
<http://www.youtube.com/watch?v=wW45UQRD-Rk> admin



YOUTUBE.COM

**Kuvendi i Forunit Gruas AKR Dega në Gajkovë**

Kuvendi i Forunit Gruas Aleanca Kosova e Re Dega në Gajkovë

80

2 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 14, 2013 · 🌐



Adriatik Beqa zgjedhet Kryetar i degës së AKR-së në Shtime

<http://www.akr-ks.eu/articles/542> admin

AKR-KS.EU



**AKR**

Është mbajtur Kuvendi i tretë Zgjedhor Degës së Aleancës Kosova e Re në Shtime, ku i pranish...

👍 88

1 Comment 1 Share



Behgjet Pacolli ✓

May 16, 2013 · 🌐



Emërimi i Fadil Ismajlit hap një kapitull sfidues për AKR-në në Qeverinë e Kosovës. Implementimi i shpejtë i reformave ekonomike aq të nevojshme është misioni ynë kryesor, andaj që nga neser duhet t'ia fillojmë punës.

z. Ismajli posedon të gjitha kapacitetet profesionale dhe njerëzore për të qar përpara vizionin e AKR-së për Kosovën.

👍 161

16 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 17, 2013 · 🌐



Të nderuar miq,

Duke i lexuar shkrimet dhe dëgjuar komentet për ndodhitë e fundit në AKP dhe rreth riformatizimit të Qeverisë, vendosa që nga pozita krejtësisht neutrale të bëj këtë koment te stergjatur pak, duke pas parasysh edhe ngapak anën emocionale timen

Këtë koment nuk do ta lidhja me ndonjë obligim as moral dhe as profesional, për të ju përgjigjur autorëve të këtyre thashethemeve por me këtë dëshiroj të komentoj për opinionin publik i cilët meriton të jet i informuar drejtë.

Me gjithë respektin meritë për mediet, të cilat do ti ndaja këtu në dy grupe; në medie autoritative që respektojnë kodin gazetaresk (të cilat janë të pakta fatkeqësisht në Kosovë) dhe në ato të ashtuquajtura media që funksionojnë në mënyrë të egërt, tendencioze, pa kurrfarë respekti për profesionalizmin, që nga pronarët e tyre përdoren si instrument për të denigruar qdo gjë, vetëm për arritjen e synimeve të pronarëve të tyre, synime këto të cilat lidhen ngushtë ose me interesat e tyre, ose nga frustrimi, inatet e zilitë ndaj personave të caktuar.

Siç e dinë të gjithë, unë në Kosovë nuk kam ardhur për të krijuar ekzistencën time nga politika, por kam ardhur nga një sukses me renome botërore, të arritur me punë mbi 40 vjeqare. Selinë, biznesi im, e ka në vendin më demokratik në botë, aty ku dominon respektimi i ligjit, nderi, sinqeriteti, pra ne Zvicër. Aty kam krijuar edhe ardhmërinë, jo vetëm timen, por edhe të gjithë farefisit timë të gjerë. Si rezultat, vëllezërit e mi, kusherinjtë e mi, sot udhëheqin me keto kompani të rangut botëror, që shërbejnë si model i korrektësisë, kualitetit dhe përgjegjshmërisë në të gjitha fushat ku operojnë. Si rezultat i kësaj, që nga vitet 1993 dhe këndej, grupi i këtyre kompanive ka një xhiro sa dy herë e gjysmë buxheti i Kosovës. Madje, tani renditen klientët të cilët duan te punojme me Mabetexin (si rezultat i kësaj është edhe sukcesi i fundit i projektimit dhe ndërtimit të EXPO 2017 në Astana që kap shifra shumë miliardëshe). Mos të flas për projektet e realizuara në të shkuarën, të cilat sot shihen, preken dhe në to punojnë qindra mija njerëz nëpër botë. Jam krenar që këto projekte janë ndërtuar ekskluzivisht nga punëtorët dhe ekspertët e vyeshëm të Kosovës që meritojnë qdo lavdatë dhe këta janë të shumtë, disa mijëra, jo vetëm tani, por që nga vitet 90 e këndej. Këta janë njerëz, që me paratë e fituara atje ndërtojnë ardhmërinë e tyre në Kosovë.

Ishte ëndërr edhe imja si e qdo kosovari që ti kontribohet vendit. Unë kontributin tim, kam menduar ta jap në zhvillimin ekonomik të vendit, vullnet ky që qdokund do të gjente mirëkuptim. Në Kosovë, mua personalisht më ndodhi e kundërta. Në vend se të mirëpritej, kjo iniciativë tani përdoret si shkak për të denigruar personalitetin tim me fyerje e sharje, të padinjitetshme, të pamoralshme, destruktive e qdo gjë tjetër. Kompanitë e krijuara nga unë, sot përpos atyre mijëra personave jashtë vendit, garantojnë edhe punësimin e më

se 2500 vetave këtu në Kosovë. Sa profitabile janë kompanitë e mija këtu në Kosovë, po të mendoja ne aspektin ekonomik do të turpërohesha tua them. Ato vazhdojnë të punojnë me humbje dhe ekonomikisht janë të paarsyeshme (për shkak të mungesës së fuqisë blerëse në Kosovë) dhe ju them se këto humbje mbuloohen nga subvencionimi nga firma amë në Zvicër. Këtë më së miri e dëshmojnë remitencat bankare që vijnë, qofshin pagat e punëtorëve që punojnë jashtë, qofshin subvencionet për ndërmarrjet kosovare.

Entuziazmi im për ti kontribuar ekonomisë së vendit, nga pozita "ex officio" do të më humbte që në fillim kur kuptova se mirënjohja pothuajse nuk ekziston më, kur e kuptova se këtu vjen në shprehje fjala e urtë që "nuk ka profet në vendin tend"! Shpresova shumë që nga pozita institucionale do të krijohet mundësia për të vepruar, ngase këtu ekziston nevoja qdo ditë e qdokund. Edhe këtu shpejt demoralizohem, kur dëgjoj se për qdo iniciativë që shkon drejt reformave (për të cilat ka nevojë ky vend), nga qarqet e ndryshme ngriten zërat se "ky e ka për interes të vetin". Autorët e këtyre thashethemeve sigurisht e bëjnë për shkak të nivelit të ulët të vetëdijes ose për shkak të inateve. Këtyre të pa dishmeve u rekomandojë që të konsultojnë realitetin kurse për keta tjeret, unë kam vetëm një përgjigje brutale, nga se ju them atyre se ju nuk meritoni përgjigje më të mirë "ju nuk e thoni të vërtetën sepse ëndërroni të jeni dhe të jetoni jeten time qofte edhe nje minut, por dua të ju dëshpëroj, se me shpirtngushtësinë tuaj nuk do t'ia arrini kurr! Ju e dini vet kush jeni dhe qka përfaqësoni. Këtu dua të kërkoj ndjesë për publikun e sinqertë që e lexon këtë, dhe ju them se kjo nuk është mënyra e sjelljes time, por kjo përgjigje është vetëm për ata që e dinë vet kush janë.

Ti kthehemi, AKP-së. Unë nuk kam ditur për ekzistencën e zotit Rexha. Atë e kam takuar vetëm njëherë, tek ambasadori i Britanisë. Zonjën Dardane Peja asnjëherë në jetën time se kam takuar, dhe asnjëherë nuk e kam njohur.

Pas të bërave të zotit Rexha në AKP dhe pas tërheqjes së zonjës Bernadett Roberts nga bordi i AKP-së, e kam parë të arsyeshme që të rekomandoj zotin Rexha të tërhiqet menjëherë, për arsye se dëmi për ekonominë tonë shkonte në kahje të pariparueshme. (analizojeni kontributin ekonomik që SHBA ka dhënë për Kosovën, vetëm në konferencën e donatorëve në Bruxelles, 500 milion.) e mos të flasim për dëmin politik. Zoti Rexha, nëse e konsideron veten më të menqurin është dashur të kërkonte menjëherë falje dhe të dorëhiqeni e mos të bëjëshit deklaratat arrogante që vetëm parlamenti mund të meshkarkojë. Zoti Rexha ma jep një dëshmi të vogël që unë kam pasur interes për Trepqën ashtu siq ju deklaroni në media, ose ma jep vetëm një dëshmi që unë kam ndikuar te zonja Peja që ajo të dorëhiqet. Jo zoti Rexha, nuk është e verte dhe urdhero kerko falje! Jam shumë mirënjohës për atë që ka ndodh, që tani të kemi një ministër të sinqertë, profesional në Zhvillimin Ekonomik, dhe dhashtë zoti që ai mos të pengohet në mënyrë që ne të implementojmë idenë tonë, dita e së cilës moti i ka ardhur, atë të reformave ekonomike. I garantoj qytetarët e Kosovës se, nëse konstruktiviteti i kolegëve tanë në qeveri do të ekzistojë, ne do të fillojmë ndërtimin e kapaciteteve energjetike, në bazë të formulës PPP. Ato asete që kanë mbetur do të përdoren për krijimin e veprimtarive me partneritet privat publik, do të fillon trajtimi i minierave, të cilat që 15 vite kanë mbetur jashtë

funksionit dhe do të krijojmë mundësi për fillimin e krijimit të ndërmarrjeve për zhvillimin e agroekonomisë. Do të vazhdojmë punën në krijimin e një ambienti të sigurt për të bërë biznes e shume tjera. Do të insistojmë pa u ndalur, edhe tek kolegët tanë të ministrive të tjera që të rishikohen ligjet, e sidomos ato të gjyqësisë në mënyrë që veprimtarëve ekonomik tu lehtësohet jeta afariste.

 200

34 Comments 18 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

May 21, 2013 · 🌐

...

Solidarizohemi duke ndare dhimbjen me popullin amerikan me rastin e fatkeqsisë natyrore që goditi ne Oklahoma.

 262

16 Comments 1 Share



**Behgjet Pacolli** ✓

May 22, 2013 · 🌐

...

Të nderuar miq të mi

Sot djali im Isa I mbush shtatë vjet. Ka qenë një dëshirë e madhe e prindërve të mi, që mos të shkojnë nga kjo botë pa u gëzuar me lindjen e një djali dhe kjo dëshirë atyre iu plotësua shtatë vite më parë. Në atë kohë, babai im, që ishte I sëmurë rëndë, me të marrë lajmin për lindjen e Isës, aq shumë përjetoi gëzim, sa mori forcë dhe shijoi qaste të lumtura me nipin e tij.

Në këtë ditë, unë kam marrë me mijëra urime nëpërmjet telefonit. Dëshiroj të ndaj me ju vetëm një mesazh urimi, që ma ka dërguar një vajzë, (mbesa e Zyrafete Gashit), që vuan që një kohë nga një sëmundje e rëndë, dhe për të cilën jam duke u kujdesur intensivisht.

"Isa I dashur sot mbush 7 vjet. Qofsh krenar me emrin e gjyshit, me mamën e babin. Sa i privilegjuar të jesh djali i madh i Behgjet Pacolli që ka gëzu mijëra shpirtëra e tani kujdeset edhe nihere ta kthejë në jetë tezen Zyrafete Gashi. Qofshi të bekuar nga zoti".

 Bessa F Qazimi and 3.5K others

535 Comments 24 Shares





Behgjet Pacolli

May 23, 2013

Miqtë e mi,

Në informim e sipër për ngjarjet dhe zhvillimet në vend, më tërhoqi vëmendjen një gjë. Një OJQ që për fushë të interesit ka Sigurinë, paska bërë një hulumtim për Sfidat e Sigurisë në Kosovë, ku ndër të tjera ka nxjerr edhe rezultate politike për partitë politike në Kosovë. Në fakt më shumë se rezultatet që personalisht mu dukën të manipuluar, më bëri përshtypje negative ideja që një OJQ nga fusha e sigurisë të merret me forma tipike të manipulimit publik, me rezultate që më shumë se të vërtetat kanë për synim manipulimin qytetar dhe topitjen e mendjes publike në raport me subjektet e ndryshme partiake në Kosovë. Vazhdoj të çuditem me këtë nivel njerëzish, e edhe më shumë më çudisin gjithë ato media që u paskan kushtuar kaq shumë vëmendje në hapësirat e tyre të çmuara.

Për mua personalisht dhe subjektit politik që unë i takoj, AKR-së, votuesi që është partneri ynë më besnik në rrugëtimin tonë politik, ka qenë, është dhe do të mbetet garanti ynë kryesor. Ne kemi besim tek qytetari i Kosovës dhe bashkë me te do të shkojmë përpara.

Sondazhet, analizat, shkrimet e çka jo tjetër, që synim kanë parandë dhe pasurimin e individëve në kurriz të të tjerëve, janë njejtë, po sikur fluskat, shfaqen shpejt dhe shuhen po aq shpejt.

Qytetari beson në vlerë. Sinqeriteti është vlerë. JO gënjeshtria dhe asnjëherë manipulimi.

Pasditë të këndshme



182

11 Comments 11 Shares



Behgjet Pacolli

May 24, 2013

Të nderuar miq,

Pa filluar mirë nga puna, ministrin tonë të ri Fadil Ismajlin, nisin ta sulmojnë padrejtësisht dhe në mënyrë tendencioze. Para propozimit të tij për ministër, AKR është informuar shumë mirë për punën e tij prej pasluftës e këndeje. Fadil Ismajli është njeriu më meritor për mbarëvajtjen e kompanisë KOSST ; ai është vlerësuar nga të gjithë qeveritë e pasqirimit të Kosovës, qeveritë e të gjithë partive, nga administrata ndërkombëtare në Kosovë, të cilat e kanë konfirmuar gjithmonë në pozita drejtuese në manaxhimin e sektorit energjistik. Ai nuk është subjekt i ndonjë penalizimi prej ndonjë hetimi administrativ vendor dhe ndërkombëtar ; ai nuk ka marrë pjesë në kurrfarë vendimarrje individuale që favorizon dikënd në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Nga përvoja ime e di se sinteza e eksperiencës, diturisë, vendosmërisë dhe përkushtimit janë premisat më të mira për sukses. Ministri Fadil Ismajli i posedon këto cilësi dhe koha do të tregon se ndryshime të mëdha në ekonominë e Kosovës (nëse këto nuk pengohen nga të tjerë), do të ndodhin.

Do të ishte pozitive që zotëri Ismajli të mbështetet në synimet e tij, së bashku me ministrat e tjerë të AKR-së për të bërë ndryshime pozitive në ekonominë e Kosovës, ndryshime që aq shumë i nevojiten vendit tonë. Një gjë është e sigurt, se ai do të jetë transparent dhe i vendosur në punën e tij duke respektuar ligjin në Kosovë dhe për këtë janë garanci dhe puna e tij e mëhershme, vlerësimet e mëdha që ai ka patur brenda dhe jashtë Kosovës.



128

12 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

May 25, 2013 · 🌐



Zv.Kryeministri Pacolli merr pjesë në samitin e Unionit Afrikan

Gjatë këtij samiti,z.Pacolli do të zhvillojë takime të rëndësishme me udhëheqës shtetesh nga kontinenti I Afrikës, me fokus të veçantë tek shtetet që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Unioni Afrikan është organizatë politike, me 54 shtete anëtare



👍 229

10 Comments 11 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 26, 2013 · 🌐



Të nderuar miq,

Në ditën e dytë të qëndrimit tim në Adis Abeba të Etiopisë, pata mundësinë të zhvillojë një sërë takimesh, në kuadër të samitit të Unionit Afrikan.

Pas takimit me komisioneren e lartë të këtij Unioni, z.Dlamini Zuma, sot kam takuar presidentin e Guinesë Ekuatoriale Teodor Obiang, presidentin e Ruandës, z.Paul Kagame dhe presidentin e Afrikës së Jugut z.Jakob Zuma.

Gjatë takimeve të ndara, i njoftova udhëheqësit afrikan për proceset politike pas arritjes së marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si akt me të cilin shteti serb de facto dhe de jure, ka pranuar shtetin e Kosovës. Në këtë kontekst, shpreha edhe njëherë nevojën e lidhjes së marrëdhënieve diplomatike me vendet afrikane.

Një ndihmë të madhe gjatë këtij samiti, është duke më ofruar miku im dhe i Kosovës presidenti i Ganës, John Dramani Mahama, i cili në vazhdimësi ka përkrahur procesin e shtimit të njohjeve për Republikën e Kosovës.

👍 184

8 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 27, 2013 · 🌐



Te dashur miq,

Sot vajza ime Hana i mbushi 9 vite. Jam i lumtur që Hana është duke u rritur në një ambient krejtësisht popullor, ajo shkollohet në shkollë publike dhe rrethohet nga miqtë e saj të familjeve të rëndomta. Jam krenar për humanitetin e saj që e kultivon gjithnjë e më fuqishëm dhe dashurinë e saj për të tjerët. Dua të konfesohem për një problem; Hanen e lash 4 muajshë, vet, për një muaj të tere (papergjegjeshëm) si foshnje ku prezencën ime ishte shumë e nevojshme dhe shkova në Afganistan për të liruar Shqipe Hebabin. Pas kethimit tim tek familja ime (pasi atje e kreqva sukseseshëm misionin tim) fillova ta realizoj sa i papergjegjeshëm kam qen duke e radhitur Hanen në prioritet sekundare. Kjo qeshtje edhe sot më mundon por shpresoj që një ditë (kur ajo e kupton më mirë) do të flas me Hanen dhe do të kerkoj falje.

👍 898

164 Comments 11 Shares



Behgjet Pacolli

May 29, 2013 ·



Vizita e Presidentit Pacolli ne SH.P.K FUNGO ne Kamenicë admin



379

8 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

May 29, 2013



Pamje gjate vizites se presidentit Pacolli në Fabrikën "HUGOS" në Topanicë. admin



356

11 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

May 29, 2013



Presidenti i AKR-se me bashkepuntorë në t`pame tek familja e respektuar e Sheh Banit në Gjakovë. admin



440

45 Comments 16 Shares



Behgjet Pacolli

May 30, 2013



<http://gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=9796>

GAZETATRIBUNA.COM

### Qeveria ka humbur kohë

Lideri i AKR-së Behgjet Pacolli, vlerëson se partisë së tij i është dhënë shumë vonë Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Partneri kryesor i koalicionit qeverisës së Thaçit, ka thënë në një intervistë për ga

314

8 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

May 30, 2013



Tanzania ka njohur Republikën e Kosovës

Ne foto Zv.kryeministri Pacolli me presidentin e Tanzanise z.Jakaya KIKWETE dhe me ministrin e puneve te jashtme dhe bashkepunimit nderkombtar te Tanzanise z.Bernard MEMBE admin



723

34 Comments 19 Shares



Behgjet Pacolli

May 30, 2013 ·



Edhe nje foto e zv.Kryeministrit Pacolli e bërë me lidshpin e Tanzanisë vite më parë gjatë lobimit në Tanzani rreth njohjes se Kosoves. admin



249

4 Comments 3 Shares





Behgjet Pacolli ✓

May 31, 2013 · 🌐



Ky koment i dedikohet zotit Xhemajl Rexhes te INTERAKTIV-it. (KTV). -----

-----  
Xhemajl,te falemnderoj qe interesohesh per shkrimet e mija ne Fb.E rrespektoj poashtu edhe komentin tend lidhur me fjalen "konfesohe" E vertete,fjale e huaj dhe ka te bej dicka me religjionin por nuk eshte "rrefim" si tentove te spjegosh se vetem rrefimi nuk do te mjaftonte ne menyre qe te paraqet edhe disa ndjenja qe percillnin at tregim.Nuk ishte elegante poashtu thenja se" aq shume lajka ....dhe pak kush e ka kuptuar" E vertet qe une shumehere ne fjalorin tim perdori fjalet ma ADEKUATE qe me se miri i pergjigjet temes qe e trajtoj duke pas parasysh se cdo gjyhe posedon disa fjale qe jane ma te aferta me temen sesa te gjuhet tjera si psh.fjala LIKE qe ti e perdor.Edhe une do te kisha te drejte te protestoj,ty si prezentuas ose moderator (edhe keto dy fjalet e fundit asnjena nuk eshte ne shqip dhe kane prejardhje nga latinishtja por ne shqip si e quan ti?) per perdorimin e fjales LIKE.Sa mija njerz qe nuk perdorin gjuhen e informatikes nuk te kuptuan as ty me Like-in tend.Per mua eshte ne rregull por edhe ti eshte dashte te me kuptosh mua Une per shkak te angazhimit tim ditor,ne mbremjet e voneshne punoj me rrjetin social,shumehere edhe ngapak i lodhur dhe,si ju te gjithe,edhe une perdori ndonje fjale te huaj.KONFESOHEM nuk eshte rrefim,si ti e spjegon,por eshte ADMIT(angl),ZUGESTEHEN,(gjer)RECONAÎTRE(fren)Ne asnjenen gjuhe nuk behet fjale per "rrefim" , si ti e quan, por ne shqip do te ishte" E PRANOJ" cka prap nuk e perfaqeson ekzakt ate qe une doja te them pershkak te mungeses se fjales adekuate ne shqip.Folja konfesohe(eshte fjale e huaj,nga latinishtja)ishte ajo ma adekuate per shprehjen e ndjenjes sime nepermes tregimit per temen qe trajtoja ose PRANOJA nje te beme (gabim) bashke me shprehjen e dhimbjes e besimit shpirtorore me njenje te pergjegjesise perpara Perendis.Nese ti Xhemajl ke nje fjale ma adekuate se "konfesohe" (qe vlen edhe per ata qe tregojne te bemet e tyre para priftit ne "kastigun" e kishes)me thuj,une tjetet here do ta perdori apo edhe ma tutje ti mbetesh me "like"-at e tu e une me "konfesohe"per tregimin tim.  
Eshte ora 02.08 e mengjezit,dua te pushoj e ty sukses dhe sa here qe ti perdore fjali me prejardhje nga gjuhet e huaja mos harro edhe "contorno-n(ju e quani garnitur) emocionale apo loxhike qe percjellin tregimin.Perndryshe do te mbetet vetem nje LIKE ose METAFOR siq ti e perdore ne kontrobutin tend gazetaresk. Heeeem,dreqi e mart, kursesi me u nda nga fjalet e huaja, as nga"gezette" "metaforo"LIKE "ectr.

👍 329

52 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

May 31, 2013 · 🌐



Në rrugë për vendlindjen time. Sot në orët e pasdites isha në një vizitë të punëtorëve të ndërmarjes "Tali". E cila është duke ndërtuar një rrugë që lidh fshatin Llabjan, Prekoc me fshatrat Krilevë, Srezoc e Kamenicë. Kjo rrugë shkurton për 1/3 edhe kohën edhe distancën e arritjes nga Kamenica në Prishtinë. Për mua ishte një kënaqësi e veçantë pasi që kjo rrugë tranziton fshatin tim të vendlindjes, Marecin.

Shumë do të pyesnin pse kjo ditë e veçantë për një asfaltim të rëndont?

U them se Mareci, vendlindja ime është 1 e 29 pjesë e territorit të Kosovës. Në vitet e 50-ta, Mareci kishte mbi 700 familje, me rreth 4200 banorë, kishte zyre lokale administrative, 5 shkolla dhe minierën, që njihet si miniera e Artanës, e cila në fakt hyrjet në horizontet e ka në Marec, e jo në Novobërdë.

Duhet të besoni se për herë të parë rryma elektrike në Marec ka ardhur në vitet 80 (duke përfshirë këtu konglomeratin afër minierës), dhe deri më sot asnjë kilometër asfalt nuk e ka pasur. Asfalti i parë është shtruar në dy ditët e fundit në rrugën që e përmenda më lartë. Për bashkëfshatarët e mi është një ditë e madhe dhe shumë domethënëse. I përgëzoj ata dhe do të dëshiroja shumë (dhe do dëshiroja tu bëja thirrje atyre që janë shpërngulur prej aty) që të kthehen në Marec, tia kthejnë shpirtin atij vendi të bukur të Kosovës. Kjo rrugë tani është një arsye më tepër për tu kthyer në Marec.



👍 117

1 Comment 8 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

May 31, 2013 · 🌐



<http://gazetaexpress.com/?cid=1,13,113179>

WWW.GAZETAEXPRESS.COM



### **Gara që u fitua nga Pacolli - Politika - Gazeta Express**

Zëvendëskryeministri i Parë Behgjet Pacolli ka njoftuar të enjten se Tanzania e ka njohur pavarë...

 34

1 Comment

# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli added 12 new photos.  
May 31, 2013 · 🌐



Rruge me e shkurte prej Kamenice per ne Prishtine



👍 568

10 Comments 11 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli ✓

June 3, 2013 · 🌐



Trepçën nuk duhet ta përcjellë fati i njëjtë i ndërmarrjeve që janë privatizuar deri më tani në Kosovë. Gjiganti metalurgjik, sipas njohësve të ekonomisë duhet të trajtohet më ndryshe.

/Postuar nga Admin/

INFOKOSOVA.NET



### Propozimi i Pacollit, opsion i mirë për Trepçën

Vetë termi privatizim në Kosovë sipas tyre nuk është referencë për storie suksesi. Ndërkaq, idej...

👍 145

8 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

June 5, 2013



Nota Verbale e njohjes nga Tanzania si dhe ne foto Zv.kryeministri Pacolli me presidentin e Tanzanise z.Jakaya KIKWETE dhe me ministrin e puneve te jashtme dhe bashkepunimit nderkombtar te Tanzanise z.Bernard MEMBE

THE UNITED REPUBLIC OF TANZANIA  
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS AND  
INTERNATIONAL CO-OPERATION,  
P.O. BOX 3026,  
DAR ES SALAAM.

O/A 699/755/01

The Ministry of Foreign Affairs and International Cooperation of the United Republic of Tanzania presents its compliments to the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo and has the honour to formally inform your Excellency and through you to the People of Kosovo, that following the visit and application for recognition made by H.E Behgjet Pacolli, First Deputy Prime Minister to Tanzania, and following the decision of the Government and endorsement by the Parliament on the 29<sup>th</sup> of May 2013, Tanzania has officially recognised Kosovo as an Independent Sovereign State. Tanzania has further urged other members of East and Southern Africa to do the same.

The Ministry of Foreign Affairs and International Cooperation of the United Republic of Tanzania avails itself of this opportunity to renew to the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo the assurances of its highest consideration.

Dar es Salaam, 05 June, 2013.



Ministry of Foreign Affairs of the  
Republic of Kosovo.  
PRISTINA



375

7 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

June 7, 2013

Të nderuar miq

Kuvendi I Kosovës, përfundimisht miratoi një rezolutë për Luginën e Preshevës. Thënë të drejtën, në seancën paraprake, unë pata shkuar dhe nga afer ndjeka punimet e seancës duke shprehur që kjo rezolutë do të miratohej. Nuk dua të bëhem pjesë e mosmarrveshjeve ndërmjet kryeministrit dhe disa deputetëve që ndodhën atë ditë sa I përket kësaj.

Them kështu ngase debati atë ditë zhvillohej në frymën e propozimeve dhe dhe unë i gëzohesha faktit që të gjithë diskutonin për një zgjidhje më të mirë.

Një hije e keqe ra, në momentin kur deputetet nuk ishin prezent për votim të kesaj rezolute dhe u ngrit dilema për qëllimin dashamirës ndaj kësaj pjese të popullit tonë në atë pjesë të kufirit.

Në seancën e fundit, të enjten, u miratua rezoluta, Sigurisht një lajm shumë I mirë dhe veprim shumë I nevojshëm. E mbështes idenë po ashtu që kjo qështje të bëhet edhe pjesë e kushtetutës, ngase rëndësia është shumë e madhe.

Rezoluta si e tille nuk është asgjë nëse nuk kemi veprime konkrete. Është shume e drejtë të mbrohen të drejtat e shqiptarëve në luginën e Preshevës, ashtu siq vepron Serbia në Kosovë, edhe pse ata kane qellime thjesht politike në disa raste. Kur flas për veprimet konkrete që duhet të ndërmerren, e kam fjalën për fillimin e lehtësimit të jetës së këtyre qytetarëve. T'u japim ndihme në arsim, në ekonomi në kulture. Pra, t'u ndihmojmë në qdo aspekt që shkon në dobi të bashkëkombasvetanë. Të kemi bashkpunim të rregullt me spektrin politik shqiptar në këtë anë. Të ngrisim qështjen e të drejtave të tyre edhe në raport me nderkombetarët.

Tu krijojmë disa lehtësira fiskale për prodhimet që vijnë nga ajo treve. T'u mundësojmë akses në veprimtaritë ekonomike dhe akademike në Kosovë, ndërsa këto veprime kursesi mos ti përdorim këto veprime për poena politike në Kosovë. Të krijohet ideja e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave. Krijimi I tregut ekonomik unik mbarëshqiptar, të përfshijë sipas modaliteteve edhe Luginën e Preshevës.

153

9 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

June 8, 2013

Të nderuar miq të mi

E lexova një lajm në portalin autoritativ Indeksonline. Ajo që dua të them është se përgjegjësia që kam, më bën që të sakrifikoj shumë gjëra që s`kam pasur nevojë ti sakrifikoj. Është e vërtetë se unë kam deklaruar 60 për qind të hotelit grand vetëm për një fakt. Para se të hyja në politikë, kompania ime ka blerë në mënyrë të rregullt dhe nëpërmjet llogarive bankare të bankave ndërkombëtare ka paguar 5 milion e 100 mijë euro. Këto mjete nëpërmjet këtyre rrugëve bankare janë derdhur në llogarinë e AKM së atëhershme(AKP-së së tashme). Këto mjete nuk vijnë nga fitimet e kompanisë time nga Kosova, por vijnë si rezultat I punës shumë vjeqare dhe të mundimshme që kam bërë si qdo mërgimtar tjetër jashtë Kosovës.

Për opinionin publik dua të sqaroj se janë ndërmarrë të gjitha që kjo pronësi të legjitimohet dhe me kohë të kryhen të gjitha obligimet e marra me kontratën, sa I përket përmbushjes së obligimeve, (që në Kosovë quhet SPIN OFF). Këto veprime janë marrë me kohë dhe po të ndodhte ashtu siq korrektësia dhe drejta e do, sot kryqyteti do të kishte edhe një objekt që do të shkëlqente, shoqërisë do ti sillte mirësi si në rrafshin fiscal ashtu edhe në garantimin e mbi 400 vendeve të punës. Kjo do ti shtohet edhe 2500 vendeve tjera të punës që kompanitë e mija sot garantojnë në Kosovë.

Politizimi I thellë I kësaj qështje, pamundësia e zgjidhjes së këtij problemi për shkak të sjelljeve jashtë normave të biznesit të AKM(AKP), dhe të bashkëpronarit minoritar kanë bërë që sot ky objekt të mbetet vetëm një gërmadhë dhe të kalojë në rrugët e gjyqësisë.

Për shkak të politizimit të thellë edhe të disa organeve gjyqësore kjo qështje gjendet ende pazgjidhur nëpër sirtaret e gjyqtarëve.

Fillimisht, Gjykata komunale e pati trajtuar këtë lëndë dhe vendimi I parë I kësaj gjykate ishte në favor të kompanisë time dhe masa siguroese e lëshuar në favorin e kompanisë time, që është ende në fuqi dëshmojnë fare mirë se kjo pronë nuk mund të tjetërsohet dhe se vendimi I prerë nuk është marrë.

Kompania ime është në pritje të vendimit nga kjo Gjykatë, pasi që ndaj vendimit të parë,, bashkëpronari ishte ankuar dhe një gjykatës I Gjykatës së Apelit e kishte kthyer në rishqyrtim për shkaqe të pakuptueshme dhe të pabaza. Ky rishqyrtim ende nuk është proceduar.

Andaj dikujt që lëshon deklarata denigruese u përgjigjem në mënyrë civilizuese që deklarimet duhet ti bazojnë në fakte.

Në emër të demokracisë, dhe legjitimitetit të pronës, firma ime s`do të ndalet asnjëherë deri tek vendimi I formës së prerë në instancën më të lartë Gjyqësore këtu në Kosovë(në Gjykatën Kushtetuese), e jashtë Kosovës deri tek vendimi I Gjykatës së Strasburgut gjegjësisht i marrëveshjeve bilaterale të nënshkruar me shtetin zviceran.

Prona është e shenjtë dhe do të jetë e shenjt si në qdo vend të civilizuar. Paragjykimi I dikujt që unë nuk është dashur ta deklaroj pronën e kompanisë time është I gabuar, tendencioz dhe I kundërligjshëm. Për këtë pronë janë paguar mjetet dhe ato mjete që sot janë në arkën e AKP-së konsiderohen si pronë e kompanisë time pasi që për to nuk ekziston ndonjë vendim tjetër I formës së prerë.

Pra është obligim imi institucional që këtë pronë ta deklaroj dhe unë e kam bërë këtë. Po të kisha vepruar siq dikush deklarohet unë nuk do të respektoja ligjet e AKK, të cilat fare mirë kushtëzojnë qdo bartës institucional që të deklarohet për kapitalin dhe pronën e tij.

Jam shumë I qetë në këtë qështje sepse kam vepruar siq duhet dhe siq e parasheh ligji.

Nëpër portale, kam parë edhe disa komente të disa lexuesve që shprehin "mllefin" e tyre për pasurinë timë. Për këta lexues kam një përgjigje: Pasuria ime nuk është fituar në Kosovës por është fituar jashtë Kosovës dhe kjo dihet. Firma ime jashtë Kosovës, sot I subvencionon pothuajse të gjitha subjektet e veta në



Kosovë, pasi që këto të fundit për shkak të rrethanave, fuqisë së ulët blerëse në Kosovë, për shkak të ekonomisë joformale, nuk janë profit prurëse.

Arsyeja kryesore pse këto subjekte edhe në mungesë të profitit vazhdojnë të operojnë në Kosovë, është përgjegjësia që e ndiej ndaj familjeve të cilave u garantohen të ardhura.

Po ashtu, dua të ju them se MABETEX, pronësitë e veta nëpër Kosovë, mbi 90 për qind I ka përvetësuar nga tregu I lirë dhe përveq dy rasteve (Farmed-aty ku sot është EULEX-I dhe ndërtesa e Ramiz Sadikut-ku gjendet drejtoria e MABETEX në Kosovë), nuk ka privatizuar nga AKP.

E vetmja kontratë që ndërmarrjet e mija kanë kryer me autoritetet publike është Rilindja ku përpos obligimeve kontraktuale, këtij objekti, Mabetexi I ka dhuruar edhe amfiteatrin. Mos të flasim për miliona e miliona euro që janë investuar në ndihmë familjeve në nevojë, kontribut në ngritjen e infrastruktures së parlamentit, ngritjes së Universitetit Amerikan, e kontribute tjera janë të shumta. Mirë është kjo, dhe ju them se Dikushi sdo të më dekurzjoj asnjëherë në misionin tim të shkoj përpara, ngase ai Dikush nuk e përfaqëson askënd, e aq më pak realitetin e shoqërisë kosovare që ka qenë dhe mbetet e mrekullueshme. Ai "Askushi", nëse dëshiron të jetë "Dikush"i, duhet të merret me dikend tjetër e jo me mua.

237

24 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

June 11, 2013 ·

<http://www.telegرافي.com/.../dakordohen-per-krijimin-e...>



WWW.TELEGRAFI.COM

### Dakordohen për krijimin e një zone të lirë ekonomike

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli ka pritur sot në një takim ministrin e Ekonomisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, Sulltan Saeed Al Mansoori, me të cilin është dakorduar që të ketë një bashkëpunim...

136

7 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli ✓

June 12, 2013 · 🌐

...

Urojme te gjithë qytetaret e Republikës së Kosovës me rastin e 12 Qershorit dites së çlirimit të Kosovës në 14 vjetorin e saj.

👍 473

19 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli ✓

June 13, 2013 · 🌐

...

Mediat në Emiratet e Bashkuara Arabe lidhur me viziten e delegacionit të lartë të këtij shteti në Kosovë

<http://www.wam.org.ae/servlet/Satellite?c=WamLocEnews...>

WWW.WAM.ORG.AE

WAM

i

👍 64

3 Shares



Behgjet Pacolli ✓

June 13, 2013 · 🌐

...

Shmarrocët që vrasin

Të nderuar miq,

Menjëherë pas luftës në Kosovë unë kam marrë vendim që të kthehem në Kosovë dhe të përpiqem ti ndihmoj këtij vendi. Për katër vite, para shpalljes së pavarësisë unë kam themeluar organizatën "Kosova Neë Alliance", me të cilën kam lobuar në SHBA, në periudhën kur ky shtet ishte i involvuar në zhvillime të brendshme pas 11 shtatorit. Rreth meje, në atë periudhë unë kam ofruar personalitete të shquara dhe me ndikim në Washington, të cilët kanë ndihmuar kauzën tonë të shpalljes së shtetit.

Shume shpejt do të dalë edhe një libër me fakte, të cilat pasqyrojnë këtë punë në atë kohë. Ky lobim gjithsesi kishte për qëllim që emri i Kosovës të ishte aktual në Washington dhe të krijojë klimë të favorshme për për të drejtën e Kosovës për të krijuar shtetin.

Kthimi im në Kosovë pas intervenimit tim në Kabul për lirimin e Shqipe Hebitit karakterizohej nga një besim dhe ndjenjë e fuqishme për njerëzit e mi, njerëzit e Kosovës. Që nga ajo periudhë e deri më tani, unë jam i ushqyer me këto ndjenja. Ju besoj njerëzve, iu kam besuar dhe vazhdoj të ju besoj sepse kam ndjenja njerëzore. Është fat për ne që qytetarët e Kosovës janë të edukuar dhe tek ta mbizotëron dashamirësia, edukata e mirë familjare dhe mbajtja e fjalës së dhenë. Kjo ishte preteksti pse unë u futa në Kosovë, u futa në politika pa asnjë plan paraprak. Hyra në një ambient që nuk dija se si funksionon dhe jetoja gjithmonë

me ndjenjën e mallit për të shkuarën dhe me qëllimin fisnik për të kontribuar pozitivisht.

Qdo gjë tjetër arrihet, dituria mësohet, pasuria arrihet me punë, mirëpo edukata dhe shpirtbardhësia nuk arrihen asnjëherë, nëse atë nuk e ke pjesë përbërëse të personalitetit. Qëllimi i këtij shkrimi janë mu këta njerëz.

Këto ditë e patë një kampanjë mediatike të pa skrupull të nxitur nga një person me emër dhe mbiemër, e ai është Ramadan Idrizaj, për mua një SHMARROC i vërtetë. Ky njeri i paskrupullt, SHMARROC, i cili erdhi tek unë plot dy muaj, pasi që kompania ime kishte blerë nga shitja e lirë ndërtesën e FARMEDIT, shfrytëzoi mikpritjen time në Lugano në vitin 2005 (edhe pse ai thotë që më paska pasur mik më herët, unë atë njeri për herë të parë e kam takuar aty), në hotelin pesë yjesh bashkë me gruan (qëndroi katër ditë dhe nuk pati nevojë të paguaj asgjë), më impresionoi me propozimet e tij, u paraqiti si doktor dhe tha se FARMED është afër spitalit dhe duhet të bëhej një spital.

Më pëlqeu ideja dhe pa menduar dy herë, i dhash atij, (sipas kërkesës së tij), dy variante: ose ta blejë dhe ta ndërtonte spitalin për të cilin fliste, (unë e shihja si nevojë të madhe për Kosovën atëherë), ose varianti tjetër që isha gati të investoja bashkë me të vetëm të ngrisja një spital dinjitoz. Unë atij i dhash këto mundësi, por me kalimin e kohës, ai nuk e bëri atë, as të parën e as të dytën. Pas afro 8 muajve, ky far "doktor" Idrizaj, prap erdhi dhe kërkoi i dëshpëruar për mosrealizimin e kontratave, (duke kërkuar falje që s'ka mund të implementoj at) një borxh prej 250 mijë euro për të paguar një borxhli të tij. Ashtu siq, etika ime e do, unë i ndihmova atij dhe ai kurrë këtë borxh nuk e ktheu. Duke kuptuar më vonë se ky ishte njëri prej atyre Shmarrocëve (në anën tjetër dëgjoja se ai pasurohej duke shfrytëzuar nëntokën dhe njerëzit e kriminalizuar), e pash të arsyeshme që të kërkoj borxhin të më kthehej prapa, të cilin më mirë do ta destinoja tek ata që kanë nevojë e jo tek një njeri i tillë.

Kur erdhi puna që ai duhej të paguante borxhin, ai shfrytëzoi disa media dhe me intrigat e tij përpiqet të përdorë atë rrugën deri tash mirë të njohur mediat, me shpifje dhe rrenat e tij, tenton të denigrojë personalitetin tim. Këtu kam një pergjigje për këtë njeri. Ti mundesh "zotri" të përdorësh nëntokën tënde, ti mund të përdorësh metodat tua, edhe mediat, por mos mendo se ti më dëmton mua. Opinioni publik të njeh Ramadan Idrizaj. Të njohin organet e rendit dhe ligjit se kush je ti. Të njohin studentët e tu, kolegët e tu dhe ata të gjykojnë më së miri. Unë nuk merrem me ty dhe ky rast, është fakt që më mëson të anashkaloj ty dhe njerëzit e sojit tënd që ende për fat janë të paktë në shoqërinë tonë, e cila do po ashtu do ti gjykojë. Por më dhimbet energjia e ime, e hargjuar me ty dhe njerëzit e sojit tënd dhe frika ime tani është se për shkak të këtij mësimi nga ti, mos po anashkaloj edhe njerëzit që e meritojnë afërsinë me mua.

Në fund dua ta përmend një thënie të gjyshit tim: Shumë herë buka jote të vret, atëherë kur i ndihmon njerëzit jomeritor. Por pyetja është se si me identifikoj në fillim këta njerëz? Unë vazhdoj të mbaj zemren e hapur, dhe e lus perendimë që në të ardhmen në këtë zëmërgjerësi të kenë qasje njerëzit meritor.





Behgjet Pacolli ✓

June 14, 2013 · 🌐



Postuar nga Admin

INFOKOSOVA.NET



### Shmarrocët që vrasin

Menjëherë pas luftës në Kosovë unë kam marrë vendim që të kthehem në Kosovë dhe të përpi...

👍 157

14 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli ✓

June 17, 2013 · 🌐



<http://gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=12061>

WWW.GAZETATRIBUNA.COM



### 200 të rinj mitrovicas aderojnë në AKR

Aleanca Kosova e Re, në prani të një numri shumë të madh të delegatëve, mbajti Kuvendin e Tretë Zgjedhor të Forumit Rinor të Degës së AKR-së në Mitrovicë, ku të pranishëm ishin edhe Presidenti i partisë, Behgje

👍 81

5 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

June 17, 2013 · 🌐



Kuvendi i Tretë Zgjedhor të Forimit Rinor të Degës së AKR-së në Mitrovicë. Miresearchje te gjithë atyre që aderuan sot ne AKR.



👍 197

4 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

June 18, 2013 · 🌐



Takimi me delegacionin e Tajlandes



👍 314

10 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

June 18, 2013



Në homazhe para varrit të dëshmorit të kombit Basri Canollit-Shpendit në Canaj të Marecit.



733

13 Comments 23 Shares



Behgjet Pacolli

June 18, 2013

Fjala e Presidentit te AKR,z. Behgjet Pacolli, njeherit edhe zvkryeminister i pare i Qeverise se Kosoves ne Marec, lagja Canaj, ne perkujtim te deshmorit te kombit. admin <https://www.facebook.com/video/video.php?v=10200131826443325>



Ismet Mulaj is with Myzejene Selmani and Banush Pacolli.

June 18, 2013

Fjala e Presidentit te AKR,z. Behgjet Pacolli, njeherit edhe zvkryeminister i pare i Qeverise se Kosoves ne Marec, lagja Canaj, ne perkujtim te deshmorit te kom... See more

108

4 Comments 3 Shares





Behgjet Pacolli ✓

June 19, 2013 · 🌐



Marrëveshja ndihmon procesin e njohjeve

<http://www.epokaere.com/index.aspx?SID=13&PMID=4&LID=2...>

EPOKAERE.COM

Marrëveshja ndihmon procesin e njohjeve



👍 56

6 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli ✓

June 23, 2013 · 🌐



Urojme qe zgjedhjet te kalojne si eshte me se miri ne Republikën e Shqiperise.

👍 413

22 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

June 26, 2013



Të dashur miq,

Dëshiroj të shpreh urimet e mija më të sinqerta për fituesit e zgjedhjeve në Shqipëri, dhe për sjelljen dinjitoze të palës që ka humbur zgjedhjet.

Një gjë me të cilën krenohemi edhe ne, është sjellja e popullit shqiptar dhe klasës politike gjatë dhe pas zgjedhjeve. Ata ju kanë treguar botes se dimë se çka është civilizimi, si të respektohet demokracia dhe vota e lirë.

Pavarësisht nga kush do të fitonte zgjedhjet në Shqipëri, ka ardhur koha e një ideje të madhe. Nuk ka ide më të fuqishme sesa ajo ide, koha e të cilës ka ardhur. Është ideja e veprimit të përbashkët ekonomik, të koordinuar apo e një hapësire të përbashkët kombëtare dhe rajonale, ku hapësira e banuar nga shqiptarët ka peshën më të madhe, si paradhomë e integritetit evropian dhe është obligim ynë që ti japim shembullin me të mirë bashkësisë nderkombëtare. Më konkretisht, ka ardhur koha e projekteve të përbashkët që përkryejnë pavarësinë energjitike të shqiptarëve, nëpërmjet ndërtimit të linjës së interkonieksionit, dhe burimeve të reja energjitike që e shohin Shqipërinë dhe Kosovën si një sistem unik. Ka ardhur koha e një projekti të përbashkët për portin e Shëngjinit, në realizim të premtimit të kahershëm të qeverisë së Shqipërisë, për t'ja dhënë Kosovës atë. Ka ardhur koha e heqjes së barrierave doganore mes dy vendeve. Ka ardhur koha e një strategjie zhvillimi ekonomik mbarëkombëtar. Ka ardhur koha e mbledhjeve periodike të qeverive të dy vendeve, e qeverive të rajonit për të nxitur projektet e përbashkët, pra që ky bashkëpunim të institucionalizohet!

Ka ardhur momenti i fundit që ti kundërvihet korrupsionit dhe dukurive negative. Ka ardhur koha e ndërtimit të një administrate funksionale, që funksionon sipas ligjit. Ka ardhur koha kur premtimet të kthehen në vepra.

Ka ardhur koha për të krijuar një platformë agroekonomike për një treg të përbashkët pjesë e së cilës do të mund të ishin shtetet tjera në rajon.

Krejt këto janë gjëra që qytetarët e Shqipërisë por edhe në Kosovë i kemi kuptuar se koalicioni fitues do të realizojë

Partia fituese ka premtuar shumë gjëra të tjera, edhe pse me vështirësi, për shkak të situatës aktuale ekonomike, jam i bindur se do të fillojë implementimin e tyre

Jam i bindur se partia fituese e zgjedhjeve e ka kuptuar se tani duhet të lihen anash të gjitha dhe të flitet me gjuhën ekonomike. Zhvillimi ekonomik dhe shpëputja e popullatës nga varferia është strategjia më e mirë e një qeverie të qëndrueshme dhe rruga më e shkurtër për të ruajtur dhe përfutur miq nëpër botë.

Për fat të mirë, të dy krahët e politikës në Shqipëri e kanë patur në fushatë bashkëpunimin me Kosovën si prioritet të tyre, megjithë diferencat që kanë shfaqur. Unë jam krenar se këtë ide, së bashku me shumë intelektualë, me figura publike në Shqipëri, Kosovë, e rajon, e kam hedhur prej kohësh dhe kemi bërë disa hapa përpara në këtë drejtim. Sot për këtë ide po flitet shumë dhe do të kalojmë nga fjalët tek veprat! Na duhet zhvillim kombëtar që të kapim kohën e humbur dhe të parakalojmë ato shtete dhe kombe në rajon që janë para nesh.

Fituesve të këtyre zgjedhjeve u dëshiroj punë të mbare dhe do dëshiroja shumë që me këto reforma të fillohet menjëherë. b.p.

289

17 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

June 27, 2013 ·

RINI E PRISHTINËS

Ftoheni të merrni pjesë në Konventën e Forumit Rinor të AKR-së, Dega e Prishtinës.

PRISHTINA ESHTË RINI!

RINIA ESHTË AKR!

Postuar nga Admin.



237

6 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

June 29, 2013 ·

Presidenti i AKR-së Behgjet Pacolli gjatë fjalës së sotme në konventën rinore të Prishtinës! | Pallati i Rinisë.

Postuar nga Admin



323

6 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

June 29, 2013 ·



Zv.Kryeministri Pacolli gjatë njërës prej katër vizitave lobuese që zhvilloi në El Salvador. Në foto me zëvendës Presidentin e El Salvadorit Salvador Sánchez Cerén, dy miq tjerë bashkëpunëtorë gjatë lobimit si dhe mikun e madh të shqiptarëve z.William Walker. admin



511

23 Comments 11 Shares

# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli added 23 new photos.

June 30, 2013 · 🌐



👍 851

35 Comments 15 Shares



Behgjet Pacolli

July 1, 2013 · 🌐



E falenderoj profesorin e nderuar, Kryetarin e Prishtinës, z. Mustafa për rekomandimin e tij që nëse nuk më pëlqen Prishtina, mund të ik. I nderuari Kryetar, unë edhe mund të ik, falë punës dhe angazhimit tim kam ku të shkoj dhe ku të mbaj familjen time, POR, ikja ime nuk do të zgjidh problemin dhe kaosin e Prishtinës, dështimin tënd dhe të paraardhësve tu për të siguruar jetë më të mirë në komunën tonë, ikja imë nuk e fsheh, vetëm e ven në pah edhe më shumë.

Nuk është hera e parë i nderuari Kryetar që JU ofroni si zgjidhje të problemeve tua largimin e kritikëve. Lagjet e Prishtinës të cilat duken si rrugë të Kabulit, pa asfalt, pa ujë, me gropa dhe pluhur nuk mbulohen nga ikja ime. Puna ime flet pa folur unë dhe ashtu do të duhej të ishte edhe për JU, por ju doni të na verboni të mos shohim paaftësitë e administratës tuaj apo të na largoni të mos flasim për shëmtinë e Prishtinës.

Për dallim nga shumica e bashkëqytetarëve tonë, unë kam ku të shkoj, POR nuk kanë ku të shkojnë ata të cilët nuk kanë ende sot ujë, asfalt dhe vend ku mund të ndihen të sigurt për jetën dhe sigurinë e fëmijëve të tyre. Ato janë dështimet tua dhe të administratës tënde Kryetar dhe përkundrejt respektit njerëzor që ka për JU më befasoni me verbërine për të parë shëmtinë për të cilën JU keni kontribuar për dy mandate të plota.

Me respekt,

Behgjet Pacolli  
Qytetar i Prishtinës

👍 1.4K

213 Comments 62 Shares



Behgjet Pacolli

July 2, 2013 · 🌐



Gjatë një takimi me z.Edi Rama dhe Z.Pandeli Majko.

Nder te tjera pata rastin te bisedoj per reformat ekonomike qe qeveria e ardhshme ka per qellim te i implementoj.

Është biseduar, për qasjen e përbashkët të Kosovës dhe Shqipërisë në projektet ekonomike, e sidomos për krijimin e një tregu të përbashkët gjithëkombëtar pa barriera,

Folëm për portin e Shengjinit, për platformat agroekonomike që duhet të themelohen për një treg të përbashkët gjithëkombëtar.

Një ditë pas përfundimit të zgjedhjeve lokale ka mbajtur konferencë për media presidenti i AKR-së, zotëri Behgjet Pacolli. Ai zgjedhjet i ka cilësuar si të suksesshme, ka përmendur dy komunat në të cilat partia e tij është në balotazh, atë të Gjakovës dhe të Mitrovicës. Pacolli ka thënë së janë rritur në votë më dallim nga zgjedhjet e kaluara. Në vazhdim japim deklaratën e plotë të presidentit të AKR-së, zotëri Behgjet Pacolli.

Behgjet Pacolli: Zgjedhjet e djeshme në pikëpamje të organizimit shënuan një hap të madh në pjekurinë demokratike të Kosovës dhe shtetit të saj. Ato treguan një nivel të mirë të pjesëmarrjes së popullit në zgjedhje, megjithatë problemet e listave. Kjo është dëshmi e dëshirës së popullit për të marrë vetë fatet e qeverisjes në duart e veta. Megjithatë problematikën në veri zgjedhjet treguan se shteti i Kosovës po vendos ngadalë, por sigurt kontrollin e vet në gjithë territorin. Pjesëmarrja zyrtare është 45-50 për qind, dhe sipas kalkulimeve tona, (me pastrimin e listave), pjesëmarrja reale është rreth 70 për qind.

AKR dhe lista e kandidatëve për kryetar të Gjithë Kosovës dhe të Kosovës së Mëtejme, si: Menduh Xhepa, Ismet Mustafa, Beqir...

[See More](#)

👍 144

5 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
November 11, 2013 · 🌐



Të dashur miq,  
Shprehi ngushëllimet e mija më të thella për popullin dhe qeverinë e Filipineve për viktimat e Tajfunit që goditi këtë vend.  
E ndaj dhimbjen me popullin mik të Filipineve.  
Behgjet Pacolli



👍 1.1K

25 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

November 11, 2013



Mbi 110.000 vota të pavlefshme, ndërsa në votim kanë marrë pjesë mbi 800 mijë vetë.

Afro 30 mijë vota të pavlefshme janë në votimin për kryetar.

Mbi 80 mijë janë në votimin për parti.

Ky është cënim i madh i vullnetit të popullit. Afro 15% e votave kanë shkuar dëm.

Cilat janë arsyet ?

Votimi ndër ne është demokratik, por është shumë i komplikuar për qytetarin tonë.

Në fletëvotimin për parti, për asambleista mund të jenë bërë më shumë lojëra në përpjekjet për të manipuluar votën.

Çfarë duhet bërë në këto kushte ?

Të kemi rivotim ?

Apo t'i hyjmë një rishqyrtimi të vullnetit të popullit, nëpërmjet rivlerësimit të votave ?

Në votimet e ardhshme duhet ta thjeshtojmë fletën e votimit. Nuk jemi as në Suedi, dhe as në Finlandë.



643

32 Comments 16 Shares



Behgjet Pacolli

November 13, 2013

Aleanca Kosova e Re, falenderon qytetarët e Kosovës që I besuan AKR-së me votën e vet në këto zgjedhje. Ky besim është edhe një dëshmi që programi dhe vizioni I AKR-së vazhdon të gjejë mbështetje te shoqëria kosovare.

AKR zotohet tek qytetarët e Kosovës se ka vepruar dhe gjithmonë do të veprojë konform interesave të tyre dhe shtetndërtimit dinjitoz të Kosovës.

Zgjedhjet lokale të tre nëntorit dëshmuar për pjekurinë e lartë politike të qytetarëve të Kosovës në rrugën e integritimit në familjen e madhe të vendeve demokratike.

AKR-ja, falë besimit të qytetarëve shkon në balotazh në dy komuna të Kosovës, Gjakovë respektivisht Mitrovicë.

AKR bën thirrje te elektorati I këtyre dy komunave që të vazhdojnë të mbështesin kandidatët e saj, Mimoza Kusari Lilen dhe Agim Bahtirin duke garantuar se qeverisja në këto dy komuna do të jetë në funksion të qytetarit, mirëqenies së tij, dhe një qeverisje për të gjithë qytetarët pa dallime politike, fetare, etnike etj.

AKR në këto dy komuna, do të jetësojë premtimet që dalin nga programi I AKR-së, program ky tashmë I njohur për të gjithë qytetarët.

Sa u përket komunave të tjera, ku AKR-ja nuk është pjesë e garës në raundin e dytë, gjithmonë duke falenderuar elektoratin për besimin e dhënë, I fton që edhe më tutje të qëndrojnë besnik programit dhe vizioni të AKR-së, se vetëm së bashku mund të jemi më të qëndrueshëm në rrugëtimin tonë të përbashkët politik.

AKR-ja si parti liberal demokrate e dëshmuar, vlerëson se në rrethanat aktuale të mos ndërhyjë në vullnetin individual të votuesit për mbështetje ose jo të ndonjërit prej kandidatëve në komunat përkatëse.

Kryesia e AKR-së në respektim të statutit dhe të frymës liberale, nuk ndërhyr tek asnjë degë e saj, dhe rekomandon strukturat e saj që të respektojnë vullnetin e qytetarëve.

AKR inkurajon qytetarët e Kosovës që edhe në raundin e dytë të zgjedhjeve të dalin sa më masovisht dhe të tregojnë edhe njëherë pjekurinë e lartë politike të dëshmuar me 3 nëntor.

admin.

328

18 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

November 19, 2013

Të nderuar miq,

Neser në mbrëmje, në orën 22.30 jam I ftuar në një intervistë në RTV 21.

Do të flasim për aktualitetin politik pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, për situatën dhe vështirësitë e raundit të dytë në Gjakovë, për perspektivën e Gjakovës dhe Mitrovicës me qeverisjen e AKR-së dhe shumë e shumë tema të tjera.

b.p

420

16 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

November 21, 2013

Ngushëllime të sinqerta familjes Olldashi. Vlerësoj lartë kontributin e ish deputetit Olldashi. Ndarja e parakohshme nga jeta e Olldashit është e dhimbshme". BP

981

35 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

November 27, 2013

Të dashur bashkëqytetarë të mi, bashkëkombas të mi, kudo që jetoni,

Festa kombëtare e Shqipërisë, është ditë feste për gjithë shqiptarët kudo që jetojnë, pra dhe për ne kosovarët që prej pak vitesh kemi shtetin tonë të ri, të lirë dhe të mosvarur. Ne kemi një histori mijëra vjeçare të përbashkët, ku 101 vjetët e fundit pas ditës së shenjtë të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë kanë gjurmët dhe kontributin e përbashkët të të gjithë kombit. Bijtë dhe bijat e Kosovës, heronjtë e Kosovës e kanë shenjuar këtë pavarësi dhe 101 vitet e saj, me firmën e tyre në Deklaratën e pavarësisë, me gjakun e tyre në betejat më të rëndësishme të kombit për afirmim të identitetit tonë, për liri, për pavarësi, për shtetformim.

Të dashur bashkëqytetarë,

Kombet e mëdha i kanë përvjetorët jo thjesht si ditë përkujtimi, por si ditë projektimi për të ardhmen e përbashkët. Heronjtë e pavarësisë dhe të lirisë, nuk do ishin të qetë nëse ne, pasardhësit e tyre nuk do të punojmë të gjithë së bashku për mirëqenien dhe begatinë e popullit. Nuk ka liri dhe pavarësi të përkryer, nëse nuk ka zhvillim ekonomik dhe mirëqenie. Ndaj le të shërbejë kjo festë si moment reflektimi për të menduar për të ardhmen e sigurt nëpërmjet zhvillimit ekonomik. Ky zhvillim ekonomik duhet të arrihet nëpërmjet shfrytëzimit të të gjithë burimeve natyrore, njerëzore, punësimit të rinisë sonë të mrekullueshme. Ne duhet të bashkojmë ndërkohë të gjithë energjitë tona kombëtare kah rikrijimi i të gjithë epërsive tona gjeopolitike, forcimi i aleancave strategjike, në të gjithë territoret ku banojnë shqiptarët duke filluar pikërisht nga ekonomia, si bazë e mirëqenies për të gjithë. Në fillim të shekullit të 21-të, shqiptarët si komb duhet të rreshtohen të parët në garën për begati të gjithë shoqërive dhe vendeve të rajonit. Kjo do të ishte përbushja më e mirë e aspiratave të heronjve të përbashkët të lirisë dhe pavarësisë sonë kombëtare.

Behgjet Pacolli

688

25 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

November 29, 2013 · 🌐



Mimoza Gjakovën do e bëjë shembull se si qeveriset një Komunë

Kandidatja për Kryetare të Komunës së Gjakovës znj.Kusari Lila pasditen e sotme ka takuar banorët e fshatit Botushë ku prezent ishte edhe unë.

I kam bërë thirrje banorëve të fshatit Botushë që të votojnë znj.Kusari Lila, pasi që Gjakova ka nderin të ketë një kryetare të veshme, një përsosur me zemër të madhe dhe një grua e cila ka vizion të qartë dhe konkret për zhvillimin e Komunës së Gjakovës. "Mimoza do ketë gjithmonë mbështetjen për realizimin e projekteve, Mimoza Gjakovën do e bëjë shembull se si qeveriset një Komunë, Mimoza është shpresa e vetme për banorët e Komunës së Gjakovës".

Kandidatja e Aleancës Kosova e Re për Kryetare të Komunës së Gjakovës, znj.Mimoza Kusari Lila, ka falenderuar banorët e fshatit Botushë për mbështetjen e vazhdueshme, duke i siguruar që pas 1 Dhjetorit ndryshimi do vërehet përmes punës dhe angazhimit të përbashkët.

"Unë do jem Kryetare e të gjithë banorëve të Komunës së Gjakovës dhe investimet asnjëherë nuk do t'i drejtoj në vendet ku jam votuar më shumë. Komuna e Gjakovës sot është sinonim i varfërisë dhe nuk mund të paramendohet që zhvillimi i Komunës të bëhet në baza partiake.

Sot më duhet t'i them disa fjalë edhe për luftëtarët dhe trimat e Komunës së Gjakovës të cilët derdhen gjakun për liri dhe për një jetë më të mirë. Ideali i tyre nuk është plotësuar, familjet e tyre nuk kanë mirqenie të plotë dhe zhvillim, kontributi i luftëtarëve nuk është shpërblyer ende. Programi ynë përfshinë edhe investime konkrete për Kosharen e cila do të jetë vend që do pasqyrojë historinë e lavdishme por edhe vend i zhvilluar turistik. Për Botushën që në ditët e para të qeverisjes do të angazhohemi që të permisojmë infrastrukturën si dhe fermeret të jenë përfytyes nga fondit që do ndajmë për bujqësi dhe blegtori".

👍 378

17 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli ✓

November 29, 2013 · 🌐



Dega e AKR-së në Gjakovë konsideron se shpifjet e fundit të AAK-së në lidhje me "skenarët kriminal" janë përpjekjet e fundit për të manipuluar me opinionin publik pasi që pas 1 Dhjetorit s'do ta kenë më këtë mundësi.

AKR-ja nuk është parti e skenareve, por ndoshta komunikata e AAK-së bazohet në provojen që ky subjekt ka në lidhje me manipulimet e proceseve zgjedhore.

Pa dashur të ngrisim tensione dhe pa dashur që t'i rikujtojmë skenarët kriminal që qeverisja në largim i ka realizuar tash e 7 vite, AKR Dega në Gjakovë i bën thirrje të gjithë banorëve të Komunës së Gjakovës, që mos të bien pre e provokimeve të qeverisjes në largim dhe në mënyrë masive të dalin në zgjedhje në mënyrë që vullneti i banorëve të Komunës së Gjakovës të vendos për të ardhmen dhe për ndryshimin.

Kryetarit dhe qeverisjes që sot përfundoi mandatin i bëjmë thirrje që një herë në karrieren e tyre të respektojnë vullnetin e banorëve të Komunës së Gjakovës dhe mos të mundohen kot të manipulojnë me shpifje, se banorët e Komunës së Gjakovës tashmë kanë vendosur ashtu siq vendosën edhe me 3 Nëntor.

👍 219

7 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli ✓

November 29, 2013 · 🌐



AKR është në balotazh në dy komuna nga më të rëndësishmet e Kosovës si Gjakova dhe Mitrovica. Gjithmonë ne kemi qenë parti e fortë me ide dhe vizion në këto komuna, por jo prej ushtrive apo bandave elektorale. AKR nuk është akuzuar nga kurrkush për vjedhje votash siq po bën dikush sot : As në këto komuna, dhe as në gjithë Kosovën. AKR-së i kanë vjedhur sistematikisht votën duke filluar nga 2007 kur ne u paraqitëm për herë të parë. AKR nuk ka ushtri elektorale, AKR nuk ka hedhur para të pistë në fushatë për tubime të shtrenjta dhe blerje votash, sepse AKR beson tek forca e popullit.

Vetëm ne si popull kemi shprehjen «kur hajni thërret, kapeni hajnin». Kjo shprehje më kujtohet kur dëgjoj fabrikime banale se AKR ka skenarë kriminalë për vjedhje votash. Kush vjedh njehere, s'ka turp te vjedhe gjithmone. Kush s'ka vjedhur kurre me pare, ka turp te vjedhe dhe njehere te vetme.

AKR në Gjakovë dhe Mitrovicë ka krijuar frymën për ndryshim! Kjo frymë masive popullore i ka përfshirë të gjithë qytetarët brenda Kosovës dhe ata në diasporë që mbajnë familjet me djersën e tyre. Kush ndihet kosovar, kush ndihet gjakovar, kush ndihet mitrovicali, kush e do ndryshimin, do dale ne votim, apo ka ardhur ne Kosove dhe do të voton në 1 dhjetor. Arma jonë e vetme përballë hajdutëve me armë apo me para, është pjesëmarrja masive e popullit në votim, Vota e Lire. Edhe diktaturat shumëvjeçare bien përballë forcës së popullit. Në demokraci sikur është Kosova, arma për ndryshim është vota e popullit dhe të gjithë duhet të dorëzohen para saj. Nuk ka pushtete të përjetshëm..

👍 399

29 Comments 14 Shares





Behgjet Pacolli updated his cover photo.

November 30, 2013 · 🌐



👍 1.2K

46 Comments 25 Shares



Behgjet Pacolli ✓

December 5, 2013 · 🌐



Sonte njerëzimi padyshim humbi një personalitet të rrallë.

Nelson Mandela ishte dhe do të mbetet gjithmonë frymëzimi për një botë më të mirë. U preftë në paqe. b.p

👍 947

22 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli ✓

December 6, 2013 · 🌐



Gjithë Afrika e Jugut, gjithë Afrika, gjithë bota mbante sytë nga shtrati ku luftonte me vdekjen, një nga njerëzit më të mëdhenj të shekullit të 20-të, Nelson Mandela. Si një popull që e ka përjetuar genocidin në momente të ndryshme të shekullit që shkoi, aparteidin veçanërisht në vitet 80-90 të shekullit të shkuar, ne kosovarët e ndienim veprën e madhe të tij. Kështu ne, së bashku me botën, së bashku me popujt miq të Afrikës, së bashku me afrikanojugorët e ndjejmë dhimbjen pse me ikjen e tij nga jeta u largua një copëz histori. Respekti më i madh për figurën e Nelson Mandelës, do të ishte ruajtja e trashëgimisë së jashtëzakonshme që ai la : ruajtja e një shteti të barabartë për gjithë qytetarët, pavarësisht racës, etnisë, bindjes politike dhe fesë...Jam i lumtur që në pranverën e vitit 2010 e takove në një audiencë që më kishte rezervuar në rezidencën e tij në Johannesburg gjat një vizite duke lobuar për Kosovën. Ai e donte Kosovën!

👍 889

20 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

December 6, 2013



...Mandelen!

Miksha ime e madhe Rose Witaker,gruaja qe me mundesoj qe edhe une te jam ne listen e atyre qe kishin kontakte te drejtperdrejta me Nelson Mandeleb,me shkruan;

>>In Memory Of Nelson Mandela>>

He was a native son of South Africa, but that nation will surely pardon the rest of the world for claiming Nelson Mandela as one of our own as well. President Mandela was the champion, the avenger, the soldier and the statesman for all who despise injustice, having courageously put his own liberty and life on the line so that his oppressed countrymen and women could breathe free.

I first heard of him when I was in college and already engaged in the fight to end apartheid in that beautiful country on Africa's southern tip. As a member of my university's first South African Divestment Coalition in the 70's, I drew upon Mr. Mandela's commitment to fuel my own.

Later, as the first Assistant U.S. Trade Representative for Africa, I was honored to meet the heroic Mr. Mandela in person with President Clinton. Though President Mandela would not have remembered it, I shall never forget the warm embrace he gave me once -- an affectionate gesture that I found surprising until I realized that he had mistaken me for Oprah Winfrey.

Although humankind is poorer for the loss of Mr. Mandela, the loss is mitigated by the joy and privilege of having had him in our midst. Many aspire to leave the world better than they found it. Nelson Mandela actually did it, fortifying freedom, opportunity and justice.



186

7 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

December 6, 2013 · 🌐



Prishtinë, 06.12.2013

\

SHKËLQESISË SË TIJ

JACOB GEDLEYIHLEKISA ZUMA

President i Republikës së Afrikës së Jugut

President i Kongresit Kombëtar Afrikan ANC

Shkëlqesia Juaj,

I dashur President,

Me hidhërim të madh mësova për vdekjen e Presidentit tuaj të përjetshëm, babait të kombit jugafrikan, Nelson Mandela. Ne gjendemi shumë larg gjeografikisht, por unë dhe populli im kemi shumë arsye për ta ndjerë këtë humbje.

Si ish President, si zëvendëskryeministër i Kosovës kam patur rastin të takohem me Ju disa herë, të vizitoj vendin tuaj të madh dhe të prek kështu nga afër rëndësinë e veprës së kësaj figure historike.

Pata rastin të kuptoja thellë pse Afrika e Jugut, gjithë kontinenti afrikan, gjithë bota mbante sytë nga shtrati ku luftonte me vdekjen, Nelson Mandela, një nga njerëzit më gjurmëlënës të shekullit të 20-të.

Ndërkohë si një popull që e ka përjetuar genocidin në momente të ndryshme të shekullit që shkoi, aparteidin veçanërisht në vitet 80-90 të shekullit të shkuar, ne kosovarët e kuptonim që më herët veprën e madhe të tij.

Ajo vepër la ndikimin në gjithë botën, në shumë revolucione dhe luftëra për vetëvendosje, për drejtësi midis racave, etnive dhe kombeve.

Këto janë arsyet i dashur President Zuma, pse ne kosovarët, së bashku me botën, së bashku me popujt miq të Afrikës, së bashku me afrikanojugorët, e kemi të fortë dhembjen për largimin e Presidentit Mandela nga jeta.

Bashkë me të u largua një copë e madhe historie. Respekti më i madh për figurën e Nelson Mandelës do të ishte ruajtja e trashëgimisë së jashtëzakonshme që ai la; Një shtet i barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht racës, etnisë, bindjes politike dhe fesë.

Ne sot lutemi për shpirtin e tij, për familjen e tij, për trashëgiminë e tij politike dhe njerëzore.

Sinqerisht Juaji

Behgjet Pacolli,

Ish President i Republikës së Kosovës

President i Aleancës Kosova e Re



338

16 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

December 16, 2013

...

Nuk ka ngjashmëri absolute mes burrave të mëdhenj të kombeve të ndryshëm. Por tani kur ndiqja varrimin e të madhit Nelson Mandela, kur mendoja gjithë ceremonitë neper qytetet e vendet të ndryshme të Afrikës Jugore, për nder të tij, u binda se ky njeri po e ndihmonte dhe i vdekur vendin e vet, stabilitetin e tij, pajtimin midis racave të ndryshme. Kjo ishte arsyeja pse ceremonitë zgjatën aq shumë.

Edhe Ibrahim Rugovën tonë, kur vdiq e nderuan të gjithë, kundërshtarë dhe miq. Ibrahim Rugova gjithashtu, tash që mungon nga jeta, ka ndikuar shumë në pajtimin e politikës së dy krahëve, të shoqërisë sonë. Kujtimi i tij, mauzoleu i tij është bërë shtyllë ku mbahet ekuilibri i vendit, themel prej nga ka nisur shteti ynë i ri. Por tash duhet t'i kemi sytë nga e ardhmja, nga zhvillimi ekonomik, për të cilin ai fliste aq shumë. S'ka liri, dhe pavarësi, pa zhvillim ekonomik...

549

30 Comments [16 Shares](#)



Behgjet Pacolli

December 16, 2013

...

Dite historike per Kosoven. Gruaja e parë fillon detyren si kryetare komune. Nje grua nga me te suksesshmet ne historine e Kosoves. Model jo vetem per grate por per te gjithë, rinine, ata qe jane shkolluar jashte, model i politikës se re.

Dite historike per AKR. Po udheheq nje nga komunat me te rendesishme te Kosoves, po udheheq per here te pare pushtetin komunal.

Jam i emocionuar me menyren e qete dhe te qyteteruar me te cilen Mimoza e filloi detyren e veshtire. Nderoi deshmoret, dha mesazhe bashkuese per te gjithë, respektoi paraardhesin, takoi njerezit e punes dhe te rendit. I qofte e lehte puna ne sherbim te Gjakoves. Gjakova sot ndihet ndryshe, plot shprese...

957

62 Comments [17 Shares](#)



Behgjet Pacolli

December 16, 2013

...

"I am fundamentally an optimist. Whether that comes from nature or nurture, I cannot say. Part of being optimistic is keeping one's head pointed toward the sun, one's feet moving forward. There were many dark moments when my faith in humanity was sorely tested, but I would not and could not give myself up to despair."

- Nelson Mandela

146

8 Comments



Behgjet Pacolli

December 17, 2013

...

Jam shume i lumtur qe Akr do te udheheq ne dy komunat per te cilat jam angazhuar shpirtesishte prej kur kam ardhur ne skenen politike te Kosoves,Gjakoven dhe Mitrovicen.Manifesti gjegjesishte programi i pare i Aks-se,i shkruar ne fillim te vitit 2007, parashifte kjar krijimin e zonave te lira ekonomike ne keto dy komuna.E falamnderoj cdo kend qe pati kuptim dhe kontriboj ne jetesimin e ides se krijimit te ketyre zonave.Nje mirenjohje, pa dyshim, i shkon ministrive rrespektive (Ministris se Tregetise dhe Industrise), UAID-it dhe kryeministrise per kontributin e dhene per kete Iniciative.Zona e lire ekonomike do ti sjell ketyre komunave nje zwillim te hovshem.Qytetaret e ketyre komunave kane bere zgjedhje te drejte me voten e tyre e jam i bindur se kjo do te deshmohet me pune te ndershme te cilen do ta bejne ne menyre dinjitoze kryetaret rrespektiv zonja Kusari dhe zt.Bahtiri.Une atyre u deshiroj pune te mbar e mbeshtetja nga ana ime do te jet e fuqishme



397

22 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

December 17, 2013

...

I falënderoj të gjithë asambleistët dhe drejtorët e drejtorateve komunale, anëtarë të AKR në gjithë Kosovën, për sinqeritetin, angazhimin dhe përkushtimin në punë.  
Ju dëshiroj fat dhe suksese të mëtutjeshme në rrugëtimin tonë të përbashkët.  
Atyre që nuk janë rizgjedhur, ju them se puna e tyre nuk do të harrohet.  
Të rinjve, që nga tani kanë marrë detyrën, ju dëshiroj punë të mbarë dhe presim prej tyre punë proaktive, të dinjitetshme dhe transparente.



305

4 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

December 18, 2013

...

Accept your defeat, embraced your failure, pickup the challenge, keep moving work harder hoping that one day you will surely get there.



124

11 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli ✓  
December 18, 2013 · 🌐

...

Suksese Kancelares Merkel që u rizgjodh për herë të tretë në krye të qeverisë! Ka shumë arsye për ta uruar ne mbritjen e ketij objekti historik! Së pari ka bërë sërish një koalicion të madh politik së bashku me opozitën për të qeverisur. Së dyti, ka një bilanc të shkëlqyer arritjesh veçanërisht në fushën e ekonomisë për vendin e vet.

Por mbi të gjitha ne duhet të vlerësojme që Gjermania e zonjës Merkel e ka mbështetur Kosovën shumë në të gjitha planet. Më së fundmi po e mbështet nëpërmjet kushtëzimeve që i ka vendosur Serbisë në rrugën e anëtarësimit e që lidhen me vendin tonë. Gjermania dhe Britania e Madhe janë vendet më të qarta në imponimin që Serbia ta njohë Kosovën si shtet para se të anëtarësohet në BE! Mirënjohje Gjermanisë!

👍 271

13 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
December 18, 2013 · 🌐

...

Të nderuar miq,

po e publikoj të plotë intervistën time dhënë gazetës Epoka e Re, që sot është publikuar. Nëse keni kohë ju lutem lexojeni. b.p.

Flet për "Epokën e re", Behgjet Pacolli

U fuqizuar me punë

- Punuam ndershëm, prandaj na shpërblyen qytetarët

Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka thënë se shumëkush ka menduar se subjekti i tij politik ka humbur me hyrjen e tij në qeverisje. Ai ka thënë se zgjedhjet lokale e dëshmuar të kundërtën. "Puna jona e ndershme në qeverisje na u shpërblye nga qytetarët në zgjedhjet lokale duke fituar dy komuna. Besoj shumë se AKR-ja do të jetë një forcë politike e cila në zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të marrë mbështetje më të madhe nga qytetarët", ka thënë Pacolli. Sipas tij, fuqizimin e AKR-së në skenën politike e dëshmoi fitorja në komunën e Gjakovës dhe Mitrovicës. Pacolli ka thënë se me qeverisjen e AKR-së shërbimet e këtyre dy komunave do të jenë më cilësore. "Kryetarët e këtyre dy komunave nuk do ta ndjejnë veten si kryetarë, por si shërbëtorë në shërbim të qytetarëve", ka thënë Pacolli

Shqipe HETEMI

Prishtinë, 17 dhjetor - Lideri i Aleancës Kosova Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka thënë të martën se kjo parti është fuqizuar në zgjedhjet lokale, posaçërisht me fitoren në komunën e Gjakovës dhe të Mitrovicës. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Pacolli ka thënë se AKR-ja vazhdon rrugëtimin suksesshëm drejt fuqizimit të mëtejshëm në skenën politike. Ai ka premtuar se gjatë mandatit qeverisës në Gjakovë dhe Mitrovicë do të ketë rritje ekonomike dhe zgjedhje të problemeve me të cilat ballafaqon qytetarët. Në këtë kontekst, Pacolli ka thënë se kryetarja e

Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila dhe kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, do të jenë shërbëtorë të qytetarëve.

Presidenti i AKR-së ka folur edhe për procesin e shtetndërtimit, duke vlerësuar se Kosova është duke u fuqizuar si shtet. “Në këtë kohë Kosova është duke vazhduar të faktorizohet si shtet me një miqësi të fuqishme me vendet e rëndësishme të botës. Kosova është njohur më tepër se nga gjysma e shteteve të botës dhe jemi duke punuar fuqishëm që shteti ynë të jetë pjesë e OKB-së”, ka thënë Pacolli.

Duke folur për ulëset e rezervuara për minoritetet në Kuvendin e Kosovës, Pacolli ka thënë se është shprehur pro vazhdimin të ulëseve të rezervuara për minoritetet. “Ky është mendimi im personal, i cili mund të mos jetë në përputhje me mendimin e partisë. Konsideroj se duhet të jenë ulëset e rezervuara edhe për dy mandate sepse kemi të bëjmë me njerëz shumë konstruktivë, të cilët kanë kontribuar për proceset e ndryshme në të cilat ka kaluar shteti i Kosovës”, ka thënë Pacolli. Lideri i AKR-së insiston që presidenti i vendit të zgjidhet nga qytetarët, pasi vetëm në këtë mënyrë, sipas tij, mund të fuqizohet roli i presidentit të vendit.

“Epoka e re”: Z. Pacolli, çfarë kahe të re në skenën politike po merr AKR-ja pas fitores në komunën e Gjakovës dhe të Mitrovicës?

Pacolli: Aleanca Kosova e Re vazhdon rrugëtimin suksesshëm drejt fuqizimit të mëtejshëm në skenën politike. Këtë fuqizim të AKR-së e dëshmon edhe fitorja e saj në dy komuna të rëndësishme të Kosovës në zgjedhjet lokale të 3 nëntorit dhe 1 dhjetorit. Por kjo nuk është asgjë e re, është vetëm fillimi i jetësimit të programit tonë. Këtë program e kemi përpiluar me shumë profesionalizëm dhe guxim për të vepruar më tutje. Programi i AKR-së flet për një qeverisje efektive, për një qeverisje ku në rend të parë radhiten puna, transparenca, sinqeriteti dhe ndershmëria. Këtë program AKR-ja e ka implementuar deri tani në qeverisje qendrore dhe do të vazhdojmë ta zbatojmë edhe në nivel të qeverisjes lokale. Jemi shumë të lumtur që i kemi fituar pikërisht dy komunat për të cilat kemi menduar se duhet t’u kthehet dinjiteti dhe zhvillimi ekonomik. Prandaj, ka filluar të realizohet synimi ynë, që Mitrovica dhe Gjakova të jenë dy komuna, gjegjësisht dy zona të lira ekonomike.

“Epoka e re”: Çfarë ndryshimi do të ketë në këto dy komuna me qeverisjen e AKR-së?

Pacolli: Qeverisja jonë në këto dy komuna do të jetë një qeverisje me një burokraci të reduktuar. Synojmë reduktimin dhe, ndoshta, përgjysmimin e drejtorive në këto komuna, duke u dhënë rëndësi sa më tepër shërbimeve cilësore për qytetarët. Gjithashtu, do t’i eliminojmë problemet që i preokupojnë dhe mendojnë qytetarët çdo ditë.

Gjatë këtij mandati qeverisës në Mitrovicë dhe Gjakovë do ta rregullojmë infrastrukturën rrugore, do ta rregullojmë rrjetin e ujit, do ta rregullojmë rrjetin kabllor të energjisë elektrike si dhe do ta përmirësojmë trafikun urban. Për realizimin e renovimit të transportit, renovimin e makinave të zjarrfikësve, makinat e emergjencës-ndihmëse do t’i shfrytëzojmë grandet nga komunat e ndryshme të botës me të cilat synojmë të kemi bashkëpunim. Po ashtu, gjatë

qeverisjes së AKR-së do të rregullohet edhe problemi i mbeturinave të cilat aktualisht i ngufasin qytetarët. Do të kujdesimi që gjatë mandatit tonë qeverisës në komunën e Gjakovës dhe të Mitrovicës të ketë ujë dhe energji elektrike gjatë gjithë kohës. Me qeverisjen e AKR-së shërbimet e këtyre dy komunave do të jenë cilësore dhe kryetarët e këtyre dy komunave nuk do ta ndejnë veten si kryetarë, por si shërbëtorë në shërbim të qytetarëve.

“Epoka e re”: Po çka do të bëni në aspektin ekonomik?

Pacolli: Në aspektin e zhvillimit ekonomik do të fillojmë ta implementojmë strategjinë qeveritare për krijimin e zonave të lira ekonomike. Në këtë rast i falënderoj USAID-in dhe kryeministrinë që kanë pasur mirëkuptim në shtyrjen përpara të idesë për krijimin e zonave të lira ekonomike. Pra, së shpejti do të fillojë jetësimi i zonave të lira ekonomike. Ne jemi në kontakt të përhershëm me shumë kompani nëpër botë të cilat do të vijnë t’i vizitojnë këto dy komuna në mënyrë që të fillojë transferimi i prodhimtarisë prej investitorëve në Komunën e Mitrovicës dhe të Gjakovës. Gjatë këtij mandati qeverisës presim që në këto dy komuna të kemi një rritje ekonomike dhe zhvillim të hovshëm.

“Epoka e re”: Fitorja e dy komunave jep shenja se AKR-ja po ngjitet majave që të jetë forca e tretë politike?

Pacolli: Ne i kemi lënë oportunitizmin dhe interesat partiake. Kemi qenë një opozitë shumë konstruktive duke kontribuar në proceset e ndryshme të shtetndërtimit. Kemi qenë ata që kemi bërë të mundur vazhdimësinë e funksionalizimit të institucioneve në Kosovë, atëherë kur është rrezikuar që pas gjashtë muajve të shkohet në zgjedhje të parakohshme. Prandaj, ishim ne AKR-ja që e shpëtuam vendin dhe i dolëm krah shtetit të Kosovës. Nuk kemi pasur kurrfarë preferenca për partinë apo partnerin, pasi preferenca jonë ka qenë shtetndërtimi i Kosovës së porsalindur. Kjo ka qenë parimore për ne dhe jemi shumë të lumtur që kemi kontribuar në këto procese. Edhe po të kthehemi mbrapa sërish do ta bënim një gjë të tillë, pasi jemi të interesuar të përfitojë Kosova. Mund t’ju them se ka pasur rezerva nga shumëkush këtu në Kosovë se AKR-ja ka humbur se është bërë pjesë e kësaj qeverie, por ndodhi e kundërta, qytetarët i besuan sinqeritetit dhe punës së ndershme të AKR-së në qeverisjen e nivelit qendror. Puna jona e ndershme në qeverisje na u shpërblye nga qytetarët në zgjedhjet lokale duke fituar dy komuna. Besoj shumë se AKR-ja do të jetë një forcë politike e cila në zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të marrë mbështetje më të madhe nga qytetarët.

“Epoka e re”: Çfarë vlerësimi keni për procesin e dialogut Kosovë - Serbi?

Pacolli: Në këtë kohë Kosova është duke vazhduar të faktorizohet si shtet me një miqësi të fuqishme me vendet e rëndësishme të botës. Kosova është njohur më tepër se nga gjysma e shteteve të botës dhe jemi duke punuar fuqishëm që shteti ynë të jetë pjesë e OKB-së. Ndërkohë, procesi i dialogut ishte një hap i guximshëm, i cili nuk ka pasur alternativë tjetër. Prandaj është dashur të dialogojmë dhe është mirë që po dialogojmë. Sado që duket i komplikuar procesi i dialogut, Kosova nuk është duke humbur në këtë proces për arsye se të dy shtetet synojnë të jenë pjesë e Evropës. Dhe me këtë synim zërat nacionalistë, irredentistë e separatistë do të bien, sepse Evropa është shtëpia e madhe ku



secili e ka vendin e vet. Këtyre ditëve ka qenë temë edhe deklarimi i kryetarëve të komunave serbe se nuk do ta njohin Kosovën, mirëpo jam i bindur se këta kryetarë, pas një viti apo dy viteve, do të jenë po ata djemtë që do të kontribuojnë për shtetin e Kosovës. Kemi pasur një shembull me pjesëtarët e komunitetit serb në institucionet e Kosovës, të cilët më herët kanë thënë ashtu, por sot janë më bashkëpunues se kurrë.

“Epoka e re”: Z. Pacolli, mendoni se edhe për dy mandate duhet të jenë të rezervuara ulëset për komunitetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës?

Pacolli: Mendoj se po. Ky është mendimi im personal, i cili mund të mos jetë në përputhje me mendimin e partisë. Konsideroj se duhet të jenë ulëset e rezervuara edhe për dy mandate sepse kemi të bëjmë me njerëz shumë konstruktivë, të cilët kanë kontribuar për proceset e ndryshme në të cilat ka kaluar shteti i Kosovës.

“Epoka e re”: Kohët e fundit nuk jeni aktivë në lobim për njohje sikurse më herët. Pse?

Pacolli: Nuk isha shumë aktiv për shkak të përgatitjeve për zgjedhjet. Për një kohë e pata lënë partinë krejt anash duke iu përkushtuar interesave shtetërore, në këtë rast procesit të lobimit. Kështu që pata shkaktuar një humbje partisë të cilën jam munduar ta rikuperoj në një farë mënyrë gjatë kohës së fundit. Pas zgjedhjeve jam aktivizuar sërish dhe tash isha në një turne dhe shumë shpejt pres njohje nga kontinenti i lashtë i Afrikës. Kështu që, rezultati i punës do të shihet sepse janë duke u bërë hapa të përshpejtuar, të cilët do të rezultojnë me disa njohje nga Afrika.

“Epoka e re”: Nga cilat shtete janë këto njohje dhe a do të vijnë gjatë këtij viti?

Pacolli: Nuk janë procese që varen prej neve, por janë procese të cilat varen nga vullneti i shteteve përkatëse. Jemi duke bërë punën tonë dhe po presim që puna të na shpërblehet. Mund të rikonfirmoj se njohjet janë në proces e sipër. Jam shumë i bindur se dy njohje do të vijnë deri në përfundim të këtij viti.

“Epoka e re”: Çfarë të mira i ka sjellë AKR-së koalicioni me PDK-në? Ju personalisht jeni forcuar si lider?

Pacolli: Absolutisht nuk e ndjej asnjëherë se unë dhe AKR-ja kemi përfituar. Përkundrazi partia ka pësuar sepse ne do të ishim shumë më aktivë në Kuvend. Nga ky koalicion ka përfituar shteti i Kosovës sepse kemi kontribuar në proceset e shtetformimit dhe shtetndërtimit.

“Epoka e re”: Ju vazhdimisht insistoni që presidenti të zgjidhet nga qytetarët e jo nga Kuvendi i Kosovës?

Pacolli: Presidenti duhet të zgjidhet nga qytetarët për arsye se një president i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës është praktikisht vetëm një objekt i manipulimit. Kjo nuk është dashur të ndodhë. Presidenti duhet të zgjidhet nga qytetarët në mënyrë që të faktorizohet presidenti dhe të mos jetë vetëm si dekor dhe vetëm për çështje ceremoniale. Por, të jetë pjesë e proceseve në të cilat presidenti do t'i merrte përgjegjësit. Në këtë mënyrë presidenti do të jepte kontribut në proceset për ndërtimin e vendit. Jemi shtet i ri dhe secila pjesë e institucioneve duhet të jetë proaktive, prandaj edhe institucioni i presidentit nuk duhet të jetë si dekor, por është dashur të jetë aktiv në procese. Fuqizimi i



këtij institucioni bëhet me votën e qytetarëve dhe është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e shtetit të Kosovës.

 167

20 Comments 8 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓

December 19, 2013 · 



Ja qëndrimet e AKR-së për reformat

INFOKOSOVA.NET

### Ja qëndrimet e AKR-së për reformat

Me qëllim të qartësimit të pozicionit të AKR-së, karshi zhvillimeve shumë të rëndësishme që ka...



 283

8 Comments 4 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli ✓

December 19, 2013 · 🌐



Pacolli: Trepça s' duhet të shitet as koncesionohet, ajo duhet të kthehet në pronë publike

Postuar nga Admin.

INFOKOSOVA.NET



**Pacolli: Trepça s' duhet të shitet as koncesionohet, ajo duhet të kthehet në pronë publike**

531

26 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli ✓

December 21, 2013 · 🌐

...

Interkonesioni Kosove Shqiperi ----- Ngjarje e madhe firma për ndërtimin e linjës së interkoneksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës në Shtëpinë e Lidhjes së Prizrenit. U vonuam shumë, por më në fund ja mbërritëm kësaj dite... Është shumë e pafalshme sesi ne dy vendet më të pasura, gjegjësisht me ujë Shqipëria dhe me thëngjill Kosova, vuajmë akoma për furnizim me energji. Tash me këtë linjë, një pjesë të madhe të problemeve do të zhduken.

Që herët, menjëherë pas luftës jam munduar shumë së bashku me zotëri Fadil Ismailin të vendos lidhjet midis dy sistemeve tona energjitike. Kemi patur pengesa të çuditshme. Në vitin 2007, 2011, kemi paraqitur planet tona për krijimin e një sistemi të përbashkët elektroenergjitik në kuadër të një konference për krijimin e një Hapësire të përbashkët mbarëkombëtare ekonomike. Jam shumë i lumtur që ishte zotëri Fadil Ismaili, njeri nga autorët e kësaj strategjie që e hodhi firmën mbi dokument.

Ky është ai patriotizmi modern për të cilin flas shumë. Bashkimi fillon nga ekonomia, nga energjia...

👍 367

31 Comments 11 Shares



Behgjet Pacolli ✓

December 23, 2013 · 🌐

...

JUVE, të gjithë qytetarëve të Kosovës të besimit krishter (katolikë) ju uroj Kërshëndellat (Krishtlindjen), me urimet e mija më të sinqerta duke ju dëshiruar, (cdokujt, pa mar parasysht ku jetoni e ku gjendeni), mirësi në familjet e juaja ,gëzime,fat e dashuri dhe lutem për shëndetin, lumturinë dhe mirëqenien e juej.

Duke ditur se kjo festë, tek ne, ka qenë e mbetët sinonim i zemërgjersise tolerances dhe dashuris,deshiroj që te festoni e kënaqeni GJITHËMONË

👍 218

17 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

December 24, 2013



Sot pata rastin të bashkëbisedoj në një debat me studentët e fakultetit filozofik të Universitetit "Hasan Prishtina" të Prishtinës. Gjatë minutave që kaluam së bashku, unë ndava me studentët eksperiencën time në shtetndërtimin e Kosovës, konkretisht angazhimin tim praktik në lobimin për shtimin e njohjeve të reja për Kosovën. u ndava I mrekulluar nga energjia e këtyre të rinjëve që shfaqnin interesimin e tyre për qështjet madhore të vendit. Në anën tjetër, personalisht mua më brengos fakti që niveli akademik në arsimin tonë të lartë, është I bazuar gjithmonë në teori dhe shumë pak në praktikitet. Praktikatat tregojnë se mësimi teorik është një gjë që harrohet shpejt dhe është e pafektshme nëse nuk sinkronizohet me mësimin praktik të gjërave. b.p



917

17 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

December 28, 2013

Pershendes te gjithë miqet e mij nga Londra dhe ju deshiroj nga zemra te kaloni sa me mire keto ditë feste.Viti i ardhshem te jet vit i perspektivave per cdokend nga ju,Urime vitin e ri,Behgjeti

517

41 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

December 31, 2013

Te dashur miq! Qe nga 1 dhjetori e kendej mua me arrijne pergezimet dhe urimet e juaja per Gjakoven dhe Mitrovicen.Nga thellesija e zemres ju falemnderoje per kete dhe per fjalet miradije ne llogari te kryetareve,akr.se dhe timen.Sigurishte fitorja eshte e gjithë neve sebashku.Me keqardhje nuk mundem te ju falemnderoje nje nga nje e per kete ju lutem te konsideroni kete edhe si pergjigje per ju personale.Jane shume dhjetra mija falemnderime qe me kane arritur e ju e kuptoni se per t'u pergjigjur seicilit do te ishte e pamundur.Vazhdoni te shkruani,miq te mij!



CESME

Uğur Yılmaz

125

13 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

December 31, 2013

Të gjithë qytetarëve të Kosovës si dhe bashkëkombasve kudo që ndodhen.

Në këto pak çaste para ndërrimit të viteve deshiroj me këtë mesazh të ndaj së bashku me ju, gëzimin e vitit që presim, të uroj për ju, njerëzit tuaj më të dashur, një vit të ri plot shëndet, mbarësi, lumturi, gëzim, suksese.

Uroj që viti 2014 të jetë viti i realizimit të aspiratave dhe ëndrrave tuaja më të bukura.

Gëzuar! BP

692

25 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

December 31, 2013

Të dashur bashkatdhetarë, Nga thellësija e zemrës,te gjithë Juve ju uroj festën e vitit te Ri me deshirën e sinqertë per një mirëqenje më të mirë,fat e gëzime në familjet e juaja! Sinqerishte,Behgjeti

831

45 Comments 9 Shares

*Viti 2014*

A horizontal line with a blue-to-white gradient, centered below the text.







Behgjet Pacolli

January 2, 2014 · 🌐

...

Pacolli: Populli nuk mund të durojë shumë

Presidenti i Aleancës për Kosovë të Re, Behgjet Pacolli, në intervistën e dhënë për Telegrafin, ka thënë se si pjesë e koalicionit qeverisës, për shkak të numrit të deputetëve të tyre në Kuvend nuk ka mundur të jetësojë projektet e synuara. Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës tha se pakicat mund të marrin edhe një mandat të ulëseve të rezervuara, por me disa kushte. Sipas tij, modeli i dy komunave të cilat i ka fituar AKR-ja, Gjakovës dhe Mitrovicës, do të jetë trampolinë e cila do të sigurojë rritje të përkrahjes për AKR-në në zgjedhjet nacionale.

<http://www.telegrafi.com/.../pacolli-populli-nuk-mund-te...>



218

19 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

January 7, 2014 · 🌐

...

E dëgjova intervistën e ish rektorit të Universitetit të Prishtinës, aktualisht kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, z.Enver Hasani në Rubikon me Adriatik Kelmendin.

Ai më përmendi emrin dhe në këtë kontekst, ndër të tjera, tha se donacionin që e kam bërë për restaurimin e fakultetit filologjik të UP e paskam bërë për interesa të fushatës elektorale!!!

E turpshme, jo humane dhe shumë tendencioze një deklaratë e tillë, nga një njeri që është përfaqësues i një institucioni të tillë të Kosovës si Gjykata Kushtetuese, aty ku duhet të jesh i sinqertë, aty ku nuk duhet të përdoren thashethemet dhe supozimet.

Në këtë kontekst, z.Hasani më mbete një borxh. A nuk është supozim apo gënjeshtër e juaja, kur e thoni këtë, apo keni dëshmi se ka ndodhur ashtu siq e lansuat?

Jeni kryetar i Gjykatës Kushtetuese z.Hasani. Ju e bëni interpretimin e aktit më të lartë juridik të shtetit. A thua edhe vendimet e juaja bazohen në supozime, në mite, thashetheme? Ju them se në Rubikon ju thatë diqka për të cilën duhet të kërkonti fajle.

Për zotin Hasani dhe të gjithë që mendojnë sikur ai, ju them se donacioni në fjalë e ka pasur vetëm një qëllim: përmirësimin e kushteve mësimore për studentët e Universitetit historik të Prishtinës. Po të ishte për qëllim përfitimi në fushatë elektorale, zoti Hasani që e bën shpeshherë hipokritin, e di mjaft mirë, se investimi do të orientohej për shembull diku tjetër, ku direkt ndikohet në përfitimin e votave.

E pyes z.Hasani se ku bazohet ai kur thotë se unë e paskam bërë për fushatë zgjedhore?

Në kohën kur është nënshkruar kontrata, ai pa lejen time e ka thirrur konferencën për shtyp, dhe kam qenë i befashuar kur kemi dalë në një sallë tjetër dhe para gazetarëve, duke marrë rolin e heroit kryesor deklaroi se po e bën mbindërtimin e fakultetit filologjik. Pra ai vet e ka lansuar në opinion dhe jo unë.

Ju e dini se në Kosovë unë kam ndërtuar edhe një Universitet tjetër në formë donacioni, Universitetin Amerikan. E kam ndërtuar pas luftës, në kohën kur në mendjen time nuk ekzistonte fare mundësia e përfshirjes në politikë. Për qfar qëllimi e paskam bërë atë donacion në atë kohë z.Hasani???

Zotit Hasani dhe të gjithë njerëzve që mendojnë dhe orkestrojnë skenare në Kosovë iu them se donacionet që unë i kam bërë në jetë, gjithmonë i kam bërë me qëllimin më fisnik dhe human. Pa asnjë qëllim tjetër.

Nuk kam faj unë, për shpirtngushtsinë e juaj që ju mendoni e veproni vetëm për qëllime personale në kurriz të qytetarëve.

Këtë dhe skenarët tjerë, shpresoj shumë që në mënyrë të sinqertë do ti sqaroni në memoaret e juaja që paralajmëruat se do ti botoni.



778

154 Comments 20 Shares



Edhe një hap para, në prag të mbledhjes së

Këto ditë në Prizren do të mbledhet për herë të parë në historinë e dy vendeve tona, të kombit shqiptar, dy përfaqësi të zgjeruara të qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës. Besoj të gjithë e kanë mësuar se Këshillat e ministrave të Maqedonisë dhe të Serbisë kanë zhvilluar një mbledhje të përbashkët. Edhe ata të Bullgarisë me atë të Maqedonisë. Sot do marrim vesh qartë nëse ka apo jo një program të bashkëpunimit të harmonizuar afatshkurtër apo afatmesëm midis dy pjesëve të një kombi. Sot do të marrim vesh nëse ky takim ka vetëm karakter protokollar, apo një program të vërtetë pune, për sot dhe për të ardhmen.

Mediat do të merren gjatë me këtë mbledhje, por unë dua të them në fillim modestisht se ç'kam bërë për t'ja arritur kësaj dite. Dhe çfarë shoh unë se duhet të ndodhë nesër.

Çfarë kam bërë para kësaj mbledhjeje?

Në përpjekjet e mia për të bërë diçka për vendin dhe kombin tim, ka me siguri dy fjalë kyçe: bashkim dhe ekonomi. Këtë eksursion retrospektiv për aktivitetet e mia në favor të një forme institucionale të bashkëpunimit midis dy pjesëve të ndara të kombit, po e filloj me Unionin e afaristëve shqiptarë në vitin 2000. Ishte një inisiativë që bëri bashkë brenda njerëz të afarizmit nga Shqipëria, Kosova dhe viset e tjera etnike. Më pas në 2006, unë themelova SEED, i cili synonte të nxiste inisiativat e përbashkëta në rajon në favor të zhvillimit ekonomik. Për këtë zhvillim ekonomik kam folur shumë në fushatën e 2007-ës së AKR-së, megjithëse nuk munda dhe nuk desha të përfshihesha në qeverisje asokohe. Në vitin 2007, ndoqa me shumë interes idenë e intelektualit të shquar Arbën Xhaferi, për të ashtuquajturin Komunuelth shqiptar. Kam folur për një hapësirë ekonomike të përbashkët kombëtare në parlamentin e Shqipërisë si President në mars 2011. Dhe më në fund në dhjetor 2012, së bashku me 100 individë të shquar shqiptarë me histori sukseesi në botë, pjesë e Albanian Excellence, së bashku me ish Presidentët e Shqipërisë, Moisiu dhe Meidani, zanafilluam Lëvizjen për Unionin Ekonomik Shqiptar.

E bëra këtë hyrje për të treguar se në angazhimin tim publik ka një lloj koherence në lidhje me këto fjalë kyçe: ekonomi dhe bashkim. Asnjëherë nuk jam luhatur në bindjet e mia profesionale. Asnjëherë s'jam lëkundur nga idetë e mia për privatizimin në Kosovë dhe modelet e tij, për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, për arsimin profesional, për zonat e lira ekonomike. Të jesh koherent sot në politikë, dmth të jesh i ndershëm me premtimet e tua, me idetë e tua. Makiavelizmit, mashtrimin të politikës i jam përgjigjur gjithmonë me koherencë, me ndershmëri, pa i lëvizur fjalëve të mia, ideve të mia. Të jesh koherent do të thotë dhe të jesh i qëndrueshëm në kohë. T'i mbahesh një boshti, një strategji, një vizioni. Të mendosh në afat të gjatë. Për fat të mirë qytetarët e dy komunave më të industrializuara të Kosovës, Gjakova dhe Mitrovica për të cilat unë kam propozuar që herët ngritjen e dy zonave të lira ekonomike, e vlerësuan këtë strategji, këtë vizion. Sot kur ideja ime për mbledhjet e dy qeverive që unë e shpalla në Parlamentin e Shqipërisë si president po realizohet, unë dua të shpall ide të tjera të programit tonë që na çojnë një hap para kah themelimi i një Unioni ekonomik.

Nga mbledhja e qeverive tek ideja e Unionit Ekonomik.

Siç e thashë dhe më sipër, në fund të vitit që shkoi, unë së bashku me një grup politikanësh të vjetër dhe të rinj shqiptarë, me individualitete të shquar nga Kosova dhe diaspora, me autoritete akademike, kam shpallur idenë e Unionit Ekonomik. E kam bërë këtë në formën e një Lëvizjeje qytetare, në kapacitetin tim të një qytetari aktiv dhe jo të zëvendëskryeministrit të Kosovës. Kam patur drojen për të mos implikuar qeverinë e

Kosovës në një inisiativë të tillë, që nga dikush mund të interpretohet si papajtueshmëri me rolin tim institucional. Por kjo ide në pikëpamje të shqetësimit ndërkombëtar nuk krijon kurrfarë problemi krahasuar me inisiativa të ngjashme më të zgjeruara si ajo e Beneluksit ballkanik, West Balkan Six, apo G6 ballkanike ku bëjnë pjesë Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina. Ne thjesht në këtë idenë tonë për Unionin ekonomik qartësojmë se tash shqiptarët nuk i pengon kush që të rikrijojnë potencialet e tyre ekonomike kombëtare siç ishin para copëtimit në 1912, pavarësisht formës së integritimit: në një Union ekonomik pashqiptar, apo në një Beneluks ballkanik. Shqiptarët janë praktikisht motori kryesor i çdo forme të integritimit rajonal, pse janë komb numerikisht i krahasueshëm me të tjerët, dhe falë heqjes së barrierave, do të krijonin realitete ekonomike konkurruese në shërbim të mirëqenies së tyre kombëtare.

Idea e Unionit ekonomik shqiptar është një ide që e forcon aleancën tonë strategjike me perëndimin. Çdo ide tjetër për bashkimin e shqiptarëve, pa u koordinuar me faktorin perëndimor, gjegjësisht me SHBA-të dhe Unionin European për kohën, për modalitetet, është jo frytdhënëse në gjykimin tim. Madje është kundërproduese. Ajo krijon probleme me atë që duhet të jetë sot objektiv strategjik jo vetëm i Kosovës sonë, por mbarë kombit shqiptar: anëtarësimin e Kosovës në OKB. Një kërkesë e tillë publike, pa bërë minimumin kah bashkimi- i jep hapësirë Serbisë të kërkojë ndarjen e Kosovës siç e bën herë pas herë, kryeministri Daçiq.

Idea e Unionit Ekonomik Shqiptar është një ide e mbështetur në modelin e krijimit të Unionit Ekonomik European. A janë sovraane sot shtetet e Europës? Sigurisht, vetëm se kanë hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit në emër të një organizate të përbashkët. A na pengon dikush ne që të shkojmë kah ky lloj bashkimi? Jo. A i krijojmë pengesa perëndimit në objektivat që ka për Kosovën dhe rajonin? Jo. Pse? Sepse ne në këtë fazë nuk po kërkojmë bashkim territorial, por pajtueshmëri ekonomike, kulturore, akademike, shoqërore të kombit, të dy shteteve, apo më shumë sipas modelit european. Idea e Unionit Ekonomik Shqiptar është mbështetur në modelin e Këshillit Nordik. A janë vendet e Gadishullit nordik sovraane dhe të pavarura? Sigurisht që po. Që në vitet e para pas luftës, në 1951 krijuan Këshillin ndërparlamentar Nordik i cili mblidhet periodikisht. Në të janë përfaqësuar në mënyrë proporcionale sipas numrit të popullsisë të gjitha vendet. Ky Këshill ka vendosur që në fillim për tregun e lirë të punës dhe lëvizjen e lirë pa pasaportë të nordikëve mes shteteve të Këshillit, që pa u krijuar Shëngeni. Nevoja për institucione të tjera koordinuese në favor të mirëqenies së përbashkët për disa kombe që kanë shumë ngjashmëri, i ka bërë që të ecin dhe më tej. Në vitet 70, vendet nordike kanë krijuar Këshillin e ministrave nordike. Këto institucione nuk i kanë penguar vendet nordike as të hyjnë në Bashkimin European, as të heqin dorë nga sovraniteti i tyre për të cilin janë shumë xhelozë. Kur këtë e kanë bërë disa vende me shumë ngjashmëri, por jo i njëjti komb, pse s'mund ta bëjmë ne me Shqipërinë që jemi një komb?

Idea jonë për Unionin Ekonomik shqiptar reflekton saktësisht këtë model. A duhet të mendojmë ne për mirëqenien e kombit tonë më së pari? Po, duke u mbështetur tek burimet tona natyrore, materiale, dhe njerëzore si komb, sepse bashkë ja dalim më mirë, më shpejt. Kush do të bëjë planet për një ecje të përbashkët? Kush do t'ja japë softuerin kësaj ecjeje apo Lëvizjeje të përbashkët kah Unioni European ku duam të anëtarësohemi? Intelktualët, njerëzit e ditur, brenda dhe jashtë hapësirës sonë kombëtare, duke llogaritur dhe diasporën si kapacitet intelektual dhe ndërmarrës.

Tani kur mbledhja e qeverive po bëhet realitet, pse të mos kemi dhe ne një mbledhje periodike të parlamentareve tanë? Mbledhja periodike e tyre, ajo e kryeministrave apo

kryetarëve të qeverive do të punojë sipas softuerit të përgatitur nga njerëzit e dijes. Ata do të ekzekutojnë programin tonë të mirëqenies. Shumë mirë mbledhja e dy përfaqësive të zgjeruara të qeverive, por do duhet takohen rregullisht dhe ministrat e resoreve të ndryshme. Edhe shoqëria civile do duhet të takohet.

Në skenën tonë partiake po flitet shumë për bashkimin politik, por janë të qarta problemet që krijohen nga moskoordinimi me perëndimin, dhe s'ka kurrfarë radhe veprimesh. Unë mendoj se duhet të punojmë për ekonominë më së pari, për kulturën, shkencën, akademinë, mediat dhe sportet. Bashkim në BE, por më parë, Bashkim si BE-ja. Por duhet të koordinohemi. Mungon koordinimi dhe për sfida më të vogla. Ne s'duhet të presim se do të na koordinojnë të tjerët. Këtë duhet ta bëjmë vetë. Ndërsa ne hedhim një hap si ky i Mbledhjes së qeverive, duhet ta kemi të gatshëm planin për hapin tjetër: ku duhet të shkojmë. Nëse ne jemi bindës se nuk rrezikojmë askënd, dhe jemi brenda frymës europiane, atëherë askush nuk mund të na ndalë. Koha punon për Kosovën dhe kombin shqiptar.

 186

13 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

January 10, 2014

...

Po shihja një emision në të cilin flitej për gjuhën e ashpër të lexuesve nëpër portale. E vërtetë është, shpesh herë qarkullon një gjuhë e tillë e ashpër të cilën duhet ta mirëkuptojmë nisur nga stadi i shoqërisë në të cilën gjendemi. Jemi një shoqëri e dalë prej pak vitesh nga një luftë e ashpër, kemi vështirësi ekonomike, varfëri, drama dhe vështirësi. Problemi më i madh sipas meje, nuk është tek qytetarët, por tek ata që mundohen ta formësojnë opinionin e qytetarëve, sipas agjendave të tyre personale, mlllefave, urrejtjeve, lidhjeve anësore me politikën, apo tek vetë në njerëzit e politikës, që u prijnë taborreve partiake. Shpesh herë në ligjërimin tonë ka urrejtje, ka shpifje, ka konspiracione, ka sulme ad hominem. E kam fjalën për në politikanët dhe për njerëzit e medias. Nëse ne të parët nuk kujdesemi për të mos ta kultivuar gjuhën e urrejtjes, si mund ta kërkojmë këtë tek qytetarët? Nëse ne të parët e kemi të errësuar arsyen, pse duhet ta kërkojmë arsyen tek të tjerët?

Me këtë frymë sot lexoja disa gazeta të cilat tentojnë ta fajësojnë qeverinë e Kosovës për të ashtuquajturat dështimet e saja dhe është shumë interesante që njerëzit e harrojnë një fakt shumë të rëndësishëm se ai që fare nuk punon, sigurisht asnjë gabim nuk e bën, sepse s'ka fare mundësi për një gjë të tillë. Aty ku punohet edhe lëshimet janë shumë normale, por jam i bindur se interpretimin e të "ashtuquajturave dështime" ata që konsiderojnë se kjo qeveri vetëm ka dështuar, e bëjnë krejtësisht në mënyrën e vet, pa egzistencën e fakteve. Më impresionoi, për shembull se si gazetaret nuk folën për asnjë sukses të qeverisë, duke marrë parasysht se ka shumë, përkundër asaj që përballemi me probleme të mëdha. Kosova është njohur nga gjysma e shteteve të botës, ka fituar simpatinë e miqve të mëdhenj në të gjithë anët e globit dhe ka garantuar mbështetjen në të gjitha fushat ndërkombëtare. Ka shpallur pavarësinë, ka krijuar institucionet, ka etabluar paqen dhe ka filluar dialogun me kundërshtarit. Madje ka shkuar edhe më tej duke e filluar procesin e evropianizimit të Kosovës në kuptimin e anëtarësimit në familjen e vendeve europiane de jure dhe de facto, në aspektin e lëvizjes së lirë, të shkëmbimit të mallrave, të të drejtave të njeriut, të garantimit të pronës dhe të bashkëpunimit më të gjerë. Takimi i parë i dy qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës në Prizren është vetëm pikënisja e asaj që Kosova ka në planin e vet. Në të ardhmen priten takime të intensifikuara me Shqipërinë, dhe shpejt edhe me shtetet tjera ku jetojnë shqiptarët. Në këtë kontekst, edhe thellimi i bashkëpunimit me shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe Bujanovcit do të jetë pikësynimi i radhës.

Kosova pra ka shumë arritje, përveç mosarritjeve që i shohin ata që s'duan të shohin mirë. Mos të harrohet rritja ekonomike, të cilën Kosova gjithmonë e ka pasur mbi 3 përqind. Ka vizion për të ardhmen. Në planin afatshkurtër, është edhe krijimi i zonave të lira ekonomike, ku Kosova përveç se zhvillim ekonomik, do të krijojë edhe një perspektivë të fondeve buxhetore të Kosovës..

Krijimi i infrastrukturës rrugore është një gjë shumë e rëndësishme po ashtu në vizionin tonë për të ardhmen.. Shba-të për shembull pikënisje të zhvillimit ekonomik e ka pasur krijimin e infrastrukturës rrugore.

Kjo qeveri ka folur dhe do të flasë gjuhën e ekonomisë, dhe kur të realizojmë objektivat tona ekonomike, për mirëqenien e qytetarit, nivelin e demokracisë do të rritet dhe më shumë. Diku një filozof i madh bashkëkohor ka thënë se nuk mund të flitet për demokraci të realizuar nëse nuk kemi të ardhura për kokë banorin, që ta mundësojë atë.

201

20 Comments 4 Shares



Takimi i Prizrenit nuk duhet të mbesë vetëm ne Letër!

Si një njeri me eksperiencë të gjatë ndërmarrëse në rrafsh ndërkombëtar, unë kam një ndjesi të veçantë ngase sot është arritur dita kur dy vendet, Shqipëria dhe Kosova po nënshkruajnë marrëveshje që janë korniza e bashkëpunimit të ardhshëm në të gjitha fushat, e që çojnë kah krijimi i një hapësire të përbashkët zhvillimore. E di rëndësinë e hapësirës, e tregut, e avantazheve konkurrese të kësaj hapësire në rrafsh rajonal dhe ndërkombëtar. Prej kohësh kam punuar që aftësitë ndërmarrëse të shqiptarëve të bashkohen në një subjekt të vetëm dhe sot së bashku me klasën ndërmarrëse të shqiptarëve në të dy anët e kufirit ndihem besëplotë për të ardhmen.

Por ka dhe një arsye tjetër të fuqishme pse unë sot e shoh horizontin e këtij bashkëpunimi më qartë. Si ndërmarrës global e kam zbërthyer shumë herët idenë e rilindasit modern Arben Xhaferi, për një hapësirë unike shqiptare në rrugën tonë të integritit europian, për takimet e përbashkëta qeveritare dhe parlamentare, për institucione të përbashkëta në këtë rrugë. Së bashku me intelektualë të hapësirës sonë kombëtare, me politikanë, me profesorë kam krijuar që herët një Lëvizje që të çon kah ky objektivi i mirëqenies kombëtare themeluar mbi konceptin e njësisë së kulturës, zakoneve, të gjuhës, të territorit.

Ndaj sot po i lejoj vetes, që brenda kostumit tim të anëtarit të kabinetit qeveritar të Kosovës, të ofroj një qasje konkrete si e shoh unë ardhmërinë e këtij takimi që po zhvillojmë sot.

Më së pari, ne duhet të krijojmë një strukturë të përhershme që të projektojë zhvillimet e ardhshme, të ideojë dhe realizojë projektet konkrete brenda marrëveshjeve që nënshkruam dhe që do të nënshkrojmë në të ardhmen. Ky komitet ndërministror mikst, do sugjeroja që të bashkëdrejtohej prej përfaqësuesve të nivelit më të lartë me eksperiencë në resoret ekonomike të dy vendeve. Ai do të jetë i lidhur tërë kohën, do të zhvillojë takime shumë të shpeshta mes vedit dhe me shoqërinë civile, me grupet e interesit, etj.

Janë disa drejtime ku unë shoh se mund dhe duhet të përqëndrohet puna e përbashkët e këtij komiteti, i cili nën direktivat e dy kryeministrave do t'i japë frymë dhe jetë ideve të mëdha që do të vijnë nga truri shqiptar, ndërmarrja shqiptare, academia, individët e shquar. Komiteti do të ofrojë pika referuese në mënyrë që mbledhjet e ardhshme të miratojnë projekte konkrete me arsyeshmëri ekonomike, logjistike dhe ligjore. Unë besoj se mbledhja pasuese duhet të përgatitet nga ky komitet i përbashkët siç thashë më parë të bazuara në ligjet, mundësitë dhe arsyeshmërinë ekonomike dhe në formën e një ideje të projektuar të miratohen. Eksperienca më thotë se projektet e ardhshme të përbashkëta mund të jenë:

Krijimi i një kompanie të përbashkët të aviacionit me partneritet publiko privat për të cilën ka nevojë dhe hapësirë imediate të operimit.

Sistemi hekurudhor ashtu si është nuk mund të funksionojë asnjëherë dhe do duhet të organizohet kompania kombëtare e përbashkët e hekurudhave, mundësisht e hapur dhe me Maqedoninë (për shkak të aspektit gjeografik, pasi Maqedonia është shumë e interesuar për t'u ndërlidhur strategjikisht me portin e Durrësit.) Unë e kam diskutuar këtë dhe me presidentin e Maqedonisë kur isha president idenë e krijimit të një holdingu të fuqishëm hekurudhor sepse Maaqedonia është shumë e ndërlidhur me vendet fqinje.

Asetet e këtij holdingu do të jenë asete publike të dy shteteve të hapura për partneritete publiko-private sipas modeleve skandinaviane, të Beneluksit, të Britanisë së madhe. Do duhet të krijohet për shkak të specifikave tona (komplementaritetit thëngjill-ujë) një holding i përbashkët energjistik sipas të njëjtit model. Ai mund të shndërrohet në lojtar rajonal duke rimodernizuar të gjithë kapacitetet e veta prodhuese nëpërmjet përfshirjes në bursë. Edhe ky gjigand do të ishte i hapur për investime private nëpërmjet partneritetit publiko-privat.

Duke patur parasysh shpenzimet e mëdha, përditshmërinë e rasteve të sëmurëve të rëndë në këtë rajon dhe shpenzimet marramendëse që harxhohen për udhëtime jashtë vendit për shërim, që pos kostos së shërimit marrin kosto të përcjellësit, vizave, sigurimeve, etj, për qytetarët e të dy vendeve, dhe duke marrë parasysh seriozitetin e shtetit në këtë lëmi, është koha të fillohet me hapa konkretë për krijimin e një Qendre Kombëtare spitalore (për shërimin e sëmundjeve onkologjike, kardiologjike, të leukemisë, neurokirurgjisë, etj). Kjo qendër do të planifikohej idealisht në kufirin midis Shqipërisë dhe Kosovës, në Kukës, ku gjendet dhe aeroporti, dhe lidhshmëria ideale me autostradë. Kjo qendër (mund të gjendeshin donacione private përveç donacione të dy qeverive respektive), do të kishte përveç 600 shtretërve të shtrimit, klinika, salla operacioni me teknologji mjekësore më të fundit. Ajo do të përfshinte hotele për shoqëruesit e të sëmurëve dhe një Qendër kërkimore të medicinës.

Do duhej krijuar një Fond për sigurimin shëndetësor kombëtar sipas modelit skandinav që do të financohej ekskluzivisht prej akcizave të duhanit, alkoolit dhe mallrave të luksit dhe të ardhurave prej kontribuesve, lartësia e të cilave do të varej sipas madhësisë së të hyrave personale.


Këto do të ishin pikat kyçe në të cilat do të duhej të koncentrohej fillimisht Komiteti mikst ndërministror.

Përveç tyre është krejt normale që të harmonizohen proceset legislative, paketat fiskale respektive në veçanti, ato tatimore, doganore, mundësia e trajtimit të njëjtë të shtetasve respektivë në oportunitetet e biznesit, unifikimi i dokumentacionit shoqërues dhe i praktikave tregëtare midis dy vendeve. Do të duhet të mbahet parasysh mosdublifikimi i ngarkesës tatimore në industritë prodhuese. Dhomat e tregëtisë dhe industrisë do duhej të bashkëpunonin për t'i përgatitur lëndën e parë për mbledhjet e ardhshme qeveritare.

Shpresoj shumë që mbledhja e parë do të jetë e suksesshme duke hapur rrugë për një proces historik afrimi, bashkimi deri në integrimin e përbashkët në Unionin European. Nëse marrëveshjet që do të firmosim sot do nisin të jetësohen, atëherë duhet të jemi të qetë se kemi bërë diçka të madhe.

171

11 Comments 3 Shares



**Behgjet Pacolli** ✓  
January 10, 2014 · 🌐

Të dashur miq,  
Sonte jam i ftuar në emisionin Interaktiv, të Xhemajl Rexha me të cilin do të bashkëbisedojmë për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive të kombit dhe për shumë tema të tjera. b.p

237

11 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli  
January 10, 2014 · 🌐



Me mikun tim, futbollistin e madh Bekenbauer.

Jemi në një periudhë shumë pranë realizimit të dy ëndrrave të mia të mëdha gjatë kësaj periudhe...

Nesër në Prizren sipas një ideje të mikut tim Arben Xhaferi, që unë e mbështeta fuqimisht si President dhe qka e bej dhe sot, do të mblidhen dy qeveritë, ajo e Shqipërisë dhe e Kosovës. Bashkimi kombëtar fillon nga ekonomia.

Të hënën, FIFA do të vendosë pro Kosovës që të luajë ndeshje miqësore ndërkombëtare në futboll. S'ka kthim mbrapa në angazhimin ndërkombëtar të Kosovës në sport. Ka qenë angazhim i hershëm i imi, para se të merresha me politikë, që në ditët e para të Presidencës kur është bërë kjo foto, dhe tash, për t'i parë të rinjtë e Kosovës, të luajnë për flamurin e tyre në gara ndërkombëtare.



👍 Lindita Nebiu Hyseni and 1.1K others

62 Comments 24 Shares



 **Behgjet Pacolli**   
January 13, 2014 ·  ...

<http://lajmi.net/bashkim-hekurudhor-me-shqiperine/>

---

LAJMI.NET 

**Bashkim hekurudhor me Shqipërinë**  
Zëvendëskryeministri i Parë i Kosovës, Behgjet Pacolli, thotë se mbledhja e përbashkët e Qever...

 442 25 Comments 13 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
January 13, 2014 ·  ...

Presidenti Pacolli gjatë intervistës në INTERAKTIV



**KOHAVISION** 

YOUTUBE.COM  
**INTERAKTIV BEHGJET PACOLLI 10.01.2014**  
INTERAKTIV BEHGJET PACOLLI 10.01.2014

 239 11 Comments 8 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
January 18, 2014 · 






**Dy qeveritë**  
**Mbledhja e Vlorës, Pacolli i paraqet Peleshit projektet konkrete**

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë një takimi që zhvilloi dhe me homologun e tij, Niko Peleshi, e vuri theksin te disa nisma konkrete që duhet të ndërmerren në mbledhjen e dytë të përbashkët mes dy qeverive, atë të Vlorës në muajin maj. Kështu, në platformën e propozuar nga Pacolli, kërkohet krijimi i një kompanie të përbashkët të aviacionit me partneritet publiko-privat, për të cilën ka nevojë dhe hapësirë imediate të operimit. Po kështu, aty theksohet edhe nivjoja për një kompani të përbashkët kombëtare të hekurudhave. "Sistemi hekurudhor ashtu si është nuk mund të funksionojë asnjehere dhe do të duhet të organizohet kompania kombëtare e përbashkët e hekurudhave, mundësisht e hapur dhe me Maqedoninë për shkak të aspektit gjeografik, pasi Maqedonia është shumë e interesuar për t'u ndërlidhur strategjisht me Portin e Durrësit", theksohet në këtë platformë. Një bashkëpunim i ngushtë kërkohet dhe për çelshjet e energjisë. Ai foli dhe për nevojën e nrisjes me hapa konkretë të krijimit të një qendre kombëtare spitalore. "Kjo qendër do të planifikohaj idealisht në kufirin midis Shqipërisë dhe Kosovës, në Kukës, ku gjendet dhe aeroporti, dhe lidhshmëria ideale me autostradën. Kjo qendër mund të gjendeshin donacione private përveç donacione të dy qeverive respektive), do të kishte përveç 600 shtretërve të shtrimit, klinika, sala operacioni me teknologji mjekësore më të fundit", theksohet në platformë.


**MAJ**  
Mbledhja e radhës mes dy qeverive shqiptare, të Tiranës dhe Peshkëpës është parashikuar të mbahet në maj, në qytetin e Vlorës


Vjollca Gagica-Matoshi and 524 others · 12 Comments 20 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
January 18, 2014 · 

"Studio e Hapur", Pacolli: Në Vlorë me projekte konkrete, më pak retorikë e folklor  
Postuar nga Admin.

[BALKANWEB.COM](http://BALKANWEB.COM)  
**Pacolli: Në Vlorë me projekte konkrete, më pak retorikë e folklor**  
Balkanweb Mobile: Faqja kryesore e lajmeve për Shqipërinë , Kosovën , Rajonin , e cila i përcjell lajmet në kohë real në versionin Mobile



 90 · 4 Comments 3 Shares

**Behgjet Pacolli** January 18, 2014

"Studio e Hapur", Pacolli: Në Vlorë me projekte konkrete, më pak retorikë e folklor  
[http://www.youtube.com/watch?v=Y81\\_USTcKrl](http://www.youtube.com/watch?v=Y81_USTcKrl)



YOUTUBE.COM

"Studio e Hapur", Pacolli: Në Vlorë me projekte konkrete, më pak retorikë e folklor

116 8 Comments 6 Shares

**Behgjet Pacolli** January 21, 2014

Në nderim të presidentit Ibrahim Rugova, homazhe pranë varrit të tij në 8 vjetorin e ndarjes nga jeta. #bp



Bessa F Qazimi and 2.2K others 50 Comments 16 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
January 22, 2014 ·  ...




<http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,14,132284>

---


[WWW.GAZETAEXPRESS.COM](http://WWW.GAZETAEXPRESS.COM) 

**Behgjet Pacolli merr pjesë në Forumin e Davosit - Ekonomia - Gazeta Express**  
Zëvendëskryeministri Pacolli ka udhëtuar për në Zvicër ku do të marrë pjesë në fillimin e puni...

 420 24 Comments 6 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
January 24, 2014 ·  ...

Në këto momente të gjithë lutemi për mikeshën dhe kolegen tonë, asambleisten e AKR-së, znj. Xhytxhyzare Karaxhija Xheravina që pësoi në një aksident komunikacioni. E lusim zotin për përmirësimin e gjendjes së saj dhe vazhdimin e bashkëpunimit për të mirën e qytetarëve të Gjakovës.

 351 22 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

January 24, 2014 · 🌐

...

Duke pritur prezentimin e sekretarit amerikan të shtetit, John Kerry në forumin ekonomik botëror, pashë lajmin e publikuar nëpër portalet tona në lidhje me njohjen nga Myanmar(ish Burma). Me thënë të drejtën u befasona nga një lajm i tillë, pasi që për secilën njohje, kemi njohuri paraprakisht së paku disa ditë më herët dhe një lajm i tillë ishte i papritur.

Sidoqoftë, unë e pashë edhe deklarin korrekt nga zyra ime dhe nga ministria e punëve të jashtme, se një lajm i tillë nuk është i vërtetë. Kushdo që provokon opinionin nëpërmjet medieve me tendenca të tilla, nuk bën tjetër gjë veq se një provokim, një përpjekje për të shpikur gjera të pavërteta për të mbuluar pastaj të vërtetën e madhe të një pune të jashtëzakonshme në fushën e njohjeve, pavarësisht nëse elementi është i brendshëm apo i jashtëm. Shteti ynë është i kanalizuar drejt afirmimit të vet ndërkombëtar. Njohjet do të vijnë ngase në këtë drejtim është investuar dhe investohet shumë energji qdo ditë dhe askush nuk mundet ta minojë këtë proces të rëndësishëm.

👍 175

14 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

January 25, 2014 · 🌐

...

Me pikëllim të thellë e mora lajmin për vdekjen e znj Gjylgjizare Xharavina. Do të na mungojë shpirti i saj human, energjia dhe kreativiteti shembullor. Ngushëllimet më të sinqerta familjes Karaxhija-Xharavina. bp

👍 345

71 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

January 28, 2014 · 🌐

...

Sot i dhamë lamtumirën e fundit mikes, koleges dhe bashkëpunëtores tonë Gjylgjizare Karaxhija Xharavina.

Zarushin, une e njoh qe nga viti 2007 kur bashke filluam rugen e politikese dhe gjithmone ka qene, bujare, e afert dhe mike e vertete.

AKR humbi një aktiviste të palodhur, Gjakova humbi një humaniste të devotshme, familja humbi një nënë dhe bashkëshorte shembullore. Lavdi jetës dhe veprës së Zarushit. b.p

👍 469

39 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

January 31, 2014 · 🌐

...

Fjala e z.Behgjet pacolli gjatë vizitës në minierën e Stan Tërgut: nga admin.

Para dy ditësh ka kalu në Qeverinë e Kosovës strategjia për Trepçën, e cila është me vonesë për është një lajm i mirë. Shpresojmë që shumë shpejt se do të kalojë edhe ligji edhe do të miratohet në parlamentin e Kosovës, kështu që Trepça gjegjësisht minierat e Trepçës do të kthehen në duart e menaxhmentit dhe do të fillon një punë e mbarë.

15 vite Trepça është mbajtur peng dhe lajmi se do të kthehet Trepça në binarët e vetë është lajm i mirë. Sot nuk mundem pa e cekë se dikush nga AKP duke qëndruar në karriget e veta thotë se ligji nuk e ndalon që ne të vazhdojmë rrugën tonë dhe që ne të bëjmë investimet e mëtutjeshme për kontraktimin e këshilltarëve të ri për Trepçën. Këshilltarët më të mirë për Trepçën janë këtu, njerëzit që kanë punu dhe njerëzit që njohin mirë problematikën dhe këta dinw të jenë ata që do të merren me Trepçën dhe të thuhet se ligji nuk i pengon ata të bëjnë një kontratë është sinqerisht një lajm i keq se në çfarë mënyrë trajtohet paraja publike. Prandaj besoi që kthimi i Trepçës në binarët e vetë është lajm shumë i mirë. Për këtë e falënderoi Qeverinë e Kosovës partnerin e koalicionit që ka pas mirëkuptim dhe që i ka dhënë një shtyrje shumë të madhe këtij projekti.

Ky problem tani është i eksponum shumë dhe nuk besoi që tenton dikush ta ndalë këtë iniciativë duke parë se kjo iniciativë - është rruga e vetme e cila e rifunksionalizon Trepçën.

Ai tenderë nuk është dashur asnjëherë të hapet për arsye se asi tendera kemi pas për 15 vite dhe Trepçës nuk i kanë sjell asgjë.



👍 476

31 Comments 25 Shares


 **Behgjet Pacolli** January 31, 2014

<http://www.ekonomiaonline.com/.../pacolli-trepca-po.../>

WWW.EKONOMIAONLINE.COM

**Pacolli: Trepça po kthehet në binarë - Video - Ekonomia Online**  
Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, gjatë një vizite që i ka bërë të premtën kompleksit Indust...

320 22 Comments 14 Shares

 **Behgjet Pacolli** February 2, 2014

Personalisht kurre s'jam mburrur me titullin e magjistrir (master)te kryer ne Institutin Mössinger krahas perfundimit te nje Universitetit te Hamburgut per Ekonomi nderkombetare. Një është e sigurt; viteve 70 nuk ka ekzistuar termi shitblerje të titujve akademik. Ndoshta dikush mu për këtë, në media, më quan i pashkolle! Nuk hidherohem fare se atë titull e kam arritur me djersë e mund, duke qenë i vetëdijshëm se nuk kam aplikuar askund për të qenë ligjerues i gjuhës shqipe (nuk kam studjuar në gjuhën shqipe. Nga adoleshenca drejtë nga Marea kam vepruar jashtë Kosovës, për fat të keq)

Por unë jam tronditur nga hiperinflacioni i titujve akademike me të cilët mbushën supet e tyre edhe shumë kolege politikane, drejtues institucionesh të gjyqësorit bile të shkallës më të lartë etj. Keta akademike fiktive po prodhojnë kuadra fiktive dhe po e helmojnë shoqërinë për të nesërmen e shtetit të Kosovës. Me këtë shqetsim po e ndjek dhe protestën e studentëve që janë në të drejtën e tyre. Por nuk duhet të kemi kurban. Rektori aktual nuk duhet të jetë kurban për gjithë akademikët e rrejtshëm të Kosovës.

Duhet krijuar një ekip të urtësh me profesore të vjetër të viteve 70, ta që të marrin në shqyrtim gjithë rastet e dyshimta të karrierës së peshpejtuar akademike. Këto karriera duhen nderprerë tani. Nesër është vonë sepse demet zinxhirorë do të jenë të pallogaritshme. A do të besoni ndërtimin e një pallati një arkitekti të rrejtshëm? Nese po, unë ju them se pallati është i rrezikshëm për të jetuar! A mund t'ja besojmë ndërtimin e shtetit këtyre figurave që genjejnë veten dhe ne?

372 36 Comments 15 Shares



Behgjet Pacolli

February 2, 2014 · 🌐

...

Disa sqarime për Trepqën

Është e pabesueshme se si disa njerëz këtu në Kosovë, që synojnë të krijojnë opinion, ti hudhin gjërat në publik, pa l njohur ato ose e bëjnë atë me qëllim të caktuar.

Veprimet e tilla, nganjëherë janë të dëmshme, ngase ende lexuesi është l prirur të besojë atë që e lexon, gjegjësisht e dëgjon dhe në bazë të tyre krijohet opinioni publik, që realisht është opinion l gabuar. Nga dita e parë e aktivitetit tim në Qeverinë e Kosovës, kam vërejtur se Trepqës l është shkaktuar një dëm vështirë l riparueshëm.

Duke l kuptuar këto veprime të gabuara që ishin bërë deri atëherë, shumë konsultime me profesionistë të llojit, nga vendi dhe ndërkombëtarë, na sollën në përfundim, se nuk mund të tolerohet që një pasuri aq me rëndësi kombëtare të trajtohet pa skrupul. Situata të cilën e gjeta nuk kishte të ndalur dhe Trepqa rrezikohej nga shihja për dy para, bile edhe mbyllja e saj. Mu për këtë insistoja që Trepqa të tërhiqej nga kthetrat e Agjencionit famëkeq të Privatizimit, në mënyrë që mos të shitet gjegjësisht mos të jipet në koncesion. Dëgjoji dhe lexoj thashethemet, "se mos vallë Behgjet Pacolli është duke e marrë Trepqën". Unë u them që Jo. AS nuk ka qenë dhe as nuk është në opsionin tim Trepqa, por si zakonisht në Kosovë, krijohen mitet dhe kur unë jam në pyetje ma e lehta është të thuhet "e ka për interesat e tij". U them këtyre që lansojnë informata të tilla u them se e keni gabim, se unë personalisht jam vënë herët kundër privatizimit dhe koncesionimit të Trepqës. Siq kam qenë kundër qdo privatizimi të egër në Kosovë, ku nga ky process fituan vetëm ata që e trajtuan dhe jo edhe qytetarët e Kosovës. Tani, ka filluar procesi ku Trepqa të hiqet nga AKP-ja dhe të kalon nën mbikqyrjen e parlamentit. Deputetët e Kosovës, në vend që të paragjykojnë tani kanë shansin e madh të mbikqyrin procesin e mëtejshëm të ndërmarrjes së ardhshme publike Trepqa. Të mbikqyrin në detaje zhvillimet e veprimeve për këtë gjigand, si ndërmarrje publike. Unë kam zgjidhjen më të mirë, për Trepqën, për ardhmërinë e Trepqës dhe do të doja që të gjithë njerëzit kompetent dhe profesionist të kësaj fushe, të bashkpunojnë në realizimin e këtij synimi. Opinioni public do të informohet gjërësisht me veprimet që do të mirren për Trepqën. Këto veprime janë sigurisht që rrjedhin nga kërkesat e tregut të globalizuar, të një kompanie globale. Projekti ynë, është që Trepqa të mbetet pronë e patjetërsueshme dhe shpirtërore e Kosovës por në anën tjetër duhet të lojtare e fortë globale në fushën e vet, duke e ditur se është gjigandi l vetëm l plumbit dhe l zinkut në Evropë. Minierat tjera janë shumë larg Evropës, kështu që Trepqa l ka gjithë predispozitat që ta luajë këtë rol.

👍 155

13 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

February 2, 2014 · 🌐

...

Sqarim

Mendimin tim sa l përket UP-së e kanë keqkinterpretuar disa media se unë kinse qenkam rreshtuar në krah të dikujt.

Kjo absolutisht nuk është e vërtetë.

Në esencë, unë kam thënë që studentët me kërkesat e tyre, kanë të drejtë të pakontestueshme, të i kundërvihen një sistemi që përbëhet nga individë që kanë tituj fiktiv dhe kanë marrë tituj me metoda abusive.

Gjithashtu, jam kundër që vetëm një individ të bëhet kurban për të gjithë të tjerët.

Të gjithë duhet të japin llogari dhe të gjithë duhet të nënshtrohen para një kontrolli të rreptë, edhe për publikimet shkencore, ngase vetëm kështu mund të përmirësohet cilësia e arsimit.

👍 179

16 Comments 5 Shares





Intervista në Zëri që ia vlen të lexohet...

Zëvendëskryeministri, Behgjet Pacolli, nuk beson se Qeveria Thaçi 2, pjesë e së cilës është edhe partia e tij, do ta përfundojë mandatin para kohe, përkatësisht para muajit shtator. Presidenti i AKR-së konfirmon edhe riformatimin e ministrave të tij në ekzekutiv  
Lavdim Hamidi & Albert Ahmeti  
Prishtinë

Deputetët e Koalicionit për Kosovën e Re (KKR) nuk do të kërkojnë mocion votëbesimi për Qeverinë e kryeministrit Hashim Thaçi, ashtu siç kërkuan në vitin 2011, në mënyrë që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Drejtuesi i këtij koalicioni, zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, nuk beson se kjo qeveri, pjesë e së cilës është edhe partia e tij (Aleanca për Kosovën e Re), do ta përfundojë mandatin para kohe, përkatësisht para muajit shtator. Sipas tij, çdo tentativë për ta rrëzuar këtë qeveri e dëmton vendin.

Derisa heziton t'i komentojë deklaratat e ish-diplomatit amerikan, James Rubin, i cili pati deklaruar se krahu i luftës duhet të largohet nga pushteti, Pacolli gjatë një interviste për gazetën "Zëri" flet edhe për riformatimin e ministrave të AKR-së në qeverinë Thaçi, pasurimin e politikanëve brenda natës, ikjen e investitorëve të huaj, përkrahjen e Mimoza Kusari-Lilës dhe Agim Bahtirit nga imami kontrovers Shefqet Krasniqi, etj.

Zëri: A do ta ketë mocion votëbesimi ndaj Qeverisë dhe zgjedhjet të mbahen në mars?

Pacolli: Unë besoj që mandati i kësaj qeverie nuk do të përfundojë para kohe. Kjo qeveri do ta kryejë mandatin e saj të rregullt. Zgjedhje do të kemi në muajin shtator, është muaj i favorshëm, sepse qytetarët kthehen nga pushimet dhe zgjedhjet do të ketë sigurisht në muajin shtator. Ju e dini se unë personalisht kam sakrifikuar shumë nga subjekti im politik vetëm që kjo të ndodhë. Vetëm e vetëm që Kosova të ketë institucione stabile dhe ato të përmbushin mandatin e tyre kushtetues. Andaj nuk po shoh ndonjë arsye që kjo të ndodhë në formën që ju po e shtroni.

Zëri: A mund të ketë mocion votëbesimi në Parlament?

Pacolli: Unë nuk besoj që do të ketë, për arsye se njerëzit janë të vetëdijshëm se çdo tentativë për të rrëzuar këtë qeveri e dëmton vendin, sepse jemi në implementimin e proceseve shumë të rëndësishme për Kosovën dhe duhet të shfrytëzojmë çdo ditë në favor të implementimit të synimeve.

Zëri: Në takimet e fundit me ambasadorën amerikane, ku ju nuk keni qenë të pranishëm, janë dakorduar që të shkohet në zgjedhje në qershor?

Pacolli: Këto janë spekulime. Nuk ka kurrfarë vendimi që të shkohet në zgjedhje në qershor, normalisht opozita e ka të drejtën e vet parlamentare të kërkojë çka të dojë, por në mes të kërkesave dhe mundësive ekziston një lumë, siç thonë. Jam i bindur se kjo qeveri do ta përfundojë mandatin e vet.

Ministra të rinj të AKR-së

Zëri: Është thënë se para zgjedhjeve të përkohshme do të ketë riformatim të Qeverisë. Çka konkretisht?

Pacolli: Ne si AKR do të kemi një riformatim, krejt kjo në favor të kualitetit në fushën ekonomike, do të bisedojmë me kryeministrin dhe do ta realizojmë. Ne jemi për ndryshime,

jemi për risi. Jemi proaktiv dhe e kemi dëshmuar këtë. Në këtë pikë të mos dyshoni, sepse ne nuk do të rrimë duarkryq.

Zëri: Çka do të ketë konkretisht?

Pacolli: Formatizimi t'i sjellë kualitet qeverisjes sonë. Do të sjellë një qeverisje edhe më të mirë dhe sigurisht ministrat të cilët kanë treguar suksese ndoshta nuk do të ketë nevojë që të ndërrohen, mirëpo ne i kemi disa kërkesa për disa pjesëtarë të qeverisë që mund të japin edhe më shumë. Natyrisht, në vlerësojmë angazhimin dhe punën e gjithsecilit deri më tani, por kompleksiteti i ekzekutivit kërkon shumë punë, kërkon shumë ide të reja. Në këtë drejtim ne si AKR do të përpiqemi që të ngremë cilësinë në dikasteret tona qeverisëse, duke i plotësuar ato me njerëz të rinj, me energji të reja.

Zëri: A mund të na jepni ndonjë emër?

Pacolli: Nuk mund të jap emra, nuk ka ende ndonjë vendim. Jemi duke e përgatitur një plan të riformatimit dhe duke menduar për njerëz adekuat, reprezentues e të dinjitetshëm.

Nuk deklarohet për ministrat e PDK-së

Zëri: A do të duhej që edhe disa ministra të PDK-së të riformatohen, pasi që kanë pasur disa skandale që ia kanë dëmtuar imazhin qeverisë?

Pacolli: Nuk më takon mua të flas për partnerin e koalicionit, i mbetet kryesisë së PDK-së, gjegjësisht kryeministrit që të vendosë për këtë çështje.

Zëri: Cili dikaster ka dështuar?

Pacolli: Nuk jam i prirë që sot ta drejtoj gishtin kundër dikujt, por jam i bindur që kjo qeveri ka mundur të japë fryte më të mira, ka mundur të punojë edhe më mirë edhe pse është bërë punë e madhe. Mos harroni në një mandat të plotë, tek tash, që i bie nga fundi i mandatit, po jetësohen idetë e mia të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Dhe kjo është shumë ngadalë. Ka mundur të bëhet edhe më shpejt.

Zëri: A mund t'i përmendni tri punë të mëdha që i ka bërë kjo qeveri?

Pacolli: Sigurisht që mundem. Kemi vazhduar me ngritjen e institucioneve dinjitoze të kësaj qeverie. Nuk ka ditë ose javë që nuk miratojmë ligje apo strategji të reja, krejt kjo në favor të përmirësimit të kualitetit të qeverisjes. Për një qeverisje më transparente më të përgjegjshme dhe më efektive. Mund t'ju them se hapja e dialogut është një arritje e madhe për Kosovën, sepse për mua si njohës i mirë i situatës, tani për tani ekzistojnë dy opsione në mes dy armiqve nëse i konsiderojmë të tillë, është opsioni i dhunës dhe opsioni i dialogut. Jam i bindur se në këtë pjesë të Evropës nuk do të ketë më luftë asnjëherë për arsye se e kanë provuar të gjithë dhe kanë dalë të zhgënjyer prej saj. Kështu që i hapet horizonti i gjerë dialogut. Fillimi i dialogut ka qenë një guxim i madh nga kjo qeveri. Ndoshta bashkatdhetarët e mi nuk janë dakord me këtë, por efektet e dialogut do të shihen në të ardhmen.

Zëri: Megjithatë, Serbia është shumë më e favorizuar sesa Kosova?

Pacolli: Në çdo kontratë ka palë që në dukje duket që ka fituar apo ka humbur më tepër. Ne kemi bërë dialog për zgjidhje të qëndrueshme. Zgjidhje e qëndrueshme është që Kosova dhe Serbia të kenë një paqe të qëndrueshme, mos të ketë në të ardhmen një kufi që i pengon lëvizjen e lirë të njerëzve, të mallrave e të kapitaleve.

Zëri: A po ikin investitorët për shkak të korrupsionit?

Pacolli: Sigurisht që ka edhe arsye tjera. Nuk është vetëm "Deuchetelekomi", ka edhe investitorë tjerë që kanë ikur. Nuk dua ta anashkaloj faktin për vetëdijen e njerëzve të cilët bisedojnë me investitorët, nuk janë vetëm kryeministri dhe ministrat që flasin me investitorët, kemi një strukturë të organizuar që bisedojnë me ta. Ka pasur raste kur një kompani etabluar në Kosovë paraqet bilancin normal vjetor dhe vjen një inspektor i ATK-së dhe fillon t'i bëjë njëqind probleme që nuk ekzistojnë dhe krejt ato i bëjnë me qëllim për të

përfitur dhe normalisht që një investitor nuk i do gjërat e tilla. Nuk mund të garantoj që në Kosovë nuk ka edhe këso njerëz që i kanë frikësuar investitorët. Kosovarët partneritetin nuk dinë ta zhvillojnë, ndërsa unë si njeri me eksperiencë në këtë aspekt ju them se gjërat e mira në kohën e globalizimit nuk bëhen individualisht, por me partneritet.

Zëri: Ka pasur edhe skandale ku është përfshirë edhe qeveria, e kemi rastin e pasaportave, kanë raportuar edhe mediat ndërkombëtare?

Pacolli: Keni shumë të drejtë, unë jam absolutisht pro asaj që fajtorët e këtij skandali të identifikohen dhe të dalin para drejtësisë. Nëse ne e anashkalojmë një gjë të tillë, atëherë ne nuk do t'i tregojmë botës se kemi vullnet për të vepruar.

Milioni brenda natës, e pamundur

Zëri: Si ka mundësi që të "mbijnë" milionerët brenda natës, shumë prej tyre kanë zyrtarisht një pagë?

Pacolli: Unë nuk mund ta perceptoj atë, sepse vetë jam njeri i biznesit dhe besoni që kur flitet për miliona atëherë duhet një punë shumë e gjatë e mundimshme dhe kurrsesi nuk mund të ndodhë brenda natës, sepse nuk flasim për një ambient me fuqi të madhe të konsumit ku bëhet tregti e madhe dhe kanë mbetur shumë pare aty. Në Kosovë është i pamundur pasurimi i tillë. Nëse dikush është pasuruar brenda natës atëherë ose kjo ka ndodhur me fat, ose ka punuar diçka jashtëligjshëm dhe është pasuruar. Unë jam kundërshtar i madh i këtyre trillimeve. Duhet të ketë një kontroll të detajuar dhe të shikohet se si janë pasuruar.

Zëri: Jeni pjesë e qeverisë dhe ndoshta jeni në pozicion të pafavorshëm për të folur për njerëzit e politikës të përfshirë në korrupsion. Keni pasur rastin personal me "Grandin", ku ju janë kërkuar mjete nga njerëzit e politikës, si mund të thuhet se nuk ka korrupsion në qeveri?

Pacolli: Nuk do t'i quaja njerëz të politikës për arsye se nëse ka qenë i përfshirë një njeri i institucioneve, është parë që ata njerëz më nuk janë në Qeverinë e Kosovës, dhe të drejtën t'ju them atë rast unë do të isha i paskrupull, nuk do të toleroja një gjë të tillë. Në rastin e "Grandit" është shembull eklatant, mbetet një enigmë për Kosovën, sigurisht do të ketë edhe rezonancë ndërkombëtare sepse nuk besoj që firmat e mia, të cilat po drejtohen prej të tjerëve, por unë nuk ik prej asaj që jam pronar i tyre, nuk do ta lënë që kjo të bjerë në baltë, për arsye se aty ka qenë një kontratë, janë paguar paratë dhe ato nuk mund të avullohen askund. "Grandi" do të kalojë nëpër të gjitha instancat në Kosovë dhe është përgatitur lënda për arbitrarët ndërkombëtarë që në këtë rast duhet të bëhet nga njëra prej dhomave të Bankës Botërore.

S' deklarohet për pensionimin e krahut të luftës

Zëri: Keni thënë se duhet të pensionohet krahu i luftës, a keni ju të drejtë ta bëni këtë kërkesë?

Pacolli: Kjo deklaratë është bërë në kohë të fushatës dhe nuk dua të deklarojem tani se a kam pasur të drejtë apo jo.

Zëri: A i frikësoheni partnerit të koalicioni për një deklaratë të tillë?

Pacolli: Nuk kam arsye pse t'i frikësohem, mirëpo e di se në shumë raste është mirë që të merresh me punët e tua e jo me të tjerëve.

Zëri: A është hidhëruar kryeministri për deklaratat që i keni dhënë në zgjedhjet lokale?

Pacolli: Nuk e di. Pyeteni atë.

Zëri: Pse po ikin njerëzit prej Kosovës?

Pacolli: Sinqerisht është një problem i madh. Po të isha unë përgjegjës i institucioneve të Kosovës do të punoja shumë më tepër, krejt fuqitë e mia do t'i fokusoja në liberalizimin e vizave sesa për integrim. Unë do të doja që në derën e BE-së të trokisnim kur të jemi më të

fuqishëm. Për ne me këtë nivel të zhvillimit ekonomik e me këto probleme do të na trajtojnë si vend të nivelit të dytë. E shoh një problem të madh faktin që rinia e Kosovës është në pamundësi që të dalë, nuk është vetëm çështje ekonomike.

Zëri: A është duke ndodhur shpëlarje e trurit në Kosovë prej sekteve fetare?

Pacolli: Absolutisht po, por jo vetëm prej sekteve fetare, por edhe prej asociacioneve të ndryshme. Shkuarja e njerëzve tanë në Siri nuk mendoj që kanë pasur ideologji që të shkojnë atje t'u ndihmojnë grupeve opozitare që të sjellin demokracinë në Siri, nuk besoj në këtë, por është shpëlarje e trurit. As vetë nuk e dinë se pse kanë shkuar atje, nuk e dinë pse po luftojnë atje. Kjo është dukuri në rritje e sipër. Edhe në vitet e 80-ta kemi pasur xhami e hoxhallarë, por edhe priftërinj, këta e kanë kryer punën e vet, rinia ka dalë jashtë dhe është kthyer e ka pasur mundësi të jetë në kontakt me shoqëritë e civilizuara. 99 % e tyre janë kthyer me pikëpamje të civilizuara.

Zëri: A pajtoheni me këto rrymat islame që thonë se duhet të ndryshojë Kushtetuta e Kosovës e që nuk duhet të jemi shtet laik?

Pacolli: Kushtetuta është shumë e mirë dhe nuk ka pse të ndryshohet.

Përkrahja nga Shefqet Krasniqi

Zëri: Ka imam kontrovers si Shefqet Krasniqi, i cili ju përkrah publikisht. Ai ka takuar Mimoza Kusarin e Agim Bahtirin?

Pacolli: Përkrahja e zotëri Krasniqit ka qenë në frymën e përkrahjes së një kauze, për arsye se AKR-ja ekziston në skenën politike të Kosovës për t'i përkrahur qytetarët e Kosovës.

Zëri: Sa ju ndihmon përkrahja e njerëzve kontroversë?

Pacolli: Unë personalisht, e as subjekti politik që unë drejtoj nuk mund t'i mohoj apriori, në çfarëdo forme mbështetjen e cilitdo qoftë. Ai është imam në një xhami të njohur të kryeqytetit. Rrjedhimisht përfaqësues i një institucioni. I takon BIK-ut të vendosë për përfaqësuesit e vet. Ne na takon t'i respektojmë si institucion. Nuk dua ta gjykoj as zotëri Krasniqin e askënd tjetër. Nuk kam pasur asnjë shenjë prej tij që ai ka tentuar që nëpërmes AKR-së të krijojë ndonjë platformë veprimi. Ne kemi një platformë, një program, të cilin po e implementojmë edhe pse jo ashtu siç duam. Unë nuk mund t'i them zotëri Krasniqit mos fol për neve, as mos na simpatizo e as mos na shaj. Nëse ai i ka përkrahur Mimosën edhe Agim Bahtirin, një hoxhë tjetër na ka fyer. E drejta për të besuar në Zot është e secilit, këtë nuk ia mohon askush, kështu që nuk dua ta paragjykoj as Krasniqin e as hoxhën e Mitrovicës. E respektoj çdokënd që mund të japë kontributin e vet në zhvillimin e shoqërisë.

Zëri: A duhet të japë dorëheqje rektori i Universitetit të Prishtinës?

Pacolli: Unë nuk kam të drejtë të flasë për një institucion të pavarur. Ibrahim Gashi ka qenë nënkryetar i AKR-së. Sa i përket punës së tij në parti, ai ka qenë shumë i devotshëm. Ka kërkuar që të largohet nga partia dhe që në momentin kur ka shkuar në Rektorat e Universitetit, asnjëherë nuk e kam thirrur për ta pyetur për ndonjë gjë. Ai tani nuk është pjesë e AKR-së, sa i përket aspektit të karrierës nuk na intereson neve.

Zëri: Pasi që jeni njeri i rëndësishëm në Qeveri, shoqërisë i duhet edhe një mendim i juaji për këtë gjendje?

Pacolli: Po të ishte ndonjë kontekst ekonomik nuk do të hezitohet të flisja, por është një kontekst krejtësisht tjetër që nuk i njoh rrethanat dhe do të ishte e tepruar po të flisja.


Zëri: Dështoi shitja e PTK-së, cilat janë humbjet nga ky privatizim?



Pacolli: Ministri aktual i Zhvillimit Ekonomik kur ka ardhur e ka gjetur një kontratë të shkruar, e ka gjetur një komision ndërministror dhe këshilltarët ndërkombëtarë, praktikisht ky e ka trashëguar atë proces. Ai ka vërejtur një mangësi dhe nevojën që kjo kontratë të miratohet në Kuvendin e Kosovës dhe ai ka ardhur në Qeveri, e ka marrë pëlqimin që kontrata t'i

paraqitet Kuvendit të Kosovës. E pastaj se si ka shkuar procesi e dimë të gjithë. Nuk mund të them se a ka gabuar Parlamenti i Kosovës apo jo. Unë kam pasur shumë presione nga shoqëria civile që të parandalohet shitja e PTK-së. Unë postën do ta trajtoja ndryshe, do ta trajtoja në kohën e mëhershme. Unë më parë kam thënë se ndoshta do të ishte mirë që posta t'i jepet në menaxhim një fondacioni investues anglez, i cili ofronte 400 milionë që ta marrë dhe ta menaxhojë për gjashtë vjet.

 Ardian Krasniqi and 697 others

26 Comments 9 Shares




**Behgjet Pacolli**   
February 4, 2014 · 

Nga paraqitja ne RTK Subvencion rreth Trepces <http://www.rtklive.com/new/index.php?cid=1&newsId=90942...> admin

RTKLIVE.COM

**Pacolli: "Trepça" do t'i kthehet popullit**

Zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli ka thënë sonte se kombinatin metalurgjik "Trepça" nuk duhet të shitet dhe as të tjetërsohet. Sipas tij, ky kombinat duhet t'i mbetet popullit të Kosovës. Ai po ashtu ka thënë se...

 324

24 Comments 18 Shares



**Behgjet Pacolli**   
February 4, 2014 · 

Intervista e plotë(video) në RTK SUBVENCION e zv.Kryeministrit Pacolli;"E ardhmja e Trepçës dhe zhvillimi ekonomik" admin  
<http://www.youtube.com/watch?v=r1fkR18L9IU...>

YOUTUBE.COM

**SUBVENCION 03.02.2014**

SUBVENCION 03.02.2014

 192

12 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

February 8, 2014 · 🌐

Reagim i AKR-së

Supozimet e këshilltarit të Kryeministrit të Shqipërisë dhe njeriut që kohë pas kohë është prezent edhe në mediet e Kosovës Shkelzen Maliqit, me deklarimet e tij të pa matura dhe tendencioze në një intervistë të porositur dhe të nxitur e publikuar sot, rreth kushtëzimit që kine AKR paska bërë me emërimin e Ibrahim Gashit, dëmtojnë para së gjithash rëndë, identitetin dhe dinjitetin e njerëzve dhe të AKR-së.

Zoti Maliqi përpiqet të damkos me shablon ide dhe përpiqet të shkatërroj individ e grupe të caktura të selektuara me paramendim prej tij dhe gjithmonë me porosi nga grupe a njerëz që personalisht ai i di dhe i njeh.

Ne i themi atij se ai gënjen dhe duhet ti vije turp për gënjeshtat e tij.

Për sjelljet e tij të ulta që nuk përkojnë me moshën e tij, e as me pozicionin që aktualisht mban. Ai nuk ka pasur asnjë kontakt me subjektin tonë politik dhe as me z.Pacolli poashtu.

Na lejoni të deklarojmë edhe njëher që prej momentit kur z.Gashi ka dhënë doreheqje nga AKR, ai nuk ka pasur asnjë kontakt me subjektin tonë politik dhe as me z.Pacolli poashtu.

Ju themi me kompetencë që asnjëherë nuk kemi diskutuar me partnerin tonë të koalicionit për z. Gashi konkretisht dhe pozicionin e tij.

Nëse ekziston një version tjetër, e ftojmë kryeministrin Thaqi që të deklarohet për këtë.

Supozimet e Shkelzen Maliqit, që target gjithmonë e ka AKR-në, janë tendencioze dhe të nxitura nga struktura që vetëm ai i njeh.

Poashtu na lejoni që të ndajmë me ju një shqetësim të përbashkët, qytetarë të Kosovës.

Janë të dhimbshme këto skena që i shohim në mediat tona. AKR është deklaruar sa i përket kësaj situatë dhe ruan qëndrimet e saj paraprake.

Presidenti i AKR-së ka deklaruar disa ditë më herët, që menjëherë duhet të zhvillohet një hetim i gjithmbarshëm për të gjithë stafin akademik në UP dhe gjith falsifikatorët duhet të dalin para drejtësisë.

Ne jemi për zgjidhje të situatës. Për ne ka rëndësi funksionimi i mirëfillt i UP-së dhe institucioneve të saj legale. Gjithcka tjetër në këtë moment është irelevante.

👍 204

29 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

February 9, 2014 · 🌐

E vlerësoj lartë aktin moral të dorëheqjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës z.Ibrahim Gashi. Dorëheqja e tij duhet të shërbejë si pikënisje për një hetim sa më të shpejtë të gjithë profesorëve në UP, dhe të mos ngelet z.Gashi kurban i aferave të jashtëligjshme në kete institucion të rëndësishëm. Dorëheqja e z.Gashi ka qenë e nevojshme pas zhvillimeve dramatike që ndodhën para rektoratit të UP ndërsa, është për keqardhje qdo tendencë manipulimi të studentëve nga individë kushdo qofshin ata për qëllime krejtësisht private.

👍 335

31 Comments 4 Shares



- AKR-ja po përgatit një befasi të madhe për qytetarët e Kosovës. Oferta jonë politike do t'i tejkalojë të gjitha parametrat normalë të skenës aktuale politike

Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, nuk e ka hedhur poshtë mundësinë për të qenë pjesë e garës së sivjetme për postin e kryeministrit. Por, ai ka thënë se për këtë çështje vendos Këshilli Drejtues i partisë. “Nuk është tërësisht në vullnetin tim çështja e kandidimit apo jo për postin e kryeministrit. Kjo është një çështje për të cilën do të vendosë Këshilli Drejtues i partisë. Asnjëherë nuk kam dal kundër këtij vullneti. U takon organeve të partisë të vendosin për këtë çështje”, ka deklaruar Pacolli, duke shtuar se AKR-ja është e gatshme dhe ka kapacitete ta udhëheqë qeverinë e ardhshme. “AKR-ja është gatshme t'i drejtojë një mori procesesh nga pozita e të parit të ekzekutivit”, ka thënë Pacolli

Shqipe HETEMI

Prishtinë, 13 shkurt - Lideri i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, të enjten nuk e ka përrjashtuar mundësinë të garojë për postin e kryeministrit të vendit. Megjithatë, ai ka thënë se për kandidimin ose jo të tij do të vendosin organet e partisë. “Nuk është tërësisht në vullnetin tim çështja e kandidimit apo jo për postin e kryeministrit. Kjo është një çështje për të cilën do të vendosë Këshilli Drejtues i partisë. Asnjëherë nuk kam dal kundër këtij vullneti. U takon organeve të partisë të vendosin për këtë çështje”, ka thënë Pacolli në këtë intervistë për “Epokën e re”.

Ai ka vlerësuar se AKR-ja ka kapacitete dhe është e gatshme për ta drejtuar qeverinë e ardhshme. “AKR-ja është gatshme të drejtojë një mori procesesh nga pozita e të parit të ekzekutivit. AKR-ja ka brenda vetes individë dhe kuadro kredibilë dhe të gatshëm t'u prijnë proceseve”, ka thënë Pacolli. Në këtë kontekst, ai ka thënë se çështjen e kandidimit të tij e sheh si mundësi të mirë për implementimin e programit zhvillimor ekonomik. “Në fakt, nuk është sfidë e cila ma tundon mendjen dhe ma luhat vendimin. Unë këtë e shoh më tepër si mundësi të implementimit të programit zhvillimor ekonomik që aktualisht është aq i nevojshëm në Kosovë. Këtu në të vërtetë nuk sfidohem unë personalisht, sfidohen ideja, programi e koncepti që do t'u garantonte Kosovës dhe qytetarëve tanë zhvillim, ngritje e progres”, ka thënë Pacolli.

Ai ka bërë me dije se në zgjedhjet parlamentare AKR-ja do të garojë e vetme dhe se, sipas tij, rezultati i këtyre zgjedhjeve do të jetë një befasi e këndshme për të gjithë. “AKR-ja futet në zgjedhje si triumfatore në dy komuna të mëdha të Kosovës. Rezultatet do t'i shihni edhe ju, por unë nga këtu mund t'ju garantoj se AKR-ja po përgatit një befasi të madhe për qytetarët e Kosovës. Oferta jonë politike do t'i tejkalojë të gjitha parametrat normalë të skenës aktuale politike. Kjo ndoshta do të jetë edhe nisma më e madhe në skenën e vendit”, ka deklaruar Pacolli. Ndonëse nuk është në dijeni për iniciativën e AAK-së për rrëzimin e Qeverisë, Pacolli ka thënë se nuk ka hapësirë për asnjë lloj frike pasi opozita e ka për obligim ta luajë rolin e saj. “Unë nuk e di nëse ka një iniciativë të tillë. Nuk ka hapësirë për kurrfarë frike. Opozitëbërja është obligim dhe detyrë e tyre”, është shprehur Pacolli.

“Epoka e re”: Z. Pacolli, do të jeni kandidat për kryeministër në zgjedhjet parlamentare të këtij viti?

Pacolli: Së pari kjo është një çështje për të cilën do të vendosë Këshilli Drejtues i partisë. Natyrisht unë asnjëherë nuk kam dal kundër këtij vullneti. U takon organeve të partisë të vendosin për këtë çështje. Mirëpo ju them me kompetencë dhe përgjegjësi të plotë se AKR-ja është gatshme të drejtojë një mori procesesh nga pozita e të parit të ekzekutivit.

AKR-ja ka brenda vetes individë dhe kuadro kredibilë dhe të gatshëm t'u prijnë proceseve. Personalisht nga kjo pozitë nuk mund as ta pohojë e as të mohojë këtë që po më pyesni ju. Natyrisht historiku i qëndrimit dhe zhvillimit tim në politikë nuk më ka lënë gjithmonë shije të mirë. Ju e dini se jo rrallë kam sakrifikuar edhe veten time në të mirë të proceseve nëpër të cilat po kalonte vendi. Shikuar nga kjo perspektivë, ju edhe mund të habiteni nga ky qëndrim imi, por natyra ime është sfiduese, është në vijimësi natyrë kërkuese. Kosova ka nevojë të madhe për energji, ide e kreativitet. Mendoj se në këtë rrafsh AKR-ja ka njerëz dhe energji që t'i japë ende Kosovës.

“Epoka e re”: Keni vendosur apo jo ta sfidoni veten edhe për këtë post?

Pacolli: Nuk është tërësisht në vullnetin tim çështja e kandidimit apo jo për postin e kryeministrit. Por, meqë insistoni, le të mendojmë hipotetikisht, dhe ta marrim si të mirëqenë pyetjen tuaj. Në fakt, nuk është sfidë e cila ma tundon mendjen dhe ma luhat vendimin tim eventual. Unë këtë e shoh më tepër si mundësi të implementimit të programit zhvillimor ekonomik që aktualisht është aq i nevojshëm në Kosovë. Këtu në të vërtetë nuk sfidohem unë personalisht, sfidohen ideja, programi e koncepti që do t'i garantonin Kosovës dhe qytetarëve tanë zhvillim, ngritje e progres. Kjo do të thotë më shumë mirëqenie dhe më tepër standard jetësor. Kjo do të thotë dinjitet e krenari për çdo qytetar të Kosovës. Ne sot kemi rininë më të madhe në Evropë. Kemi rininë më të shëndoshë në Evropë. Ata janë aq të mirë, aq të vullnetshëm dhe të gatshëm për çdo sfidë. Na takon neve t'ua japim hapësirën. Ky ndoshta është motivi im më i madh. Është detyrimi që kemi ndaj tyre. Detyrim që ne t'u krijojmë atyre kushte, që ata t'i çojnë përpara idetë dhe vizionin e tyre që nuk u mungon. Jam i bindur se, pos AKR-së, nuk ka vizion tjetër që e garanton këtë. Në tërë këto vite angazhim në rrafshin politik, unë personalisht dhe të gjithë njerëzit vullnetmirë që i janë bashkuar frymës së AKR-së, vazhdimisht kemi thënë se çelësi i rregullimit të ambientit social, bile edhe politik, ka qenë krijimi i mundësive që Kosova të zhvillohej në fushën ekonomike. Kur ne flisnim, disa na tallnin. Sot jemi në situatën kur AKR-ja është e vetmja forcë politike që ka shtyrë disa gjëra para. E them megjithatë, sepse ne asnjëherë nuk kemi qenë në ato pozita të fuqishme vendimmarrëse sa të vendosnim shpejt dhe në proporcion me kërkesat qytetare. Ta themi, për zonat e lira ekonomike, për Trepçën, për energjinë elektrike, apo edhe për procesin e privatizimit. Nga këto pozita që jemi, megjithatë kemi shtyrë para Ligjin për Trepçën, po vëmë bazën e krijimit të zonave të lira ekonomike në komunat të cilat i drejton AKR-ja e të tjera. Por, ka gjëra që ne për shkak të forcës së vogël politike e kemi pasur të vështirë t'i realizojmë, siç është platforma agroekonomike. Kosova s'ka qenë e gatshme t'i sigurojë 300 hektarë tokë për t'i shfrytëzuar për agroekonomi, për mbulim të nevojave qytetare të konsumit të brendshëm e lërë më për ta rritur nivelin e eksportit. Pra, ka shumë e shumë gjëra që ne, pavarësisht vizionit, nuk mund t'i implementojmë si rezultat i mungesës së kësaj fuqie. Natyrisht nuk do të mjaftonte një intervistë për ta shprehur tërë gamën e çështjeve që kanë të bëjnë me vizionin tonë ekonomik, për vizionin që i garanton Kosovës zhvillim. Por, duke dashur të përgjigjem më konkretisht në pyetjen tuaj, u mundova t'ju jap një arsyetim themelor në pyetjen se çka, në fakt, ne si AKR do të bënim nëse do të kishim në dorë udhëheqjen e ekzekutivit.

“Epoka e re”: Nuk i frikësoheni një gare ku do t'i keni përballë Hashim Thaçin, Isa Mustafën, Ramush Haradinajn e Albin Kurtin?

Pacolli: Ju thashë se po flasim për situatë hipotetike. Konsideroj se dallimi ndërmjet meje (apo dikujt nga AKR-ja) dhe dikujt tjetër që ju po përmendni qëndron pikërisht tek vizioni ekonomik që secili prej nesh ka. Ka kaluar koha kur Kosova është përballur me sfida të tjera, tash është koha e zhvillimit, koha e implementimit të vizionit ekonomik. Është e vërtetë e madhe se Kosova ka filluar ta përmbyllë një kapitull të rëndësishëm të



konfliktit tonë me shtetin fqinj, Serbinë. Mbyllja e një plage disadekadëshe po krijon kushte edhe më të fuqishme për hapësira të reja në kuadër të nevojave që Kosova ka zhvillim. Dallimet në këtë pikë janë goxha thelbësore. Edhe pse do të tingëllojë shumë jomodest, më duhet t'ju them një gjë. Përkatësia jonë dallon në shumë nuanca në raport me oponentët e tjerë politikë, pikërisht në raport me vizionin që ne kemi për ekonominë e Kosovës. Duke mos dashur të përsëritëm, më lejoni t'ju them se koha e AKR-së për Kosovën e zhvilluar nuk ka ardhur ende. Është pikërisht kjo mundësi e madhe që na bënë të besojmë se krijimi eventual i kësaj hapësire është motivi ynë kryesor si parti politike që ta marrim shumë seriozisht edhe këtë garë.

“Epoka e re”: Përfundimisht keni hequr dorë nga ambicia për t'u bërë president i vendit? Pacolli: Asnjëherë nuk do të kthehem për të garuar në garën presidenciale me këtë standard kushtetues dhe me këtë ligj zgjedhor. Presidenti duhet të zgjidhet nga populli. Këtë e kam thënë dhe ritheksuar dhjetëra herë. Ky është çelësi që do të garantonte zgjedhje presidenciale të lira dhe fer. Ju e dini se unë kam qenë pre e një sjellje jo dinjitoze të deputetëve tanë në Kuvend. Kjo është arsyeja pse unë jam tërhequr dhe nuk kthehem asnjëherë me këto rregulla të këtij procesi. Konsideroj se unë kam hapur rrugë për ndryshime kushtetuese për të cilat jemi pajtuar të gjithë dhe të cilat, si rrjedhojë e përgjegjësisë së dy partive, kanë dështuar deri më sot. Në situatën kur ndryshimet bëhen dhe populli vendos drejtpërdrejt për të parin e shtetit, gjërat ndryshojnë dhe unë do ta mendoja seriozisht kandidimin.

“Epoka e re”: Z. Pacolli, do të mund ta kalojë pragun zgjedhor AKR-ja në këto zgjedhje? Pacolli: AKR-ja futet në zgjedhje si triumfatore në dy komuna të mëdha të Kosovës. Rezultatet do t'i shihni edhe ju, por nga këtu mund t'ju garantoj se AKR-ja po përgatit një befasi të madhe për qytetarët e Kosovës. Oferta jonë politike do t'i tejkalojë të gjitha parametrat normalë të skenës aktuale politike. Kjo ndoshta do të jetë edhe nisma më e madhe në skenën e vendit. Ka kohë që po konsolidojmë aspekte të fuqishme strukturale brenda partisë dhe po e forcojmë partinë me emra dhe kuadro të reja, që përfaqësojnë aspekte të fuqishme nga sferat prej nga vijnë. Megjithatë, t'ia lëmë kohës dhe së ardhmes së afërt që edhe vetë qytetarët të binden me këtë.

“Epoka e re”: Do të garoni të vetëm apo si koalicion parazgjedhor?

Pacolli: Vetëm, absolutisht. Përgjigjja ima paraprake më bën të besoj fuqishëm se do të hyjmë vetëm. Dhe do t'ia dalim vetëm. Rezultati do të jetë një befasi e këndshme për të gjithë.

“Epoka e re”: Si e shihni iniciativën e AAK-së për rrëzimin e Qeverisë?

Pacolli: Nuk e di nëse ka një iniciativë të tillë.

“Epoka e re”: Nuk i frikësoheni kësaj iniciative?

Pacolli: Nuk ka hapësirë për kurrfarë frike. Opozitëbërja është obligim dhe detyrë e tyre.

 **Behgjet Pacolli**   
February 16, 2014 · 

<http://gazetatribuna.com/?FaqelD=8&LajmiD=43434>

GAZETATRIBUNA.COM  
**Ligji për Trepçën si mundësi konsensusi**  
Vendimi i fundit i qeverisë së Kosovës për t'i dhënë dritën e gjelbër kalimit të kompleksit mineral "Trepça", nga AKP në duart e qeverisë së Kosovës dhe në fund shndërrimi i saj në ndërmarrj

 236  9 Comments  5 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
February 17, 2014 · 

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës

Kam nderin e veçantë që në emër të Aleancës Kosova e Re dhe në emrin tim personal, t'ju uroj përvjetorin e gjashtë të shtetësisë së Kosovës, me besimin se vlerat demokratike të shtetit tonë të ri janë duke u avancuar çdo vit e më shumë.

Përvjetorë të tillë pa shmangshëm na kujtojnë të gjitha sakrificat shumëvjeçare të popullit të Kosovës dhe dëshmorëve të kombit në rrugën drejtë lirisë, pavarësisë dhe demokracisë.

Shpreh bindjen më të thellë, se kjo ditë e shenjtë për Kosovën dhe kosovarët shënon fillimin e ri për një të ardhme të ndritur për vendin tonë, me besimin e plotë se energjitë tona janë të orientuara drejt ndërtimit dhe forcimit të shtetit të Kosovës.

Zoti e bekoftë Kosovën!

Urime!

 542  33 Comments  7 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
February 26, 2014 ·  ...

Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka paralajmëruar se mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për moszbatimin e rezolutës së 7 prillit të vitit 2011, e cila parashihte që presidenti i vendit të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli.

Postuar nga Admin.

---



INFOKOSOVA.NET

**Pacolli: Rezolutën mund ta dërgojë në Kushtetuese**  
Ish-presidenti i Kosovës është shprehur i zhgënjyer me Hashim Thaçin dhe Isa Mustafën për m...

---

 296 14 Comments 3 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
February 27, 2014 ·  ...

<https://www.gazetaexpress.com/.../pacolli-thaci-e.../>

---



WWW.GAZETAEXPRESS.COM

**Pacolli: Thaçi e Mustafa u frikësohen zgjedhjeve (Video)**  
Kryetari i Aleancës Kosova e Re, në një intervistë për Kosovapress ka thënë se Hashim Thaçi dh...

---

 266 12 Comments 6 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
February 27, 2014 · 

  
**William Uoker**  
*ish ambasador / SHBA-ve,  
Shef / misionit vëzhgues  
të OSBE-së,  
Kosovë, 1998*

*Kur ai (Behgjet Pacolli) merret me një kauzë, me një mision, ai është i gatshëm për të investuar kohën e tij, pasurinë e tij personale, mirëqenien e gjithçka duhet për të sjellë një zgjidhje të drejtë dhe praktike.*

*Behgjet Pacolli është kështu një biznesmen i suksesshëm, një humanist i madh, një zgjidhës problemesh, një burrë shteti i cili dëshiron të kontribuojë me të gjitha cilësitë për një jetë më të mirë për bashkatdhetarët e tij kosovarë, dhe të gjithë popujt e Ballkanit!*

 Meriton Basha and 1.3K others  41 Comments  72 Shares



Behgjet Pacolli  
February 28, 2014 · 🌐

...

Qytetari mban mend gjithçka kemi bërë, dhe jo çfarë bëjmë para zgjedhjeve

Nga Behgjet Pacolli

Sa herë që afrohet koha e zgjedhjeve, disa parti politike krijojnë një lojë të posaçme që u ngjan se do prodhon vota më shumë në garën e afërme për besimin e qytetarit. Bëhen lloj lloj manovrash, diku për t'ju larguar qeverisjes, diku për t'ju afruar asaj. Kështu i kam parë, me këtë sy veprimet e fundit për të ndërprerë mandatin e qeverisë, apo për t'ja zgjatur jetën asaj. Bëhen deklarata të forta, të buta, nisen veprime që mohohen të nesërmen, bëhen takime të fshehta dhe të hapura, që frymëzohen nga interesi partiak i seicilës palë, gjegjësisht interesi politik i tyre. Të mbrosh apo të frymëzohesh nga interesi partiak, nuk është kurrgjë e ndalueshme. Por interesi politik, interesi partiak jo gjithmonë përputhet me interesin e Kosovës. Interesi i Kosovës është interesi i gjithë qytetarëve pa dallime partiake, ndërsa interesi partiak është interesi i një grupi udhëheqës, i një partie, i votuesve të saj, të cilët në kohë pluralizmi nuk janë baraz me trupën votuese, me të gjithë qytetarët e Kosovës me të drejtë vote. Sot në këtë kohë të veçantë diskutimesh të tilla, unë dua të shpjegoj pse interesi partiak i dikujt, s'ka rëndësi se kujt, nuk përputhet me interesin e Kosovës. Dhe dua të bëj një thirrje të hapur sesi të pajtojmë interesat tona partiake me interesin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Sipas llogarivekushtetuese ne duhe të shkojmë në zgjedhje në janarin e vitit të ardhshëm. Si pjesë e qeverisjes unë kam pakënaqësitë e mia, pse pjesë të rëndësishme të programit tonë nuk janë përmbyshur, ose janë zhagjitur pafundësisht. Si pjesë e një marrëveshje politike dhe një rezolute parlamentare tërësisht kushtetuese, ne duhet të përfundojmë reformën zgjedhore dhe kushtetuese para se të shkojmë në zgjedhje. Në çfarëdo rrethane, AKR-ja është e gatshme për zgjedhje, kur siç e kanë pranuar dhe kundërshtarët apo aleatët tanë politikë, AKR-ja ishte njëloj fituese morale e zgjedhjeve të fundit vendore. Pra interesi ynë partiak nuk çenohet kurrsesi nga zhvillimi i menjëhershëm i zgjedhjeve, përkundrazi. Na vjen keq që nuk po mbahen zotimet e asaj marrëveshjeje politike të shpallur dhe garantuar solemnisht prej miqve tanë perëndimorë, por ne do ta rrisim peshën tonë politike që të imponojmë realizimin e tyre.

Interesi i Kosovës është gjithashtu që institucionet të punojnë deri në ditën e fundit të mandatit të tyre, madje disa institucione nuk duhet të ndalen kurrë. Por kjo zhurmë politike, këto manovra politike, me deklarata publike, me takime, me fushata të fshehta apo publike e çënojnë punën e tyre. I trullosin institucionet, i lënë të paqartë njerëzit për fatin e tyre. Dhe mbi të gjitha ndërpresin procese të rëndësishme, apo më pak të rëndësishme që kjo qeveri i ka nisur dhe s'janë vetëm në interes të saj, por në interes të Kosovës. Të ndërpresësh këto procese, e dëmton besueshmërinë ndërkombëtare të Kosovës, e dëmton besueshmërinë e një institucioni si Kuvendi i Kosovës i cili sot nuk është funksional, por që duhet të jetë funksional deri në fund. Të gjithë e dimë se ky parlament nuk po merr vendime të rëndësishme, por vazhdon të shndërrohet në arenë debatesh që nuk prodhojnë kurrgjë.

Për këto arsye si president i AKR, pa kurrfarë interesi partiak, por vetëm duke vënë mbi krye interesin e Kosovës, do doja të bëja një thirrje të gjithë partive politike. Hajde ta rrisim qartësinë tonë për jetën e institucioneve dhe proceset jetike për një shtet të ri sikur joni që mbushi 6 vjet.

Të bëjmë një marrëveshje të plotë politike për kohën kur do i mbajmë zgjedhjet. Pasi ta përcaktojmë atë afat, të lemë institucionet të punojnë, në veçanti parlamentin dhe pastaj qeverinë. Kush është në opozitë dhe shpreson të vijë në pushtet duhet ta kuptojë se nëse bën manovra jolojale sot për t'a bllokuar qeverinë, nesër kur të ndërrohen rolet do të pësojë të njëjtën gjë prej rivalëve politikë. Pra pasi të fiksojmë afatin e zgjedhjeve, pasi të mbarojmë reformën zgjedhore, t'i lemë kohën e duhur proceseve që kemi nisur, apo institucioneve organizuese të zgjedhjeve si KQZ. Të miratojmë ndoshta dhe një listë ligjesh apo vendimesh të cilat ky Kuvend duhet t'i miratojë para se të shkojë në zgjedhje. Unë jam i vetëdijshëm për raportet e numrave në parlament dhe këtu do ta vlerësoja opozitën për qëndrimet shpesh konstruktive që ka mbajtur duke mos krijuar krizë qeveritare të panevojshme. Kështu ajo i ka dhënë bonx rivalit në qeveri, të cilat dikur do t'ja kërkojë. Por konstruktiviteti duhet të vazhdojë deri në fund.

Ptesa ime, qëndrimi im publik më duket se e respekton qytetarin e Kosovës, më mirë se çdo manovër jopublike e dikujt. Qytetari është dëshmitar katër vjeçar apo më i hershëm se çfarë ka bërë gjithseicili në rolin e vet, në opozitë apo në qeverisje. Gënjejehet kushdo që mendon se qytetari e ka kujtesën e shkurtër dhe do mbajë mend vetëm manovrat e fundit të mandatit. Pra gënjejehet rëndë kushdo që mendon se mund ta mashtrtojë qytetarin me hilet apo lojrat e veta të këtyre ditëve të fundit. Më duket se e tregova pse këto lojra pra frymëzohen nga interesi politik dhe jo nga interesi i vendit, interesi i Kosovës, interesi i qytetarit të saj. Qytetari i do të gjithë në punë, të gjithë në rolin e vet, pa stërkambsa, pa dredhi dhe me sinqeritet.

👍 228

11 Comments 7 Shares



Këtë letër, zoti Behgjet Pacolli në cilësinë e kryetarit të AKR-së, në vitin 2010 i pati dërguar shefit të ICO-së, Pieter Feith.

Në këtë letër, zoti Pacolli jep propozimin konkret se si të krijohet fondi zhvillimor i Kosovës, (Agjensioni i Gjeneratave të reja) fond i cili do të shërbente për krijimin e perspektivës zhvillimore për gjeneratat e reja, në dobi të vendit, të ekonomisë së tij. Andaj, edhe pse më vonesë, vlerësohet fakti se tashmë flitet për fond zhvillimor, që për Kosovën është shumë i nevojshëm.

16/06/2010

I nderuar zoti Feith,

Duke ju falënderuar për kontributin tuaj të shquar në drejtim të Pranisë Civile Ndërkombëtare në Kosovë, do të doja t'ju nënvizoja disa probleme të rëndësishme për ecurinë e shoqërisë dhe politikës në vendin tonë.

Me cilësinë e kryetarit të Partisë Aleanca Kosova e Re, një parti që ka në themel të vet zhvillimin ekonomik të Kosovës, begatinë e qytetarëve tanë, transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes, do të doja të shprehja vlerësimin tim për angazhimin tuaj dhe për instrumentet e tjerë evropianë, si misioni EULEX, në favor të ndërtimit të ngrehinës institucionale të Kosovës, drejtësisë në veçanti, në shërbim të qytetarit të Kosovës.

Ne besojmë se angazhimi juaj profesional, parimësia, paanshmëria e misionit tuaj është garanci për suksesin e funksionimit të institucioneve sot dhe në të ardhmen në Kosovë. Beteja kundër korrupsionit në këtë fazë të shtetësisë sonë është jetike për cilësinë e ndërtimit të themeleve të Kosovës së re dhe ajo ka krijuar shpresë tek qytetari ynë.

Zoti Feith,

Ne kemi ndjekur me interes prononcimet tuaja në kontekste të ndryshme, në SHBA, në institucione evropiane, në Kosovë në lidhje me pavarësinë e Kosovës si një punë të kryer dhe në favor të sovranitetit të Kosovës në gjithë territorin e saj. Në këtë kuadër, pohimi juaj se Kosova nuk mund të ndahet është mjaft i vlerësueshëm dhe ne shpresojmë shumë se puna juaj në vendosjen e autoritetit të ligjit të Kosovës në gjithë territorin do të vazhdojë edhe më tutje. Për prosperitetin ekonomik të qytetarëve, për autoritetin e shtetit të ri, për konsolidimin e financave publike është jetik mbizotërimi i Kushtetutës së Kosovës, i ligjeve të saj, kontrolli i institucioneve të saj në gjithë territorin, nga Jugu në Veri, nga Perëndimi në Lindje.

I nderuar zoti Përfaqësues Civil Ndërkombëtar,

Po ashtu kemi ndjekur me vëmendje të madhe dhe debatin tuaj publik me institucionet vendore të Kosovës, në lidhje me paratë e Fondit të Agjencisë Kosovare të Privatizimeve, dikur Fondi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, si dhe për paratë e Trustit Pensional.

1) Si një njeri që ka shpenzuar dhjetra vjet në nivele të larta të biznesit ndërkombëtar,  
2) që e njeh mjedisin biznesor këtu;  
3) si dhe pas studimit të kuadrit ligjor që rregullon këtë çështje, (Propozimit Gjithëpërfshirës, aneksi 6 dhe 7, dispozitat tranzitore të Kushtetutës së Kosovës, si dhe Ligjin në fuqi për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 19), unë e konsideroj plotësisht të drejtë qëndrimin tuaj refuzues ndaj kërkesave të qeverisë. I njëjti qëndrim imi vlen dhe për paratë e Trustit Pensional të Kosovës. Këto fonde janë djersa e brezave të shumtë të kosovarëve në vite dhe jo paratë e një qeverie të vetme. Prandaj ato nuk duhet të hyjnë në kasën e qeverive, dhe sidomos të atyre qeverive që deri më tani nuk kanë gjeneruar begati për qytetarin e Kosovës, përkundrazi e kanë varfëruar atë, për

shkak të neglizhencës së tyre, mungesës së përgjegjësisë dhe profesionalizmit të tyre në një proces privatizimi tejet të diskutueshëm. Investimi i të ardhurave nga privatizimi apo nga Trusti Pensional në mjete, instrumente sipas rangimit të institucioneve ndërkombëtare të rangimit financiar, është diçka plotësisht e arsyeshme që ju e theksoni me të drejtë. Në vlerësojmë njëjtë sikur Ju, se destinacioni për të cilën i kërkon kjo qeveri, për nevoja të ngutshme të buxhetit apo për projekte pa fizibilitet të argumentuar, nuk përmbush kushtet e ligjit.

Në përputhje me parashikimet e nenit 19.2 të ligjit për AKM-në, që këto para”... do të investohen nga Agjencia në llogari, instrumente ose mënyra të tjera të investimit të cilat janë ranguar për investim nga agjenci ndërkombëtare të rangimit dhe në përputhje me kriteret e arsyeshme dhe të matura të investimit”, në Kosovë ekzistojnë kushtet që këto fonde të prodhojnë fryte të reja zhvillimi, në dobi të vendit, të ekonomisë së tij, të punësimit të gjeneratave të reja.

Unë do t’ju bëja një propozim në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi: të krijohet Agjencioni i Gjeneratave të Reja, i drejtuar nga manaxherë profesionistë të kontrolluar nga një bord i përbërë nga përfaqësues të Pranisë Ndërkombëtare (ICO), të shoqërisë civile, të parlamentit dhe të qeverisë. Ky Agjencion do të menaxhojë këto para deri sa të mbërrijmë tek kryerja e të gjithë obligimeve ndaj puntorve, dhe më vonë, (me paratë e mbetura), të investojë ekskluzivisht, e përsëris ekskluzivisht, në ekonomi, për mirëqenien e gjeneratave të reja, në edukimin e tyre, shëndetin e tyre, dhe në punësimin e tyre.


Kur e them këtë, jam shumë i vetëdijshëm se me privatizimin difektoz të deritanishëm në Kosovë (prej nga ku gjenerohen këto para) dëmi më i madh i është bërë fëmijëve të Kosovës për të cilët nuk ka asnjë garanci jetësore, asnjë mundësi për punësim.

Ne si AKR, në bashkëpunim dhe me ekspertë të shquar kosovarë dhe ndërkombëtarë i kemi studiuar mundësitë që ofron ekonomia kosovare dhe garantojmë se ka hapësira investimi në instrumente të frytshme. Më shumë guxim, më shumë ndjenjë ndërmarrësie, e kombinuar me maturinë, do të bënte që këto para të fjetura, me interesa të ulët, t’i shërbenin më shumë të ardhmes së Kosovës, ekonomisë së saj, duke u shndërruar në gjenerues zhvillimi, punësimi, gjallërimi të jetës së vendit dhe një perspektive më të mirë për brezat e rinj të Kosovës.

Unë jam i bindur në mirëkuptimin Tuaj, dhe jam i gatshëm që t’jua shpjegoj idetë e mia, bashkë me një grup ekspertësh. Mendoj se Ju do të shquani në propozimin tim një bazë të shëndetshme bashkëpunimi, që do të hapte një pistë të re angazhimi për të gjithë: për miqtë tanë ndërkombëtarë, për ndërmarrësit solidë vendorë duke krijuar më së fundi një mjedis të shëndetshëm për investime të huaja. Do të keni në këtë angazhim të ri, jo vetëm mbështetjen tonë të palëkundur, por të gjithë qytetarëve të Kosovës. Këto para nuk duhet të shkojnë e përsëris dhe njëherë, në arkat e qeverisë.

Thellësisht i Juaji,

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli  
February 28, 2014 ·

...

Nga Behgjet Pacolli

Sa herë që afrohet koha e zgjedhjeve, disa parti politike krijojnë një lojë të posaçme që u ngjan se do prodhon vota më shumë në garën e afërme për besimin e qytetarit. Bëhen lloj lloj manovrash, diku për t'ju larguar qeverisjes, diku për t'ju afruar asaj. Kështu i kam parë, me këtë sy veprimet e fundit për të ndërprerë mandatin e qeverisë, apo për t'ja zgjatur jetën asaj. Bëhen deklarata të forta, të buta, nisen veprime që mohohen të nesërmen, bëhen takime të fshehta dhe të hapura, që frymëzohen nga interesi partiak i seicilës palë, gjegjësisht interesi politik i tyre.

Të mbrosh apo të frymëzohesh nga interesi partiak, nuk është kurrëgjë e ndalueshme. Por interesi politik, interesi partiak jo gjithmonë përputhet me interesin e Kosovës. Interesi i Kosovës është interesi i gjithë qytetarëve pa dallime partiake, ndërsa interesi partiak është interesi i një grupi udhëheqës, i një partie, i votuesve të saj, të cilët në kohë pluralizmi nuk janë baraz me trupën votuese, me të gjithë qytetarët e Kosovës me të drejtë vote. Sot në këtë kohë të veçantë diskutimesh të tilla, unë dua të shpjegoj pse interesi partiak i dikujt, s'ka rëndësi se kujt, nuk përputhet me interesin e Kosovës. Dhe dua të bëj një thirrje të hapur sesi të pajtojmë interesat tona partiake me interesin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Sipas llogarivekushtetuese ne duhe të shkojmë në zgjedhje në janarin e vitit të ardhshëm. Si pjesë e qeverisjes unë kam pakënaqësitë e mia, pse pjesë të rëndësishme të programit tonë nuk janë përmbushur, ose janë zhagitur pafundësisht. Si pjesë e një marrëveshje politike dhe një rezolute parlamentare tërësisht kushtetuese, ne duhet të përfundojmë reformën zgjedhore dhe kushtetuese para se të shkojmë në zgjedhje. Në çfarëdo rrethane, AKR-ja është e gatshme për zgjedhje, kur siç e kanë pranuar dhe kundërshtarët apo aleatët tanë politikë, AKR-ja ishte njëlloj fituese morale e zgjedhjeve të fundit vendore. Pra interesi ynë partiak nuk çënohet kurrsesi nga zhvillimi i menjëhershëm i zgjedhjeve, përkundrazi. Na vjen keq që nuk po mbahen zotimet e asaj marrëveshjeje politike të shpallur dhe garantuar solemnisht prej miqve tanë perëndimorë, por ne do ta rrisim peshën tonë politike që të imponojmë realizimin e tyre. Interesi i Kosovës është gjithashtu që institucionet të punojnë deri në ditën e fundit të mandatit të tyre, madje disa institucione nuk duhet të ndalen kurrë. Por kjo zhurmë politike, këto manovra politike, me deklarata publike, me takime, me fushata të fshehta apo publike e çënojnë punën e tyre. I trullosin institucionet, i lënë të paqartë njerëzit për fatin e tyre. Dhe mbi të gjitha ndërpresin procese të rëndësishme, apo më pak të rëndësishme që kjo qeveri i ka nisur dhe s'janë vetëm në interes të saj, por në interes të Kosovës. Të ndërpresësh këto procese, e dëmton besueshmërinë ndërkombëtare të Kosovës, e dëmton besueshmërinë e një institucioni si Kuvendi i Kosovës i cili sot nuk është funksional, por që duhet të jetë funksional deri në fund. Të gjithë e dimë se ky parlament nuk po merr vendime të rëndësishme, por vazhdon të shndërrohet në arenë debatesh që nuk prodhojnë kurrëgjë.

Për këto arsye si president i AKR, pa kurrfarë interesi partiak, por vetëm duke vënë mbi krye interesin e Kosovës, do doja të bëja një thirrje të gjithë partive politike. Hajde ta rrisim qartësinë tonë për jetën e institucioneve dhe proceset jetike për një shtet të ri sikur joni që mbushi 6 vjet.

Të bëjmë një marrëveshje të plotë politike për kohën kur do i mbajmë zgjedhjet. Pasi ta përcaktojmë atë afat, të lemë institucionet të punojnë, në veçanti parlamentin dhe pastaj qeverinë. Kush është në opozitë dhe shpreson të vijë në pushtet duhet ta kuptojë se nëse



bën manovra jolojale sot për t'a bllokuar qeverinë, nesër kur të ndërrohen rolet do të pësojë të njëjtën gjë prej rivalëve politikë. Pra pasi të fiksojmë afatin e zgjedhjeve, pasi të mbarojmë reformën zgjedhore, t'i lemë kohën e duhur proceseve që kemi nisur, apo institucioneve organizuese të zgjedhjeve si KQZ. Të miratojmë ndoshta dhe një listë ligjesh apo vendimesh të cilat ky Kuvend duhet t'i miratojë para se të shkojë në zgjedhje. Unë jam i vetëdijshëm për raportet e numrave në parlament, dhe këtu do ta vlerësoja opozitën për qëndrimet shpesh konstruktive që ka mbajtur duke mos krijuar krizë qeveritare të panevojshme. Kështu ajo i ka dhënë borxh rivalit në qeveri, të cilat dikur do t'ja kërkojë. Por konstruktiviteti duhet të vazhdojë deri në fund.

Ftesa ime, qëndrimi im publik më duket se e respekton qytetarin e Kosovës, më mirë se çdo manovër jopublike e dikujt. Qytetari është dëshmitar katër vjeçar apo më i hershëm se çfarë ka bërë gjithseicili në rolin e vet, në opozitë apo në qeverisje. Gënjehet kushdo që mendon se qytetari e ka kujtesën e shkurtër dhe do mbajë mend vetëm manovrat e fundit të mandatit. Pra gënjehet rëndë kushdo që mendon se mund ta mashtrojë qytetarin me hilet apo lojrat e veta të këtyre ditëve të fundit. Më duket se e tregova pse këto lojra pra frymëzohen nga interesi politik dhe jo nga interesi i vendit, interesi i Kosovës, interesi i qytetarit të saj. Qytetari i do të gjithë në punë, të gjithë në rolin e vet, pa stërkambsa, pa dredhi dhe me sinqeritet.

228

11 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

March 5, 2014



Milot Shkodra and 2.7K others

58 Comments 38 Shares



Behgjet Pacolli

March 5, 2014 ·

...

Lidhur me idenë e Presidentit të AKR-së z. Behgjet Pacolli për krijimin e fondit zhvillimor, dhe letrën që në vitin 2010 i pati dërguar z.Pieter Feith, patën raportuar edhe mediet gjatë asaj kohe. Konkretisht z.Pacolli pati propozuar që pas kryerjes së obligimeve ndaj punëtorëve pas privatizimit të ndërmarrjeve publike, me paratë e mbetura të krijohej ky fond zhvillimor që do ti shërbente zhvillimit ekonomik të vendit dhe gjeneratave të ardhshme.

Shkrimi lidhur me këtë propozim në njërin nga mediet.///admin

Telegrafi:

>>>>>>>>

Pacolli propozon krijimin e një agjencie të gjeneratave të reja

Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli përmes një letre drejtuar përfaqësuesit të Zyrës Civile Ndërkombëtare në Kosovë, Peter Feith nënvizon disa probleme për ecurinë e shoqërisë dhe politikës në vend, ndërsa shpreh qëndrimin se beteja kundër korrupsionit në këtë fazë të shtetësisë është jetike për cilësinë e ndërtimit të themeleve të Kosovës së re.

Në letrën e kryetarit të AKR-së vlerësohet angazhimi i ICO-së, EULEX-it, në favor të ndërtimit të ngrehinës institucionale të Kosovës, drejtësisë në veçanti.

"...Në këtë kuadër, pohimi juaj se Kosova nuk mund të ndahet është mjaft i vlerësueshëm dhe ne shpresojmë shumë se puna juaj në vendosjen e autoritetit të ligjit të Kosovës në gjithë territorin do të vazhdojë edhe më tutje", thuhet në letër.

Pacolli po ashtu e konsideron plotësisht të drejtë qëndrimin refuzues të ICO-së ndaj kërkesave të qeverisë për fondet të cilat gjenden jashtë vendit.

"I njëjti qëndrim vlen dhe për paratë e Trustit Pensional të Kosovës. Këto fonde janë djersa e brezave të shumtë të kosovarëve në vite dhe jo paratë e një qeverie të vetme. Prandaj ato nuk duhet të hyjnë në kasën e qeverive, dhe sidomos të atyre qeverive që deri më tani nuk kanë gjeneruar begati për qytetarin e Kosovës...", shprehet Pacolli, në letrën drejtuar përfaqësuesit të ICO-së.

Me këtë rast, kryetari i AKR-së propozon që të krijohet një Agjenci zhvillimore e gjeneratave të reja, drejtuar nga manaxherë profesionistë të kontrolluar nga një Bord i përbërë nga përfaqësues të pranishëm ndërkombëtarë, shoqërisë civile, të Parlamentit dhe Qeverisë së Kosovës.

"Ky Agjencion do të menaxhojë këto para deri sa të mbërrijmë tek kryerja e të gjithë obligimeve ndaj puntorve, dhe më vonë, (me paratë e mbetura), të investojë ekskluzivisht, e përsëris ekskluzivisht, në ekonomi, për mirëqenien e gjeneratave të reja, në edukimin e tyre, shëndetin e tyre, dhe në punësimin e tyre", shprehet Pacolli. /Telegrafi/



115

2 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

March 6, 2014 ·


...

Marsi pa dyshim përbën muajin tone të lavdisë, heroizmit dhe ringjalljes sone nacionale. Renia heroike e Jasharajve shenoi kthesen me të madhe në historinë tone të re. Ata ranë për të ringritur në kembe një komb dhe një botë të tere. Liria dhe shtetësia e Kosovës qëndron fuqishëm në themelet e heroizmit të Jasharajve. Kosova dhe shqiptaret anë e mbane, u kanë rezervuar atyre vendin me të lartë, në piadestalin e krenarisë dhe vlerave tona kombëtare. Në senderimin e amanetit të tyre ne kemi ende shume pune për të bere. Kujtimi për ta na e mban gjalle motivin dhe dashurine për atdheun, për Kosoven tone. Lavdi e perjetshme dhe i lartësuar qofte kujtimi për Ta.




234

7 Comments 6 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
March 7, 2014 · 🌐


Sot është 7 Marsit - Dita e mësuesit.  
Dua të shpreh konsideratën time për të gjithë brezat e deritanishëm që e kanë ushtruar këtë profesion të shenjtë.  
Gjithashtu, i uroj të gjithë ata mësues e mësuese të cilët vazhdojnë ta bëjnë këtë punë.//b.p

👍 238 4 Comments 5 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
March 7, 2014 · 🌐

Te dashur miq,  
Sot në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës ka kaluar ligji për Ndermarrjet Publike. Kjo është sfida e parë, para se i njejtë të kalojë edhe në Kuvend.  
Në fakt kjo është ëndërra jonë e kahmotshme për Kosovën. Është pjesë e programit tonë për zhvillimin ekonomik dhe të fuqishëm të vendit.  
Është projekti dhe vizioni që garanton zhvillim dhe mirëqenie.  
Me anë të këtij ligji ndër të tjera, mundësohet që disa ndërmarrje të rëndësishme të tërhiqen nga AKP, rrjedhimisht të tërhiqen nga proçrsi i shitjes, për të ju nënshtruar pastaj një procesi tjetër të rivitalizimit, zhvillimit dhe ngritjes edhe më të fuqishme të tyre.  
Ato do të jenë pronë e Kosovës dhe qytetarëve të saj, sepse në bazamentin e tyre qëndron djersa dhe mundi i punëtorëve tanë në disa gjenerata.  
Ky është vetëm fillimi i një rrugëtimi të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe aq të nevojshëm të Kosovës.  
Kjo është Kosova që e duam. Kjo është ideja ime dhe e AKR-së që sa kohë, dita e së cilës i erdhi. Jam i bindur se parlamenti i Kosovës do të vepron me përgjegjësi dhe do ta miraton këtë projektligj.  
Sfidat vazhdojnë, ne nuk ndalem!

👍 251 18 Comments 7 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
March 8, 2014 · 🌐

Per 8 Marsin  
Është e tepërt të thuhet sa të rëndësishme janë gratë në të gjithë fazat e jetës sonë që nga lindja deri në vdekje, duke filluar me nanën. Është e pakët të kujtohem për to vetëm në ditë feste.  
Nuk mund të ketë shoqëri të përparuar nëse gratë nuk janë të barabarta me burrat. Kosova, ne shqiptarët duhet të bëjmë shumë për këtë barazi.  
Urime 8 marsin nëna dhe motra.

👍 251 4 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli

March 9, 2014 · 🌐

...

Të dashur miq,

Qdo ditë marr mesazhe të ndryshme falenderimi, qoftë nëpërmjet telefonit apo facebook, për angazhimet e mijta për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës, për përpjekjet për ndryshimin e gjendjes ekonomike në vend etj.

Jam thellësisht mirënjohës për gjithë këto vlerësime edhe pse fatkeqësisht në kohën në të cilën jetojmë, mirënjohja nuk po zë vend edhe shumë.

Ju siguroj të gjithëve, se kur është në pyetje Kosova, qytetari i saj, bashkëkombasit e mi, nuk do të kursej asgjë dhe gjithmonë do të jem në gatishmëri të kontribuoj aq sa kam hapsirë dhe mundësi. #b.p

👍 344

43 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

March 10, 2014 · 🌐

...

Kushe ka mizën pas veshit? Shpesh herë në mënyrë të vetëdijshme, ose të pavetëdijshme mediat krijojnë gracka ku ngec politika. Ky ishte rasti i intervistës sime në Telegrafi. Unë kurrë s'kam bërë akuza nominale në adresë të kurrkujt, por vetëm kam denoncuar dukuri negative, kriminale me të cilat është përbaltur një pjesë e politikës. Ndaj m'u duk e çuditshme pse njerëz të një partie vendosën të përgjigjeshin ndaj denoncimit të një dukurie si haraqi, që unë përmendja në intervistë. S'di si të veprojt tash në një rast si ky. Të përgënjeshtroj ? Po çfarë ? Mençuria popullore ka prodhuar shumë fjalë të urta që e shpjegojnë këtë situatë...

👍 258

17 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

March 11, 2014 · 🌐

...

Qëndrimi për Tribunalin.

Unë kurrë s'kam dëgjuar diçka zyrtare për këtë tribunal nga ndonjë përfaqësues ndërkombëtar i çdo niveli.

Mos është mitologji e jona, krijesë e dikujt për të turbulluar ujrat ?

Pse unë nuk e besoj dhe nuk e pranoj një ide të tillë ?

Që në krye të herës unë jam për të luftuar çdo krim të kryer gjatë luftës, pas luftës, nga kushdo qoftë. Besoj se ka krime të pazbuluara, që meritojnë të zbulohen dhe ata që i kanë kryer duhet të shkojnë para drejtësisë.

Unë besoj se EULEX-i ka kapacitete për ta luftuar këtë krim. Nëse nuk i ka, le t'i zgjerojë.

Që të krijohet një Tribunal të tillë, do duhet të ketë një Prokurori ndërkombëtar, e cila duhet të ketë krijuar aq shumë punë, pra të ketë hetuar aq shumë raste sa të lindë nevoja e një gjykate të tillë. Por nuk besoj kurrë se ka aq shumë punë dhe se është grumbulluar aq shumë lëndë e parë. E drejta penale në përgjithësi nuk i toleron gjykatat speciale, ndaj ky tribunal do shkonte kundër parimeve të përgjithshme të së drejtës penale.

Ndaj një Tribunal ad hoc për Kosovën më duket diçka e tepruar.

Nëse për gjithë ish Jugosllavinë ku u kryen disa luftëra u krijua vetëm një Tribunal, pse duhet të krijohet një i tillë vetëm për Kosovën ?

Janë vetëm disa tribunale ad hoc të krijuar në botë për krimet e luftës. Kosova s'mund të barazohet as me Ruandën, as me Liberinë, as me ish Jugosllavinë, për genocidin, për pastrimin etnik të kryer, për përmasat dhe ashpërsinë e tyre. OKB, ka një Gjykatë penale ndërkombëtare, ku mund të ndiqen penalisht kryesit e krimeve.

Nëse tribunali për ish Jugosllavinë mbyllet- ngaqë s'ka punë, pse vallë duhet të hapet një tribunal i ri për Kosovën ?

Tribunale të tillë ngrihen nën egidën e OKB. Kosova nuk është anëtare e OKB-së, prandaj dyshoj se ekziston një ide e tillë në gjirin e ndërkombëtarëve.

Një ide si kjo kriminalizon një popull, një shtet të ri në zanafillën e tij, në fillim të jetës së tij shtetërore dhe kjo ngjan pa kuptim.

👍 108

2 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

March 13, 2014 · 🌐

...

## Drejtesia ndërkombëtare duhet të gjejë rrugën më të drejtë



Behgjet Pacolli

Kohët e fundit në mjedisin tonë politik dhe mediatik është duke çarkulluar fantazma e një të ashtuquajturit Tribunal për krimet e luftës apo për krimet e një periudhe të caktuar, në Kosovë. E quaj fantazëm pasi unë kurrë s'kam dëgjuar diçka zyrtare për këtë tribunal nga ndonjë përfaqësues ndërkombëtar i çdo niveli.

Nga Behgjet Pacolli

Mos është mitologji e jona, dmth e dikujt, e një çarku, e ndonjë individi meqë po afron koha e zgjedhjeve ?

Mos është krijesë e dikujt nga jashtë, -s'oi nga- për të turbulluar ujrat në kohë zgjedhjesh?

Këtë unë nuk e di me siguri, por si politikan s'mund të mi pa mbajtur qëndrim ndaj një çështjeje që po merr rrethet peshe në debatin tonë politik. Ky ndërkombëtar është një çështje për Kosovën, është një çështjeje që të ndodhë në Kosovë.

[See More](#)

👍 69

4 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli

March 18, 2014 · 🌐

...

Sot patëm kënaqësinë që të miratojmë në qeveri vendimin për krijimin e zonave të lira ekonomike në Gjakovë dhe Mitrovicë.

Ky vendim që është jetësimit i një vizioni të kahershëm të AKR-së, është njëri ndër vendimet më të rëndësishme që ka marrë shteti i Kosovës në aspektin e krijimi të një baze të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik.

Zonat e lira ekonomike në Gjakovë dhe Mitrovicë, do të ndikojnë fuqishëm në krijimin e vendeve të reja të punës, në prurjen e investimeve të huaja, në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e të gjithë qytetarët e Kosovës.

Urime dhe suksese të mëtutjeshme. #b.p

👍 444

45 Comments 17 Shares



Behgjet Pacolli

March 18, 2014 · 🌐

...

Sonte në RadioTelevizionin e Kosovës në mënyrë të drejtëpërdrejtë do të flas ndër të tjera edhe për vendimet jashtëzakonisht të rëndësishme dhe shumë të pritura për zonat e lira ekonomike në Gjakovë dhe Mitrovicë dhe hapjen e perspektivave të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

BP

👍 287

19 Comments 6 Shares



Behgjet Pacolli  
March 21, 2014 · 🌐

...

Me vëmendje e përcolla intervistën e Adem Demaçit në RTK dhe dua të them se intervista më pëlqeu shumë, sidomos në vlerësimin e tij për punën e kryeministrit të Shqipërisë z. Edi Rama rreth bashkëpunimit të qeverisë së tij me Kosovën.

Baca Adem nënvizoi qartë të gjitha veprimet e Edi Ramës rreth unifikimit kombëtarë në fushën e ekonomisë, kulturës, diplomacisë, logjistikës etj. Këto veprime, gjithsesi duhet të mbështeten dhe të jetësohen në funksion të fuqizimit ekonomik dhe politik në rrugën e integritimit në Bashkimin Europian. #bp

👍 248

31 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli  
March 22, 2014 · 🌐

...

URIME GJITHË BESIMTARËVE BEKTASHIAN- DITA E SULTAN NEVRUZIT

Të gjithë besimtarëve Bektashian iu uroj ditën e Sulltan Nevruzit, ringjalljes së gjithckaje Bektashiane.

Në këtë ditë të rëndësishme ku ringjallja e pothuajse gjithckaje ka karakter të thellë jo vetëm religjioz, nuk kemi se si mos të jemi mirënjohës e falenderues pse jo dhe urues të shumëckaje të cilën e kanë dhënë vëllezerit dhe motrat tona Bektashi.

Bektashit, të cilët që nga Rilindasit e Kombit tonë kanë qenë dhe janë jashtëzakonisht të dobishëm për gjithë kombin tonë me frymën e tyre të dijës, pajtimit, solidaritetit e ndërtimit të shumë gjërave të rëndësishme për gjithë ne.

Me respekt e dashuri, mirëardhësh Sulltan Nevruz.  
bp

👍 117

6 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli  
March 22, 2014 · 🌐

...

Intervista në Zona B, Klan Kosova (Video)



YOUTUBE.COM

ZONA B - Mysafir: Behxhet Pacolli - 19 Mars 2014 - KLANKOSOVA.tv

👍 271

21 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

March 22, 2014 · 🌐

...

Kudo ku janë njerëzit e AKR-së, në drejtim të komunave, në parlament, në qeveri ndjekin programin që bashkë e kemi hartuar prej 2007-ës, zonat e lira, rivitalizimi i Trepçës, bashkimi ekonomik me Shqipërinë.

Nuk ka diskutim se sot për AKR-në është krijuar një moment i mirë për realizimin e këtij programi kur dy njerëz kryesorë tanët si zëvendëspresidentja Mimoza Kusari Lila dhe ndërmarrësi i shquar Agim Bahtiri po drejtojnë dy komunat nga më të rëndësishmet e Kosovës. Mimoza së bashku me mua është pjesë e gjithë hartimit të platformës për unionin ekonomik kombëtar, për zonat e lira. Më vjen mirë që këto ide u diskutuan dhe sot midis kryetares së Gjakovës dhe kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama. Edi është kryeministri i parë i Shqipërisë që i ka futur një pjesë të këtyre ideve në programin e partisë së tij dhe të qeverisë që ai drejton. Për herë të parë dy qeveritë tona janë takuar në Prizren sipas një ideje të mëhershme që unë e shpalla në 2011. Për herë të parë po jetësohen ligji për Trepçën, për zonat e lira që unë i kisha kërkuar që në 2007-ën. Më mirë vonë se kurrë. Koha e AKR-së, po vjen

👍 237

16 Comments 15 Shares





Behgjet Pacolli is with Bes Gashi.

March 23, 2014 · 🌐 · 📍


...

Vizita e Zv. Kryeministrit Behgjet Pacolli në Suedi ishte në faqen e parë të gazetës GT / Expressen. Në Suedi z. Pacolli i fton Suedezet të investojnë në Kosovë.



👍 1K

60 Comments 127 Shares



Përkundër këtyre krahasimeve të Putinit, kritika të forta erdhën nga Behgjet Pacolli gjatë një vizite në Uddevalla.

- Ne kemi dëgjuar në shtypin ditor të krahasimeve që Putini përmend Kosovën. Por Krimea dhe Kosova nuk mund të krahasohen, shprehet Behgjet Pacolli.

Ai përmend se Kosova ka pasur arsyet e saja për të marrë mbështetjen e Perëndimit, dhe se, kur vendi në vitin 2008 shpalli pavarësinë nga Serbia, kjo është bërë pjesërisht me mbështetje nga SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia. 107 vende e kanë njohur deri tani pavarësinë e Kosovës. Por ai theksoi se Rusia nuk është njëra prej tyre.

- Arsyet në rastin e Kosovës ishte humanitare. Sepse Serbia ka qenë e angazhuar në spastrimin etnik, tha Pacolli, dhe përmend se si shqiptarët, edhe pse ata janë shumicë në Kosovë, nuk kanë të njëjtat të drejta si sërëbet dhe janë vazhdimisht të nënshtruar prej diskriminimit etnik.

Lufta e përgjakshme në Kosovë 1998-1999 solli mbi 10.000 viktima civile, shumë prej tyre gra dhe fëmijë.

- Një milion njerëz u detyruan të largohen. Kjo ndodhi për shkak se njerëzit kishin humbur të drejtat e tyre. Prandaj, problemi i Krimesë nuk ka të krahasuar me Kosovën, tha Behgjet Pacolli duke iu përgjigjur presidentit Vladimir Putin.

"Shqiptari më i pasur në botë"

Politikani liberal 62 vjeçar njihet si shqiptari më i pasur në botë. Ai deklaroi në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 një pasuri prej 3.7 miliardë krone suedeze. Vizita e tij në Suedi zhvillohet pas ftesës së kryetarit komunal, Magnus Jacobsson (KD), dhe Naim Murselit, kandidat parlamentar (KD), shqiptarë dhe mik i Pacollit, kohët e fundit vizituan Kosovën. Tani pritet një vizitë kthyesë për të diskutuar bashkëpunimet e mundshme në teknologji dhe energji. Pacolli vizitoi të enjten Kynningsrud dhe Uddevalla Energi AB.

- Ka mundësi të mira për investime në Kosovë. Përveç kësaj, ne kemi shpallur dy zona të tregtisë së lirë në vend, të cilat duhet të jetë interesante për kompanitë suedeze dhe skandinave, tha Behgjet Pacolli, i cili të premten vizitoi disa kompani në Gothenburg.

<http://www.expressen.se/.../nu-kritiseras-putins-kosovo.../>

TIDNINGEN

Skriv ut text

Storlek på text.

Se senaste förstasidorna

Följ GT direkt på facebook

Like 8.3k

Förstasidan  
Avslöjar  
Allt om bilar  
Allt om mode  
Allt om resor  
Auktioner  
Bar & politik  
Bloggar  
Debatt  
Din hund  
Dokument  
Ekonomi

KOSOVOS RIKASTE MAN. Kosovos miljardär och vice premiärminister Behgjet Pacolli är skarpt kritisk mot de ryska jämförelserna mellan konflikten i Krim och situationen i Kosovo. Foto: Maria Steén

## Nu kritiseras Putins Kosovo-jämförelse

Ardian Krasniqi and 1.1K others

54 Comments 31 Shares



Behgjet Pacolli added 13 new photos — in Uddevalla, Sweden.

March 23, 2014 · 🌐



Takime më disa kompani suedeze dhe më komunitetin Shqiptar në Uddevalla.



👍 931

23 Comments 19 Shares



Behgjet Pacolli

March 24, 2014 · 🌐



Si sot 15 vite më parë, bota demokratike, aleanca ushtarake më e fuqishme në botë, NATO ndërmorri hapin më të rëndësishëm gjatë historisë së ekzistencës së vet. Filloi sulmet ajrore për të shpëtuar një popull që përballlej me gjenocidin serb.

Respekt dhe mirënjohje të thellë, gjithë mbështetësve të popullit tone në rrugën e drejtë të lirisë, SHBA-së, vendeve të Bashkimit Europian dhe gjithë anëtarëve të NATO-s. #b.p



👍 770

13 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

March 24, 2014 · 🌐

...

Të gjithë jemi dëshmitarë të situatës kaotike permanente në kryeqytetin e Kosovës, dhe pamundësisë për ta kthyer Prishtinën në një kryeqytet dinjitoz dhe funksional.

Kjo duhet që ta shtyjë Qeverinë e Kosovës të mos qëndrojë indiferente para kësaj situatë. Ne mund të debatojmë pafundësisht për fajësinë, duke i drejtuar gishtin sa njëres dhe tjetres palë për gjendjen aktuale, por në këtë formë nuk zgjidhen problemet.

Unë, do të kërkoj me këmbëngulje nga të gjithë faktorët institucionalë, e sidomos nga ekzekutivi i vendit, që pa u vonuar të vendosë për dy gjëra:

1. Sa më shpejtë duhet të miratohet ligji për Prishtinën dhe ti jepet mundësia qeverisë lokale, që të ndërmarrë masat e duhura për të ndaluar degradimin e mëtutjeshëm të kryeqytetit dhe për ta bërë atë të jetueshëm për qytetarët që jetojnë aty;
2. Sa më shpejtë të krijohen kushtet për ndërtimin e Prishtinës së re, duke i dhënë prioritet ndërtimit të infrastrukturës për institucionet, në mënyrë që administrata shtetërore të tërhiqet nga qyteti dhe tu krijojë hapësirë banorëve që jetojnë në qytet.

Kjo duhet të përfshijë edhe vendimin për ndërprerjen e menjëhershme për ndërtimet në tokat pjellore. #bp



👍 279

7 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli added 3 new photos — in Uddevalla, Sweden.  
March 24, 2014 · 🌐

...

Takime më disa kompani suedeze dhe më komunitetin Shqiptar në Uddevalla.



👍 931

23 Comments 19 Shares



Behgjet Pacolli

March 26, 2014 · 🌐

...

Rruga e kombit, Merdare-Vërmicë, përkundër qmimit të lartë, është investimi që është dashur të bëhet dhe sot përbën krenarinë tonë.

Ndërkaq sa l përket autostradës në drejtim të Shkupit që planifikohet të ndërtohet, mendoj që traseja duhet të ndryshojë, pra që të mos shkohet në kufi me Maqedoninë, por në Ferizaj me një rrethrotullim modern duhet të drejtohet në drejtim të Gjilanit. Pjesa tjetër drejt Elez Hanit, duhet të zgjerohet dhe të jetë brenda standarteve.

Kjo duhet të ndodhë për arsye ekonomike, strategjike dhe në interes të qytetarëve të asaj pjese, ngase Anamorava duhet të lidhet me autostradë moderne.

Unë fuqishëm do të lansoj edhe idenë që edhe Gjilani të shpallet Zonë e Lirë Ekonomike, dhe autostrada do të shërbentë drejt zhvillimit të hovshëm ekonomik.



👍 1.1K

65 Comments 28 Shares



Behgjet Pacolli

March 26, 2014 · 🌐

...

Sonte do të jem në orën 22.45 në emisionin Top Show në Top Channel.

Do të jem përballë gazetarëve ekonomikë nga Kosova dhe Shqipëria dhe do flas për zonat e lira ekonomike, për Trepçën, për Unionin Ekonomik me Shqipërinë...

/BP

👍 176

10 Comments 8 Shares





"Në puntatën e kësaj të mërkure, në studion e "Top Show"-t, të drejtuar nga Alban Dudushi, ka qenë zv/kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Behgjet Pacolli, një nga figurat më shumë të diskutuara në hapësirën politike të Kosovës, por dhe më gjerë. Në fakt, hyrja e një miliarderi në politikë gjithmonë ngjall shpresa, por edhe dyshime, gjë që ka ndodhur edhe me zotin Pacolli. "

Alban Dudushi: Le ta nisim bisedën aty ku është dhe fillimi i prezencës suaj në politikën e Kosovës, më 17 Mars 2006, kur ju themeluat partinë "Aleanca Kosova e Re", e prej asaj kohe keni qenë një figurë konstante në politikën e Kosovës, pas një fillimi të vrullshëm. Cila ishte arsyeja që ju u kthyet në Kosovë?

Behgjet Pacolli: Sigurisht që përbën lajm futja në politikë e një personi që ka jetuar e ka pasur sukses jashtë Kosovës, në një kohë që prej jetës së rëndomtë në Kosovë gjithkush dëshironte të largohej nga ai vend apo ta ndryshonte atë. Rikthimi im në Kosovë ka qenë i pakuptueshëm për shumë njerëz. Shumë njerëz nuk e kanë kuptuar shpirtin tim dhe, të ndikuar nga fjalët se unë jam mësuar të përfitoj prej biznesit, kanë menduar se unë jam rikthyer në Kosovë për të përfituar në të njëjtën mënyrë. Në fakt, në mënyrë tepër të padiskutueshme, mund të them se jam rikthyer në Kosovë për shkak se kam qenë gjithnjë afër popullit tim. Edhe pse fizikisht kam qenë jashtë për shumë kohë, mendja dhe shpirti im kanë qenë gjithnjë në Kosovë, duke mos kaluar as natë e as ditë pa qenë i lidhur me vendin, me familjen, me farefisin, me miqtë e mi. E kam përjetuar shumë rëndësi periudhën para luftës në Kosovë, ashtu dhe periudhën e luftës dhe fillimin e një jete të re për vendin tim pas luftës, ku ishin krijuar mundësi për njerëzit me mundësi më të mëdha dhe ku mbizotëronte formula e ekonomisë së globalizuar, ku i varfri duhet të shkatërrohet dhe i pasuri apo i forti duhet të forcohet edhe më tepër. Kjo vlente për mua, nëse shihja shoqëritë e ngritura ekonomisht, por kurrsesi nuk vlente për atë që kishte kapluar Kosovën, me një ekonomi të shkatërruar dhe një varfëri tepër të lartë. Mbi 40% e popullatës jetonte në varfëri, ndoshta edhe në mjerim, ku të ardhurat për frymë ishin shumë të ulta, ku asgjë nuk funksiononte, ku vetëm një pjesë e vogël e njerëzve kishin mundësi të punojnë, ndërsa mbi 60-70% e popullatës ishte e papunë. Sigurisht, të rrija duarkryq në liqenin e Luganos dhe të shikoja nga jashtë këtë situatë, do të ishte një vrazhdësi shumë e madhe dhe brutalitet nga ana ime.

Alban Dudushi: Unë kam qenë në atë periudhë, kur herë pas here përmendej emri juaj si një biznesmen i fuqishëm. Njerëzit kishin shumë shpresa se ndërhyrja juaj në ekonominë e Kosovës mund të sillte një zhvillim më të shpejtë. Për njerëzit, ndoshta do të ishte më me interes që ju të vini në dispozicion paratë tuaja në formë investimesh në Kosovë, se sa prezenca juaj në politikë...?

Behgjet Pacolli: Nuk di nëse do të ishte e drejtë së pari, që paratë e tua t'ia jepje për menaxhim dikujt tjetër, për arsye se unë e ndaj të mirën nga e keqja shumë bukur, di si kalohet lumi sepse e kam kaluar atë, dhe të fusësh paranë tënde diku, ku edhe vet nuk je i sigurt se ajo do t'i kontribuojë dikujt është e vështirë. Ndaj konsideroj se hyrja ime në spektrin politik të Kosovës i ka kontribuar vendit, apo asaj pjese që mendon ndryshe dhe që nuk është kapluar nga doktrinat e patriotizmit dhe ta quajë pervers. Por, ka dhe njerëz që e shikojnë AKR-në vetëm nga ekonomia, nga puna. Ju e dini mirë se nga puna vjen edhe mirëqenia, aty ku ka mirëqenie ngrihet edhe vetëdija e qytetarëve. Në këtë drejtim them se në Kosovë kam parë njerëz të suksesshëm, nuk janë shumë, kam parë të tjerë që pretendojnë të jenë politikanë të suksesshëm dhe të vetmin burim jetësor e kanë vetëm prej politikës, ndërsa unë jam një njeri që falë zotit dhe punës time, jeta ime politike ka

ardhur me një mirëqenie të krijuar dhe asnjëherë nuk e kam parë dhe nuk e shoh politikën si burim jetësor për mirëqenien time.

Alban Dudushi: Në fakt ky është një dyshim i arsyeshëm për ata njerëz, që të vetmin burim jetese kanë politikën, dyshimi është i arsyeshëm që ata janë më të ekspozuar ndaj fenomeneve të caktuara që kanë të bëjnë me korrupsionin, etj., çështje apo plagë që kanë prekur Kosovën. Por, nga ana tjetër, shumë njerëz dyshojnë se një njeri i realizuar në aspiratat e veta ekonomike, me fuqinë financiare që ju keni, politikën në fakt e ka një lloj hobi, apo kapricioje, ta provoj dhe këtë dhe derisa kam qenë i suksesshëm andej, përse mos jem edhe këtej.

Behgjet Pacolli: Po të isha në disa shtete shumë të zhvilluara, siç janë disa prej vendeve të Europës Perëndimore, apo SHBA-të, do të thoja se ndoshta do të kishin të drejtë. Unë veproj në një shtet që nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë rëndësi politike asnjëherë. Ne mundemi ta rreshtojmë këtë shtet aty ku janë edhe shoqëritë civile, vetëm me punë dhe kursesi me mendime të ndryshme politike, për arsye se ne nuk jemi në gjendje të krijojmë politika që do të dominojnë apo do të ndryshojnë politikat globale. Ne jemi më të mirët, nëse punojmë dhe ngrihemi falë punës sonë, nëse rrisim mirëqenien për qytetarët tanë dhe që këta të kenë një shans për të qenë të respektuar vetëm falë ekonomisë së tyre. Kjo sepse, siç e thashë, me ngritjen ekonomike vjen edhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe ndjenja për të respektuar tjetrin e për të pritur respekt prej tij. Mos harroni se këtë fenomen që përcjellin klasat si në Kosovë, ashtu dhe në Shqipëri, mund ta ndryshojë vetëm një mendim ndryshe. Më vjen mirë gjithashtu që vetëm pak ditë më parë ndjeva nga një njeri shumë i rëndësishëm i politikës shqiptare, atë që do të doja ta dëgjoja prej shumë kohësh, i cili tha se 'ne deri tani kemi luftuar njerëzit e pasur, ata që kanë më shumë mundësi se sa njerëzit e rëndomtë, ndërkohë që në fakt duhet t'i mbështesim ata, pasi vetëm kështu do të mund të bëhet e mundur që ata të krijojnë më shumë mirëqenie për të tjerët që s'kanë mundësi. Dhe kjo gjë do të sillte më pas të mira për njerëzit e përfshirë, për komunitetin, për vendin e për kombin.

Alban Dudushi: Dhe e keni fjalën për zotin Edi Rama?

Behgjet Pacolli: Ai e tha këtë para një forumi të biznesmenëve në Pejë dhe më la shumë përshtypje, pavarësisht se nuk isha aty. Ndaj, sinqerisht, mund të them se kam një besim se gjërat do të ndryshojnë. Një gjë tjetër që po ndodh në Kosovë, nga vit 2007 kur kam hyrë në spektrin politik të Kosovës, secili e ka pasur të qartë nëse do të ishte i sinqertë dhe do të besonte, virtyte që duhet të mbizotërojnë mes njerëzve. Unë kam thënë se hyrja ime në politikë nuk do të thotë përfitim ekonomik apo politik për mua, por kam ardhur të vë në dispozicion eksperiencën time. Unë e shpreha eksperiencën edhe në manifestin e partisë AKR dhe ky program prej dikujt u lexua, ndërsa prej shumëkujt nuk u lexua, as nga ata që debatonin mbi programet politike. Ky program është publikuar në internet, i përkthyer në anglisht dhe në shqip dhe u publikuan broshura tërheqëse, por nuk u lexuan. Duhet të kalonin diku te 7 vite që dikush të rikthehej dhe t'i trajtonte këto teza. Këtu shihet se unë kam pasur një vizion ndryshe për Kosovën, edhe tani kam një vizion tjetër, për këtë do të më vinte shumë keq, nëse nuk do të më jepej mundësia ta vija në dispozicion të zhvillimit të kësaj shoqërie.

Alban Dudushi: Të kthehemi pak në disa qasje që ju keni në lidhje me ekonominë e Kosovës, që i përmendët edhe në fillim. Qasja juaj ndaj privatizimit. Ju jeni miliarder, keni të gjitha burimet financiare, por jeni kundër Agjencisë së Privatizimit atje, madje shkoni edhe më tej dhe mbështesni një lloj partneriteti midis privatit dhe publikut. Ma shpjegoni pak këtë.

Behgjet Pacolli: Është jo e sinqertë të besohet se unë kam ardhur të zaptoj ekonominë e Kosovës. Së pari sepse ka një fuqi blerëse shumë të ulët dhe Kosova nuk është treg

atraktiv për mua. Është vështirë të besohet gjithashtu se kompanitë e mia në Kosovë, të cilat janë të njohura për nga kualiteti, do të krijonin në Kosovë një perspektivë të përfitimit. Në Kosovë, te kompanitë e mia unë kam punësuar sot diku te 2500 punëtorë, në sektorin bankar, të sigurimeve dhe në prodhimtari, bujqësi etj. E dini mirë se jashtë janë edhe rreth 9000-10000 të tjerë dhe krenohem me këtë që kam bërë për vendin tim, për familjet e vendit tim dhe të kombit tim, sepse kam të punësuar edhe shumë nga Shqipëria, të cilët i falënderoj për eksperiencën e tyre sidomos në ndërtimtari. Po të isha ai që synoja të privatizoja apo të vija kontrollin mbi ekonominë e Kosovës, unë e kam vendin e duhur të shkoj tek Agjencia e Privatizimit e të blej apo të stërblej aty. Por nuk e bëj këtë sepse ajo është një agjenci famëkeqe, kriminale, që e ka varfëruar Kosovën deri aty sa ka provokuar papunësi dhe varfëri në Kosovë.

Alban Dudushi: Ju nuk blini aty, por jeni zv/kryeministër i vendit dhe këto akuza i bëni si biznesmen më shumë se sa zv/kryeministër, ndërkohë që keni mekanizma për të vepruar.

Behgjet Pacolli: Unë i përgjigjen drejtpërdrejt atyre njerëzve që më akuzojnë. Unë jam aksionari kryesor i kompanive të mia dhe nuk kam hequr dorë prej aksioneve të mia, pavarësisht se kam hequr dorë nga menaxhimi dhe tani përgjigjem thjesht si aksioner kryesor. Kompanitë e mia e refuzojnë mënyrën e privatizimit të ekonomisë së Kosovës. Në disa raste, dikush ka blerë, e ka përvetësuar dhe më pas ma ka shitur mua. Një fabrikë që është privatizuar për 3 milionë euro, unë e kam blerë pas 5 viteve për 12 milionë e 500 mijë euro, për arsye se e di që ajo është vlera e përafërt me atë që është dashur të privatizohet që në fillim. Kështu ka ndodhur edhe me shumë gjëra të tjera të privatizuara nga kompanitë e mia, kuptohet prej dorës së dytë dhe jo prej Agjencisë së Privatizimit. E urrej këtë agjenci, sepse një njeri që me 1 milionë euro ka pasur mundësi të bëjë diçka, atë njeri kjo agjenci e ka bërë edhe kandidat për të qenë i varfër, sepse paratë janë marrë, ato para nuk mbesin në qarkullim në Kosovë dhe kjo dihet nga të gjithë, por kanë shkuar jashtë dhe punojnë për fondet e nuk e di se kujt. Ndërsa Kosova mbetet me pamundësi, pa objektin apo fabrikën që është shitur dhe pa parà. Kështu, pronari i ri duke mos pasur mundësi, gjëja e parë që ka bërë është mbyllja e dyerve të fabrikës, duke e kthyer atë në ndonjë restorant, lokal, a diçka tjetër. Në vitin 2007 kam thënë ndal kësaj agjencie, kam thënë se dora e saj duhet të ndalet. Kam parë edhe keqtrajtme të kompanive publike, që paraqesin ndjenjë shpirtërore kur dihet se baballarët tanë kanë punuar aty. Ne jemi duke shfrytëzuar ndërtimet e njerëzve të asaj kohe, duke mos ndërtuar asgjë të re vet, përfshi këtu edhe burimet elektrike, edhe godinën e Kuvendit.

Alban Dudushi: Më sqaroni diçka, ju jeni brenda qeverisë si opozitar?

Behgjet Pacolli: Jam në qeveri për një arsye, që Kosova të mos ketë vakuum institucional. Besoj se po të mos ishim ne të gatshëm edhe përballë sakrificave tona apo të miat personale, vendi do të shkonte edhe për 8 muaj në një vakuum institucional dhe drejt zgjedhjeve të reja. Ne jemi shumë vonë, duhet të ecim shumë shpejt, pavarësisht se mirë apo keq, me elegancë apo jo, ne duhet të ecim përpara. Ky është shkaku pse jam pjesë e kësaj qeverie dhe kam vendosur që të veproj brenda kësaj kornize me atë që mundem dhe atë që di.

Alban Dudushi: Në rast se prezenca juaj është kaq kushtëzuese për qeverinë...

Behgjet Pacolli: Ishte, sigurisht nuk do të jetë në të ardhmen, por ishte kushtëzuese...

Alban Dudushi: Pikërisht në këtë periudhë ju keni pasur mundësinë që edhe përmes kushtëzimit të arrinit të realizonit më tepër nga idetë tuaja. Kujtoj se së fundi kemi zonat e lira, kemi trajtimin e Trepçes, etj., në një kohë që e dimë se qeveria do të shkrihet shumë shpejt në fund të Majit apo në fillim të Qershorit, kur kemi zgjedhjet.

Behgjet Pacolli: Zonat e lira ekonomike, një ide e vjetër e AKR, u bë pas shumë insistimeve. Ligji për Trepçën, po ashtu i vjetër, është jetësuar tani dhe për këtë jam i lumtur, për arsye se Trepça kishte një shans të jetë një viktimë e madhe. Tashmë do të jetë një kompani publike dhe do të shkojë 100% nën transparencën e Parlamentit të Kosovës. Nuk ka privatizim apo koncensionim të minierave të Kosovës, por do të trajtohen sipas ligjeve të mineraleve gjerësisht të firmave që i përkasin ekonomisë së globalizuar. Ashtu do të trajtohet Trepça, nëse qeveria e re do të ketë respekt dhe guxim për t'i menaxhuar ato.

Alban Dudushi: Dua të flasim edhe për nja dy gjëra që kanë të bëjnë me diplomacinë. Jeni aktivizuar shumë, në periudhën që ju ishit në qeveri si zv/kryeministër i Kosovës, në çështjen e njohjes së Kosovës, një lloj diplomacie personale, ekonomike. Shpesh herë jeni akuzuar se nuk keni bërë gjë tjetër, veçse keni miksuar interesat ekonomike tuaja me vendet ku keni shkuar, kryesisht vende diktatoriale, me atë që është njohja e Kosovës.

Behgjet Pacolli: Jam i lumtur që ka ndodhur diçka, që si rezultat ka ardhur suksesi i fituar me punë, me shumë dashuri dhe shumë interes. E di se pas shpalljes së Pavarësisë është vënë në luhatje qendrueshmëria e shtetit të Kosovës dhe është marrë si shembull Tajvani, që prej disa vitesh nuk ka mundur të sigurojë më shumë se 26 njohje. Madje është shumë e vrazhdë edhe nga Serbia, që gjithmonë thoshte se Kosova është njohur vetëm prej disa shteteve të vogla dhe nuk do të jetë asnjëherë shtet. Nga qeveritë e shkuara është përfolur gjithmonë se ata do t'ia arrinin 100 njohje dhe këto nuk qendronin, as ato që pretendonte dikush nga qeveria serbe. Unë kam përveshur mëngët dhe kam shfrytëzuar gjithë bagazhin tim çfarë kam, pa harxhuar asnjë cent të buxhetit të Kosovës, asnjë kilogram benzinë nga ai buxhet, as pagë për mua dhe as shpenzime udhëtimi. Përkundrazi kam marrë aeroplanin tim dhe jam nisur drejt botës. Madje kam shkuar edhe në Afrikë, ku asnjë vend nuk e kishte njohur përveç Senegalit, nëse s'gaboj. Duke ditur rëndësinë e madhe të kontinentit të Afrikës, mendoj se ai do të jetë kontinenti i së ardhmes për shkak të pozitës gjeo-strategjike, por edhe pasurive të saja, kam punuar shumë dhe kam sjellë mbi 27 njohje vetëm nga ky kontinent.

Alban Dudushi: Si keni arritur t'ua mbushni mendjen?

Behgjet Pacolli: Kam pasur njohje edhe nga Amerika Latine, gjerësisht nga Amerika Qendrore, dhe nga Oqeania. Sinqerisht, të udhëtosh me një pasaportë të një shteti që nuk e njihite askush, do të ishte e paimagjinueshme. Mua më ka ndihmuar edhe fakti që kam udhëtuar së bashku me një pasaportë të një vendi tjetër. Ndoshta ka ndihmuar dhe vullneti i njerëzve që kanë përpiluar Kushtetutën e Kosovës, që qytetarët e Kosovës të kenë mundësinë të mbajnë edhe dy pasaporta. Kam pasur fatin të përdor këtë pasaportë të dytë por edhe gjithë bagazhin tim të krijuar gjatë këtyre viteve, ekonomik sidomos, gjë që të mundëson hapjen e dyerve gjithkund nëpër botë. Është shumë me rëndësi që të udhëtosh, por derën pas ta lësh hapur, pasi ajo mund të vlejë për t'u kthyer sërish mbrapsht. Mua ato dyer për Kosovën më janë nevojitur, dyert i kam pasur të hapur dhe kam synuar të takoj direkt krerët e shteteve, presidentë apo kryeministra. Kam vizituar mbi 49 shtete, jam takuar me mbi 39 presidentë, duke i sjellë Kosovës 26 njohje vetëm nga Afrika dhe diku te 11 njohje nga vendet e tjera. Unë kam qenë i dashuruar me punën time.

Alban Dudushi: Keni pasur interesa financiare në këto vende ku keni vajtur? Keni pasur biznese tuaja apo keni folur për biznes përveç se për Kosovën?

Behgjet Pacolli: Unë u jam dashur thujse të gjithëve në botë, mjafton të hapim uebsajtin e kompanive të mia dhe aty çdo gjë është e qartë. Në të vërtetë, nëse dikush kërkon kontakte me presidentin e një vendi, shikohet së pari se çfarë ka bërë, duke i ofruar dokumentacionin për atë se çfarë unë përfaqësoj. U është raportuar edhe

dokumentacioni për atë se çfarë përfaqësoj unë tani si qeveritar, si njeriu i dytë i qeverisë së Kosovës, por trampolina ka qenë, le ta kuptojë dikush drejt apo për keq, kompania ime që e kam ndërtuar për 40 vjet me radhë. Kjo gjë më ka lehtësuar mua vajtjet, për shkak se askush nuk ka pasur interes të njohë Kosovën, ata kanë pasur interes të bashkëpunojnë me Behxhet Pacollin. Normalisht gjatë bisedës dhe trajtimit të çështjes, ne kemi ardhur shumë shpejt te problemi i njohjes, të cilën shumë prej tyre nuk kanë mundur ta refuzojnë. Disa edhe kanë premtuar, por nuk e kanë realizuar deri më tani, por shumica kanë ardhur dhe janë evidente, ndaj dhe Ministria e Punëve të Jashtme nuk do ta ketë të vështirë të bashkëpunojë dhe të zhvillojë marrëdhëniet diplomatike.

Alban Dudushi: Më bën përshtypje idea juaj për një lloj unioni ekonomik mes Shqipërisë dhe Kosovës, një lloj bashkimi i hapësirave shqiptare. Një ide që ka qenë gjithashtu edhe nga i ndjeri Arbën Xhaferri, që për hir të së vërtetës nuk ka pasur ndonjë simpati shumë të madhe për ju dhe me kalimin e kohës, sidomos në fund, jeni afruar me zotin Xhaferri. Behgjet Pacolli: Sigurisht që e kam respektuar shumë atë njeri dhe i përkulem sidomos ideve të tij. Unë nuk jam njeri "pushtues" që të shkoj e të trokas në derë dhe që të më hapin derën, por e lë çdo gjë të marrë kohën e vet. Edhe pse e dija që Arbën Xhaferri me vëllezërit e mi kanë pasur një miqësi, për shkak se jetonin afër njëri-tjetrit, unë nuk kam dashur kurrë të përfitoj prej tij. Ka ardhur momenti kur ai ka dëgjuar mirë idetë e mia, ka dëgjuar edhe eksponimin tim në Parlamentin shqiptar, në Shqipëri, gjë të cilën nuk e konsideroj si gabim por si diçka që është dashur të ndodhë, edhe pse e dija se ekzistonin pasojat për mua. Është dashur që dikush ta thotë në mënyrë institucionale ta thotë se ky vend nuk mund të mbijetojë duke mbetur i mbyllur, siç kemi qenë prej shumë vitesh. Edhe në javën e parë të mandatit të parë si President kam sfiduar Veriun, herën e parë pas 13 viteve, asnjë njeri nga institucionet e Kosovës nuk ka guxuar të shkojë atje. Unë kam thirrur ministrin e Punëve të Brendshme dhe i kam kërkuar nëse mund të më shoqëronte për atje, nëse jo do të shkoja vet. Kam shkuar sepse atje kam shpirtin tim dhe ku ndodhet shpirti im unë nuk i frikësohem askujt. Unë jam edhe besimtar te Perëndia dhe e di se pa urdhrin e atij, askush nuk mund të bëjë asgjë. Kam besuar se do të shkoja atje për një qëllim të mirë dhe e kam sfiduar, jo vetëm 1 herë, sepse kam shkuar edhe 2 herë të tjera, kam vizituar pikat kufitare dhe jam kthyer. Edhe idea ime për bashkimin ekonomik dhe kombëtar ka qenë e qëlluar dhe insistoj edhe sot se është e vetmja rrugë, e cila do të harmonizojë të gjitha kërkesat e të gjithë shqiptarëve në rajon.

Alban Dudushi: Patriotizmi juaj, që dua ta quaj si një lloj patriotizmi të moderuar, në ndryshim nga të gjithë termat romantike të patriotizmit, përsëri tingëllon i çuditshëm duke ditur se ju keni bashkëpunuar me Moskën, keni rindërtuar Kremlinin, keni bashkëpunuar me shumë vende të tjera të ish-Bashkimit Sovietik gjithashtu. Keni një lloj marrëdhënie të hapur me botën sllave, e cila duket se nuk i pëlqen shumë ambientit shqiptar.

Behgjet Pacolli: Të sfidosh një treg siç është Rusia ka qenë një sfidë e madhe dhe nuk kam qenë i vetmuar. Kam pasur një konkurrencë, nëse flisni për kontratë specifike që ka kapur shumën prej mbi 2 miliardë e gjysmë dollarë, unë nuk kam qenë i vetmuar në atë ofertë, por kam pasur edhe nja 400 firma që synonin të hynin aty dhe që nuk kanë qenë të Shqipërisë, por të vendeve demokratike që e ndihmonin Kosovën, si SHBA-të, Britania dhe vendet e Europës Perëndimore. Do të ishte absurde sot nëse do t'i thoja dikujt se nuk ka qenë akt patriotik, që të shkosh e të hapësh edhe ato dyer që jo kushdo mund t'i hapë. Kam hapur ato dyer që 1 njeri ndoshta në 3 milionë vjet jetesë mund ta bëjë. Unë e kam bërë me dinjitet, me krenari, me njerëzit e Shqipërisë e të Kosovës, kemi punuar dhe puna ime nuk është bërë gratis. Nuk ua kam falur atë punë, por siç e dini edhe nga shtypi, kushdo që ka dashur të punojë me mua është dashur të paguhet edhe çmimi i

duhur për të punuar. Nuk e mohoj se një karrige e konferencave është shitur edhe 50 mijë dollarë. Ai është çmimi im, nëse duan ta paguajnë në rregull, përndryshe le ta marrin prej italianëve ose tjetërkujt. Unë e kam bërë dhe nuk jam penduar kurrë për një gjë të tillë, madje nëse përsëritej një kërkesë e tillë sërish do ta ribëja, për arsye se ato parà kanë ardhur në trojet shqiptare dhe u janë shpërndarë familjeve shqiptare, përfaqësuesit e të cilëve punonin atje. Do të ishte një krim për dikënd, nëse do të mendonte t'i linte njerëzit e vet rrugës, atëherë kur Miloshevici i dëbonte nga puna dhe mos kujdesej për ta. Unë jam përkujdesur për ta, edhe nëse secilin prej tyre mund ta kisha zëvendësuar me punëtorë rusë, pagën e të cilëve do ta paguaja 10 herë më pak se atë që kam paguar për kosovarët. Nëse mendoni se ky nuk është akt patriotik, do t'i thoja kujtdo se është i çmendur dhe nuk ka lidhje me jetën dhe humanitetin. / Top Channel



331

17 Comments 12 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
March 27, 2014 ·  



GAZETAEXPRESS.COM 

**Pacolli thotë se është dashur të krijohet një treg i përbashkët Shqipëri- Kosovë (Video)**

 277 7 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli is with Afrim Batalli and 2 others.

March 27, 2014 · 🌐



Vizitë bizneseve që funksionojnë në Komunën e Gjakovës.

Zv/Kryeministri Behgjet Pacolli dhe kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari Lila, të përqendruar për të ndihmuar bizneset në Komunën e Gjakovës, si dhe për ti ofruar atyre një rrugë të lehtë zhvillimi.

Përparësitë që Gjakova tashmë i ka si zonë e lirë ekonomike, garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për Komunën e Gjakovës.



👍 359

4 Comments 9 Shares





Behgjet Pacolli is with Butrint Batalli and Afrim Batalli.


March 27, 2014 · 🌐

...

- Sot i vizitova disa biznese që funksionojnë së bashku me Kryetaren e Gjakovës, zonjen Mimoza Kusari-Lila.

Përparësitë që Gjakova tashmë i ka si Zonë e Lirë Ekonomike, garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për Komunën e Gjakovës.

#BP



👍 421

10 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

March 27, 2014 ·



Ja tre pjesët video të intervistës në Top Show, ku fola për Zonat e Lira, Bashkimin Ekonomik dhe për jetën time, etj.

YOUTUBE.COM

Top Show, 26 Mars 2014, Pjesa 1 - Top Channel Albania - Talk Show

Tema: Zonat e lira te Pacollit Te ftuar: Behgjet Pacolli

148

7 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

March 27, 2014 ·



Në një interviste për Syri Vision fola për zgjedhjet Nacionale.



YOUTUBE.COM

Lajme - Pacolli: AKR e vetme në zgjedhjet Nacionale

27-Mar-14

851

33 Comments 12 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
March 27, 2014 ·  

Pamje nga vizita ime sot në Gjakovë, ku edhe fola për Zonen e Lire Ekonomike.



YOUTUBE.COM  
**Lajme - Pacolli viziton disa Fabrika në Gjakovë**  
27-Mar-14 

 207  6 Comments  7 Shares




 **Behgjet Pacolli**   
March 28, 2014 ·  ...

Sot në qeveri me propozimin tim, morëm vendim që të autorizohet ministria e ambient dhe ministria e administratës publike që në koordinim me komunën e Prishtinës të bëjnë planifikimin dhe hartimin e strategjisë për bartjen e administratës shtetërore në pjesën e Prishtinës së re në Hajvali.

Ky vendim ka për qëllim që qytetarët e kryeqytetit ti lirojë përfundimisht nga kaosi në trafik dhe më shumë hapsirë në qendër. Puna efikase, bëhet vetëm në ambientet funksionale të punës. #bp




 Lumturije A. Morina, Ardian Krasniqi and 947 others 22 Comments 7 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
March 28, 2014 ·  ...

Gjithashtu, morëm vendim edhe për shëndërrimin e aeroportit të Gjakovës në ndërmarrje publike. Një lajm i mirë ky për gjithë qytetarët e Kosovës. Kosova tashmë do ta ketë edhe aeroportin e dytë. Urime

#b.p

 390 24 Comments 15 Shares



Behgjet Pacolli

March 30, 2014 · 🌐

...

Dy ministrat e zhvillimit ekonomik dhe energjitikës së Shqipërisë dhe Kosovës Fadil Ismajli dhe Damian Gjicknuri nënshkruan në Tiranë marrëveshjen për Tregun e përbashkët energjitik. Fadili dhe unë që herët kemi luftuar për këtë.

Nuk ka pavarësi politike pa pavarësi ekonomike, pa pavarësi energjitike!! Tash po punojmë për Unionin ekonomik kombëtar në të gjitha fushat. AKR partia e parë në gjithë hapsirën kombëtare që e futi në program bashkimin ekonomik kombëtar!



253

12 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

March 30, 2014 · 🌐

...

Agim Bahtiri do ta ketë mbështetjen time të fuqishme në realizimin e projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e ekonomik të komunës, zvogëlimin e papunësisë dhe përmirësimin e gjendjes së rëndë ekonomike e sociale që ekziston në Mitrovicë.

Ai ka një program të mirë në këtë drejtim, dhe tani veç ka kontaktuar shumë biznesmenë të fuqishëm ndërkombëtarë të cilët kanë shprehur gatishmërinë për të investuar në Mitrovicë.

<http://www.kosovapress.com/.../pacolli-edhe-me-tutje-do.../>



👍 605

27 Comments 20 Shares



Behgjet Pacolli

March 31, 2014 · 🌐

...

Neser në Hotel Kristal në Gjilan do të marrë pjesë në bashkëbisedimin me ndërmarrësit e Anamoravës, me titull "Anamorava në perspektivën e zhvillimit ekonomik – Zona e lirë ekonomike dhe autostrada".

Takimi do të mbahet prej orës 11:00.

👍 151

6 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

April 1, 2014 · 🌐

...

Në bashkëbisedim me bizneset dhe ndërmarrësit e Gjilanit me temën "Anamorava në perspektivën e zhvillimit". Falenderoj për pjesëmarrjen kryetarin e Gjilanit Lutfi Haziri dhe atë të Kamenicës Begzad Sinani.



Bessa F Qazimi and 824 others

20 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

April 1, 2014 · 🌐

...

Fuqishëm do të angazohem që Gjilani dhe Kamenica të lidhen me autostradë me pjesën tjetër të Kosovës. Ky është misioni im i parë për Anamoravën.



👍 331

10 Comments 5 Shares



 **Behgjet Pacolli**   
April 1, 2014 ·  ...

Platforma agro-ekonomike është shans i madh për Gjilanin  
<http://www.rajonipress.com/shfieto-artikujt.php?id=21268>



 439  10 Comments  3 Shares



Behgjet Pacolli

April 1, 2014 · 🌐

...

Personalisht, pas arritjes së qëllimit për krijimin e Zonës së Lirë Ekonomike në Gjakovë dhe Mitrovicë, fokusi im, përkundër vështirësive që na krijohen si parti, do të jetë Anamorava. Ky vend ka potencial zhvillimi dhe ne duhet ta shfrytëzojmë këtë.

TELEGRAFI.COM

### Pacolli me ide për autostradën e Anamoravës

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli, sot në Gjilan ka marrë pjesë në dis...

👍 214

7 Comments 4 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
April 1, 2014 ·  

Une jam për ndërtimin e autostrades, por të ndryshohet.



YOUTUBE.COM  
**Pacolli kundër Thaçit - KLANKOSOVA.tv**

 471  15 Comments  5 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
April 1, 2014 ·  

Sot isha në Roganë i shoqëruar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik Fadil Ismajli.



RAJONIPRESS.COM 

**Presidenti i AKR-së Behgjet Pacolli vizitoi Roganën - Rajonipress.com**  
Agjencia Rajonale e Lajmeve - Rajonipress.com, Lajme lokale nga anamorava, rajoni, bota, Gjila...

 280  13 Comments  4 Shares



Behgjet Pacolli

April 2, 2014 · 🌐



Sot në një takim me ish Presidentin e Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi biseduam për zhvillimet e fundit politike në Kosovë, si dhe për reformat e fundit ekonomike që janë marrë në shërbim të zhvillimit ekonomik.

- Une vlerësoi lartë kontributin e Presidentit Topi për Kosovën dhe kombën shqiptar gjatë mandatit të tij.

<http://akr-ks.com/.../pacolli-takohet-ish-presidentin-e.../>



Bessa F Qazimi and 921 others

24 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

April 4, 2014 · 🌐

...

Sot bashkë me udhëheqësinë e partisë kemi pritur në një takim Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë z. Ilir Meta me delegacion.

Lexo me shumë: <http://akr-ks.com/.../presidenti-akr-se-z-behgjet-.../>



👍 390

13 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

April 4, 2014 · 🌐

...

Sot mbajta një ligjëratë para studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Prishtinë.

RTKLIVE.COM

### Pacolli: Duhet përmirësuar mirëqenia ekonomike

Për zgjidhjen e problemit politik të veriut, qenësore është përmirësimi i mirëqenies ekonomike të qytetarëve. Kështu tha zëvendës-kryeministri Behxhet Pacolli në një ligjëratë para studentëve të Universitetit për Biznes...

👍 294

7 Comments 6 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
April 4, 2014 · 🌐

Video nga ligjerata ime në UBT, Prishtinë



VIMEO.COM

**Pacolli mban ligjëratë në UBT për Zonat e Lira Ekonomike**  
Vimeo is the home for high-quality videos and the people who love them.

👍 Bessa F Qazimi and 661 others      5 Comments 13 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
April 5, 2014 · 🌐

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari Lila ka pritur kryetarin e Parlamentit të Shqipërisë, Ilir Meta, takim në të cilin ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli.

Lexo më shumë: <http://www.koha.net/?id=9&l=5352>



382      6 Shares



Behgjet Pacolli

April 5, 2014 · 🌐



Duke ecur në këmbë me Kryetarin e Parlamentit të Shqipërisë z. Ilir Meta dhe Kryetaren tonë të Komunës së Gjakovës Znj. Mimoza Kusari-Lila u ndalem në disa zejtari.

Se pari në dyqanin e djepeve Qarri.

Duke vizituar dyqanin e djepeve ku baba i im Isa, me urdhërin e gjyshit, pse isha nip i parë, vendosi të blinte djepin tim tek dyqani i Qarrit. Breza të tërë djepaxhinjsh.



👍 1.1K

13 Comments 15 Shares



Behgjet Pacolli added 4 new photos.

April 5, 2014 · 🌐



Në takim të djeshëm në selinë e AKR kryetari i parlamentit të Shqipërisë Ilir Meta tha se zgjedhja e Mimosës si kryetare e Gjakovës është një shembull për gjithë shqiptarinë. Dhe ai nderoi znj. Mimoza Kusari-Lila, Gjakovën, AKR-në duke qendruar disa orë në komunën që do bëhet shumë shpejt shembull për gjithë Kosovën. Për disa orë Gjakova ishte si kryeqytet i Kosovës.



👍 510

15 Comments 3 Shares





Behgjet Pacolli

April 6, 2014 · 🌐 · 📷



👍 87

1 Share



Behgjet Pacolli added 6 new photos — with Mevludin Mustafa.

April 6, 2014 · 🌐

...

Dje unë e konsiderova se Gjakova u bë për disa orë kryeqyteti i Kosovës. Kryetari i parlamentit të Shqipërisë ndejti disa orë në Gjakovë. U bisedua për projekte të ndryshme të bashkëpunimit me Shqipërinë në zyrën e kryetares së komunës Mimoza Kusari Lila. U vizituan tre varreza të dëshmorëve të kombit. U vizitua Çarshija e vjetër. U vizitua xhamija e Hadumit, më e vjetra në qytet dhe kisha françeskane.

Në fakt, prej disa javësh Gjakova e ka përjetuar këtë gjendje. Ishte kryeministri Edi Rama i cili vizitoi komunën dhe hapi perspektivën e një projekti turistik për Alpet së bashku me vëllezërit tanë të Tropojës, Kukësit, dhe Hasit, një projekt i Bashkimit Europian. Me nxitjen e tij, në Gjakovë qëndroi dhe drejtori i Fondit shqiptar të zhvillimit, për të diskutuar konkretisht projektin e Alpeve. Dhe dje patëm Kryeparlamentarin e Shqipërisë. Kam patur të drejtë apo jo?



👍 Bessa F Qazimi and 382 others

4 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli added 3 new photos.

April 6, 2014 · 🌐

...

Siç ju tregova dje ne qëndruam dhe në Çarshinë e vjetër, më e gjata në Ballkan. Duke qëndruar në dyqanin e djepave, një zeje që është kultivuar me breza të tërë mu kujtua një tregim i vjetër i fëmijërisë sime. Gjyshi Osman ishte shumë i lumtur që lindi unë, nipi i tij i parë dhe i kërkoi babës të blinte një djep në dyqanin më të mirë të djepave në Gjakovë. E ku tjetër veçse tek Qarri? Më vjen mirë që ky përkujtim jetësor i bukur kishte tërhequr vëmendjen e portaleve dhe miqve të mi të shumë anëmbanë shqiptarisë dhe botës.

Më pas shkuam dhe në zeje të tjera siç ishte ajo e poçarisë, e vetmja në Kosovë. E ndoqëm për pak çaste punën e këtij njeriu së bashku me kryeparlamentarin Meta. Turizmi i së nesërme në Gjakovë, do mbështetet dhe tek vizita në zejtaritë e ndryshme të Çarshisë së vjetër.



👍 586

8 Comments 1 Share



Behgjet Pacolli added 5 new photos.

April 6, 2014 · 🌐

...

Një moment i rëndësishëm i vizitës së kryeparlamentarit Meta ishte dhe vizita në të gjithë varrezat e luftës në komunën e Gjakovës. Së pari qëndruam në Varrezat e martirëve dhe dëshmorëve në Çabrat ku u takuam me familjarë të organizatës "Thirrjet e Nënave" Pastaj shkuan në varrezat e martirëve në fshatin Mejë dhe e përmbyllëm me vizitën në varrezat e dëshmorëve në varrezat e qytetit.

Ishte shumë prekëse për ne të gjithë e gjitha kjo. Ceremonia ishte dinjitoze dhe prej një trumpete të vogël që binte gjatë sekondave që ne përkuleshim para lapidarëve të këtyre varrezave.

Kryeparlamentari Meta u trondit nga aq shumë dhimbje e gjallë që shprehej prej atyre varreve që ngjanin të freskët. Kam mësuar dhe kam kuptuar shumë nga këto varre, - tha zotëri Meta, që kapërceu çdo protokoll dhe agjendë në qëndrimin e vet në Gjakovë.



👍 719

5 Comments



Behgjet Pacolli

April 8, 2014 · 🌐

...

Me rastin e Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 9 Prillit, i urojmë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dita e Kushtetutës është ndër momentet historike dhe akt madhor dhe i rëndësishme i shtetit demokratik të Republikës së Kosovës.

Kushtetuta përmban në vete ardhmëri, paqe dhe stabilitet. Ky fakt, na jep lirinë dhe të drejtën për garantimin e sovranitetit e të integritetit territorial të Kosovës dhe zbatimin e Kushtetutës në çdo pjesë të saj.

Gjashtë vjetorin e Kushtetutës, qytetarët e Kosovës e presin me perspektivë dhe me përkushtim të lartë për avancim të vlerave dhe sundim të rendit dhe ligjit.

Urime Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës !



👍 238

9 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

April 8, 2014 · 🌐

...

## Na duhet kushtetutë e pavarësisë së plotë!



Behgjet Pacolli

Pervjetori i kushtetutës është rast bukur i mirë për të diskutuar përmbajtjen e saj. Kjo ishte kushtetutë e mirë për një Republikë të re si e jona, por ajo ka vulën e Ahtisaarit, dmth të pavarësisë së mbikqyrur. Na duhet kushtetutë e pavarësisë së plotë! Përshembull, presidenti duhet të zgjidhet nga populli. I kemi parë problemet e dëntanishme me zgjedhjen parlamentare të presidentit. I shkruajmë disa institucione të pavarësisë së mbikqyrur, por si do zgjidhen këto të pavarësisë së plotë? Kushtetuta ka faqe të bardha që presin të shkruhen.

Duhet t'i shkruajmë disa institucione të tjera si Agjencioni i Privatizimit dhe duhet të krijojmë disa të tjera si Agjencioni për Gjeneratat e reja, Agjencioni për Partecipimet; etj. Janë disa projekte që i kam shpallur prej 2007 dhe sot 7 vjet më pas po i përmendin të gjithë.

[See More](#)



88

7 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

April 10, 2014 · 🌐

...

## Votim konsensual për ligjin e Trepçës



Behgjet Pacolli

Në politikën e Kosovës flitet për gjithçka. Flitet për zgjedhjet e parakohshme madje për to flitet prej një kohe të gjatë që kur mbanan zgjedhjet e radhës. Flitet për sistemin zgjedhor, flitet për Verium, flitet për Tribunalin, flitet për Bashkimin Europian, flitet për Sirinë, madje dikush flet dhe për botën afrikane, flitet dhe për botën në përgjithësi. Flitet shumë për të kaluarën dhe flitet pak për të ardhmen. Dhe kur flet për këto çështje, normal se nuk merresh vesh me tjetrin.

Në këto kushte ndër ne, është folur shumë pak dhe është vendosur shumë pak për ekonominë. Kohët e fundit që po afrojnë zgjedhjet, po flitet pak më shumë për ekonominë. Po merren tezat dhe idetë tona, për zonat e lira ekonomike, për Agjencionin e gjeneratave të reja, për Fondet investive, për Trepçën. Madje për Trepçën, po flasin thuajse të gjithë.

[See More](#)



48

3 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

April 10, 2014 · 🌐



## Ja çfarë i kam shkruar Berishës disa vjet më parë për akuzat e Dik Martit: Thirr tryezë mbarëkombëtare të faktorit shqiptar!



Behgjet Pacolli

Duke kërkuar në arkivin tim në lidhje me akuzat e Dik Martit, gjeta këtë letër të hapur drejtuar Kryeministrit të kohës Sali Berisha. Është shumë aktuale. Nëse do ishte ndjekur këshilla ime, mbase punët në lidhje me Tribunalin do kishin ikur ndryshe... lexojeni nëse kam të drejtë.

I dashur Kryeministër i vendit amë,

Duke vlerësuar përparimet e Shqipërisë nën drejtimin Tuaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, një koalicioni partish ku bëjnë pjesë të shumta të shoqërisë shqiptare, të cilët janë të bindur se do të ofrojnë kontribute të vlefshme për të

[See More](#)

👍 58

2 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

April 10, 2014 · 🌐



Ja çfarë i kam shkruar Berishës në vitin 2011 për akuzat e Dik Martit: Thirr tryezë mbarëkombëtare të faktorit shqiptar! (ABC News)

ABCNEWS.AL

Pacolli letër Berishës: N'a ndihmoni të rrëzojmë raportin Marti | ABC News

👍 375

11 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

April 10, 2014 · 🌐

...

Ligji për Trepçën kaloi në lexim të parë!

Sot Aleanca Kosova e Re, krejt politika Kosovare, arritën fitoren e parë pluraliste. u votua mbi bazën e bindjes personale për një ligj të rëndësishëm, atë për kalimin e Trepçës, në administrim të shtetit të Kosovës.

Ky ligj për të cilin po luftoj tash 7 vjet nuk duhej të na ndante sipas taborreve partiake, por duhet të na bashkonte për interesin e Kosovës, të minatorëve të Trepçës. Dhe kështu ndodhi.

Faleminderit kujtdo që dëgjoi zërin e arsyes. Aleanca Kosova e Re tregoi dhe njëherë se mund të bashkojë politikën që zakonisht në prag të zgjedhjeve vetëm ndahet.

Tani do ja fillojmë punës që Trepça që i takon qytetarëve dhe jo burokratëve të AKP, të bëhet siç e meriton!



1.1K

57 Comments 25 Shares





Behgjet Pacolli  
April 10, 2014 ·



Foto me studentet pas emisionit Rubikon në KTV.



832

11 Comments 16 Shares



Behgjet Pacolli

April 10, 2014 · 🌐



Unë e quaj një gjë të çmendur të shkohet tani në zgjedhje, në këtë moment, të papërgatitur.

Ne kemi kërkuar një ligj të dinjitetshëm zgjedhor e sidomos me postin e Presidentit të mos bëhet lojë. Është lojë me qytetarin sot të dilet me një ligj të vjetër zgjedhor.



👍 335

13 Comments 6 Shares

 Behgjet Pacolli   
11 April 2014 ·  · 

Në këtë libër është një pjesë e vizionit tim, të Arben Xhaferit, të Rexhep Meidanit, të Alfred Moisiut, dy ish Presidentë të Shqipërisë, të Fadil Ismajlit, dhe të shumë ekspertëve të tjerë, për "Bashkimin Kombëtar që nis nga Ekonomia"



 336 7 comments 4 shares

 Behgjet Pacolli   
11 April 2014 · 

Intervista e plotë në emisionin Rubikon (Video)

 KOHAVISION.NET  
**Behgjet Pacolli - Zëvendëskryeministër i Kosovës - Rubikon - Kohavision**  
Kohavision (KTV) is a Kosovar television broadcaster, and part of Koha group. Kohavision began broadcasting in September 2000, shortly after the Kosovo War ended. The news is very important sector, with Koha e Lajmev...

 406 8 comments 7 shares



Behgjet Pacolli

11 April 2014

"Aleanca Kosova e Re do të jetë konstruktive sa i përket themelimit të Tribunalit, kurse se sa i përket mandatit të EULEX-it në Kosovë, ai ka thënë se do të jetë edhe për dy vitet e ardhshme, por që ende nuk dihet se a do të ketë këtë emër apo ndonjë emër tjetër.

z. Behgjet Pacolli ka thënë se zgjedhjet duhet të mbahen në shtator ose në tetor. "

TELEGRAFI.COM

**Pacolli: Formimi i Tribunalit nga Kuvendi, më pak i dhimbshëm**

Kryetari i Aleancës, Kosova e Re, Behgjet Pacolli, pas takimit me presidenten, Atifete Jahjaga ka...

146

3 comments 11 shares



Behgjet Pacolli

11 April 2014

Këto ditet e fundit isha në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe. Aty mora pjesë në Forumin Ekonomik Ndërkombëtar AIM, ku ëdhë u takova me Kryeministrin e Emirateve të Bashkuara, njëherësh ëdhë emir i Dubait, z. Mohammed bin Rashid Al Maktoum.

Ja një video nga takimi.



YOUTUBE.COM

محمد بن راشد يلتقي عددا من رؤساء وفود الدول المشاركة في مؤتمر الاستثمار الرابع

Tuesday, April 8, 2014 - UAE Vice President, Prime Minister and Ruler of Dubai His Highness Sh...

452

17 comments 19 shares





Behgjet Pacolli  
12 April 2014



Takim i frytshëm në Pejë. Aderime të reja dhe fuqizim i AKR-së në Dukagjin. #bp



412

8 comments 12 shares



Behgjet Pacolli

13 April 2014


...

Prej ditës së sotme po nis me publikimin e pjesëve nga libri im autobiografik. Shpresoj që jeta ime e lexuar në këtë libër, të shërbejë për diçka...

"Ky libër nuk është vetëm libër i fakteve, por dhe i ideve dhe gjykimëve përgjatë një jete përplot kthesa e të papritura. Sinqeriteti - udhërrëfyesi kryesor i jetës sime. Pyetja- cili është çelësi i suksesit tim në jetë?- do të marrë një përgjigje. Besoj se ja vlen diçka të lexosh nga jeta ime, ani pse ajo nuk është jeta tipike e një heroi. Kosova ashtu kështu ka shumë heronj. Unë kam zgjedhur ndërtimin sepse dua të lë gjurmë për brezat. Unë kam themeluar qytete dhe kjo nuk është diçka që të ndodh çdo ditë në jetë."

Pse shkruaj për jetën time?

Lexo më shumë këtu: <http://goo.gl/z3Sypc>



851

23 comments 20 shares



Ja çfarë i kam shkruar Berishës me datën 7 Janar 2011, atëherë kur Dick Marti paraqiti për herë të parë, raportin e tij me akuzat kundër UÇK dhe kombit shqiptar: Në atë kohë, poashtu i kërkova një autorizim personave që përmendeshin te libri i Karla del Pontes dhe te raporti i Martit që të nisja procesin gjyqësor kundër Pontes dhe Martit në Lugano të Zvicrës. Askush (Hashim Thaqi) e as përfaqësuesit e UÇK nuk më dëgjuan dhe puna mbeti pa u përkryer. Tentativa tjetër ishte edhe letra që e keni në vazhdim. Unë personalisht e dija se do të ndodh ajo që po ndodh tani! Këto neglizhime po ndodhin edhe tani dhe ne po na kushtojnë shtrenjtë!

Ja pra letra:

Prishtinë, 7 Janar 2011

I dashur Kryeministër i vendit amë,

Duke vlerësuar përparimet e Shqipërisë nën drejtimin Tuaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, një koalicioni partish ku bëjnë pjesë një numër i madh personalitetesh të shoqërisë sonë, nga shoqëria civile, lufta çlirimtare, bota akademike, biznesi, etj, do të kërkoja ndihmën tuaj për një shqetësim të përbashkët kombëtar. Bëhet fjalë për të ashtuquajturin raport të parlamentarit zviceran Dik Marty, i cili synon të njollojë kombin tonë me akuza të neveritshme për ndërjegjen njerëzore siç është trafiku i organeve.

Ky angazhim imi në drejtim të mbrojtjes së imazhit tonë kombëtar ka një vijimësi të hershme, madje dhe në lidhje me akuzat që Dik Marti i rimori prej koleges së tij Karla Del Ponte. Por sot jemi në një situatë të re. Me raportin e tij Dik Marti arriti sukses me tituj mediash siç thoshte ish sekretari britanik i shtetit për Evropën, Denis MC Shane. Ndërkohë sot ai po synon të shndërrojë në dokument politik, në rezolutë të KE-së, një tekst plot akuza për kombin shqiptar dhe Perëndimin. Ky zotëri, me mbështetjen e Serbisë, për të cilën nuk e ka fshehur kurrë simpatinë, synon që Këshilli i Europës në një situatë paprecedent t'i japë urdhëra Bashkimit Europian për të provuar fajësinë tonë!

Siç e keni thënë dhe Ju, ky tekst është riciklim i akuzave të Beogradit, që janë më të hershme, Ato përfshijnë mes tyre dhe akuza që fajësonin deri dhe ish kryeadministratorin e parë ndërkombëtar të Kosovës, ish ministrin e jashtëm të Francës, dr. Bernard Kushner si pjesëmarrës në operacione për heqjen e organeve, robërve serbë apo dhe NATO-n që ofronte baza në Gjermani për këto operacione! (gazeta serbe Kurir në 2006). Pastaj u akuzua ish kryeministri Rexhepi, për shkak të kaluarës së tij si mjek, etj, etj, shpifje që mesa duket nuk paskan mbaruar. Kjo situatë është krijuar dhe falë një apatie të shtetit tonë të ri të dëshiruar për marrëdhënie paqësore me fqinjët. Gënjeshtra është si vaji, ajo noton mbi të vërtetën, ka thënë një poet polak. Prej një kohe bukur të gjatë ne nuk i kemi kërkuar llogari fqinjit tonë verior, Serbisë, për mbi 10 mijë qytetarët tanë të vrarë, trupat e të cilëve janë futur dhe në furra fabrikash; për qindra të zhdukurit; për mbi 120 mijë shtëpitë e dëmtuara; qindra objektet e kultit të shkatërruara, një ekonomi të rrënuar, prej trupave të rregullta dhe paramilitare të këtij vendi. Askush nuk ka kërkuar falje prej Serbisë, por përkundrazi, po lejojmë që ajo të shpikë gënjeshtra që po notojnë mbi të vërtetën tonë tragjike të genocidit serb mbi shqiptarët!

Në këto kushte, ne duhet të reagojmë për t'ja hequr njëherë e mirë nga supet kombit tonë këto akuza të ricikluara. Ne e vlerësojmë shumë faktin se Ju vendosët personalisht të shkoni në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës në 24 janar për t'i hedhur poshtë këto akuza.



Në përpjekjet e mia në favor të kauzës sonë kombëtare që shkojnë nga lobimi për pavarësi, tek ai për njohjet e shtetësisë së Kosovës prej 26 vendeve, unë e konsideroj angazhimin për rrëzimin e projektrezolutës së Martit, dhe për pasojë dhe të raportit të tij, si angazhim jetik. Nga bisedat e mia me kolegë, edhe në Shqipëri, ku dua të përmend zotin Shpëtim Idrizi, kryetarin e Partisë për Drejtësi dhe Unitet, nga konsultimet me ekspertë, me diplomatë të shquar, ne kemi arritur në përfundimin se akuzat formalisht të Dik Martit mund të hidhen poshtë me një akt të vetëm: rrëzimin e projektrezolutës së tij në 24 janar. Kuptimi simbolik i këtij rrëzimi do të ishte se bota, se Europa e qytetëruar nuk i besoi këtyre akuzave. Për këtë qëllim ne mendojmë se duhet punuar në këto drejtime:

1. Thirrjen nga ana Juaj të një tryeze mbarëkombëtare të krerëve të partive parlamentare shqiptare, ku duhet të diskutohet për një dokument politik, një letër drejtuar të gjitha kancelarive perëndimore në emër të kombit shqiptar. Në këtë letër ne duhet të kërkojmë hedhjen poshtë të projektit të Martit, të Serbisë, e pse jo dhe të ndonjë sponsori të saj për të fajësuar kolektivisht shqiptarët si komb.
2. Ne duhet të koordinohemi me Perëndimin për hapat e nevojshëm në hedhje poshtë të projektrezolutës dhe për pasojë të raportit famëkeq të Dik Martit.
3. Ne duhet të shprehim gatishmërinë për hetime ndërkombëtare, por jo sipas urdhërave të Dik Martit, që kërkon t'ja mveshë Këshillit të Europës. Ne i pranojmë hetimet vetëm nga institucionet ekzistuese të mandatuara për hetim si EULEX-i, në bashkëpunim me prokurorinë e Kosovës dhe të Shqipërisë. Ne mund të pranojmë dhe një grup ekspertësh me renome ndërkombëtare që të zhvillojnë këtë hetim, brenda kuadrit ligjor ndërkombëtar. Unë e di se një pjesë të këtyre hapave Ju, shteti amë, keni nisur t'i bëni prej kohësh. Por në optikën time, që i sheh tre momentet brenda një qasjeje integrale, takimi mbarëkombëtar është thelbësor. Ai do të tregojë forcë, unitet, duke mos rënë pre e qëllimeve të ulta të ideatorëve të raportit për të përçarë faktorët politikë të hapësirës sonë kombëtare. Ju zotëri Sali Berisha keni autoritetin personal me i thirrë liderët e kësaj hapësire në një tubim mbarëkombëtar. Nga ky tubim, unik në historinë e pluralizmit në viset tona, nga ky demonstrim i unitetit dhe forcës së faktorit shqiptar përballë akuzave monstruoze të Serbisë, Perëndimi do ta kuptojë forcën tonë si faktor i përbashkuar, forcën e aleatit më të mirë të perëndimorëve në Ballkan. Bashkimi i forcës sonë me ofrimin e së vërtetës mbi akuzat e Martit, do të prodhojë forcën e të vërtetës!

Unë jam i bindur se Ju zoti Berisha do ta pranoni këtë ide, të njoftuar publikisht nga një artikull që botova para disa ditësh. Jam i gatshëm të udhëtoj në Tiranë për t'ju paraqitur më detajisht iniciativën. Besoj shumë se ju do ta jetësoni takimin para udhëtimit Tuaj në Strasburg. Unë do doja shumë ndërkohë që kolegët e mi të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë, e cila ka gjithashtu delegacion parlamentar në Këshillin e Europës të kapërcejnë dasitë e tyre politike të brendshme dhe t'i përgjigjen kësaj thirrje. Nga simbolika e këtij takimi, me vlerë kombëtare, kur të shohim sa shumë jemi, dhe sa mirë do ndihemi bashkë, do të dalin mesazhe me vlerë për të gjithë!

Me bindjen e thellë në mirëkuptimin Tuaj,

I juaj Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

14 April 2014 · 🌐



Kushtet e AKR-së për miratimin e Gjykatës së Posaçme

I keqardhur që sot mbërritëm tek Gjykata e Posaçme, ju solla në kujtesë letrën time drejtuar ish kryeministrit Berisha, dhe mungesën e mbështetjes për procedimin juridik në Zvicër të Dik Martit dhe Karla del Pontes. Janë ata ideatorët e kësaj që po shohim sot të realizohet. E dija se do mbërrinim deri këtu, por jo të gjithë duan të shohin larg, andaj preferojnë të merren me probleme ditore dhe me kurthe taktike.

Këto ditë hapësira është më e ngushtë për kurthe taktike dhe Kuvendi duhet marrë vendim për krijimin e Gjykatës. Ndaj doja të bëja disa saktësime.

AKR-ja tha se e ka bërë zgjidhjen pro këtij vendimi të dhimbshëm gjithashtu. Por ka disa kushte për këtë « dhurim të pjesshëm të sovranitetit » prej Kuvendit, si e keqja më e vogël përballë « grabitjes së sovranitetit », prej Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Miratimi i Gjykatës së Posaçme duhet bërë në përputhje me procedurat e parashikuara në Kushtetutë.

Kuvendi duhet të diskutojë rreth objektit të kësaj gjykate, Statutit të saj.

Duhet përfshirë në objektin e hetimit dhe gjetja e fatit të mijëra të zhdukurve shqiptarë si pasojë e krimeve serbe.

Nëse duhet ndërhyrë në Kushtetutë, duhet ta bëjmë këtë që të jemi në rregull me dokumentin themelor.

Nëse dikush ka kontestime, pse jo të shqyrtohet kushtetutshmëria e këtij Tribunali në Gjykatën Kushtetuese.

👍 190

5 comments 12 shares



**Behgjet Pacolli**

14 April 2014 · 🌐

## FEMIJERIA IME

Pas pjesës së parë të librit tim autobiografik « Nga Sfida në Sfidë », po ju përcjell sot pjesën e dytë « Fëmijëria ». Do kuptoni pse « guri është i rëndë në vendin e vet », ose arsytet më të thella pse unë pas sukseseve të mia në Perëndim, kam vendosur të punoj dhe jetoj këtu, së bashku me gjithë fëmijët dhe shoqen time që janë shtetas të Kosovës.

Do mësoni lidhjet e mia me familjen, nënën dhe babën që nuk janë më, vlerat e mia familjare, mësimet e gjyshit Osman! Do të kuptoni se sa shumë e kam dashur mësimin dhe shkollën! Do të kuptoni më shumë për Marecin, fshatin më të madh në Kosovë që gjithmonë më tërheq dhe e dua si atëherë!

### Fëmijëria

Mareci, në shtetit jugorë në një fshat që shfaq në qytetin shqiptarë i madh Të atëherë e më. Gjyshi Osman, vëllazëritë të parë dhe të mëtejshëm e një që më ndihmoi gjatë jetës. Si ndihmoi babën e shokun e Turgut Shkëmbi dhe e parë...

**T**ë lindësh në Marec, kam mend të thash se Zoti të ka privilegjuar që shumë, megjithatë unë e dua vendlindjen time, si çdokush tjetër dhe unë e ndërror me një tjetër kudo qoftë në botë. Sapo të hapësh sytë, kur gjendesh në vendin e të parëve të mi dhe të shikosh të katër anët e horizontit, qadërishit të duket sikur qëndron në kurrizin e botës. Pastaj, të krijohet ideja se Krishti të tokës dhe gjithësisë i kanë mbetur në dorë një grusht maresh e kodrinash, të cilat nuk ka ditur ku t'i vendosë, prandaj, i shpërndesur dhe i pavëmendshëm, i ka bërë grumbull në një vend, atje ku mbaron fusha e gjërë e Kosovës. Sigur atyre kodrinave është vendosur qielli, i cili e mbijll botën si rën një kambanë qelqi. Është një botë dritë e veçantë, një paisim që i bën përshlytje çdo vizitori, i këndshëm për t'u parë, por shumë i vështirë për të jetuar në të. Po qëndrosh në gjatë në këtë vend, pamja e këtyre viseve të seltë në mendje vetmërisht dhe nevojën e shpesh prej andej, për të pësuar se bota mund të ketë edhe një dukje tjetër, larg atyre kodrinave që të duket sikur shpërndihen ndër vetë dhe është asaj kambanë qelqi, që të duket sikur të rri mbi tokë.



nga shikimi në shtetit...

pas tjetër, për fëmijërinë dhe rininë time të hershme kanë pasur një domethënie, sepse i kam bërë në këmbë atë shpesh, sa që më duket se edhe sot, pas kaq viteve, sapo i mbijll sytë, më del përpara çdo kapubë, çdo llo, çdo gur, janë ato pamje që nuk më hiqen kurrë nga përfytyrimet.

Mareci është një fshat i shpërndesur, me ditë mëhalla, ose lagje, siç quhen tani. Ditur thuhet se kishte gjimnazin shqiptar, me një tre mësues banorë. Sot besoj se nuk e di njëri as sa shkollë, as sa banorë ka. Si çdo vend tjetër, zanatçia e tij nga legendat dhe pastaj në kohët më të vona, lthehet në histori. Por ne, siç ndodh zakonisht, mund të mos kemi shumë për të thënë nga historia. Nga legendat po. Një legendë për shembull thotë se të parët e hershëm të Mareci kanë qenë, babai Mara me të bijtë e tij, të cilët e kanë bërë banor dhe e kanë themeluar këtë fshat. Të bijtë e Marës ishin: Paca, Caca dhe Maika. Ata paskan pasur edhe një nip të vetin, djalin e Perës, i cili u nda prej tyre duke themeluar Krifëvin. Kjo pasqirsh qenë një si traditë, e cila është ndjekur për një kohë të gjatë, sepse Mareci gjithmonë e ka ndarë një prej djemve duke i thënë: Ti shko atje për të jetuar, matanë atij përroi, gjegjësisht asaj kodre! Duket se në këtë mënyrë është bërë zgjerimi i territorit. Kjo ka ndodhur edhe në periudhat e mëvonshme, sepse mbaj mend se vëllezërit e gjyshit i kanë pasur shpesh larg njëra-tjetër, nga dita qëndra metra, deri në dy-tre kilometra. Luaja jonë, kjo e gjyshit tim dhe prapa, ka mbetur në vendin e mëdha, afër një përroi me një lundërzakonisht të natës dhe

nga shikimi në shtetit...



nga shikimi në shtetit...

nga shikimi në shtetit...

vetë të larg të kamit të Mareci. Në fshat edhe me këmbë/mbetur ndonjëherë e shikimesh përjetshëm kamit të ditë vende. Një legendë tjetër thotë se banorët e parë të Mareci ishin vendosur edhe në njëqytetin e parandit të opozitit të vjetër.

Pavarësisht se kjo është legjendë, çka mbetur e vërtetë deri në kohën time marceane, pra deri nga vitet shpërndesur kur unë e kamit Marecin, në kamandën time më i parë bërë marrësi të brendshme, sepse të gjithë janë këndësuar mbarësi në këmbëtim, si një familje. Përvetësisht, kamit nuk ka pasur nga brendshme kamandë. Mareci gjithmonë e kanë respektuar një-tjetrin, janë ndihmues me vetë dhe i janë gjetur pranë një-tjetrit në situata të vështira. Por edhe gjendëtimet i kanë pasur të përbashkëta.

Thuhet, gjithësisht, se kamit të fshatit Mareci i kamit zot, ka ndihmues vetë, ndihma jo në shpirt të kamit që një më parë kamit më të natës e dëshmon një raportin, një vend, që quhet "In Erika", jo fort larg prej shpirtit të natës, por shpirtit të kamit fshatit unë. Mbiq mend se aty kanë qenë mbetur e rëndësia e një goditje të vjetër. Si fshat, kam digjatur të fshatit të shpirtit e kamandë, e vëmë shikim në Marec, e cila ka qenë e ndërror në natën e famitës tonë, gjithësisht është ndërror nëse, me gratë nga fshatit i shpirtit 33X ose 33m i shpirtit 33X. Pa, bërit një një dëshmi se këmbëtimet i kamit zot, për shikim të natës, ka duket veçor funksionimin i reliefit, anashkëtim i fshatit prej shpirtit me qadërshim në të dendur, ka



Vendlindja ime, Mareci. Shikimi legjendë në një fshat të vogël

dritë, kurat përshlytje me bërë kamit. Ata kamit vendin e tyre, natën e kamit, që kamit goditje në vonë, në afër ditës të shpirtit. Çdo e kamit mbetur gjithësisht me një kamit të veçantë. Përvetësisht, nga mbetur bërë kamit i një dhe më parë, shpërndesur.



+16

👍 513

31 comments 27 shares



Behgjet Pacolli  
15 April 2014 ·

Sot, bashkë me ministrin Fadil Ismajli dhe ministrin Dardan Gashi vizitova gjigandin ekonomik të Kosovës, Trepçën. Bashkëbiseduam me menaxhmentin dhe minatorët për kalimin e ligjit i cili e shëndërron këtë aset në ndërmarrje publike të Kosovës. E rikonfirmova edhe njëherë qëndrimin se Trepça nuk duhet të shitet, nuk duhet të jepet në koncesion por të ringritet dhe tu shërbejë gjeneratave të ardhshme të Kosovës. Trepça do të jetë motorri ekonomik i Kosovës.



Fistrim Terziu and 1.2K others

35 comments 30 shares



Behgjet Pacolli

15 April 2014



Lavdi Kukësit dhe gjithë Shqipërisë për mikpritjen vëllazërore! Duhet ta kujtojmë historinë që ajo të mos përsëritet dhe viktima të barazohet me dhunuesin!

15 vjetori i eksodit të bashkatdhetarëve tanë që ikën nga vatrat e tyre stërgjyshore nga tmerret e luftës dhe të ndjekur nga njësitë ushtarake serbe, do të përkujtohet nesër në Kukës. Është shumë mirë të mos harrojmë këtë krim të madh të konsumuar në mes të Europës në fundin e shekullit të 20- si genocid dhe spastrim etnik të shqiptarëve! Ky përkujtim ngjan i qëlluar sot, kur për shkak të njëllonj apatie që ne kemi treguar për të dokumentuar krimet e serbëve, po ndërron statusi i viktimitës me atë të kriminelit! Dik Marti dhe Karla del Ponte, kanë arritur njëfarë suksesi me ngritjen e Tribunalit të Posaçëm, vendim që do diskutohet javën që vjen.

I kam vuajtur shumë skenat e atyre krimeve megjithëse kam qenë jashtë Kosovës. Shumë familjarë të mi janë vrarë, shtëpi të tyre janë granatuar apo djegur. U mobilizova për të çuar ndihma së bashku me aktiviste të mëdha humanitare europiane në kampet e Kukësit ku qëndronin bashkëvendasit e mi, gra, pleq, fëmijë. Kam punuar për të sensibilizuar diplomacinë ndërkombëtare, kam marrë pjesë në shumë emisione të rëndësishme të mediave europiane për ta treguar tragjedinë e popullit tim.

Kukësi u bë monument i bujarisë njerëzore universale dhe mbarë bota kishte sytë tek Kukësi. Kukësi dhe Shqipëria penguan realizimin e planit të Milosheviqit, që duke nxjerrë afro gjysmën e popullsisë jashtë, mendonte se ata nuk do ktheheshin më. Bashkëvendasit tanë që ishin afër vatrave të tyre, u kthyen menjëherë pas mbarimit të luftës dhe kjo ishte një fitore e madhe strategjike e kombit shqiptar. Mirënjohje të përgjeshme për këtë vepër të madhe!



466

9 comments 30 shares


 **Behgjet Pacolli** ✓  
15 April 2014 · 🌐

Trepça, nuk privatizohet, nuk jepet me koncesion, por u kthehet minatorëve dhe të gjitha gjeneratave të Kosovës që do të trajtohet në bazë të normave të tregut globalizues të mineraleve

TELEGRAFI.COM

**Pacolli: Trepça nuk duhet të shitet**  
Zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli ka qëndruar të martën në Mitrovicë me ç'rast k...

👍 346 11 comments 15 shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
15 April 2014 · 🌐

Në qytetin e famshëm në botë për mikpritjen e vet, në Kukës, nesër një hap tjetër për idenë tonë të fuqishme të Unionit ekonomik: Do themelohet oda e përbashkët tregëtare

Është e fuqishme ideja të koha e të cilës ka ardh. Ideja e Unionit ekonomik, ideja ime e kahershme e bashkimit kombëtar si proces që nis nga ekonomia dhe vijon në të gjithë fushat, nesër në Kukës do të japë një fryt tjetër. Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës do takohen për të përkujtuar eksodin tragjik të qindra dhe mijëra kosovarëve gjatë Luftës së vitit 1999, por dhe do të marrin ndonjë vendim: krijimin e odës tregëtare të përbashkët. Një hap i vogël, por në drejtimin e duhur në një proces që tash nuk ndalet!

👍 255 15 comments 12 shares



Behgjet Pacolli updated his cover photo.

15 April 2014 · 🌐

...

Trepça ka të ardhme. Trepça do të zhvillojë dhe bashkojë Mitrovicën! Trepça do t'i prijë zhvillimit dhe begatimit të mbarë Kosovës!

Sot jam ndjerë i lumtur si kurrë më parë ndërsa kam vizituar Trepçën! I solla bashkë me ministrat, Fadilin dhe Dardanin, minatorëve lajmin se Trepça nuk do shitet dhe as privatizohet! I prezentova planin tim për zhvillimin e kompleksit të Trepçës! E pashë në sytë e tyre besimin tek ky plan! I thashë atyre: me besimin tuaj, me mbështetjen tuaj, ne mund të bëjmë shumëçka, jo vetëm në Trepçë, por në gjithë Kosovën



455

16 comments 37 shares



Behgjet Pacolli

15 April 2014 · 🌐



"Zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli, i shoqëruar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik Fadil Ismajli dhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Dardan Gashi, kanë vizituar sot Kompleksin "Trepça", ku menaxhmentin dhe punëtorët e kësaj ndërmarrje e kanë njoftuar me hapat që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës që këtë aset ekonomik ta kthejë në pronësi publike."



👍 349

13 comments 25 shares





Behgjet Pacolli

16 April 2014 · 🌐



Duke folur në aktivitetin për 15 vjetorin e eksodit kosovar në Shqipëri. Shpreha mirënjohjen për mikpritjen e kuksianëve dhe mbarë kombit shqiptar. Tregova për sfidën që bëra në 2011 kur kërkova në parlamentin e Shqipërisë Bashkimin Kombëtar që nis nga Ekonomia.

Fola për ide konkrete. Për rrugën e re Kalimash-Gjakovë. Fola për spitalin kombëtar që duhet ngritur në Kukës. Për Zonat e Lira Ekonomike. Fola për nevojën që porti i Shëngjinit të rifunksionalizohet. Kërkova që të krijohet një kompani e përbashkët ajrore që do të vinte në punë dy aeroportet e Kukësit dhe Gjakovës. Kërkova heqjen e doganave midis dy vendeve dhe çdo barriere tjetër.

E mbylla fjalimin e improvizuar që mori shumë duartrokitje me bindjen se "ne duhet t'i shërbejmë rinisë, t'i krijojmë perspektivë asaj. Të ngremë vetëdijen e qytetarit nëpërmjet rritjes së mirëqenies"



1.3K

59 comments 29 shares



Behgjet Pacolli

16 April 2014 · 🌐



Unë nga thellësia e zemrës falënderoj ato motra, ato nëna, ata baballarë, ata vëllezër që hapën dyert e shtëpive të tyre dhe lëshuan vend për njerëzit, për fëmijët, gratë nga Kosova.

Ishte një bujari e paparë dhe sigurisht kjo ngjarje është motivi ynë shumë i fortë sot për të krijuar vizion për një jetesë të përbashkët. Faleminderit shumë për çdo gjë që keni bërë për popullin e Kosovës, popullin tim, vëllezërit dhe motrat nga Kosova.

/ Behgjet Pacolli



Albion Egzona Pira and 1.4K others

71 comments 21 shares



Behgjet Pacolli

16 April 2014 · 🌐



AKR e fortë dhe në Malishevë

Në një odë të Panorcit të Malishevës së bashku me Ministrin e AKR-së, Fadil Ismajli u takova me dhjetra banorë të fshatrave Liabjan, Drenoc, Gurbardh, Janqist, Burim, Malishevë, Lumishtë, Shkozë, Carrallukë. Disa prej tyre kishin ardhur dhe nga ana e Pejës për të ndjekur bisedën me mua. Sekretari i degës dhe asambleisti i AKR-së në komunën e Malishevës, Hafir Rexha kishte organizuar një takim shumë të ngrohtë dhe patëm një bisedë shumë të sinqertë me banorët, që rinin në këmbë apo dhe jashtë odës për të ndjekur bashkëbisedimin me mua.

Edhe unë jam fshatar i Marevcit si ju, i thashë nikoqirëve. Peripetitë e jetës janë mësimë të mëdha dhe unë prej jetës sime kam mësuar shumë. Asnjëherë mos me humb shpresën. Nëse je i pastër në shpirt dhe nuk i bën keq dikujt, s'duhet me pas frikë prej askujt! Nuk ka më mirë se me lanë dyer të hapur në botë, që nëse kthehesh s'të duhet t'i shtysh e t'i hapësh sërish! Respekti reciprok i mban të hapura dyert e nevojës! Duhet me e dash punën, dhe atëherë perëndia të ndihmon që ta kryesh punën shumë mirë. Nëse don të lëvrosh arën, perëndia të ndihmon t'i gjesh qetë, kur don të punosh! Janë këto disa mësimë prej jetës sime, por dhe prej kohës së shkuar kur unë lashë Kosovën. Kur u ktheva, gjeta më shumë egoizëm, dhe dashuria për njeri tjetrin ishte zvogëluar pak, ndoshta prej dallimit të shtresave shoqërore, prej ndarjes, thashë para banorëve. Më pas tregova përpjekjet e mia për lobim, programin e AKR-së, veçanërisht për platformat agrorëshqimore për bujqit që do krijojnë 70 mijë vende pune, dhe iu përgjigja pyetjeve të të pranishmëve.



👍 339

12 comments 10 shares



Behgjet Pacolli added 3 new photos.

17 April 2014 · 🌐



Nga takimi në një odë të Panorcit së bashku me ministrin e AKR-së, Fadil Ismajli. Takuam banorë të fshatrave Llabjan, Drenoc, Gurbardh, Janqisht, Burim, Malishevë, Lumishtë, Shkozë dhe Carrallukë



👍 277

9 comments 2 shares



Behgjet Pacolli is in Kukës County.

17 April 2014 · 🌐

...

Kemi ende shumë punë për të bërë. Unë do doja të shoh mallin i cili është zhdoganuar në Durrës dhe ka hyrë në Kosovë të ketë shkuar tek konsumatori. Do të doja të shikoja kamionin i cili është zhdoganuar në Merdarë dhe ai të kalojë pa asnjë ndalesë dhe të shkojë tek konsumatori në Shqipëri. Do të doja shumë që të shoh një njeri të biznesit nga Shqipëria, nga Tirana i cili vjen në Kosovë dhe i nënshtrohet të njëjta atyre të cilave i nënshtrohet çdo kosovari dhe anasjelltas.

Nuk do të doja të kishte çmime referuese. Malli të udhëtojë si në Prishtinë, apo anasjelltas. Nuk na nevojitet ne ndalesë nëpër këto të ashtuquajtura dogana. Dogana është një shenjë që i takon së kaluarës. Njëri prej tyre të likudihet. Nuk kemi kufij mes vetit.

Qeveritë tona të nisim ndërtimin e rrugës, prej Kalimashit në Gjakovë, ajo rrugë do të shkurtonte kohën për të arritur në Kosovë për 35-40 minuta. I lutem dy qeverive që të ndërtohet kjo rrugë që do të ishte në funksion të ekonomisë.

Aeroporti i Gjakovës nis punën por shqetësohem pse nuk është nën funksion aeroporti i Kukësit.

I lus qeverisë shqiptate të hapë aeroportin e Kukësit. Harxhojmë shuma marramëndëse duke dërguar të sëmuret tanë në Greqi, Itali dhe në vendet e tjera.

Dhe mu këtu në Kukës, për hirë të asaj që ka ndodhur për 15 vite do të doja që të ngrihet një qendër mjekësore që do i shërbejë edhe Shqipërisë edhe Kosovës dhe për këtë dy qeveritë duhen që çmos të gjejnë mjetet dhe kjo qendër duhet të fillojë dhe të ndërtohet dhe aeroporti është këtu dhe ai do ti shërbejë kësaj qendre.

Pse të mos kemi kompani ajrore të përbashkët? Nuk nevojitet asnjë investim nga qeveritë, investimi i vetëm nga dy qeveritë që duhet të bëjnë janë licensat dhe prioriteti i kësaj kompanie të përbashkët.

Ne duhet ta kemi kompaninë ajrore të përbashkët. Prandaj ekzistojnë operatorët ekonomik privat dhe këtu duhet një motivacon më i fortë prej dy qeverive dhe ne këtë do ta bëjmë.

Dhe në fund është porti i Shëngjinit.

- Zoti Peleshi ne kemi investitor që do të vijinë në portin e Shëngjinit të investojnë, do ta rifunksionalizojnë atë, do ta kthejnë atë në një port i cili do tu shërbejë edhe Kosovës edhe Shqipërisë.

Kemi harxhuar shumë para në ndërtimin e autostradës së kombit dhe kjo autostradë duhet të jetë plotë me trafik. Ju folët për hekurudhën. Prishtinës e Tiranës i nevojitet një linjë hekurudhore prandaj dhe këtu ne do të punojmë.

Vetëm perspektiva ekonomike ngrit vetëdijen tonë, me ngritje ekonomike ne përmirësojmë standartin tonë, në përmirësimin e standartit tonë rritet dhe vetëdija jonë atëhere rritet edhe vetëdija për një bashkim të vërtetë kombëtar i cili vërtet do të ndodhë.



👍 1.9K

145 comments 238 shares



**Behgjet Pacolli** ✓  
17 April 2014 · 🌐

...

Ndërsa shtypi i Tiranës u mor gjerë dhe gjatë me zhvillimet e Kukësit, ai i joni u morë fare pak hiq detaje protokollare.

A keni ju miq të mi ndonjë shpjegim për këtë?



👍 320

33 comments 9 shares

 **Behgjet Pacolli** 17 April 2014 · 🌐 ...

Kërkova funksionimin e aeroportit të Kukësit, Portit Detar të Shëngjinit, hekurudhën Shqipëri-Kosovë, një doganë të vetme dhe heqjen e çmimeve të referenceës dhe lehtësi për biznesin.

Zoti Rama nuk dha përgjigje për aeroportin dhe Shëngjinin...

---

ILLYRIAPRESS.COM 

**Pacolli "zë ngushtë" kryeministrin Edi Rama**  
Kërkon funksionimin e aeroportit të Kukësit, Portit Detar të Shëngjinit, hekurudhën Shqipëri-K...

 1K 75 comments 37 shares


 **Behgjet Pacolli** 18 April 2014 · 🌐 ...

Në kthim nga Kukësi, ku patëm një ditë të mbushur me përkujtimin e genocidit dhe projektimin e të ardhmes kombëtare patëm një takim shumë përmbajtësor me një grup të madh të rinjsh në Prizren. Isha bashkë me Fadilin, ministrin tonë të zhvillimit ekonomik dhe nuk mund të shkëputeshim nga ajo bisedë shumë interesante me atë grup të rinjsh, shumica e të cilëve studionin ekonomi. Folëm për bankat dhe si duhet të punojnë ato për të mbështetur zhvillimin.

Folëm për karakterin rajonalist të politikës sonë dhe mungesën e përfaqësimit të Prizrenit në politikën qendrore. Dikush që kishte punuar jashtë me IT kërkoi që t'i jepet gjithmonë e më shumë hapësirë digitalizimit të administratës sonë dhe shkollës. Shpjeguem programin e AKR-së për të ardhmen.

E ndiej që sot gjithmonë e më shumë për idetë tona, për projektet për të cilat kemi 7 vjet që flasim po ekziston një terren gjithmonë e më shumë pjellor, veçanërisht tek rinia. Ky terren është arritur për shkak të ngritjes në një nivel më të lartë të vetëdijësimit popullor, për shkak të karakterit paraprirës të ideve dhe projekteve tona. Politika kosovare është e detyruar të na ndjekë në kur vjen fjala tek ekonomia.

Shikoni përshebull ç'ndodh me Trepçën. Ne kemi shumë kohë që kemi paraqitur projektin tonë dhe vetëm tani në prag të zgjedhjeve ai po nis dhe miratohet. Kjo lëvizje jona e hershme ka shtyrë gjithë liderët e partive që në kuadër të fushatës të vizitojnë minatorët dhe të flasim për mbështetjen e Trepçës. Ama vetëm ne kemi projekt për të, dhe për gjithë Kosovën! Ne folëm gjithë vitin për Trepçën dhe projektin e saj, të tjerët u shfaqën vetëm në fushatë!

 214 6 comments 6 shares



Behgjet Pacolli

18 April 2014 · 🌐

...

Me rastin e përvjetorit të 15-të të Epopesë së UÇK-së në fshatin Marec, udhëheqësia e Aleancës Kosova e Re, kryesuar nga Presidenti i Aleancës Kosova e Re z. Behgjet Pacolli dhe Sekretari i përgjithshëm, z. Ibrahim Makolli, kanë bërë homazhe në kompleksin përkujtimor në Marec, për të përkujtuar lavdinë dhe sakrificën e familjeve të rënë në luftën çlirimtare për liri dhe pavarësi të Kosovës.



👍 887

18 comments 27 shares





Behgjet Pacolli

18 April 2014 · 🌐

...

Po e ndiqni live emisionin Debat, në RTK? Njerëzit kryesorë të Aleancës Kosova e Re, ekipi ekonomik i qeverisë Fadil Ismajli dhe Bernard Nikaj dhe kryetarja fituese e Gjakovës, Mimoza Kusari Lila po flasin për atë se çfarë ka bërë AKR-ja në qeveri? Është krejt e qartë se arrijtjet kryesore të kësaj qeverie, nëse ka arritje në MSA, në zonat e lira ekonomike, në ligjin e shoqërive tregëtare, në krijimin e mjedisit të të bërit biznes, janë të lidhur me njerëzit e AKR-së. Askush prej tyre s'është përfolur për korrupsion.

Është krejt e qartë gjithashtu se nëse ne të AKR-së do të kishim më shumë hapësirë, Kosova do të kishte më shumë prosperitet, më shumë zhvillim ekonomik. Qytetari e ka kuptuar këtë, ndaj i ka dhënë besim AKR-së në zgjedhjet lokale dhe do t'i japë edhe më shumë besim në zgjedhjet e ardhshme!



👍 361

9 comments 16 shares



Behgjet Pacolli

19 April 2014 · 🌐

...

Dua t'ju uroj bashkëqytetarëve tanë katolikë dhe ortodoksë në Kosovë, Shqipëri dhe kudo, gëzuar festën e madhe dhe të themeltare të Pashkëve. Paqja, lumturia dhe harmonia qoftë me ju!

👍 222

6 comments 3 shares

 Behgjet Pacolli   
19 April 2014 · 

Sot pata kënaqësinë që të mirëpres më shumë se 150 të rinj nga Lipjani që aderuan në AKR!  
Fitorja jonë në Gjakovë dhe Mitrovicë dhe reformat ekonomike në këto dy qytete po shërbejnë si motiv për bashkim me AKR-në. Unë do të vazhdoj të promovojë vizionin ekonomik që është alternativa e vetme për Kosovën dhe qytetarët e saj.



 520  13 comments  19 shares



Behgjet Pacolli

20 April 2014 · 🌐

...

Kisha mëdyshje për t'jua paraqitur këto fjalë të Edi Ramës, kryeministrit të Shqipërisë në takimin përkujtimor të 15 vjetorit të eksodit kosovar në Kukës. Por më në fund vendosa. Disa prej fjalëve të tij japin saktësisht arsyen pse unë jam në politikë duke ardhur nga ndërmarrësia :të ndihmoj për zhvillimin ekonomik të vendit tim dhe të kombit tim! Çka unë e them vazhdimisht dhe që do ta realizoj patjetër gjithë jetën time!

Fjalimi Edi Rames:

Unë jam sot i lumtur që këtu mes nesh është edhe një figurë që pak është ndriçuar nga vlerat që i ka krijuar vetes në kohë. Sepse pak Shqipëria, por pak dhe Kosova kanë bërë gjithë këto vite, për t'i dhënë vendin që i takon njerëzve të sipërmanjës. Këtu e kam fjalën për Behxhet Pacollin, i cili foli përpara nesh si Zëvendëskryeministër i Kosovës, por i cili nuk është si ne, në rolin e një drejtuesi të qeverisë, por është ndryshe nga ne. Sepse është aty jo për të vazhduar rrugën e natyrshme të një angazhimi politik, por për t'u munduar që ta ndikojë sa më shumë politikën, që të bëhet sa më shumë forcë e zhvillimit ekonomik. Dhe duke përmendur mikun tonë Behxhet Pacollin, unë dua të shpreh gjithë lumturinë time që këtu, sot, me ne janë sipërmarrës nga Shqipëria, nga Kosova dhe nga trevat e tjera, për t'i dhënë jetë fillimit të një bashkëpunimi konkret për Dhomën Kombëtare të Tregtisë.



YOUTUBE.COM

**Nga Eksodi tek Partneriteti Strategjik**

Fjala e Kryeministrit Rama, mbajtur në konferencën "Nga Eksodi tek Partneriteti Strategjik", në ...

👍 204

14 comments 16 shares



Behgjet Pacolli  
21 April 2014

...

Sot është e hënë dhe për disa ditë ka qënë feste. Mbase keni më shumë kohë për të lexuar pak faqe nga pjesa e tretë e librit tim autobiografik. Do të mësoni mbi disa ngjarje të fëmijërisë dhe të rinisë sime që kanë shenjuar gjithë jetën që pasoi.

Do të mësoni se suksesi im jetësor i ka themelet bukur të forta përveç se në këshillat e gjyshit dhe të prindërve dhe në mësimet e mia shkollore ku jam munduar gjithmonë të jem i pari, diçka që mund të provohet nga regjistrat e shkollave të mia dhe nga dëshmitë e mësuesve.

Do të kuptoni sakrificat që kam bërë për të mësuar, do të mësoni mbi miqësitë e mia të kohës, përjetimet e mia për ngjarjet e vitit 1968 dhe episodin e pabarazisë sociale që përcaktoi ikjen time në Perëndim.

nga Shkollat EBE...



nga Shkollat EBE...

### Jeta në Prishtinë

Një nga pjesët më interesante të librit tim, është ajo që përshkruan jetën e fëmijërisë dhe rinisë sime në Prishtinë. Që nga viti 1968, në Prishtinë ka qënë festa. Mbase keni më shumë kohë për të lexuar pak faqe nga pjesa e tretë e librit tim autobiografik. Do të mësoni mbi disa ngjarje të fëmijërisë dhe të rinisë sime që kanë shenjuar gjithë jetën që pasoi.

**P**ërsëri po të bëj të ditur lexuesit time në shtet, si shpreh të vërgjërisë që në këtë vend të ndalohet për një çast dhe të bëj një rimbujtimin dhe për t'iu tërhequr dhe të shpreh shpreh. Lëvizja e ditës të ditës për të tërhequr, në përdorim nuk ka qënë pak, këtu e them përsëritë, keni, sepse zotërimi i ditës dhe e bashkëveprimi që përshkruan jetën e rinisë sime për një pjesë të jetës sime. Për, për të tjerë, keni pasur njëkohësisht interesin specifik të ashpërimit të jetës sime. Mëqëntas, kësaj jame në një mënyrë që kaq shumë nga ditët e jetës sime, në një mënyrë që mund të jem i këmbëngulës ndaj tyre ngjarjet, të cilat keni qënë të përbërësve të jetës sime të jetës sime.

Nga fëmijëria më, mend të gjë, që në ditën përjetësisht jetë mbase e para, tërhequr e rinisë sociale dhe ekonomike e Kosovës, dhe, e dita, frymë shtet, e një bashkëpunimi, të cilat këtu, dhe para përjetësisht, në një mënyrë që mund të jem i këmbëngulës ndaj tyre ngjarjet, të cilat keni qënë të përbërësve të jetës sime të jetës sime.

nga Shkollat EBE...



nga Shkollat EBE...



Behgjet Pacolli në Prishtinë, vitet 1960.

Siç e keni parë, në këtë libër, keni parë një pjesë të jetës sime të rinisë sime. Në një mënyrë që mund të jem i këmbëngulës ndaj tyre ngjarjet, të cilat keni qënë të përbërësve të jetës sime të jetës sime.

Siç e keni parë, në këtë libër, keni parë një pjesë të jetës sime të rinisë sime. Në një mënyrë që mund të jem i këmbëngulës ndaj tyre ngjarjet, të cilat keni qënë të përbërësve të jetës sime të jetës sime.

Siç e keni parë, në këtë libër, keni parë një pjesë të jetës sime të rinisë sime. Në një mënyrë që mund të jem i këmbëngulës ndaj tyre ngjarjet, të cilat keni qënë të përbërësve të jetës sime të jetës sime.



Behgjet Pacolli me familjen në Prishtinë, vitet 1960.

Siç e keni parë, në këtë libër, keni parë një pjesë të jetës sime të rinisë sime. Në një mënyrë që mund të jem i këmbëngulës ndaj tyre ngjarjet, të cilat keni qënë të përbërësve të jetës sime të jetës sime.

360

13 comments 17 shares

 Behgjet Pacolli ✓  
21 April 2014 ·  ...

"Eksperti i sigurisë, Naim Maloku, është bërë pjesë e Aleancës Kosova e Re, të zëvendëskryeministrit, Behgjet Pacolli."

Lexo me shumë: <http://www.telegrafi.com/.../naim-maloku-aderon-ne-akr-2...>



 1.1K  45 comments  15 shares

 Behgjet Pacolli ✓  
21 April 2014 ·  ...

"Aleanca Kosova e Re ka vendosur të hyjë e vetme në zgjedhjet e reja parlamentare. Lideri i kësaj partie, Behgjet Pacolli ka bërë të ditur se AKR nuk do të garojë në koalicion parazgjedhor dhe me programin e saj që bazohet kryesisht në zhvillim ekonomik."

"Programi i AKR-së i vitit 2007, i përsëritur në vitin 2009 dhe 2010, ka qenë program dinjitoz të cilin sot edhe partnerët tanë tentojnë ta kopjojnë por, pas atij programi ka një logjistikë dhe një eksperiencë ku qëndrojnë njerëz që dinë ta implementojnë"

TOP-CHANNELTV 

AKR, e vetme në zgjedhje

 271  10 comments  7 shares



Gjykata speciale s'është çudi që na ra nga qielli

Sot Kuvendi i Kosovës pritet të miratojë themelimin e një Gjykate speciale që ngrihet mbi bazën e pretendimeve të një raporti të Këshillit të Europës dhe gjetjeve të prokurorit amerikan Uilliamson.

Kjo nuk është një ngjarje e zakonshme që ndodh çdo ditë. Ajo nuk është produkt i politikës sonë ditore. Për këtë vendim janë investuar nivelet më të larta të Bashkimit European, të SHBA-ve, pra miqve tanë ndërkombëtarë. Ky vendim me pasojat që do të prodhojë, është një ngjarje me rëndësi ndërkombëtare. Ky vendim nuk është thjesht ngjarje me rëndësi kosovare, pra brenda kufijve tanë. Si e tillë, kjo ngjarje nuk mund të shihet si ngjarjet e përditshmërisë sonë, së fshatit tonë, të katundit tonë, të komunës sonë.

Rreth kësaj ngjarjeje, ashtu si dhe shumë të tjerave kur kemi përfshirje ndërkombëtare, në politikën kosovare ka tre qasje kryesore. Njera që vazhdon t'i shohë si ngjarje me rëndësi vendore. Kjo është qasje miope. Një qasje tjetër i kundërvihet ndërkombëtarëve, gjejmë aleatëve tanë duke përjashtuar çdo veprim apo përfshirje të tyre në jetën tonë politike dhe institucionale. Kjo qasje është irrealiste dhe mosmirënjohëse. AKR-ja ka një qasje tjetër : përfshirëse, pajtuese të interesave tona me ato të miqve tanë ndërkombëtarë.

Mjerisht qasja miope, irrealiste, mosmirënjohëse ka dominuar shpesh politikën kosovare në raport me ngjarje që kanë rëndësi ndërkombëtare. Ne kemi parë në mënyrë

miope ose irrealiste dhe raportin famëkeq të Dik Martit kur u prezentua në Këshillin e Europës. Përballë atyre që e panë me këtë qasje të ngushtë, ne si AKR-, unë personalisht e pamë ndryshe. E pashë si ngjarje me pasoja të rënda ndërkombëtare dhe kërkova reagim të fortë kombëtar. Kërkova tryezë mbarëkombëtare partish të udhëhequr nga kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, tryezë që të formulonte qëndrim unik ndaj akuzave që prekin jo thjesht Kosovën, Shqipërinë, por dhe Perëndimin, aleatët tanë. Kërkova që Shqipëria, shqiptarët të harmonizonin qëndrimin tonë me atë të perëndimit duke ia bërë të qartë unitetin e pozicionit tonë kombëtar. Nuk mora përgjigje. Kërkova prej të përmendurve në raport, drejtues qeveritarë ose jo, që të më jepnin mandat për të ndjekur penalisht në Zvicër për shpifje autorin dhe frymëzuesen e raportit, gjegjësisht Dik Marti dhe Karla Del Ponte. Nuk ma dhanë një prokurë dhe kështu mbeta në nivelin e denoncimeve në mediat ndërkombëtare.

Gjatë 15 vjetëve të lirisë sonë ne nuk jemi marrë seriozisht me dokumentimin ndërkombëtar të krimeve të kryera ndaj nesh, ndaj jetës së 12 mijë qytetarëve të vrarë, dhunimeve të grave, shkatërrimit të xhamive, dhe objekteve tona të kultit, shkatërrimit të shtëpive, dhe ekonomisë sonë, zhdukjes së mijëra qytetarëve. Ne jemi mjaftuar me konferenca vendore, me akademira solemne, me ndeja pa kurrfarë jehone ndërkombëtare. Serbia nuk ka bërë kështu, ajo nuk ka ndenjur duarkryq. Ajo është përpjekur ta rëndojë peshoren e drejtësisë nga ana e kriminelit.

Ashtu si në një lojë sportive, nëse ti nuk sulmon atëherë të sulmon tjetri, dhe do të duhet të mbrohesh. Kështu kemi mbërritur në ditën kur Kuvendi do të marrë vendimin për themelimin e kësaj gjykate speciale. Nëse atëherë dhe sot do të mendonim ndërkombëtarisht, do të kishim vizion, me gjasë nuk do arrinim në ditën e sotme.

Prej ditës së sotme

Kuvendi do duhet të vendosë sot thujse symbyllur rreth një vendimi kaq të rëndësishëm që siç e thashë më sipër ka karakter ndërkombëtar. Deputetët nuk dinë kurgjë rreth tekstit që do t'i nënshtrohet për vendim, deri para pak orësh. Ata nuk kanë mundësi të bëjnë kurrfarë debati ose amendimi në tekstin që do votohet. Është krejt e qartë se për shkak të mosanëtarësimit të Kosovës në OKB, ne s'mund të nënshkruajmë një marrëveshje ndërkombëtare me BE-në, që do të parashikonte themelimin e kësaj gjykate. Për shkak se s'jemi anëtarë të OKB-së, me gjasë gjykimi i këtyre krimeve të pretenduara s'mund të ndodhë as nga Gjykata Ndërkombëtare Penale e krijuar mbi bazën e Statutit të Romës të 1998-ës. Por në këtë « dhurim të sovranitetit » për Bashkimin European, në kuadër dhe të raportit që ne kemi me EULEX-in, nuk ka kurrfarë diçkaje të jashtëzakonshme. Sipas Statutit të Romës, GJNP e cila ka hyrë në fuqi tashmë, mund të hetojë dhe të gjykojë për krime lufte qytetarë të zakonshëm, por edhe burra shteti që s'kanë imunitet përballë saj, nëse një vend anëtar nuk don apo nuk ka mundësi ta bëjë këtë. Pra kjo që po ndodh në Kosovë nuk është një dhurim i paprecedent sovraniteti. Ne thjesht për shkak se nuk jemi anëtarë të OKB-së, jemi të detyruar të zgjedhim forma të tilla të veçanta funksionimi të një gjykate. Ne do duhet të bashkëpunojmë me faktorin ndërkombëtar i cili përballë Serbisë, përballë shteteve të tjera aleatë të saj, duhet të tregojë paanësi. Pas mbylljes së kësaj gjykate ne do të kemi të drejtë të mbajmë kokën lart për sjelljen tonë gjatë luftës së Kosovës. Pranimi i kësaj Gjykate në kuadër të zgjatjes së mandatit të EULEX-it, është dhe një lloj parakushti që Kosova të pranohet si shtet dhe prej anëtarëve të tjerë të BE-së që nuk na kanë njohur. Do kryenim një hap që na e detyrojnë dhe për shkak të anëtarësimit tonë në BE.

Pasi shpjegova qasjen tonë si AKR, që është qasje inkluzive, pajtuese me perëndimorët, megjithatë ka vend për ndonjë kritikë për ndërkombëtarët, por dhe për ata që ne emër të shtetit të Kosovës kanë negociuar për këtë institucion të ri.

Mungesa e transparencës në lidhje me ligjin apo korrespondencën për themelimin e kësaj Gjykate, është shumë e dëmshme. Ajo është fyese për integritetin e deputetëve, për ndërgjegjen tonë shoqërore dhe politike. Ajo është fyese për mendimin profesional shkencor të juristëve dhe profesorëve tanë. Ky është një gabim që përsëritet shpesh, ashtu siç është bërë më së fundi me përmbajtjen e negociatave me Serbinë. Mungesa e transparencës prodhon më shumë mitologji antieuropiane dhe antiperëndimore, më shumë qasje provinciale në mes të politikës dhe shoqërisë sonë. Do të krijojë më shumë fabula, përralla dhe legjenda tipike në një vend ballkanik si tonin. Do të krijohet më shumë hapësirë për qasjen e dytë, atë kundërshtuese ndaj bashkëpunimit me ndërkombëtarët.

Në një situatë si kjo, kur deputetët s'dinë asgjë për përmbajtjen e këtij ligji, objektin e gjykatës, statutin e saj, garancitë, etj, na lind e drejta që rreth saj të ndërmarrim gjithë veprimet e duhura për të verifikuar përputhjen e ligjit me Kushtetutën. Në emër të qasjes pajtuese, bashkëpunuese me ndërkombëtarët, ne do ta votojmë ligjin. Por ne do të kujdesemi deri në fund, për kushtetutshmërinë dhe transparencën e proceseve të tilla që s'janë as të parët, dhe s'do jenë as të fundit.

AKR si dhe më parë do të tregojë se i parasheh ngjarjet. AKR e di se votimi i sotëm, se Gjykata nuk na ka rënë nga qielli. AKR do ta tregojë se është gjithmonë për bashkëpunim me aleatët tanë perëndimorë. Por AKR do të tregojë si gjithmonë se ky bashkëpunim duhet të jetë dinjitoz dhe jo me symbyllur. Vetëm kështu do të jetë më i fortë dhe kurrë nuk do të errësohet nga askush.

Nga Behgjet Pacolli.

 134

17 Comments 24 Shares





Behgjet Pacolli

23 April 2014 · 🌐

...

Ju i dini qëndrimet e mia nëpërmjet kolumnës së djeshme. Sot i ndoqa me vëmendje fjalimet në Kuvendin e Kosovës. Si zakonisht AKR tregoi se nuk don të fitojë vota duke ju kundërvënë bashkësisë perëndimore në çdo rast dhe për çdo gjë. Pati ndonjë parti që duke e ditur që rezultati i votimit do ishte PËR, nxorën thesin për të fituar vota. Pse e them këtë?

Dikush sot ftoi që të bashkërendojmë qëndrimet kundërshtuese me Kuvendin e Shqipërisë. Jo zotërinj, jeni vonë. Ku ishit ju kur unë 3 vjet më parë i bëra të njëjtën thirrje Sali Berishës që ta bënte këtë bashkërendim? Apo pse isha unë dhe jo ju që e bëra ftesën për Sali Berishën?

Dikush tjetër tha të bëjmë një Gjykatë për krimet e Serbisë. Shumë vonë dhe për këtë. Edhe në letrën për Sali Berishën, dhe në intervistat e mia për mediat ndërkombëtare e kam thënë: kemi neglizhuar në të parët dokumentimin e krimeve monstruoze serbe. Jemi marrë me akademi solemne, por jo me mbledhje faktesh për t'i paraqitur në Gjykata Ndërkombëtare.

Dikush thotë që kjo që po i ndodh Kosovës është diçka e paprecedent. Jo aq shumë zotërinj. Shikoni statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Nëse Kosova do ishte anëtare e OKB-së, atëherë s'do të kishte asnjë pengesë që këto krime të gjykoreshin atje nga gjyqtarë ndërkombëtarë dhe jashtë Kosovës. Krimet e luftës janë të paparashkrueshme. Sot sipas vendimit përkundrazi, krimet e pretenduara do të gjykoen brenda Kosovës, me ligjet e saj.

Në hodhëm idenë që inisiativa si kjo e Tribunalit, duhet të diskutohen gjerësisht në shoqëri, nga profesorët tanë, nga universitetet. Kuvendi duhet të debatojë. Prej debatit, shoqëria del më e qetë dhe më e qartë. Këtu është një faj i ndërkombëtarëve. Ata e neglizhojnë dobinë e transparencës në Kosovë, duke harruar që mungesa e saj në shoqëri si e jona, për çështje kaq të ndijshme krijojnë mitologji antiperëndimore. Kjo është e pafalshme: Kosova e çliruar prej Perëndimit s'mund të jetë kundër Perëndimit sot 15 vjet më vonë prej lirisë sonë.

Institucionet tona, Presidenca, negociatorët me bashkësinë ndërkombëtare duhet të ishin më transparentë. Ata duhet të kishin këmbëngulur që objekti i punës i kësaj gjykate të ishte mbi bazën e parimit të territorit, pra për gjithë Kosovën. Ajo s'mund të jetë për të dënuar krime monoetnike, por të të gjithëve atyre që kanë bërë krime, pavarësisht etnisë.

Në duam të dimë: a është kushtetuese e gjitha kjo? Kushtetutshmëria duhet të konstatohet prej Gjykatës Kushtetuese, e cila s'mund të merret vetëm me çështje private, apo me diskutime pa vlerë. Çështja e sistemit të drejtësisë është themelore.



👍 296

9 comments 17 shares



Behgjet Pacolli

24 April 2014 · 🌐



Ja pasqyrimi i kolumnës sime për Gjykatën në mediat e Kosovës:

<http://www.telegrafi.com/.../pacolli-gjykata-speciale-nuk...>

<http://koha.net/?id=27&l=7362>

<http://www.albeu.com/.../pacolli-gjykata-speciale.../149813/>

<http://www.sot.com.al/.../pa%C3%A7olli-gjykata-speciale...>

WWW.TELEGRAFI.COM



**Pacolli: Gjykata Speciale nuk është ngjarje e zakonshme**

Kryetari i AKR-së dhe zv/kryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli, thotë se nesër Kuvendi i Kosov...

👍 218

11 comments 6 shares



Behgjet Pacolli

24 April 2014 · 🌐

...

### Strategji gjithëshoqerore kunder korrupsionit

Tash kur është krijuar Gjykata Speciale e cila do të merret me krimet e shumë ekspozuara të luftës ka ardhur koha që pjesa tjetër e EULEX-it të fokusohet dhe të na ndihmojë në luftimin e krimeve ekonomike.

Askush nuk e mohon se nuk ka pajtim dhe nuk ka qetësi pa u zbardhur dhe pa u vendosur drejtësia në secilin krim të luftës, mirëpo asnjë vendi, dhe as Kosovës nuk i lejohet që duke u marrë me të kaluarën ta harrojë të tashmen. Nuk bënë sepse kështu po humbet e ardhmja. Misioni i EULEX-it duhet të vazhdoj strukturimin ashtu siç është paraparë nga ekspertët duke krijuar një ekip të tërë prokurorësh që do të merren ekskluzivisht me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës mund të jetë adresa por edhe kjo prokurori duhet të mbështetet me lehtësirat e nevojshme.

Kurrë më shumë se tash, nuk ka pasur nevojë që ne liderët e partive politike, përfaqësuesit e shoqërisë civile, përfaqësuesit e medias dhe përfaqësuesit e tjerë relevant të mblidhemi rreth një platforme të përbashkët kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Krimi nuk kanë qenë e as nuk është traditë e shoqërisë sonë.

Prokurorët e EULEX-it duhet të lirohen nga presioni publik, derisa ne duhet të zotohemi se secili zyrtarë, në cilëndo pozitë që është, i cilëndo parti qoftë, nëse do të jetë subjekt i hetimeve, të largohet nga funksioni të cilin e ushtron.

Askush, nuk ia mohon askujt të drejtën e dëshmimit të pafajësisë, por kjo përballje duhet të bëhet individualisht pa bartur asnjë peshë institucionale.

Vetëm kështu, krijohet kultura e ndëshkimit të së keqes.

👍 201

12 comments 4 shares



Behgjet Pacolli

April 25, 2014 · 🌐



Besoj e morët vesh që lojtari i njohur shqiptar, Adnan Januzaj ka zgjedhur Belgjikën si ekipin kombëtar me të cilin do të luajë në të ardhmen.


Besoj se jeni gëzuar ndërkah se Majlinda Kelmendi u shpall kampione e Europës. Ajo është krenare që përfaqëson Kosovën dhe flamurin e saj në arenën botërore.

Doja të merresha pak më shumë me çështjen e Adnanit. Ky vendim është vendim posaçërisht i tij qoftë si vendim personal, qoftë si vendim familjar. Ne na duhet thjesht ta respektojmë atë, pa e kritikuar.

Është krejt e qartë se në marrjen e këtij vendimi kanë peshuar shumë arsye dhe shumë faktorë ekzistencialë, sportivë dhe komercialë. Ato kanë dominuar mbi thirrjen e gjakut dhe të shpirtit që me siguri ka qenë dhe mbetet e fortë tek familja Januzaj që njoh unë. Për këtë arsye unë besoj shumë se kudo që Adnani të luajë do na nderojë ne, Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar, duke e lartuar emrin e shqiptarit njëjtë sikur Shaqiri, Xhaka, Behrami.

Më vjen keq që ne s'arritëm që ta shndërronim Adnanin në gjithë kuptimet, një simbol të rinisë sonë, të afrimit të saj me sportin, të imazhit tonë kombëtar në arenën botërore. Përpjekjet e mia të shumta për ta zgjidhur problemin e afrimit të Adnanit në kombëtaren e Shqipërisë apo të Kosovës, duke adresuar të gjithë faktorët ekzistencialë, sportivë, dhe komercialë nuk dhanë dot përfundim pozitiv. Askush s'më ndihmoi në këtë drejtim. Disa i keqkuptuan propozimet e mia. Por është krejt e qartë siç e thashë më sipër se në vendimin e tij kanë peshuar pikërisht ata faktorë që unë doja t'i zgjidhja në propozimet e mia.

Unë s'dorëzohem megjithatë. Kam besim se kombi shqiptar i ndarë nëpër botë apo në viset e tij etnike do të prodhojë Adnanë të tjerë. Siç e thashënë krye të herës, ndërsa Adnani iku, Majlinda vazhdon të na bëjë krenarë! Ndaj ne si shtete, si komb do duhet të mendojmë që tani për zgjidhje tërësore që të adresojnë të gjithë ata faktorë që na e larguan Adnanin, por dhe që duhet të respektojmë kampionë si Majlina. Kështu s'do dëshpërohemi më si tani dhe do të kemi ekupe kombëtare të forta në çdo sport! Do kemi zgjidhje ligjore për të gjithë talentet dhe jo zgjidhje ad hoc për individë.



👍 391

66 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli  
25 April 2014 · 🌐

...

Jam shumë i lumtur që idetë për të cilat kemi luftuar tash sa mot po nisim e jetësohen. Menjëherë pas takimit të Kukësit në 16 prill, sot kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, të cilin e përgëzoj për qasjen proaktive njoftoi disa masa për Unionin Ekonomik Kombëtar, për heqjen e doganave, çmimeve të referencës, krijimin e institucioneve të tjera të përbashkëta mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Shikoni linkun <http://www.panorama.com.al/.../doganat-rama-heqje.../>



PANORAMA.COM.AL

### Doganat, Rama: Heqje çmimeve të referencës me Kosovën

TIRANE- Lehtesira gjate procedurave doganore, heqje te cmimeve te references me Kosoven d...



Behgjet Pacolli  
25 April 2014 · 🌐

...

Më kanë revoltuar shumë deklarimet e fundit në mediat botërore të ashtuquajturës Prokurore për krimet e Luftës në ish Jugosllavi, Karla Del Ponte, pas votimit në Kuvend të ligjit për Gjykatën speciale. Ky njeri aq shumë i mallkuar prej shumë familjeve të dëmtuara prej saj, kudo ku ka punuar, shprehte zhgënjimin për këtë votim dhe thoshte se kurrë nuk do arrihet prej kësaj Gjykate. Pasi që nuk ja arriti qëllimeve të veta për t'u involvuar në funksionimin e saj, zonja Del Ponte vazhdoi me qasjen e vet destruktive kundrejt popullit shqiptar, kundrejt viktimave të luftës së Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës, kundrejt kombit shqiptar të cilin ajo e ka përbaltur në jo pak raste..

Dihen lidhjet e saj me Beogradin, lidhjet e saj me Dik Martin. Dihet se libri i saj plot fantazira, plot frustrim ndaj një karriere që nuk u ngrit dot mbi viktimat ishte në themel të raportit famëkeq kundër Kosovës dhe kombit shqiptar, kundër aleatëve perëndimorë të NATO-s, që tre vjet më parë u miratua në Këshill të Europës.

Sot ajo ka arsye të zhgënjehet. Sot Kosova i ka kapacitetet e saj me gjykuar keqbërjet e kohës së luftës dhe të paqes. EULEX-i, ndaj të cilit zonja së bashku me Dik Martin shprehën dyshime se mund të zhvillonte hetime të drejta, i ka këto kapacitete. Dy autorët e raportit si frymëzues dhe hartues të tij nuk mund të përcaktojnë tashmë fatin e hetimeve dhe gjyqimeve, të cilat do i japin të drejtë luftës sonë e cila ishte përgjithësisht e mbështetur në rregullat ndërkombëtare të konflikteve. Si dikush që ka qenë vazhdimisht i angazhuar për të vendosur drejtësi kundër këtyre autorëve në Zvicër apo kudoqoftë, mbetem plot besim në zhvillimin e mëtutjeshëm të drejtësisë në Kosovë.

👍 242

16 comments 8 shares

 Behgjet Pacolli   
26 April 2014 · 

Intervistën time me Gazeten Express mundeni të lexoni këtu:  
<http://www.gazetaexpress.com/.../interviste-me-behgjet.../>



 902  24 comments  17 shares



Behgjet Pacolli

26 April 2014 · 🌐

...

Në vizitën e zv.Kryeministrit njëherit Presidentit të AKR-së, me bizneset të cilat veprojnë në Komunën e Pejës.

"Edhe njëherë theksojë se Pejës duhet ti kthehet nami i dikurshëm, nuk premtoj por shumë qart një program nga i cili në rast se qytetarët do ti japin AKR-së fuqinë ekzekutive, do të krijojë rreth 15.000 vende të lira pune në Komunën e Pejës për një periudh katër vjeçare."



👍 421

21 comments 8 shares

 Behgjet Pacolli   
27 April 2014 ·  ...

Nga vizita e zv.Kryeministrit, njëherit Presidentit të AKR-së, nga takimi me bizneset të cilat veprojnë në Komunën e Pejës, veçojmë mesazhin:

"Edhe njëherë theksoj se Pejës duhet t'i kthehet nami i dikurshëm! Nuk premtoj, por shumë qartë ju garantoj një program nga i cili në rast se qytetarët do t'i japin AKR-së fuqinë ekzekutive, do të krijojë rreth 15.000 vende të lira pune në Komunën e Pejës për një periudhë katër vjeçare."

Admin



**Peja me AKR**

**Do krijojmë 15 mijë vende pune!**

 744 40 comments 27 shares





Behgjet Pacolli

27 April 2014 · 🌐 · 🌐



Lavdi gjithë të rënëve për Lirinë e Kosovës!



Albion Rexhepi and 2.4K others

36 comments 30 shares



Behgjet Pacolli

27 April 2014 · 🌐

...

Gjakova është një vend martirësh dhe njera nga komunat e Kosovës ku është derdhur më shumë gjak për një pëllëmbë tokë. Nëse nuk i nderon martirët shpesh, jo thjesht në përvjetorë, apo me akademi përkujtimore, nëse nuk i kujton përditë, nëse nuk e dokumenton historinë e tyre individuale dhe familjare, qoftë për historinë, qoftë për gjyqin e drejtë, fillon dhe ambientohesh me qetësinë e lirisë dhe rehatin e harresës. Kështu na ka ndodhur pak në Kosovë, ndërsa mbërritëm në momentin e krijimit të gjykatës speciale. Nëse ne do i kishim dokumentuar për t'i paraqitur në gjyqet ndërkombëtare gjithë këto histori vrasjesh makabre në mes të Europës, sot historia do ishte krejt ndryshe.

Mimoza Kusari Lila me punën e vet të jashtëzakonshme për të ndërtuar të ardhmen e Gjakovës, asnjëherë nuk le mënjanë nderimin për të rënë. Ajo na thirri bashkë me Agim Bahtirin e Mitrovicës, me Bernard Nikajn, ministrin tonë, me shumë miq, të marrim pjesë në marshimin paqësor të Mejës. Duke patur në sytë tanë varret dhe lapidarët e tyre, ne s' do harrojmë kurrë ku i ka themelet liria dhe pavarësia që kemi sot!





👍 817

16 comments 10 shares





Behgjet Pacolli   
28 April 2014 · 

...

Sot nëpër mediet dhe portalet e Kosovës, po qarkullon lajmi se gjoja unë paskam dërguar dikend Jakup Krasniqit, "për t'ia blerë votën e tij".

Unë jam i detyruar të merrem me të për shkak të funksionit që ai aktualisht e mban, ngase me të personalisht nuk do të merresha prejse kur e ka përbuzur sofrën time në gusht të vitit 1999 në Lugano.

E kuptoj nevojën që zoti Krasniqi ka, për më shumë promovim mediatik dhe sinqerisht, duke u nisur nga një logjikë e shëndoshë nuk do t'ia vliente kursesi që unë të merresha me të.

Opinion publik, e informoj se tanimë jam kalitur me akuza shpifëse në adresën time, që nga koha kur kam ardhur në Kosovë dhe shpifjet e Jakupit i konsideroj si të radhës.

Unë i them atij se ka bërë gabim të madh dhe shkelje nën betim që nuk e ka denoncuar këtë shpifje nëse ai e konsideron fakt.

Do të ishte mirë, që organet kompetente të merren me këtë punë, ngase tingëllon e rëndë që një kryeparlamentar i një shteti të civilizuar të gënjen.

Për hirë të opinionit publik, me përgjegjësi morale dhe materiale, deklaroj se asnjëherë nuk kam kërkuar favore nga Jakup Krasniqi dhe do të isha shumë i lumtur që kjo të ndodhë edhe në të ardhmen.

Nga këtu po i drejtohem me një adresim, "Jakup ti je i frustruar për arsytet të cilat ti vet i di".

Sa më përket mua, unë i bëj thirrje prokurorisë vendore dhe të Eulex-it, që ex officio që të hapë hetime rreth deklaratës së Jakup Krasniqit. Nëse kjo mungon, unë do të ushtroj kallxim penal ndaj Jakup Krasniqit.

 615

45 comments 18 shares



Behgjet Pacolli   
28 April 2014 · 

...

Lugu i Baranit Komunë!

Pas një takimi miqësor me përfaqësuesit e Fshatit Rashi të Lugut të Baranit, vizitova disa herë këtë anë, me të vetmin qëllim që të përkrahën këta banor shumë punëtor, me të cilët dikur është krenuar e gjithë Kosova me prodhimet e tyre.

Edhe pse Lugu i Baranit, ka mbi 30 mijë banorë me 15 fshatra, nuk ishte investuar asnjë metelik nga Qeverisjet Komunale.

E vetmja kërkesë e tyre ishte që ti kthehet nami i dikurshëm që Barani të formohet komunë në vete. Edhe pse dikur kishte qenë njëra prej komunave më të zhvilluara në Kosovë.

E mbështeta fuqishëm këtë iniciativë të banorëve të Lugut të Baranit, duke premtuar angazhim maksimal që të Jetësohet kjo e drejt themelore e këtyre banorëve.

Jam shumë i kënaqur me shtrirjen e AKR-së në Lug të Baranit, për me pak së një muaj kemi formuar tetë nëndegë, të cilat do ta formojnë degën e Lugut të Baranit.

 162

4 comments 11 shares



**Behgjet Pacolli** ✓

28 April 2014 · 🌐



Të dashur miq, Më ndiqni sonte në RTK në emisionin SUBVENCION! I mirëpres sugjerimet tuaja.  
Emisioni fillon ora 21:00.



👍 629

21 comments 10 shares



Behgjet Pacolli

28 April 2014 · 🌐

...

Besoj e patë prezntimin tim në emisionin « Subvencion », në RTK. U përpoqa të jem sa më i qartë për ju. U mundova të tregoj drejtimet kryesore të programit ekonomik të AKR-së.

Unë jam i bindur se Kosova në drejtimin e AKR-së, tash kur janë provuar të gjithë forcat kryesore politike, do të arrijë suksese të mëdha. Do të ketë ngritje të madhe të prodhimit të brendshëm. Do të ketë zhvillim ekonomik dhe punësim të rinisë. Do të ketë trajtim zhvillues të pronës shoqërore dhe publike të Kosovës.

Do të ketë zgjidhje përfundimtare dhe menagjim të suksesshëm për Trepçën duke e shndërruar atë në një kompani që brenda 6-7 vjetësh do të kushtojë 10 miliard euro. Do të ketë zgjidhje për problemin e energjisë. Do të ketë zhvillim të bujqësisë me teknika moderne dhe menagjim profesional të saj.

Duhet të kuptoni se këto projekte tonat mund të realizohen vetëm nëse AKR do jetë forcë përcaktuese në zgjedhjet e ardhshme. Çdo thotë kjo? Do të thotë që AKR duhet të imponojë programin e vet ekonomik dhe njerëzit e saj në qeverisjen e ardhshme. Pra krejt ndryshe nga tani kur ne kemi imponuar shumë pak në këtë qeverisje.



AKR nuk premtan kot si po bën dikush. Ju e patë sqarimin tim alternativ për Fondin e punësimit, që është e kopiuar prej idesë sonë të kahershme të vitit 2007. Menagjimi sipas nesh do jetë krejt tjetër, duke ju drejtuar kapitalit të lirë financiar në botë.

Na jepni besim maksimal, tash që i keni provuar të gjithë, partitë e luftës dhe ato të rezistencës paqësore. Me ne është e sigurt se do të ketë prosperitet dhe zhvillim ekonomik! Por na duhet besim. Na duhen shumë më shumë vota sesa na keni dhënë sot!





👍 607

34 comments 21 shares

 Behgjet Pacolli ✓  
29 April 2014 ·  ...

Së bashku me Fadilin, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Damianin, homologun e tij të Shqipërisë në Tiranë në Forumin e Industrisë dhe Energjisë.

Është e fuqishme ajo ide, koha e të cilës ka ardh! Unioni Ekonomik Kombëtar nuk është më ide që ne e kemi shpallur më herët! Po synojmë një qasje të re përbashkuese për industritë tona dhe energjinë kombëtare!

 161  7 shares

 Behgjet Pacolli ✓  
29 April 2014 ·  ...

Të ndërtohet linja hekurudhorë, kompani ajrore të trevave shqiptare

Pacolli është shoqëruarj nga kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe zyrtarë të tjerë të partisë.

Kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, me të parë tubimin madhështorë në fshatin Hajvali u ka thënë qytetarëve se kjo tregon se AKR do jetë parti fituese në këto zgjedhje. “Kur po shoh qytetarë në masë kaq të madhe që janë bashkuar me AKR-në drejt fitores, po bindem thellë se partitë tjera si ajo e Thaçit, kanë humbur thellë”, tha Bahtiri. Kryetari i AKR-së, dega e Gollakut, Islam Pacolli, u ka bërë thirrje qytetarëve që ta votojnë AKR-në, me qëllim të zhvillimit të zonës të lënë pasdore për 15 vjet. “Me AKR-në Gollaku do zhvillohet si kurr më parë”, ka thënë ai.

[#NAKRYJMËPUNË](#)




1.3K

25 Comments 35 Shares





 **Behgjet Pacolli** ✓  
May 30, 2014 · 🌐

Presidenti Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin e degës së AKR -së në Shtime.  
Ora 12:00



BEHGJETPACOLLI.COM  
**Presidenti Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin e degës së AKR -  
së në Shtime. | Behgjet Pacolli**

 307 4 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

May 30, 2014 · 🌐

...

Universiteti POLIS organizon ceremoninë e dhënies së Çmimit Special "Lidershipi Shqiptar 2014". Behgjet Pacolli vlerësohet nga Co-PLAN për angazhimin në njohtet e Kosovës në botë, për sipërmarrjen e suksesshme në ndërtim e zhvillim, për angazhimin qytetar dhe politik, për misionet humanitare për zgjidhjen e krizave të pengjive, dhe promovimin e bashkimit kombëtar përmes ekonomisë dhe integritimit evropian e larg tendencave nacionaliste.

Pritet një pjesëmarrje e gjerë e mediave dhe autoriteteve më të larta nga Shqipëria dhe Kosova.

<http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1293>



Z/Znj. \_\_\_\_\_

Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitati ka kënaqësinë t'ju ftojë në ceremoninë e akordimit të Çmimit Special "Lidershipi Shqiptar 2014" Z. Behgjet Pacolli, Kosovë. Ceremonia do të zhvillohet ditën e premte, dt. 30 Maj 2014, ora 18:00, sala "Magna Aula", Universiteti POLIS, Tiranë.

17.45: Mbërritja (veshje zyrtare).

18.00: Fjala e hapjes nga Z. Dritan Shulina, Drejtor Ekzekutiv i Co-PLAN.

18.10: Dhënia e çmimit "Lidershipi Shqiptar 2014" për Z. Behgjet Pacolli nga Z. Besnik Aliqj, Bordi Drejtues i Co-PLAN

18.15: Adresim i auditit nga Z. Behgjet Pacolli "Lidershipi, Sipërmarrja dhe Shoqëria"

18.30: Koktejl (Kantina "Motown", U-POLIS)

#### Motivacioni:

- Qytetar e politikan aktiv i cili ka kanalizuar energjitë dhe angazhimin e tij publik duke kontribuar për konsolidimin e shtetit, pluralizmit politik dhe demokracisë në Kosovë.
- Sipërmarrës i suksesshëm në fushat e ndërtimit dhe zhvillimit i cili pas një përvoje të gjërë ndërkombëtare është investuar në Kosovë dhe më gjerë në trojet shqiptarëse.
- Mbështetës i iniciativave qytetare-akademike dhe i projekteve zyrtare shtetërore për bashkëpunimin më të mirë mes shqiptarëve, rajonit, dhe sidomos në procesin e integritimit evropian.
- Promotor i nismave së Instituti Co-PLAN dhe Universitetit POLIS për hartimin e një vizioni të përbashkët zhvillimi midis rajoneve Mitrovicë-Pejë-Gjakovë-Prizren dhe Kukës-Krumë-Tropojë.
- Nismëtar për misionet humanitare për zgjidhjen e situatave të krizave, si dhe për ndjeshmëri ndaj përgjegjësive sociale.

#### Mbi "Çmimin Lidershipi Shqiptar":

Për më shumë se 10 vitesh Instituti Co-PLAN akordon Çmimin "Lidershipi Shqiptar" si një instrument për të promovuar vlera dhe shembuj të mirë në shoqëri në fushat e Qeverisjes, Mediave, Shoqërisë Civile dhe Biznesit. Ky çmim ka për qëllim të njohë arritjet qytetare dhe intelektuale të individëve të ndryshëm, të cilët përmes punës së tyre shërbejnë si model pozitiv për shoqëinë, sjellin risi në qeverisje, dhe shfaqin standarte etike në komunikimin publik. Përveç katër kategorive të mësipërme, Co-PLAN akordon edhe "Çmimin Special Lidershipi Shqiptar" për figurat me të spikatura e me impakt të gjerë në gjithë territoret shqiptarëse. Çmimi Special u është akorduar më parë personaliteteve të tjera si: Z. Edi Rama, Shqipëri (2004), Z. Fatmir Sejdiu, Kosovë (2008), dhe Z. Arbën Xhaferri, Maqedoni (2009).



Co-PLAN / Universiteti POLIS, Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar, Tiranë  
Email: [coplan@co-plan.org](mailto:coplan@co-plan.org), Regjistr. ory: +355 (0) 69 4013924 / (0) 69 6089130

👍 312

12 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

May 30, 2014 · 🌐



Më ndiqni sonte në ora 21:00 "drejtpërdrejt apo live" tek Zone e Lirë e Arjan Çanit në TV Klan. Bisedë për familjen, ndërtimtarinë, projektet e mia për të ardhmen e Kosovës.

Repriz të diel në Klan Kosova.

(Video nga nëntor 2013)



YOUTU.BE

Zone e lire - Pacolli; Shqiptari më i pasur në botë! (1 nëntor 2013)

Facebook: <https://www.facebook.com/tvklan> Emision LIVE nga Arjan Cani, cdo te premte 21:00...

👍 353

11 Comments 25 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
May 30, 2014 · 🌐

Unë dhe AKR kemi programin më të mirë për rikthimin e dinjitetit për bujqit e Kosovës. Ne do ti krijojmë platformat agroekonomike ku bujqit do ti kenë të garantuara prodhimet e tyre dhe të ardhurat gjithashtu të garantuara.  
Me këtë model të platformës agroekonomike, ne do ti krijojmë mbi 70 mijë vende pune, vetëm në bujqësi.  
Na kryjmë punë. AKR



 1K  30 Comments  29 Shares



Behgjet Pacolli

May 30, 2014 · 🌐



AKR-ja nuk i gënjyer kurrë qytetarët!

Meqë nuk kemi gënjyer kurrë qytetarët kemi arsye që të kërkojmë votën para qytetarëve", ka thënë Pacolli. Ai para qytetarëve ka thënë se me votën për numrin 40 do të votohet programi më i mirë qeverisës. "Jam i sigurt se ju me votën për numrin 40 do të voton edhe për programin më të mirë për zhvillimin ekonomik të vendit.

#NAKRYJMËPUNË



👍 670

24 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 30, 2014 · 🌐

...

Behgjet Pacolli, lideri i AKR-së nderohet në Tiranë me çmimin special të Leadership-it 2014. Në ceremoni marrin pjesë autoritetet më të larta të shtetit shqiptar, kryetari i parlamentit, kryeministri, përfaqësues të opozitës, të botës akademike, urbanistikës, etj.



BEHGJETPACOLLI.COM

**Behgjet Pacolli, lideri i AKR-së nderohet në Tiranë me çmimin special të Leadership-it 2014. |...**

Në ceremoni marrin pjesë autoritetet më të larta të shtetit shqiptar, kryetari i parlamentit, kryeministri, përfaqësues të opozitës, të botës akademike, urbanistikës, etj.

👍 771

28 Comments 27 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 30, 2014 · 🌐

...

Ndiqni transmetimin drejtpërdrejt të intervistës time në Zone e Lirë në TV Klan.

👍 278

15 Comments 1 Share



**Behgjet Pacolli** ✓

May 30, 2014 · 🌐



Edi Rama: Behgjet Pacolli, një njeri i madh në shërbim të vendit të tij



👍 771

48 Comments 58 Shares



Behgjet Pacolli

May 31, 2014 · 🌐 · 🌐

...

Çfarë ndodh kur një skuadër e dobët ose e re luan në fushën e kundërshtarit që ka skuadër të fortë? Humbja është e sigurt! Zhvillimi Ekonomik është fusha jonë, fusha e AKR-së. Skuadra e AKR-së është skuadra më e fortë prej krejt skuadrave!

Na vjen mirë që të gjithë partitë flasin për Zhvillim Ekonomik sipas ideve tona dhe luajnë në fushën tonë. Por AKR do të fitojë!

#NAKRYJMËPUNË #VOTO40



👍 753

22 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

May 31, 2014 · 🌐

...

Intervista ime e fundit në Ora News

BEHGJETPACOLLI.COM

**AKR vizion të qartë për zhvillimin e Kosovës, të pa korruptueshëm | Behgjet Pacolli**

AKR-ja ka pasur një sfidë. Zgjedhjet u deklaruan shumë vonë dhe filluan në një farë mënyre të pa organizuara. Por sodoqoftë jemi në ditën e tretë të fushatës zyrtare. AKR-ja nuk ka bërë fushatë përpara fillimit të fushatës...

👍 255

2 Comments 9 Shares





Behgjet Pacolli

May 31, 2014 · 🌐



Plani I AKR-së për ringritjen e Trepçës pa investuar asgjë nga buxheti I Kosovës është plani I vetëm për ruajtjen e kësaj pasurie gjigante nga shitja.

Me AKR në qeverisje, Trepça do të mbetet pronë e qytetarëve të Kosovës, dhe do të bëhet kompani me vlerë 10 miliardë euro.

Trepça me planin e AKR-së do ti krijojë Kosovës mbi 15 mijë vende të punës siq ishte dikur.

[#NAKRYJMPUNË](#)



Lindita Nebiu Hyseni and 1.8K others

38 Comments 26 Shares



Behgjet Pacolli ✓

May 31, 2014 · 🌐



Pensionistët kosovarë nuk do të jetojnë më në kushte të mjerueshme. Ato do jenë shtresa e popullsisë më e vlerësuara në Republikën e Kosovës. Pensioni me qeverisjen e AKR-së pas 8 Qershorit, nuk do të jetë më i vogël se 250 euro.

"Unë i di hallet e juaja i di vlerat e juaja, i di brengat e juaj. Prandaj unë sot ju premtoj se nëse AKR udhëheq lokomotivën qeverisëse, pensioni juaj nuk do të jetë më i vogël se 250 euro. Ju do të keni një jetë më të dinjitetshme dhe jo si deri tani që paga juaj nuk ka mbuluar as shpenzimet e medikamenteve."

"Ju e ndërtuat Kosovën, ju i shkolluat gjenerata të shumta, u kujdesët për ta që të kenë shërbime më të mira shëndetësore, e tani tua kthejnë shpinën është turp. Por po u them se tani erdhën ditët e mira edhe për ju. Pas 8 qershorit ju do të jeni prioritet i qeverisë."

#NAKRYJMËPUNË



654

38 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

May 31, 2014 · 🌐



### PROGRAMI QEVERISËS 2014-2018

Të dashur bashkëvendasit e mi,

Ju po merrni në duar bashkë me fjalën time hyrëse, zotimet e mia dhe të AKR-së, programin tim për 4 vjetët e ardhshme në krye të qeverisjes në Kosovë. Ju do të merrni betimin tim solemn para jush: Do t'ju shërbej deri në frymën time të fundit, juve, familjeve tona, fëmijëve tonë që duan të jetojnë në Kosovë si kudo në botë! Ky program është programi që përfaqëson erën e ndryshimit në Kosovë. Kjo erë për AKR-në filloi të fryjë fort në Mitrovicë dhe Gjakovë!

[http://nakryjmepune.com/AKR\\_Programi\\_WEB.pdf](http://nakryjmepune.com/AKR_Programi_WEB.pdf)



👍 449

15 Comments 21 Shares

 **Behgjet Pacolli**   
May 31, 2014 ·  ...

I ftuar i mbrëmjes dje në Ora News, shikim të këndshëm



YOUTUBE.COM 

**Intervista e mbrëmjes, Behgjet Pacolli – Ora News**

 247 8 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐 · 🌐

Axhenda për sot, E diel, 1 qershor

Ora 12:00 – Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin tradicional "Takimet e vendlindjes" në Marec.

Ora 17:00 – Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin me qytetarët e lagjes "Idriz Seferi" dhe ata të "Rrugës Qarkore" në Gjilan. Takimi mbahet në restorant "Doni" në Gjilan.

Ora 18:00 - Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin me qytetarët e Zhegrës. Takimi mbahet në restorant "Katana" në Zhegër.

**NA KRYJMË**  
**PIUNË**



👍 576

17 Comments 13 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
June 1, 2014 · 🌐 · 🌐

Zhvillimi i mirëfilltë ekonomik kërkon lidërsip - Behgjet Pacolli



 Lumturije A. Morina and 1.3K others  57 Comments  67 Shares

# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli added 30 new photos — at Polis University.

June 1, 2014 · 🌐



Universiteti POLIS organizon ceremoninë e dhënies së Çmimit Special "Leadershipi Shqiptar 2014". Behgjet Pacolli vlerësohet nga Co-PLAN për angazhimin në njohjet e Kosovës në botë, për sipërmarrjen e suksesshme në ndërtim e zhvillim, për angazhimin qytetar dhe politik, për misionet humanitare për zgjidhjen e krizave të pengjeve, dhe promovimin e bashkimit kombëtar përmes ekonomisë dhe integritimit evropian e larg tendencave nacionaliste.



👍 615

18 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014



Me një program kushtuar bashkimit ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës ka hyrë në garën për zgjedhjet parlamentare në Kosovë, Aleanca për Kosovën e Re.



382

11 Comments 24 Shares





Behgjet Pacolli

June 1, 2014

Brenda disa vitesh me AKR në krye të qeverisjes Kompleksi Trepça sipas planit tim do vlersohet afro 10 miliardë euro. E sfidoj këdo prej gazetarëve ekonomikë, ekspertëve të partive apo rivalëve të tjerë politikë për kryeshmërinë e këtij objekti apo për ndonjë plan tjetër (nëse kanë)



1K

28 Comments 29 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐



Emocione të mëdha në vendlindjen time Marec. Më vijnë në mend fjalët e një burrështetasi që pasi kishte parë veprat e mia të mëdha anembanë botës pyeste veten se pse Behgjeti është kthyer në vendlindjen e tij? Përgjigja e tij bash e qëlluar ishte: për të prekur dashurinë e njerëzve të tij!! Kishte të drejtë!!



👍 913

20 Comments 18 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014

Bashkë me ministrin Dardan Gashi dhe kryetarin e Mitrovicës Agim Bahtirin vizitova fabrikën e këpurdhëve Fungo FF në Kamenicë.

AKR në planin e vet për ndërmarrësit e vegjël dhe të mesëm parasheh subvencionim dhe sigurim të tregut nëpërmjet brendeve globale.

Ndërmarrësit do ta kenë tregun e sigurtë ndërsa do të ju hapet perspektivë për krijimin e vendeve të reja të punës.



362

8 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐



Partitë tjera po bëjnë fushatë me paranë publike

Partitë tjera sot po bëjnë fushatë me paranë pulike që i marrin si taksa nga ju apo haraq biznesit. Ne as edhe një cent nuk e kemi keqpërdor. Ne nuk i qesim haraq askujt. Paratë që i merren qytetarëve i kthehen qytetarëve në të mirë të publikut.

Nëse gjeni parti tjetër më të mirë, më të ndërgjegjshme dhe me të pastër se AKR-në, unë u them votoni. Por nuk besoj se do të gjeni, e ne jemi dëshmuar se jemi më të mirët.



👍 2.6K

69 Comments 32 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐



Qendrova në Zhegërën e Agim Ramadanit, njeriut që u bë simbol i thyerjes së kufirit që ndante kombin. U thashë atyre që tani në jetësim të idealit të Agimit dhe shokëve të tij, ne do të avansojmë përpjekjet e bashkimit ekonomik me Shqipërinë, si hap i parë drejt zhvillimit ekonomik për kombin tonë. Investitorët e huaj, gjigandët botërorë do të vijnë kur të kemi treg të madh.

Gjithashtu i njoftova me planet tona për krijimin e mbi 70 mijë vendeve të punës në bujqësi përmes platformave agroekonomike. B.P



👍 356

4 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐

...

Sot ditën e 1 qershorit, festën botërore të fëmijëve, dua t'u uroj atyre jetë të lumtur dhe të bukur kudo që jetojnë, në Kosovë, diasporë, në mbarë viset shqiptare. Fëmijët e mi, familja ime, do të jetojnë këtu, fëmijët tanë kanë atdhe Kosovën, ndaj është detyrimi ynë ta bëjmë vendin tonë, një vend më të jetueshëm!

👍 276

6 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐

...

Të dashur miq,  
Me ndiqni sonte në ora 20.15 në RTK ku do të shpalosi programin më të mirë ekonomik të AKR-së.



👍 766

30 Comments 16 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014 · 🌐



Gjilani do të ketë Zonën Industrial më të madhen në rajon

Unë e di pse gjilanasit tash po i bashkohën vizionit të AKR-së. Për ata që nuk e dinë le të dalin dhe të shikojnë në rajonet tjera dhe të shohin se sa janë më larg nga Gjilani. Shikoni infrastrukturën atje dhe shikoni infrastrukturën në komunën e Gjilanit. Unë ju premtoj se me AKR-në, Gjilani nuk do të jetë vend i harruarr.

Në vitin 2007 partitë tjera talleshin me AKR-në që ofronte program ekonomik, sot ata kanë kopjuar mu të njëjtin program. "Ata nuk din sepse, sic thotë miku im nga Mitrovica, liderët e partive tjera në jetën e tyre nuk e kanë ndërtua as edhe një kotec të pulave, e le më t'ja besojmë ndërtimin e shtetit.



👍 545

10 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

June 1, 2014




Sonte u takuam me shumë të rinjë të Prishtinës. Ndër të tjera, me prezencën e tyre na nderuan edhe antarët e familjes Rugova. I falenderoj për kohën dhe takimin miqësor që kishim. Ishte mbrëmje e bukur.



725

14 Comments 8 Shares




 Behgjet Pacolli   
June 2, 2014 · 



Click to expand

0:02 / 0:48

1K 51 Comments 105 Shares

 Behgjet Pacolli   
June 2, 2014 · 


Axhenda ime për sot:  
E hënë, 2 qershor

Ora 10:00 – Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin e degës së AKR – së në Malishevë. Takimi mbahet në Shtëpinë e Kulturës në Malishevë.

Ora 12:00 – Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin e degës së AKR – së në Rahovec. Takimi mbahet në Shtëpinë e Kulturës në Rahovec.

Ora 16:00 – Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin e degës së AKR – së në Prizren. Takimi mbahet në Shtëpinë e Kulturës në Prizren.

Ora 18:00 - Behgjet Pacolli merr pjesë në tubimin e degës së AKR – së në Lipjan. Takimi mbahet në Shtëpinë e Kulturës në Lipjan.

 239 9 Comments 4 Shares

Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli

June 2, 2014 · 🌐



Intervista ime për Deutsche Welle

WWW.DW.DE

Pacolli: AKR ka vetëm një identitet - zhvillimin ekonomik të Kosovës | Ballkani | DW.DE | 02.06.2014

👍 462

14 Comments 14 Shares



Behgjet Pacolli

June 2, 2014 · 🌐



Derisa ishim rrugës për tubimin e radhës në Suharekë, e pash tendën e protestuesve të "Ballkanit" të Suharekës. U ndala dhe bisedova me ta dhe po e përsëris edhe këtu: "Agjensioni Kosovar i Privatizimit nuk është përgjegjës vetëm për këta njerëz që po protestojnë, por ky institucion duhet të hetohet për keqpërdorimet me vite që janë bërë me asetet-pasuritë e Republikës së Kosovës. Pra, AKP-ja duhet të hetohet hollësisht nga dita e parë. Qytetarët e Kosovës janë të varfër edhe për këtë arsye".



👍 488

11 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

June 2, 2014



Plaforma Agroekonomike zhvillon Rahovecin

Me ardhjen në pushtet të AKR-së do të filloj të zbatohen programet ekonomike që krijojnë mijëra vendeve të punës vetëm në bujqësi, nëpërmjet krijimit të platformave Agroekonomike, dhe komplekseve industriale për të cilat e kemi planin e gatshëm. Ky është momenti historik për të dhënë mandatin ideatorëve të zhvillimit ekonomik dhe gjenerimit të punësimit.

#NAKRYJMËPUNË



707

17 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

June 2, 2014 · 🌐



Kosova do të votoje në 8 Qershor për të zgjedhur parlamentin dhe qeverinë e re. "Aleanca Kosova e Re" e Behgjet Pacollit synon të jetë seriozisht pjesë e qeverisë së ardhshme në Kosovë. Në një intervistë për TVSH-në, kreu i kësaj partie, Pacolli, thotë se është i gatshëm për koalicionë zgjedhore me të gjitha subjektet politike në garë. "Aleanca Kosova e Re" e mbështet projektin e saj qeverisë në nxitjen e sektoreve prioritare si bujqësia dhe industria e rende.



👍 470

17 Comments 31 Shares



Behgjet Pacolli

June 3, 2014

...

Sot mundesuaam vënien e gurethemelit të fermes unike në Evropë, për prodhimin e këpurdhave të kultivuar nga Japonia, fabrika Hirano Mushroom me investitore të brendshem ka filluar gurethemelin, ku do të gjejnë pune mbi 5000 njerëz.

Urimë!

#NAKRYJMËPUNË



Fidan Murati and 5.1K others

253 Comments 121 Shares



Behgjet Pacolli

June 3, 2014 · 🌐



Të dashur miq,

Në Mitrovicë në një tubim madheshtore i urova qytetaret e kësaj komune për nisjen e ndertimit të fabrikes se këpurdhave të premtuar nga Kryetari Agim Bahtiri.

Mitrovicasve ju tregova për planet e AKR-së, për Trepçën e cila do ti hap rreth 20 mije vende pune. I sigurova ata qe Trepça nuk do të shitet por do të jete gjithmone e tyre, e qytetareve të Kosovës.

Ne i treguam Mitrovices se AKR i mban fjalet, i mban premtimet.

Pas fillimit të ndertimit të fabrikes se pare të këpurdhave, kryetari Bahtiri me mbështetjen e fuqishme nga unë, është i angazhuar qe të hap edhe kater fabrika të tjere të cilat në total do të punesojne mbi 15 000 mije punetore.

AKR është parti qe mban fjalen. #NAKRYJMËPUNË




754

28 Comments 20 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
June 3, 2014 · 🌐

Isha për ngushëllim në familjen të ndjerit Fatlum në Bllagoj të Pejës. Ju shpreha ngushëllimet e mia më të sinqerta, dhe pata një ndjesi se mes nesh do të lindë një miqesi e fortë që do të vazhdojë në të ardhmen si e don tradita shqiptare.

👍 417 12 Comments 6 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
June 4, 2014 · 🌐



👍 Fidan Murati and 1.9K others 52 Comments 76 Shares



 Behgjet Pacolli   
June 4, 2014 · 

Ne kete aplikacion mund te gjeni listen e kandidateve per deputet nga Aleanca Kosova e Re!  
Liste me kandidat te dinjitetshem, pa afera koruptive, profesionist te vertete dhe te perkushtuar per zgjidhjen e probleme tuaja.  
Keta deputet, qe Ju do ti votoni do te perfaqesojne interesin e popullit dhe do te kryjne pune per te miren e Kosoves.  
Voto AKR 40



**NA KRYJMË PIJNË**  
40 akrr

Behgjet Pacolli  
Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës

LISTA E KANDIDATËVE

514 12 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

June 4, 2014



Izolimi i Kosovës, mungesa e lirisë së lëvizjes, nuk dëmton vetë Kosovën, por dhe BE-në. Po rritet një brez i ri i cili nuk ka mundësi të udhëtojë në Europë dhe kjo nuk është diçka pozitive... Me AKR në krye të qeverisjes, edhe Kosova do t'i ngjitet me shpejtësi trenit European të integrimëve. Ne do t'i bindim partnerët tanë të BE-së, të liberalizojnë urgjentisht vizat me Kosovën dhe të vendosim dialog të vërtetë me ta për të gjitha çështjet.

Kombi shqiptar nuk mund të integrohet i fundit në Europë dhe në bashkësinë perëndimore të kombeve! Kombi shqiptar nuk mund të pësojë pengesa apo kushtëzime eventuale nga ndonjë shtet tjetër i rajonit.

E shkruajta këtë reflektim sot kur Shqipëria mori dritën e verdhe për statusin e kandidatit nga Komisioni European. Urime vendit amë për këtë lajm të gëzuar për mbarë kombin shqiptar! Çdo përparim i Shqipërisë drejt institucioneve europiane është avansim i kombit!



579

16 Comments 22 Shares



Behgjet Pacolli

June 4, 2014

...

Gjilanasit nuk mund t'i pengoj askush që të zhvillojnë komunën e tyre. E di që jeni bërë mbret i Gjilanit dhe mund të mos lejoni të mbahen tubimet e AKR-së në hapësirat publike, por po u them z.Haziri, se prap qytetarët e Gjilanit gjetën vend për tu tubuar dhe për të treguar ty se nuk mund t'i ndalësh ata që me 8 qershorë të votojnë AKR-në.



608

17 Comments 13 Shares





Behgjet Pacolli  
June 5, 2014 · 🌐



👍 873

29 Comments 45 Shares



Behgjet Pacolli  
June 5, 2014 · 🌐



Askush për shkaqe politike nuk mund ta ndalë ndërtimin e fabrikës

- Ai vend ku do të ndërtohet fabrika është një territor industrial, identifikohet për industri. Dhe është një territor jashtë Prishtinës. Askush për shkaqe politike nuk ka me mujt me e ndalë punësimin.

<http://www.kosovapress.com/.../pacolli-askush-per-shkaqe.../>



👍 1.4K

75 Comments 52 Shares



Behgjet Pacolli

June 5, 2014 · 🌐

...

Sot promovova librin tim « të lobosh për Kosovën, SHBA dhe pavarësia » në mjediset e Panairit të librit « Prishtina 2014 ». Është një përmbledhje dokumentash që botohen për herë të parë. Ato tregojnë veprën e madhe lobuese gjate viteve 2003-2007 që unë së bashku me diplomatë, figura të shquara publike të SHBA-ve, zhvilluam që SHBA-të të mbronin përfundimisht opcionin e pavarësisë për Kosovën.

Foli botuesi i « Botës Shqiptare », Kujtim Gjonaj, i cili e quajti këtë libër, « libër të miqësisë me Amerikën », nga një personalitet që ne në Shqipëri e duam shumë ». Foli Mimoza Kusari Lila e cila rrëfeu impresionet për librin. Profesor Afrim Hoti, ekspert i të drejtës ndërkombëtare e quajti Libër themelor, uverturë e historisë së diplomacisë kosovare.

Unë tregova për atmosferën e kohës, në të cilën u zhvillua lobimi, që kulmoi me deklaratën e Presidentit Bush në Tiranë : « Kosova e meriton pavarësinë tani! »



👍 652

16 Comments 17 Shares



Behgjet Pacolli

June 5, 2014



Sapo u ndava me punëtorët e Eurofruti në afërsi të Mramorit, që paketonin manaferra, dredhëza, kërpudha për tregun gjerman. U kënaqa shumë me këtë ndërmarrësi të sukseshme.

Me AKR në krye të qeverisjes fabrika si kjo do të shumëfishohen falë mbështetjes së qeverisë. Rrjedhimisht do të hapen edhe mijëra vende pune Do të ketë mbështetje për fermat që do ndërliken me këto fabrika. Kjo do jetë e ardhmja e bujqësisë sonë, dhe mirëqenies për bujqit tanë.



958

20 Comments 20 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
June 5, 2014 · 🌐

Besëlidhja e Gollakut me AKR!

Banorët e Gollakut me bënë të ndihem krenar qe jam i kësaj ane. Sapo isha në fshatin Mramor, afër vendlindjes time, me pritën aq bukur si para një jave Mareci.



 694  12 Comments  9 Shares





Behgjet Pacolli

June 6, 2014 · 🌐



Nga njera anë e Kosovës në Gollak në anën e tjetër, mbrëmë isha në Gjakovë. AKR është parti e gjithë Kosovës, por nga Gjakova do të vijojë ndryshimin e gjithë Kosovës!



👍 1K

17 Comments 26 Shares



Behgjet Pacolli

June 6, 2014 ·



AKR i bën thirrje partive për ndërprerje të fushatës, pas tragjedisë së rëndë ndodhur në Termocentralin Kosova A

Pas tragjedisë së rëndë të ndodhur në Termocentralin Kosova A ku ka patur humbje jetësh njerëzore dhe shumë të lënduar;

Kur ende nuk është sqaruar dinamika dhe gjithë elementët e kësaj tragjedie.

Në përpjekje për të shmangur politizimin e mundshëm të kësaj ngjarjeje në ditën e fundit të fushatës, AKR bën thirrje për ndalimin e fushatës zgjedhore për të lejuar nderimin dinjitoz të të vdekurve dhe respektimin e familjeve të tyre.

AKR kërkon shpalljen ditë zie në nivel Kosove për nderimin e viktimave.

Nëse partitë e tjera nuk pajtohen me këtë propozim, AKR kërkon që të mos politizohet ngjarja.

498

15 Comments 16 Shares



Behgjet Pacolli

June 8, 2014 ·



Sapo votova, e kryeva punën time për sot, obligimin tim. Të gjithë ju bashkëqytetarë të mi që e doni ndryshimin, një Kosovë më të begatë, kryejeni dhe ju obligimin tuaj masovikisht. Ndihmoni më të moshuarit, të sëmurët të votojnë. Votoni ndershëm! Me këtë votë po përcaktoni 4 vjet të ardhshëm të jetës suaj!

ZERI.INFO

### Pacolli votoi i shoqëruar nga dy fëmijët e tij

Bengjet Pacolli, kryetar i Aleancës Kosova e Re, ka votuar rreth orës 10:00 në Shkollën Filllore n...



709

42 Comments 14 Shares



Behgjet Pacolli

June 8, 2014 · 🌐




Me Hanën dhe Isën, dy fëmijët e mi, qytetarë të Kosovës duke i mësuar një ushtrim elementar të demokracisë, votën.






3.6K

88 Comments 25 Shares



 **Behgjet Pacolli** ✓  
June 8, 2014 · 🌐

Bashkëqytetarë të mi,  
Dilni dhe votoni. Kanë mbetur edhe një orë kohë. Shfrytëzojeni të drejtën tuaj. Për të ardhmen më të mirë.

 466  38 Comments  4 Shares



Behgjet Pacolli

June 11, 2014 · 🌐



Është fyese dhe e pamoralshme kur shoh nëpër medie, se spekulohet me votat nga punëtorët e Mabetexit në Kazakistan. Ky spekulim mediatik që ka nisur vetëm dje të prodhohet në kuzhina të caktuara është mjerim mendor i dikujt që është i obsesionuar nga AKR.

Unë personalisht, nga familja ime dhe askush nga drejtorët e Mabetexit nuk kemi përmendur vota të punëtorëve të MABETEX që punojnë në Kazakistan apo kudo në botë. Njerëzit që punojnë në kompanitë e mija, nuk janë kushtëzuar asnjëherë që të votojnë për ndonjë parti politike.

Punëtorët në mënyrë dinjitoze janë duke punuar dhe nuk kanë qenë, dhe nuk do të jenë të obliguar që të votojnë jashtë vullnetit të tyre. Kjo është arsyeja pse as di se çfarë kanë bërë ata, a kanë votuar, a nuk kanë votuar. Është paradoks që përsëritet kur dëshmitë e ndershmërisë sime si kjo e mospërdorimit të votës së punonjësve, të tentohet të përkthehet në të kundërtën e vet.

AKR respekton çdo votë të qytetarit të Kosovës. Deri më sot nuk janë numëruar ende të gjithë votat dhe ne inkurajojmë institucionet gjegjëse ta përkryejnë deri në fund këtë numërim që është parakusht për proceset e tjera. AKR bën thirrje tek të gjithë spektri politik, që të presin me qetësi numërimin e çdo vote të qytetarëve të Kosovës.



835

77 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

June 12, 2014 · 🌐



Sot 15 vjet nga hyrja e trupave të NATO-s që çliruan Kosovën do duhet të mendojmë më gjatë për rrënjët e lirisë dhe të shtetësisë sonë. Sot kur shoh popuj ose kombe që kanë ende probleme me lirinë dhe pavarësinë e tyre, duhet të kuptojmë sa me fat që kemi qenë dhe të jemi të vetëdijshëm për çlirimtarët tanë.

Unë e kam një përgjigje: është aleanca me perëndimin, në rrënjë të kësaj lirie dhe të këtij fati që ka patur populli i Kosovës për t'u çliruar nga një pushtim i gjatë. Bijtë e Kosovës luftuan për liri, por aleanca me perëndimin na e solli dhe lirinë dhe pavarësinë.

E bëj këtë refleksion veçanërisht për një pjesë të rinisë e cila për shkak të moshës së re nuk është plotësisht e vetëdijshme për këtë. Mungesa e lëvizjes së lirë në Europë dhe në Perëndim në përgjithësi mbase ja bën dhe më të vështirë ta kuptojnë plotësisht këtë të vërtetë të madhe të historisë sonë. Por kur të gjithë të lëvizin të lirë, kur të rinjtë të kenë mundësi të punojnë, të studiojnë ku të duan në botën e zhvilluar, gjegjësisht në perëndim, kur të jemi plotësisht pjesë e botës globale, atëherë gjithçka do të jetë më e qartë dhe e kuptueshme.

Urime liria për popullin e Kosovës! Faleminderit çlirimtarëve të Kosovës, nga viset tona apo atyre që vijnë nga perëndimi!



👍 448




14 Comments 15 Shares

 Behgjet Pacolli   
June 12, 2014 · 

<http://www.gazetaexpress.com/.../pacolli-na-duhen-vec.../>



451 46 Comments 16 Shares

 Behgjet Pacolli   
June 15, 2014 · 

Jam thellësisht i tronditur nga vrasja e kandidatit për deputet Elvis Pista. Shteti duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe sa më shpejtë ti nxjerrë para drejtësisë, qyqarët që bënë këtë akt barbar.

 Vjollca Gagica-Matoshi and 426 others 21 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

June 16, 2014 · 🌐



Në intervistën time në RTV21 e thashë qartë se vota e sovranit është e cënuar veçanërisht në dëm të AKR-së. Ne jemi të bindur se rinumërimi në zonat problematike apo dhe i votave të pavlefshme do na japë të drejtë. Thashë se pa u numëruar çdo votë ngado që vjen ajo, nuk mund të kemi procesin kushtetues të krijimit të institucioneve, gjegjësisht të qeverisë së re. Jam i shqetsuar se ethet për pushtet i bënë partitë e Kosovës të harrojnë ekonominë dhe se kriza politike dëmton pikërisht perspektivën ekonomike. Krejt për fund thashë se unë nuk do t'i bëj qejfin askujt dhe nuk do t'i braktis 35 mijë votat e deritanishme të AKR.

<http://youtu.be/P6U94tMCZ2Y>



YOUTU.BE

**Argument plus - Behgjet Pacolli 16.06.2014**

Argument plus - Behgjet Pacolli 16.06.2014

👍 787

43 Comments 13 Shares





Behgjet Pacolli

June 24, 2014 · 🌐

...

Urime Shqipërisë për statusin e kandidatit për Bashkimin European! Çdo përparim i Shqipërisë është përparim i kombit! Shpresojmë që edhe Kosova do të fitojë shumë shpejt lëvizjen e lirë drejt vendeve të Bashimit European për rininë tonë, për qytetarët tanë!



👍 Vjollca Gagica-Matoshi and 1K others

35 Comments 12 Shares



Behgjet Pacolli

June 27, 2014 · 🌐

...

Të nderuar besimtarë të besimit Islam, më lejoni që në emrin tim personal dhe të Aleancës Kosova e Re, të shpreh urimet e sinqerta për fillimin e Muajit të shenjtë të Ramazanit.

Uroj që muaji i madhërishtëm i Ramazanit të gjejë familjet tona në harmoni, mirëqenie, lumturi dhe dashuri. Uroj që ky muaj të jetë muaji i paqes, tolerancës dhe harmonisë mes njerëzve, duke sjellë zemërgjerësi, mirëkuptim, dashuri dhe solidaritet tek ne.

Ju dëshiroj të gjithë qytetarëve të besimit Islam agjërim të lehtë, me vullnet dhe besim.

👍 826

28 Comments 15 Shares



Behgjet Pacolli

July 1, 2014 · 🌐

...

Krenar me ju!



BBC.COM

### Unlikely heroes of Switzerland

Switzerland's multicultural football team for Brazil 2014 is finally being held as a success, at las...

👍 653

13 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

July 2, 2014 · 🌐

...

Miratimi i Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990 shënon një nga aktet më të rëndësishme, me anë të të cilit u institucionalizua kërkesa e vazhdueshme e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Kjo shënon kthesën historike dhe një ndër momentet vendimtare në rrugëtimin tonë të gjatë për liri, pavarësi e demokraci, që i hapi rrugë ndërtimit të shtetit të Kosovës.

👍 252

4 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

July 4, 2014 · 🌐

...

Shtetet e Bashkuara të Amerikë kanë qenë katalizatori kryesor i zhvillimit të vendit tonë që nga koha e pasluftës, duke kontribuar në realizimin e idealeve të Kosovës dhe popullit të saj. Janë SHBA-të ato që u kanë sjellë paqe, liri dhe demokraci kombeve dhe popujve në mbarë botën, me besimin dhe dedikimin e tyre maksimal në përkrahje të këtyre vlerave, të cilat duhet të gëzohen nga të gjithë.

4 Korriku është ditë feste edhe për Kosovën, e cila është gjithmonë falenderuese për mbështjetjen e vazhdueshme të qytetarëve Amerikanë, në kohët më të vështira dhe më vendimtare për vendin tonë, veçanërisht në procesin e themelimit të një shteti demokratik, ku synimi ynë kryesor krahas zhvillimit të vendit tonë, vazhdon të jetë forcimi i sundimit të ligjit, stabilitetit prosperitetit në regjion dhe me gjerë.

Me këtë rast, ne e ritheksojmë fuqishëm miqësinë tonë të përhershme si dhe partneritetin dhe mbështjetjen reciproke me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke shprehur mirënjohjen tonë, njëkohësisht edhe urimet tona në këtë ditë të veçantë për miqtë tanë, popullin dhe Qeverinë e SHBA-ve.



👍 751

24 Comments 28 Shares



Behgjet Pacolli

July 8, 2014

Me pikëllim të thelle mora lajmin për vdekjen e mikut tim Aziz Abrashi. Ngushëllimet më të thella për familjen Abrashi dhe gjithë njerëzit që patën fatin të bashkëpunojnë me këtë njeri të madh.



Vjollca Gagica-Matoshi and 322 others

37 Comments



Behgjet Pacolli

July 27, 2014

Rasti i Fitër Bajramit është një mundësi për mua për t'ju drejtuar të gjithë bashkëkombasve, bashkëqytetarëve të mi dhe bashkëvendasve të mi me urimet më të mira pas këtij muaji të shenjtë.

Unë dua të besoj shumë se ky muaj sakrifice dhe përkushtimi ndaj vuajtjes njerëzore, respektimi ndaj vlerave më të mira individuale dhe grupore i ka ndriçuar më shumë mendjet tona dhe i ka bërë zemrat tona më të hapura për të mirën. Si shoqëri dhe si individë na presin sfida të reja për afirmimin tonë kombëtar dhe vendor. Si njeri që ka një eksperiencë të gjatë pune dhe jete mendoj se ka disa premisa për sukses.

Na duhen një raport i shëndoshë me të vërtetën dhe jo me të rrejshmen; vendosja e interesit të përgjithshëm mbi atë egoistik; ruajtja e mirënjohjes në vend të kthimit të shpinës për mikun që t'u gjend në momente të vështira, ndihma për atë që vuan në vend të lakmisë për më shumë.

Ne shqiptarët kemi traditë në të gjithë këto drejtime dhe vetëm duhet të zhvillojmë vlerat më të fuqishme që kemi, pa e humbur kurrë orientimin nga e mira.



725

31 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

August 4, 2014

Ky është projekti më avangardë të cilin e bashkëprojekton dhe e ndërton Mabetex-i: Expo 2017 në Astana! Vlera e projektit- disa miliard EURO!



12K

408 Comments 493 Shares


 **Behgjet Pacolli** ✓  
August 7, 2014 · 🌐

BEHGJETPACOLLI.COM 

**Intervistë me Pacollin: Bllokada mund të tejkalohet, zgjedhjet mbesin opSION | Behgjet Pacolli**

Tejkalimi i ngërçit politik është i lehtë nëse politikanët do të mendonin për institucionet e Shtetit para interesave private. Edhe zgjedhjet e reja janë opSION për të dalë nga kjo situatë. Aleanca Kosova e Re është duke u...

 143 3 Comments 4 Shares

 **Behgjet Pacolli** ✓  
August 10, 2014 · 🌐

Postuar nga Admin

KOHA.NET 

**Ngërçi politik, mesazh i keq për investitorët**

Vonesat për formimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të Kosovës, të dala nga zgjedh...

 102 1 Comment 2 Shares



Behgjet Pacolli

August 11, 2014



Zgjedhja popullore e zotëri Recep Taip Erdogan në krye të Turqisë si President, është një rast që unë t'i uroj shkëlqesinë së tij dhe popullit vëlla turk suksese të mëdha në ndërtimin e mëtejshëm të një Turqie moderne, demokratike dhe të begatë.

Që nga 2003-i, kur zoti Erdogan erdhi në krye të politikës turke, Turqia ka katërfishuar GDP-në e vet dhe është shndërruar në një faktor të rëndësishëm global.

Ne kosovarët i jemi mirënjohës Turqisë për ndihmën e pakursyer dhënë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, në veçanti pjesëmarrjen e saj në operacionet për çlirimin e Kosovës, njohjen e pavarësisë ndër shtetet e parë, dhe mbështetjen e vazhdueshme për konsolidimin ekonomik dhe ndërkombëtar të shtetësisë sonë.

484

23 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli added 14 new photos.

August 12, 2014 · 🌐

Jemi në periudhë vere, dhe besoj kemi më shumë kohë për të lexuar. Kush ka dëshirë le të njohë më shumë nga jeta ime. Diçka keni lexuar më parë dhe tani keni mundësi për më tepër.

Në fakt gjithë jeta ime është një libër i hapur. Janë me gishta librat autobiografikë të politikanëve dhe njerëzve tanë publikë në Kosovë që kanë shkruar jetën e tyre...

nga fillimi në 2014...



nga fillimi në 2014...

## Një vit i veçantë

1979-1980 - Në fillim të viteve të 80-ta, në Kosovë, si dhe në tërësi në Evropë, u zhvillua një lëvizje e re kulturore dhe artistike. Në Kosovë, kjo lëvizje u quajt "Rindërtimi i kulturës".

**V**iti 2014 ka qenë një vit i veçantë për mua. Në fillim të vitit, kam qenë në Kosovë dhe kam punuar në administratë. Në fund të vitit, kam qenë në Itali dhe kam punuar në administratë. Kjo është një përvojë e re dhe më ka dhënë një pamje të re të botës.

Faktori i kësaj ndryshimi është faktori i kohës. Koha ndryshon dhe ne ndryshojmë me të. Në vitin 2014, kam qenë në Kosovë dhe kam punuar në administratë. Në fund të vitit, kam qenë në Itali dhe kam punuar në administratë. Kjo është një përvojë e re dhe më ka dhënë një pamje të re të botës.

nga fillimi në 2014...



Me Ramiz Kallmetin, 1982

Kam qenë në Kosovë dhe kam punuar në administratë. Në fund të vitit, kam qenë në Itali dhe kam punuar në administratë. Kjo është një përvojë e re dhe më ka dhënë një pamje të re të botës.

Në fillim të vitit, kam qenë në Kosovë dhe kam punuar në administratë. Në fund të vitit, kam qenë në Itali dhe kam punuar në administratë. Kjo është një përvojë e re dhe më ka dhënë një pamje të re të botës.

nga fillimi në 2014...



nga fillimi në 2014...



Në fillim të vitit, kam qenë në Kosovë dhe kam punuar në administratë. Në fund të vitit, kam qenë në Itali dhe kam punuar në administratë. Kjo është një përvojë e re dhe më ka dhënë një pamje të re të botës.

nga fillimi në 2014...



Në fillim të vitit, kam qenë në Kosovë dhe kam punuar në administratë. Në fund të vitit, kam qenë në Itali dhe kam punuar në administratë. Kjo është një përvojë e re dhe më ka dhënë një pamje të re të botës.

👍 289

17 Comments 11 Shares





Behgjet Pacolli added 3 new photos.  
August 13, 2014 · 🌐

Jemi në periudhë vere, dhe besoj kemi më shumë kohë për të lexuar. Kush ka dëshirë le të njihë më shumë nga jeta ime. Diçka keni lexuar më parë dhe tani keni mundësi për më tepër.

Në fakt gjithë jeta ime është një libër i hapur. Janë me gishta librat autobiografikë të politikanëve dhe njerëzve tanë publikë në Kosovë që kanë shkruar jetën e tyre...

nga Sllida në SHIDE...



e kam shqetësuar në asnjë formë. Nga viti 1990 e prapa, me Bakallin kemi pasur kontakte të shpeshta. Një kohë të gjatë, nën përkujdesjen time ka qëndruar në Lugano, qoftë në hotel, qoftë në shtëpinë time. Bisedonim shpesh për Kosovën dhe për mënyrën e zgjidhjes së krizës së saj. E dija se mBante lidhje me ish-amBasadorin e Amerikës në Beograd, IgelBërgerin (Lawrenc EagleBurger) dhe atij i dërgonte raporte dhe analiza. Kishte raste kur Besonte se për Kosovën, me ndihmën e Bashkësisë ndërkombëtare, mund të gjendej një zgjidhje paqësore. Në këtë pikë ndonjëherë mBështeste Rugovën. Më pastaj zhgënjehet. Nxirrte argumente dhe kundërgargumente dhe vinte në përfundim se çështja e Kosovës mund të zgjidhej vetëm me luftë. Më vjen keq jo vetëm pse vdekja e rëmbëu heret, kur ai ende kishte energji dhe akoma mund të kontribonte për Kosovën, por më shumë për faktin se Kosova e viteve të pasluftës nuk ka ditur t'i shfrytëzojë aftësinë udhëheqëse dhe dijeve të tij politike.

Pas këtij digresioni, do të kthehem i përsëri te rrjedha e rrefimit. Aksidenti, përveç pasojave të paevitueshme në gjendjen time shëndetësore, nuk solli ndonjë ndryshim në punën time. Madje, mund të them se, simbolikisht, shikuar në aspektin kohor, kjo ngjarje ishte njëlloj kthese. Nuk e shpjegoj dot si ndodhi kjo, por e di që atëherë, më saktë nga fillimi dhe mesi i viteve tetëdhjetë, unë do të bëja depërtime të reja shumë domethënëse në fushën e Biznesit. MBase kishte ardhur momenti. Në horizont shiheshin ndryshime të mëdha globale. Lidhur me këto ndryshime, një gjë e ndieja në mënyrë intuitive: Perëndimi do të dominonte mBi Lindjen, kapitalizmi do të verifikohet si sistem shoqëror më përparës të mëdha karshi socializmit. Lindja, Bashkë me socializmin, kishin degraduar. Por, ndryshe nga shumë të tjerë, unë e dija se shtetet e Lindjes duhej të mëkëmbeshin dhe të ringjallehin, të transformoheshin në çdo pikëpamje, përfshirë edhe teknologjinë e prodhimit. Ky ishte shansi i madh për Botën e Biznesit. Prandaj, gara mund të fillonte dhe në atë garë unë kisha pjesën time dhe - shanset e mia.

Disa muaj pas aksidentit, unë fillova të punoja përsëri, pavarësisht nga konstruksioni i metale të nuk më linte as të ktheja, as të mënjanoja kokën. Arsyeya përse u futa në punë kaq shpejt, në njëfarë mënyre, ishte situata e re e krijuar në firmë. I kënaqur me

140

ngjashmësi me...

e kam shqetësuar në asnjë formë. Nga viti 1990 e prapa, me Bakallin kemi pasur kontakte të shpeshta. Një kohë të gjatë, nën përkujdesjen time ka qëndruar në Lugano, qoftë në hotel, qoftë në shtëpinë time. Bisedonim shpesh për Kosovën dhe për mënyrën e zgjidhjes së krizës së saj. E dija se mBante lidhje me ish-amBasadorin e Amerikës në Beograd, IgelBërgerin (Lawrenc EagleBurger) dhe atij i dërgonte raporte dhe analiza. Kishte raste kur Besonte se për Kosovën, me ndihmën e Bashkësisë ndërkombëtare, mund të gjendej një zgjidhje paqësore. Në këtë pikë ndonjëherë mBështeste Rugovën. Më pastaj zhgënjehet. Nxirrte argumente dhe kundërgargumente dhe vinte në përfundim se çështja e Kosovës mund të zgjidhej vetëm me luftë. Më vjen keq jo vetëm pse vdekja e rëmbëu heret, kur ai ende kishte energji dhe akoma mund të kontribonte për Kosovën, por më shumë për faktin se Kosova e viteve të pasluftës nuk ka ditur t'i shfrytëzojë aftësinë udhëheqëse dhe dijeve të tij politike.

Pas këtij digresioni, do të kthehem i përsëri te rrjedha e rrefimit. Aksidenti, përveç pasojave të paevitueshme në gjendjen time shëndetësore, nuk solli ndonjë ndryshim në punën time. Madje, mund të them se, simbolikisht, shikuar në aspektin kohor, kjo ngjarje ishte njëlloj kthese. Nuk e shpjegoj dot si ndodhi kjo, por e di që atëherë, më saktë nga fillimi dhe mesi i viteve tetëdhjetë, unë do të bëja depërtime të reja shumë domethënëse në fushën e Biznesit. MBase kishte ardhur momenti. Në horizont shiheshin ndryshime të mëdha globale. Lidhur me këto ndryshime, një gjë e ndieja në mënyrë intuitive: Perëndimi do të dominonte mBi Lindjen, kapitalizmi do të verifikohet si sistem shoqëror më përparës të mëdha karshi socializmit. Lindja, Bashkë me socializmin, kishin degraduar. Por, ndryshe nga shumë të tjerë, unë e dija se shtetet e Lindjes duhej të mëkëmbeshin dhe të ringjallehin, të transformoheshin në çdo pikëpamje, përfshirë edhe teknologjinë e prodhimit. Ky ishte shansi i madh për Botën e Biznesit. Prandaj, gara mund të fillonte dhe në atë garë unë kisha pjesën time dhe - shanset e mia.

ngjashmësi me...

e kam shqetësuar në asnjë formë. Nga viti 1990 e prapa, me Bakallin kemi pasur kontakte të shpeshta. Një kohë të gjatë, nën përkujdesjen time ka qëndruar në Lugano, qoftë në hotel, qoftë në shtëpinë time. Bisedonim shpesh për Kosovën dhe për mënyrën e zgjidhjes së krizës së saj. E dija se mBante lidhje me ish-amBasadorin e Amerikës në Beograd, IgelBërgerin (Lawrenc EagleBurger) dhe atij i dërgonte raporte dhe analiza. Kishte raste kur Besonte se për Kosovën, me ndihmën e Bashkësisë ndërkombëtare, mund të gjendej një zgjidhje paqësore. Në këtë pikë ndonjëherë mBështeste Rugovën. Më pastaj zhgënjehet. Nxirrte argumente dhe kundërgargumente dhe vinte në përfundim se çështja e Kosovës mund të zgjidhej vetëm me luftë. Më vjen keq jo vetëm pse vdekja e rëmbëu heret, kur ai ende kishte energji dhe akoma mund të kontribonte për Kosovën, por më shumë për faktin se Kosova e viteve të pasluftës nuk ka ditur t'i shfrytëzojë aftësinë udhëheqëse dhe dijeve të tij politike.

Pas këtij digresioni, do të kthehem i përsëri te rrjedha e rrefimit. Aksidenti, përveç pasojave të paevitueshme në gjendjen time shëndetësore, nuk solli ndonjë ndryshim në punën time. Madje, mund të them se, simbolikisht, shikuar në aspektin kohor, kjo ngjarje ishte njëlloj kthese. Nuk e shpjegoj dot si ndodhi kjo, por e di që atëherë, më saktë nga fillimi dhe mesi i viteve tetëdhjetë, unë do të bëja depërtime të reja shumë domethënëse në fushën e Biznesit. MBase kishte ardhur momenti. Në horizont shiheshin ndryshime të mëdha globale. Lidhur me këto ndryshime, një gjë e ndieja në mënyrë intuitive: Perëndimi do të dominonte mBi Lindjen, kapitalizmi do të verifikohet si sistem shoqëror më përparës të mëdha karshi socializmit. Lindja, Bashkë me socializmin, kishin degraduar. Por, ndryshe nga shumë të tjerë, unë e dija se shtetet e Lindjes duhej të mëkëmbeshin dhe të ringjallehin, të transformoheshin në çdo pikëpamje, përfshirë edhe teknologjinë e prodhimit. Ky ishte shansi i madh për Botën e Biznesit. Prandaj, gara mund të fillonte dhe në atë garë unë kisha pjesën time dhe - shanset e mia.

👍 289

17 Comments 11 Shares



Behgjet Pacolli

August 29, 2014 · 🌐



Qëndrimet që po mbahen ndaj vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese nga klasa politike e jonë më kujtojnë një episod nga librat e rinisë sime, që titullohej « avanturat e Dinpakut dhe shokëve të tij ».

Dinpaku ishte heroi kryesor i shoqërisë së xhuxhave të cilët kishin emrat sipas cilësive të tyre (psh Dinpaku=Din Pak).

Dinpaku në jetë provoi të bënte gjithçka : muzikantin, skulptorin, piktorin.

Një ditë kur Dinpaku ndihej piktor, ftoi shokët e tij në një ekspozitë me portretet e tyre : të Dinshumit, të Sigurtit, të Pasigurtit, etj. Të gjithë shokët morën pjesë dhe i thoshin Dinpakut: sa bukur i ke bërë pikturat!

Vetëm se kur mbërrinin para portretit të vetëvetes, i thoshin: aaaa,Dinpak nuk e ke bërë mirë këtë, nuk më ngjan mua!

Nëse doni, dhe mençuria jonë popullore afron një tjetër thënie : kush gëzohet nga hapja e gropës për tjetrin, mund që bien vetë brenda!!



278

31 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

September 21, 2014 · 🌐

...

Me vizitën e Papës Françesku, për një ditë Shqipëria, vendi amë, kombi shqiptar megjithë pjesët e tij, pra dhe Kosovën, ishte në vitrinën kryesore të botës. Në vitrinë mund të jesh për mirë, mund të jesh për keq. Është fat i madh të jesh për mirë dhe kombi ynë doli me një imazh të mrekullueshëm nga kjo vizitë.

Por çfarë i treguam ne botës? Për një kombinim rrethanash ne shqiptarët kudo që jetojmë në Tiranë, në Prishtinë, në Podgoricë, në Shkup, apo kudo, i përkasim feve të ndryshme megjithëse jemi një komb i vogël. Dhe bashkëjetojmë në një menyrë harmonike. Harmonia është diçka që i duhet shumë botës së përfshirë në konflikte. Në botë sot janë në konflikt madje dhe ata që i përkasin të njëjtës fe. Këtë të vërtetë të kombit tonë e pohoi fuqishëm dhe vetë Papa Françesk, në modestinë e tij: Shqipëria me bashkëjetesën e vet fetare është burim frymëzimi për botën!

Faleminderit Papa Françesku për vizitën që na mundësoi këtë vitrinë të mrekullueshme!



👍 697

28 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli

September 30, 2014

...

E lexova në një medium një lajm se gjoja qenkam i sëmurë dhe i jam nënshtruar një operacioni. Është për keqardhje se si disa mediueme janë shëndërruar në burim të pavërtetash vetëm për të përfituar disa lexues më shumë. Miqtë e mi, i informoj se absolutisht nuk është i vërtetë ky lajm, pra është një gënjeshtër e kulluar. Unë gëzoj shëndet të plotë dhe shihemi së shpejti. b.p.

1K

96 Comments 14 Shares



Behgjet Pacolli

October 3, 2014

...

Të dashur qytetarë të Kosovës  
Të nderuar besimtarë të fesë Islame,  
Festat janë momentet e veçanta në të cilat njerëzit, qoftë në saje të mundësive të veta, qoftë të solidaritetit njerëzor, për një çast i kthejnë shpinën hidhërimit dhe të keqes.  
E tillë është edhe Festa e Kurban Bajramit të cilën do ta festojmë nesër.  
Duke shfrytëzuar këtë rast, më lejoni që të gjithë juve t'ju uroj këtë festë që në thelbin e vetë përmban dashurinë dhe sakrificën për tjetrin.  
Le të jemi solidar njëri me tjetrin sa më shumë që të jetë e mundur në gjithë jetën tonë njashtu siç jemi në këto raste të veçanta!  
Gëzuar e me fat festa e kurban bajramit!  
Paqja, drejtësia, mirësia dhe toleranca mbretëroftë në familjet tuaja gjithmonë!

872

46 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
October 17, 2014 · 🌐



Unë kisha ofertë ekonomike dhe jo ofertë demagogjike, fjalësh të bukura. Më vjen keq shumë, por ky shans iku dhe sfidat e mbijetesës sonë ekonomike, të luftës kundër varfërisë, për pasojë sfidat e qeverisjes ngelën para nesh dhe në kurrizin tonë.

GAZETAEXPRESS.COM

### Shansi i humbur

Unë kisha ofertë ekonomike dhe jo ofertë demagogjike, fjalësh të bukura. Më vjen keq shumë,...

👍 772

75 Comments 25 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
October 22, 2014 · 🌐



Pranimi i Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar IOC, me të drejta të kufizuara njëherë dhe në dhjetor me të drejta të plota është një lajm plot dritë në qiellin e zymtë të jetës sonë.

Ky pranim është konfirmim se hyrja e Kosovës në familjen e kombeve me të gjitha atributet e një shteti të vërtetë, një objektiv për të cilin kemi luftuar vazhdimisht, është një proces që s'mund ta ndalë askush.

Ky anëtarësim edhe sipas nenit 30.1 të Kartës Olimpike është konfirmim i luftës sonë për njohjet, gjegjësisht luftës për njohjen e Kosovës si shtet i pavarur prej komunitetit ndërkombëtar, që ishte njeri prej kushteve të anëtarësimit.

Pse them se është lajm me dritë? Ky lajm sjell shpresë se rinia jonë që e do sportin, që ka plot aftësi dhe zotësi sportive do të ketë mundësi të përfshihet në garat e ndryshme anembanë botës. Ne si popull, rinia jonë veçanërisht e duam sportin, e duam garën, pavarësisht vështirësive të jetës sonë.

Ky anëtarësim do ta thyejë zinxhirin e izolimit ndërkombëtar të Kosovës, të pengesave për lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë. Ky izolim duhet thyer përfundimisht sepse po i sjell shumë probleme të mëdha Kosovës. Ditë më të mira paskëtaj vijnë!

👍 Fidan Murati and 381 others

23 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

November 6, 2014

Miqt e mi, sonte në ora 20:15 jam i ftuar në "Rubikon" të Kohavisionit. Shikim të këndshëm.

# RUBIKON

ME ADRIATIK KELMENDIN

**E MARTË / E MERKURË / E ENJTE**

**20:00**

511

24 Comments 11 Shares



Behgjet Pacolli

November 7, 2014

Intervista në Rubikon



YOUTUBE.COM

RUBIKON - Behgjet Pacolli 06.11.2014

RUBIKON - Behgjet Pacolli 06.11.2014

311

25 Comments 23 Shares



Behgjet Pacolli ✓  
November 8, 2014 · 🌐

...

Para disa ditësh në qendrën infektive në Prishtinë ndërroi jetë Valon Xhambazi, një djalë i ri, 28 vjeçar. Shkaku i vdekjes së Valonit, ishte helmimi nga mishi i pulës (kaqikat), ndërsa gjithashtu të helmuar janë edhe gjithë familja e tij e ngushtë. Sinqerisht, një lajm i tillë ishte tronditës për mua, që vetëm një ditë para vdekjes e takova Valonin i cili ishte një bashkpunëtor i imi këtu në Prishtinë. E dhimbshme që vdekja e këtij të riu 28 vjeçar. Por, tronditëse dhe alarmante është arsyeja e kësaj vdekjeje. Sipas fakteve, ai u helmua nga mishi i pulës, produkt i cili nga qytetarët e vendit tonë konsumohet shumë.

E kam ngritur zërin në vazhdimësi kundër mënyrave mafioze të udhëheqjes së shtetit. Është për keqardhje se si politikanët tanë garojnë për poste e ofiqe, dhe mbajnë peng gjendjen që 5 muaj, ndërsa në anën tjetër, qytetarët vdesin sepse mungon forca e ligjit.

Mafiozët dirigjojnë gjithçka, normalisht me mbështetjen e politikanëve që garën për të marrë pozicione e konsiderojnë jetike. Mafiozët mbajnë peng edhe kontrollin e ushqimit, kushtit elementar për jetesë. Qytetarët sot nuk e dinë se çka të zgjedhin si ushqim, sepse mbeturinat janë të përziera me produktet ushqimore. Mekanizmat shtetëror të kontrollit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit nuk funksionojnë. Për këtë, dikush është fajtor. Unë mendoj se kjo klasë politike, këta udhëheqës të sotëm janë përgjegjës për tërë këtë gjendje të keqe.

Po. Pikërisht këta, individë që ëndërr e kanë mirëqenien personale, janë përgjegjës për vdekjen e Valonit. Sepse nuk kanë lidhje me mënyrën se si mënaxhohet ushqimi i qytetarit. Se si menaxhohet kontrolli i ushqimit. Kush dhe si e kontrollon cilësinë e ushqimit? Kush i kontrollon ushqimet që ngrihen e shkrihen disa herë dhe ashtu të kontaminuara u servohen qytetarëve për tu konsumuar. Kush e kontrollon higjienën e gjellëtove, restoranteve, e depove ku qëndron ushqimi?

Edhe sa njerëz duhet të vdesin që të alarmohen qytetarët dhe mos të bëjnë gabimet që bënë deri tani, duke ua dhënë besimin njerëzve që brengosen vetëm për interesin personal. Këta njerëz, janë përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë bërë Kosovës dhe qytetarit të saj. Janë përgjegjës për dëmtimin e perspektivës ekonomike duke e keqtrajtuar shtetin dhe pronën shoqërore. Kosova duhet të çlirohet nga kjo kastë e politikanëve me mentalitet egoist dhe aspak human. Dhe papërgjegjësia e tyre është duke e dërguar Kosovën në greminë. Pikërisht në atë gjendje që e përmendi edhe ambasadorja e nderuar Jacobson.

Nuk mjafton të jesh i dhunshëm, nuk mjafton të jesh i fortë, i pasur(me pasuri të fituar për një natë), nuk mjafton të jesh ish komandant i luftës, i pashëm, i veshur me kollare dhe me rroba të modës së fundit, ose me diploma të universiteteve ballkanike, për të udhëhequr shtet.

Të udhëheqësh shtet do të thotë të menaxhosh një shoqëri të tërë, në mënyrë dinjitoze, në mënyrë të sinqertë, transparente etj, të bazuara krejt këto në eksperiencë, vizion dhe ajo që është më se e rëndësishme të rrih në mënyrë vertikale para qdo problemi. Para së gjithësh nevojitetet korrektësi, transparencë që të mos kesh nevojë për të vjedhur. Të kesh eksperiencë, vizion traditë prijje për të menaxhuar.

Qytetarët e Kosovës e kanë shansin që ta kuptojnë se ata janë vetë përgjegjës se kënd e zgjedhin për të udhëhequr me shtetin. Zgjedhja e njerëzve dinjitozë nuk duhet të nisët as nga inatet as nga interesat e ngushta personale por nga atributet që i përmenda më lart.

👍 790

75 Comments 17 Shares



Behgjet Pacolli

November 9, 2014 ·

...

Kush e ka mizën pas veshit reagon, është një thënie që në këtë rast vjen më së bukur në shprehje.

Z. Mustafa, partitë nuk inspektojnë asgjë, as cilësi, as nivel të higjienës, e as standarte për produktet jetësore. Janë institucionet që e bëjnë atë.

Z. Mustafa, cilësia e një produkti, që matet nga Agjensioni I veterinarisë dhe ushqimit, (I cili gjithashtu e ka përgjegjësinë e vetë) mund të jetë në nivel në momentin që futet në Kosovë. Por këto produkte, në mungesë të kontrollit insistues të inspektionit sanitar natyrisht shëndërrohen në materie të rrezikshme për shëndetin e qytetarit.

Zoti Mustafa, cili është roli I komunës në inspektimin e higjienës nëpër restorantet, supermarketet, dyqanet dhe vendet ku mbahen, shiten dhe konsumohen produktet ushqimore? Si trajtohen ato?

Cili është roli I inspektorëve komunalë pasi që ti personalisht ke qenë për vite me radhë kryetar komune? Apo më mirë, qe ta jap një shembull... A është komuna e Prishtinës, që kohë më parë ka ndërprerë kontratë për furnizim me naftë pikërisht pse inspektorët e saj kanë vërejtur se cilësia e naftës për ngrohje është kancerogjene? Situatën në Prishtinë e keni kontrolluar ju. Inspektorët kanë qenë nën autoritetin tuaj.

Prandaj miku im, nivelin dhe gjendjen e lidershit politik kosovar shumë bukur e pasqyroi edhe ambasadorja Jacobson, nëpërmjet numërimit të aferave korruptive për të gjithë dhe në këtë drejtim besoj qdo fjalë është e tepërt të thuhet.

Siq po shihet korrupsioni në Kosovë po merr edhe jetëra të njerëzve dhe është mëkat se si ju, humbjen e jetës së Valonit, e konsideroni si diçka të rëndomtë.



Nëse ju keni vizion dhe pretendoni ta udhëheqni Kosovën, një shëtitje do të ju mjaftonte të reflektoni.

580

79 Comments 9 Shares





Behgjet Pacolli   
November 9, 2014 · 

...

Zoti Mustafa, po ti rikujtoj disa fakte, pasi që po flet për përgjegjësitë e pushtetit qendror dhe atij komunal. (edhe pse unë nuk e amnistova askend në këtë proces).

Ju u lajmëruat edhe pse unë në shkrimin e parë nuk e përmenda emrin tuaj. Unë opinionit publik po i tregoj kush është mafia.

Zoti Mustafa, pikërisht për shkak të dyshimeve të bazuara dhe të rënda për korrupsion, në komunën e Prishtinës u arrestuan mbi 10 zyrtarë të lartë të inspektionit.

Miku im, pikërisht për shkak të dyshimeve të rënda për korrupsion, në prokurorinë e shtetit janë dërguar rreth 70 lëndë nga pasardhësit tuaj në udhëheqjen komunale, kundër jush. Fakti që 70 lëndë janë në prokurori, flet për punën tuaj në udhëheqjen e Prishtinës. Qfarë përgjigje tjetër kërkon nga unë?

Dhe fakti që ju i dhatë karakter politik, më bën të dyshoj që flirti juaj me pasardhësit në komunë, fsheh në prapavijë logjikën se ju dëshironi t'iu shpëtoni këtyre 70 lëndëve. Këtë e thonë ju, sepse kështu kalkuloni logjika juaj.

Për fund, edhe njëherë ju rekomandoj që sinqerisht ti referoheni dhe të reflektoni shumë ndaj deklaratës së ambasadores së nderuar, Jacobson, pas së cilës, qështë e vërteta s'keni qka kërkon në skenën politike të Kosovës.



Edhe unë po ju them se e ke fëlliq krejt. Dhe këtë LDK dhe qytetarët nuk e kanë merituar.



628

82 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli   
November 11, 2014 · 

...

Shqipëria nëpërmjet kryeministrit Edi Rama po afirmon në marrëdhëniet rajonale kulturën e dinjitetit. Kështu ishte rasti i mesazheve të tij për pavarësinë e Kosovës në vizitën e tij historike në Beograd.

Serbëve nuk u pëlqen kur shqiptarët flasin me dinjitet me gjuhën e Europës dhe Perëndimit.

Bashkëqytetarët e mi të Kosovës janë ndjerë mirë nga ky përfaqsim ndaj e nderuan kryeministrin Rama në rrugët e Kosovës ndërsa ai kthehej nga Serbia. Ne e nderuam vëllain tonë si e meriton ai! Me dinjitet mund të fitohet shumëçka. Shqiptarët e Luginës duhet të ndihen mirë që dëgjuan prej gojës së Kryeministrit Rama në vizitën e tij lajmin se Qeveria Serbe do të njohë diplomat e Republikës së Shqipërisë.

Një mundësi më shumë që të rinjtë e Luginës të mos e braktisin vendlindjen e tyre. Shqiptarët po mendojnë njëllonj, po frymojnë njëllonj. Duhet dhe jetësimi i iniciativave ekonomike përbashkuere që të jemi më të fortë dhe më të begatë!



504

29 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

November 25, 2014



Me pikëllim të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të mikut tim Riza Lluka.

Me Rizën kam pasur një njohje të hershme.

Në vazhdimësi me të, kam mbajtur një raport miqësor, të afërt dhe shumë të sinqertë. Riza ka qenë një njeri i këndshëm, i afërt me njerëzit dhe mbi të gjitha një humanist i madh.

Ata që e njohën, ia dijnë këto veti këtij njeriu me vlera të larta njerëzore.

Familjes së Rizës, i shpreh ngushëllime të thella.

Prehu në paqe miku im i shtrenjtë.



250

23 Comments 2 Shares



Behgjet Pacolli

November 28, 2014



Gjithë bota shqiptare dhe miqtë e saj festojnë Ditën më të ndritshme të Kombit, 28 Nëntorin. Nuk ka ditë më të rëndësishme për një komb se ajo që bashkon më shumë se të tjerat.

Kjo ditë e veçantë na gjen më të fortë pse na gjen më krenarë se jemi shqiptarë. Ka patur shumë ngjarje që e kanë forcuar krenarinë të të gjithë brezat e shqiptarëve kudo që jetojnë.

Krenaria është shumë, por nuk është gjithçka. Ajo është themeli i forcës, por nuk është vetë forca. Forca është kur ne mendojmë njëlloj, kur ne veprojmë njëlloj, kur ne bashkojmë mendjet, fuqitë, pasuritë shpirtërore dhe materiale për t'i shërbyer kombit.

Ndaj urimi im për sot është: Gëzuar Ditën e Flamurit! Vitin tjetër qofshim më të fortë dhe më të bashkuar në mendime, në fuqi, në pasuri dhe begati!



821

17 Comments 8 Shares



Behgjet Pacolli

December 1, 2014

...

Sot feston 85 vjetorin e ditëlindjes miku im, Presidenti Alfred Moisiu, pinjoll i familjes së shquar të Moisinjve, djali i Komandantit të vërtetë të Luftës Spiro Moisiu, gjenerali patriot dhe Mik i madh i Kosovës; bashkëthemelues i Lëvizjes për Unionin Ekonomik Kombëtar së bashku me mua dhe Presidentin Meidani. I uroj jetë të gjatë, të lumtur dhe aktive si deri më sot mikut tonë të shtrenjtë!



1.3K

49 Comments 5 Shares



Behgjet Pacolli

December 1, 2014 · 🌐

...

1 vit më parë AKR fitoi në kuadër të zgjedhjeve komunale dy komuna të rëndësishme të Kosovës si Gjakova dhe Mitrovica.

Qytetarët votuan për shkëputjen nga modeli ekzistues i politizimit të komunave dhe i drejtimin të tyre si feude partiake. Ai votoi për kandidatët më të mirë dhe Mimoza Kusari Lila dhe Agim Bahtiri ishin kandidatët më të përkushtuar për qytetarin.

Fituan projektet më të mira për Gjakovën dhe Mitrovicën si Zona të lira Ekonomike, me Trepçën e menaxhuar ndryshe sipas një modeli perëndimor dhe jo të privatizuar, me ferma të mëdha bujqësore dhe blegtorale si kudo në botë.

Këto dy komuna po menaxhohen me ndershmëri dhe qytetarët e kanë prekur ndryshimin. Por projektet e mëdha duan mbështetjen e qeverisë qendrore.

Mjerisht në kushtet e sotme, askush në nivel të ekzekutivit s'e ka mendjen tek ekonomia, tek mirëqenia e qytetarit dhe projektet pengohen. Megjithatë njerëzit e AKR-së do të gjejnë hapësira për të sjellë që nga mandatin e parë ndryshime thelbësore në jetën e Gjakovës dhe Mitrovicës. E drejta dhe e mira vonon, por kurrë s'mënon. (harron)



Vjollca Gagica-Matoshi and 979 others

41 Comments 9 Shares



Behgjet Pacolli  
December 2, 2014 · 🌐

...

Ka shumë popuj të vegjël apo dhe më të mëdhenj sesa Kosova, kauza e të cilëve sot në botë dhe luftërat për këtë kauzë janë të panjohur ose nuk merren në konsideratë. Në kohërat tona nëse kjo kauzë nuk njihet, gjasa që ajo të zgjidhet, të adresohet janë të vogla. Ibrahim Rugova, ditëlindjen e të cilit kujtojmë sot, kishte meritën historike se ishte i pari që e bëri botën të njohë Kosovën, të kuptojë genocidin mbi popullin e Kosovës, të vlerësojë luftën e Kosovës, t'i krijohet respekt për popullin dhe kombin tonë.

Pa këtë njohje, a ndërkombëtarizim siç e quajmë, s'do të kishte ardhur faza e ndërgjegjësimit të qendrave të mëdha të vendosjes për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës. Ishte më pastaj lufta çlirimtare që i përshpejtoi cilësisht proceset, mbështetur dhe mbi këtë trashëgimi të vyer të Ibrahim Rugovës.

Vepra politike e Ibrahim Rugovës përfaqëson një trashëgimi të madhe jo thjesht për LDK-në, e cila falë drejtimit të tij ishte parti udhëheqëse e skenës politike të Kosovës. LDK-ja e drejtuar prej Rugovës mishëronte një kuadër të gjerë interesash të qytetarit duke i harmonizuar ato më së miri, çka i garantonte dhe rezultate të larta zgjedhore. LDK-ja e Rugovës sillte me dinjitet me partitë e tjera kundërshtarë dhe mu prej kësaj, sot kur ai s'është më, rivalët e tij më të fortë i referohen trashëgimisë së tij politike si një monumenti të përbashkët kombëtar. Vepra e tij bashkoi shumë para vdekjes, por akoma dhe më shumë pas vdekjes.

Popujt e vegjël kanë nevojë për mite, mbi të cilat themelojnë konceptin e tyre shtetëror të mëpastajmë. Rugova ishte dhe mbetet një mit i dobishëm për shtetformimin dhe shtetndërtimin e Kosovës, me idetë e veta për aleancat ndërkombëtare të Kosovës, me sjelljen e vet të moderuar politike, me paqen që përcillte me sjelljet dhe fjalët e tij. Ja pse unë e kam quajtur atë themelues të pavarësisë së Kosovës, dhe një nga figurat më të mëdha shqiptare të fundshekullit të 20-të. Nderim të përjetshëm figurës së tij!



👍 1.7K

40 Comments 29 Shares



Behgjet Pacolli

December 4, 2014 ·

...

Të dashur miq, që nga muaj nëntor profili im në Facebook është njohur dhe verifikuar nga Facebook. Ky është i vetmi profil i im zyrtar në rrjetet sociale, dhe menaxhohet nga vetë une Behgjet Pacolli.

1.5K

67 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

December 8, 2014 ·

...

Qeveria s'është përkryer ende, por që tani ne mund të formulojmë urime për suksesin e saj. Suksesi i ekzekutivit është suksesi i Kosovës, suksesi i qytetarëve pavarësisht se se kush është në krye të qeverisë, se kush është pjesë e saj.

Një qeveri e ndërtuar nga koalicioni i dy partive më të mëdha të vendit, është diçka e rrallë në demokraci. Ajo zakonisht ndërtohet kur problemet, sfidat janë shumë serioze. Të tilla janë sfidat e Kosovës, për zhvillimin ekonomik, për rritjen e mirëqenies së qytetarit, për respektimin e ligjit, për shkollat më të mira, për spitale më dinjitoze. Nuk ka gjë më të dhimbshme sesa të shohësh nisjen e bashkëvendasve të tu, kryesisht të rinj, drejt emigracionit, duke i kthyer shpinën shtëpisë dhe familjes së tyre. Shpresoj shumë se qeveria do ta ndalojë këtë hemorragji të shpirtit kombëtar, që po na krijon dhe do të na krijojë probleme të mëdha.

Qeveritë ndërtohen mbi bazë marrëveshesh dhe programesh. Marrëveshja në kanun, dhe në fe është shtyllë e ndërgjegjes njerëzore. Shqiptari e ka të shenjtë marrëveshjen si komb. Meqë ne si klasë politike e kemi të dobët kulturën e marrëveshjes, të fjalës së dhënë, meqë kjo qeveri është ndërtuar mbi një marrëveshje e cila nga ana e vet u ndërtua mbi prishjen e një marrëveshjeje tjetër, unë dua të uroj që marrëveshja e dy forcave kryesore politike të Kosovës të jetojë gjatë. Pas shumë marrëveshesh të prishura qoftë koha e një marrëveshjeje të mbajtur!

Dua të besoj shumë në realizimin e programit të kësaj qeverie që ende s'e kemi parë megjithatë! Edhe programi është fjalë e dhënë! Fjala e dhënë është diçka e lidhur me ndërgjegjen, me fytyrën, me nderin për shqiptarin! S'kemi dëgjuar shumë diskutime për programe, pse si zakonisht debati politik në këto 6 muaj pas zgjedhjeve nuk zhvillohej rreth programit, por rreth pushtetit. U humb shumë kohë me kësaj lloj debati, ndaj tash duhet të merremi me programin dhe realizimin e tij! Një koalicioni i dy partive kryesore të vendit është luks pse opozita është shumë e vogël, ndaj askush s'ka alibi për mosrealizimin e programit që do doja shumë të ishte përqëndruar tek ekonomia!

722

40 Comments 11 Shares



Dëshiroj ta përgëzoj kryeministrin e ri të Kosovës, Isa Mustafën, për fillimin më rrëmbim të punëve. Ai ndërtoi gjatë natës dy ulëse të reja në kuvendin e Kosovës, për t'i bërë vend qeverisë më të madhe në historinë e Kosovës. Saktësisht gjashtë muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve, dy partitë më të mëdha në vend, PDK dhe LDK, arritën që t'i formojnë institucionet e vendit. Gjithashtu, mund të them, se kjo qeveri e re, tashmë e ka thyer edhe një rekord. Filluan të punojnë ende pa e dhënë betimin solemn duke i shtuar gjatë natës, dy ulëse të reja për ministrat e rinj në Kuvendin e Kosovës. Prapë se prapë, formimi i qeverisë së re, është edhe një lajm i mirë por edhe i mjerë për shoqërinë tonë. Liderët e partive politike u treguan të gatshëm që, për t'i plotësuar deri në fund egot personale ta shpjenin Republikën e Kosovës deri tek një kaos total, Mirëpo, më e keqja u evitua, vetëm atëherë kur kryetari i LDK'së dhe ai i PDK'së, u siguruan që t'i ndanin për vete, dy pozitat kyçe: atë të kryeministrit për Isa Mustafën dhe atë të presidentit, pas dy vitësh, për Hashim Thacin. Kurse, qytetarëve nuk u mbetet rrugë tjetër, vetëm t'i gëzohen një fakti dhe një fati të tillë, të pikëllueshëm. Unë, megjithatë, dëshiroj të besoj që formimi i institucioneve është një lajm i gëzueshëm për vendin. Dëshiroj të besoj që ministrat e ri do të gjejnë forcën dhe vullnetin e mjaftueshëm që të janë në krah të qytetarëve, më shumë se sa në krah të interesave partiake. E posaçërisht dëshiroj të besoj që kryeministri i ri, i ka ruajtur energjitë e tij pozitive për këtë kohë. Ndonëse, ajo çfarë dëshiroj të besoj, dhe ajo çfarë realisht besoj, në këtë rast, ka dallim të madh. Por, edhe unë, do t'i përmbahem kodit të pashkruar për ta respektuar 100 ditëshin e një heshtjeje përballë qeverisë së re. Dëshiroj më këtë rast t'i falënderoj shumë ministrat e deridjeshëm të AKR-së, që përgjatë gjithë qëndrimit të tyre në qeveri, punën e tyre e kanë kryer në mënyrë shembullore. Këta ministra, treguan zell dhe kulturë të lartë të punës. Ata asnjëherë për këto 4 vite nuk ishin, madje, as të përfolur për afera korruptive e të mos flasim për hetime zyrtare. Përkundrazi, ministrat, si Mimoza Kusari, Fadil Ismaili, Ibrahim Makolli, Bernard Nikaj dhe tash së fundmi Ismet Mulaj, ishin shembulli që duhet ndjekur nga kolegët e tyre në të ardhmen. Sot Kosova mund të mburret se është ndër vendet me të volitshme për të bërë biznes në Ballkan, kjo fjalë punës së madhe të Mimoza Kusarit dhe bashkëpunëturove të saj. Dhe kishte edhe shumë raste të tilla të ngjashme. Mos te harrojmë ngritjen e renditjes së ambientit të berit biznes të Kosovës mbi 37 vende vetëm në dy vitet e para të udhëheqjes së kësaj ministrije nga Zonja Mimoza Kusari. Nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit pjesë e së cilës komponenta tregtare është 70% e saj. Kalimin e ligjit për mbrojtjen e investimeve të huaja dhe shumë marrëveshje për mbrojtje dhe promovim të investimeve. Reformën e mirëfilltë të politikave tregtare e shumë të tjera.

Mos te harrojmë punën kolosale që u bë për Trepçen në menyrë që ajo mos të privatizohet e ti mbetet qytetarëve të Kosovës. Brezovicën arritëm ta fusim në binarët e duhur në menyrë që ajo të zhvillohet. Puna e madhe për KEK-un poashtu mbeti e pakryer për shkaqe të mos funksionimit e zingjirit qeverisës dhe parlamentit të mandatit të fundit. Shumë iniciativa tjera të ministrave të AKR-së mbetën vetëm në letër për shkaqe të xhelozive ose të mosvullnetit të partnerëve të saj për ta zhvilluar Kosovën. Me padurim po presim që këto iniciativa të marin drejtimin e duhur. AKR la mbrapa një program që i nevojitet Kosovës. Koha po tregon se idetë tona (AKR) ishin avangardiste.

Kur unë udhëtoja në Afrikë, shumëkush u tall, sot njohjet vijnë nga Afrika si rezultat i punës dhe vizionit tim.

Të njejtit të cilët dikur u tallëshin sot mburrën për njohjet që vijnë bile duke u munduar që këto të fundit të ja atribojnë suksesit të tyre. Edhe shumë njohje do të vijnë nga Afrika, Amerika e Jugut e Asuani. Poashtu me padurim po presim se çfarë suksese do të tregojë përfaqësuesja e Isa Mustafës në Ministrinë e Tregtisë e Industrisë e cila vazhdimisht ishte një zë i ashpër (Kundër punës së zonjës Kusari) brenda Kuvendit të Kosovës. Edhe pse e njehta punoi si këshilltare e ish-Ministrit të Tregtisë, Zharku për reformën e të bërit biznes në kohën kur Kosova ishte e listuar në vendin 119-të të Indeksit të Bankës Botërore, ndërsa sot e merr Ministrinë me Kosovën në vendin e 75-të. Por nuk ishte vetëm kjo. Po shpresoj shumë që ministrat e rij nuk pretendojnë në hapjen e gurëthyesve tjerë, (keta që janë sot e shkatërruan ambientin e Kosovës), pompave të benzinit apo ridefinimin e drejtimit të autostradave që të kalojnë nëpër tokat e tyre. Do ta përcjellim me llupë edhe punën e emërimit më të befasishtëm të kësaj qeverie, atë të Ministrit të Punëve të Brendshme, z.Skendër Hyseni (perndryshe Diplomat më pervojë) dhe po dëshiroj të besoj që Hyseni nuk e ka pranuar këtë post, vetëm pse ai i Ministrit të Punëve të Jashtme ju zu nga dikush tjetër, por pse z. Hyseni është i pasionuar për ta luftuar krimin.

Mos të harroj të përmend, se ky kabinet qeveritar, për nga përmasat dhe numrin e ministrave tashmë që në start, është kabineti më i madh qeveritar në historinë e Kosovës, e ndoshta edhe të rajonit. Sigurisht, nuk e keni harruar se sa ishte tallur LDK me qeverinë e kaluar, pjesë e së cilës ishte edhe AKR, pikërisht për këtë çështje. Ndërsa, unë e pashë, se si në sallën e Kuvendit, e cila është ndërtuar (pjesa më e madhe donacion) nga Mabetex, në momentet e fundit, krejt pa shije, partnerët e rinj qeveritar, u detyruan t'i shtonin, madje, edhe dy ulëse ministrare. Sepse ato aktualet nuk po i zinin që të gjithë. Unë personalisht nuk kam asgjë kundër numrit të madh, sa kam kundër improvizimeve. Sikur AKR të kishte mundësi që të bënte një qeveri, sipas ideve të saja, padyshim që nuk do të krijonim këso tollovie qeverisëse. Gjithsesi që nuk do të shtonim edhe më shumë ulëse për ministra në Kuvendin e Kosovës. Ju e dini që ne e kemi pasur në programin tonë qeverisëse, heqjen e disa zyresh. Megjithatë, edhe përkundër numrit kaq të madh të ministrave, 21, PDK dhe LDK, ndarjen e resoreve qeveritare, duket se edhe kësaj here, më shumë se sa për një përfaqësim mbarënational, janë përkujdesur për një përfaqësim miqësor. Dy prej rajoneve kryesore në vend, ai i Gjakovës dhe ai i Mitrovicës, nuk janë të përfaqësuar fare në ekzekutiv. Ndonëse, këto dy qytete, kanë qenë, dhe vazhdojnë të mbesin, si dy prej zonave më të rëndësishme ekonomike në vend. Nuk e kuptoj pse partnerët PDK dhe LDK kanë zgjedhur t'i ndëshkojnë këto dy qytete. Këtu janë dy mundësi, që kanë sjellë në këtë "gabim", nga paditurija për prioritetet, ose nga hakmarrja se këto dy qytete udhëhiqen nga AKR. Mbes me shpresë që këtë nuk e kanë bërë nga hakmarrja ndaj AKR-së, por nga mosdija!!!!!!



# Behgjet Pacolli



Behgjet Pacolli added 20 new photos.  
December 11, 2014

...

Ish Zëvendëskryeministri Pacolli, ka zhvilluar katër turne në kontinentin e Afrikës dhe ka vizituar një apo më shumë herë, më shumë se 35 shtete të këtij kontinenti.

Gjatë këtyre vizitave, Zëvendëskryeministri Pacolli, ka takuar rreth 30 Presidentë, ose kryeministra. Shume prej tyre, ai i ka takuar edhe në New York në samitet e përvitshme në OKB.

1. Republikën e Guineas-Bissau (frankofon)
2. Republikën e Afrikës Qendrore (frankofon)
3. Republikën e Guineas-Conakry (frankofon)
4. Republikën e Nigerit (frankofon)
5. Republikën e Beninit (frankofon)
6. Republikën Federale e Nigerisë
7. Republikën e Gabonit (frankofon)
8. Republikën e Bregut të Filipsitë (frankofon)
9. Republikën e Ganës
10. Republikën e Sao Tomes (frankofon)
11. Republikën e Tanzanisë
12. Republikën e Afrikës së Jugut
13. Republikën e Marokut
14. Republikën e Tunizisë
15. Kongo brazavile (frankofon)
16. Republikën e Togos (frankofon)
17. Republikën e Malit (frankofon)
18. Republikën e Kenisë
19. Republikën e Çadit (frankofon)
20. Republikën e Kongos
21. Republikën e Lesotos
22. Republikën e Burundit (frankofon)
23. Republikën e Ruandës (frankofon)
24. Republikën e Ugandës
25. Republikën e Namibisë
26. Republikën e Angolës
27. Republikën e Mozambikut
28. Republikën e Zimbabvesë
29. Republikën e Zambisë
30. Sudanin
31. Republikën e Guinesë Ekuatoriale (frankofon)
32. Republikën e Kamerunit (frankofon)
33. Republikën e Etiopisë
34. Sudanin e Jugut
35. Madagaskar (frankofon)



1.1K

39 Comments 26 Shares




Behgjet Pacolli added 24 new photos.

December 13, 2014 · 🌐

...

Disa foto nga aktivitetet e kryera nga Fondacioni Behgjet Pacolli në Kosovë



👍 1.3K

51 Comments 23 Shares



Behgjet Pacolli ✓

December 14, 2014 · 🌐

...

Vdiq një politikan i madh gjerman, një mik i Kosovës dhe shqiptarëve. Partia Kristiandemokrate që Andreas Schockenhoff përfaqësonte në nivele të lartë, sot ka formuluar kushtet më të drejtë ndaj Serbisë për ta ndërlidhur integrimin europian të saj me pranimin e pavarësisë së Kosovës. Ngushëllime familjes për humbjen e parakohshme, partisë CDU, dhe shtetit mik gjerman.

👍 229

6 Comments 3 Shares



Behgjet Pacolli

December 17, 2014 ·

...

S'ka prind, s'ka mendje njerëzore normale kudo në botë që të mos jetë prekur nga masakra tragjike e kryer mbi fëmijët e një shkolle në Peshavar të Pakistanit. Si dikush që për arsye humanitare, kam patur rastin ta vizitoj Peshawarin në turnet e mia nëpër botë, për të shpëtuar pengje, për të promovuar Kosovën, apo dhe për arsye profesionale, jam prekur pamasë. Besoj e kujtoni historinë e lirimit të Shqipe Hebibit dhe pengjeve të tjera, histori që më detyroi të shkoja dhe në atë Peshawarin e goditur sot nga ky akt vrasjesh gjakftohta mbi fëmijët e pafajshëm.

Dua të pyes, por përgjigja është e nënkuptuar për të gjithë. A ka fe që justifikon një krim kaq qyqar? A ka mendje normale që mund të japë urdhërin për një veprim si ky? A ka kauzë të drejtë politike apo fetare që mund të frymëzojë krime si këto që na kujtojnë disa krime mbi fëmijët e Kosovës? Ne duhet t'i dënojmë me forcë publikisht aktet e tilla çnjerëzore duke pyetur pse,pse, pse janë kaq shumë dhe të kontribojmë,me aq sa kemi fuqi,në parandalimin e tyre dhe abuzimeve e tragjedive që po kryhen në emër të fesë, të "patriotizmit" ose ndonje kauze tjetër të shëmtuar!!

563

27 Comments 10 Shares



Behgjet Pacolli

December 18, 2014 ·

...

Të nderuar miqt e mi,

Para disa muajsh, nëpërmjet një paraqitje në television pata folur për rrezikun që qytetarëve tanë nga qentë endacakë. Evidentimi i një rreziku të tillë për bazë e kishte përditshmërinë e rrugëtimit tim nëpër qytetet e Kosovës. Alarmi që unë u përpoqa të jap në atë kohë kishte për qëllim nxitjen e zyrtarëve kompetentë nëpër komuna që të ndër marrin veprime konkrete në parandalimin e rrezikut nga qentë endacak.

Fatkeqësisht, dje erdhi viktima e radhës nga qentë. Një fëmijë 5 vjeqar vdiq nga sulmi i qenve, ndërsa rreziku vazhdon të jetë në nivel të lartë.

Jeta e qytetarëve duhet të jetë prioritet i secilit zyrtar, i secilit individ në këtë vend. Asgjë tjetër nuk ka kuptim nëse mungon angazhimi për të siguruar jetën e qytetarëve.

Është pak e quditshme për mua se si asnjëherë nuk është trajtuar seriozisht rreziku nga qentë e shumë endacakë. Për më tepër, këta qenë lehtësisht shpërndajnë epidemi të rrezikshme. Unë apeloj që me urgjence të trajtohet ky problem dhe organet kompetente, komunat përkatëse të krijojnë mekanizma për eliminimin e këtij rreziku të madh. Familjes së vogëlushtit të ndjerë, i shpreh ngushëllimet më të thella dhe keqardhjen e madhe si një familjar dhe si prind.

321

31 Comments 7 Shares



Behgjet Pacolli

December 18, 2014 ·



Ditët e fundit gazetatat po shkruajnë se krerët e Republikës së Kosovës mund të shkojnë në veri, vetëm duke marrë leje në Beograd. Nuk dua ta besoj dhe e konsideroj diçka të papranueshme këtë lajm. Nëse do ishte i vërtetë do pyesja seriozisht, si liderët tonë e konsiderojnë at pjesë të Kosovës dhe kend e perfaqësojnë ata!!!

Në 3 vizitat si President i vendit, në muajin e parë të punës time në pikat kufitare në veri të Kosovës dhe në qendrat e banuara më së shumti nga qytetarët e etnisë serbe, (shikoni fotot) u shfaq fuqishëm shteti ynë, shteti i Kosovës. Unë askend nuk e pyeta për te vizituar veriun (Mitrovicën e veriut dhe kufijtë e shtetit në veri). Për mua vizitat në veri të Kosovës duhët të jenë rutin, asgjë e jashtëzakonshme dhe për to nuk duhët të kërkohët leje prej askujt.



1.5K

96 Comments 32 Shares



Ja si duhet ta ndihmojmë Kosovën, ose pse një kompani suedeze investon në Kosovë Kryetarja e Gjakovës Mimoza Kusari Lila ishte prezente kur në mes kompanisë Intertex (antare e grupit MABETEX) dhe kompanisë TROX (fornizuese e ndërmarrjes VOLVO) u nënshkrua kontrata për ndërtimin në komunën e vet, të një fabrike për prodhimin e mbulojave të automobilave për mbrojtjen e tyre nga dëmet gjatë transportit (deri të blerësi). Për Intertexin, kontratën e nënshkroi zt.Valon Luka. Fillimi i bashkëpunimit në mes një firme Kosovare dhe Volvos është i jashtëzakonshëm. Dmth. një ngjarje që nuk ndodh çdo ditë. megjithëse të ngjashme duhet të ndodhin çdo ditë.

Në Gjakovë kompania Trox nga Goteborgu do të prodhojë mbulesat e autoveturave të Volvos. Fabrika do të ndërtohet në Gjakovë ku do të punësohen 200 vetë. 200 të punësuar, dmth 200 familje të shkëputura nga varfëria, dmth 200 kandidatë më pak për të ikur me autobusë në Hungari apo udhëve të botës.

Ky investim i ri në Gjakovë ka dhe shumë domethënie të tjera.Fabrika në fjalë ka qenë një investim që realizohej më parë në Ukrainë. Tash do bëhet në Kosovë. E kjo është një domethënie e rëndësishme jo thjesht në rrafsh kosovar, por dhe më gjerë. Është një shembull i mirë që pason mbas Kompleksit të këpurdhave që është duke u ndërtuar në Mitrovicë, pas shumë pengesave (të qellimshme të atyre që nuk e dojnë Kosovën). Ka shumë investime të tjera që mund të zhvendosen drejt Kosovës për një arsye apo për një arsye tjetër. Por që të ndodhë kjo duhen plotësuar disa parakushte.

Së pari, duhet një administratë komunale si ajo e Gjakovës dhe e Mitrovicës e qeverisur me transparencë, ndershmëri dhe profesionalizëm që të frymëzojë besim tek partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Dhe prova e radhës, e prekshme e këtij besimi ishte pikërisht kontrata e firmosur në Göteborg. Përgëzime kryetares Mimoza Kusari Lila, që Gjakova po përfshihet në hartën botërore të investimeve, pothuajse, pa ndihmën e qeverisë, megjithëse do të mund të ishte ndryshe, do duhej të ishte ndryshe. Këtu kryetarja ka shërbyer si garantuese e një investimi kaq të rëndësishëm nga pikëpamja simbolike me punën e vet, me diturinë e vet. Gjakova me në krye Mimosën do të vazhdojë ta bëjë këtë brenda mundësive dhe hapësirës ligjore që ekziston.

Së dyti, kjo që ndodhi në Göteborg ka patur nevojë për një shtysë fillestare, për një "mesit", për një nxitës apo promotorë. Ata janë Naim Murseli dhe Visar Jaha prej Gjakove, që jetojnë në Suedi dhe që e dojnë Gjakovën, e dojnë Kosovën, e dojnë Suedinë, atdheun e tyre të dytë. Me shumë përkushtim, këmbëngulje ata ndihmuan në realizimin e kësaj marrëveshje. Unë i falënderoj nga zemra Naimin dhe Visarin dhe do dëshiroja shumë që ne të kemi edhe shumë të rinj dhe të reja në rolin e ambasadorëve jozyrtarë të Kosovës në diasporë që angazhohen për ta ndihmuar vendin e tyre, kombin e tyre.

Së treti, ju të gjithë e mbani mend kur gjatë fushatës, ne si AKR kemi thënë se do ta përfshijmë Kosovën në hartën globale të investimeve. Ne besonim dhe besojmë se Kosova i ka të gjithë potencialet për t'u përfshire në këtë hartë: rininë e talentuar, pozitën strategjike në raport me tregjet globale, diasporën e përgatitur dhe kontributore të madhe, etj. Por investitorët kanë nevojë për garantë në Kosovë. I kërkojnë këta garantë në qeveri, dhe mes aktorëve vendorë të biznesit. Ata nuk do të vijnë nëse nuk i gjejnë këta garantë. Unë në qeverinë e Kosovës isha garant (edhe pse i vetmuar) për shumë investime që u nisën për të ardhur, por që u bllokuan, apo s'kanë ndërmend të vijnë për shkak të mungesës së bashkëpunimit të faktorëve tjerë institucional. Kështu ishte rasti i kompleksit Trepça, apo kontrata e famëshme në Nigjeri (ju kujtohet

denoncimi i AKK kundër meje dhe kësaj iniciative që kishte vlerë mbi 500 milion për ndërmarrjet e Kosovës, kontratë kjo që sot implementohet nga firmat rumune) dhe shumë raste të tjera. Pa modesti mund ta them lirisht : unë dija dhe di më mirë se shumë të tjerë ta bëj këtë. Për disa punë duhet dhe mjeshtëri. Duhet njohur perëndimi, ekonomia kapitaliste, duhet njohur tregu dhe parimet e tij, duhet elasticitet në vendimmarrje, duhet eksperiencë e dëshmuar. Nuk duhen fjalë, deklarime propagandistike. Dua të paralajmëroj me dhimbje: nëse nuk afrohen këto garanci për investitorët, atëherë askush s'do të vijë në Kosovë. Punësimi do të tkurret dhe shumë më shumë kosovarë do detyrohen të ikin. Jo vizat që nuk do të liberalizohen, por kushtet për marrjen e tyre do të vështirësohen akoma dhe më shumë.

Parakushti i katërt është ekzistenca e një partneri vendor (Kosovarë) që ka fokus tjetër biznesi në sipërmarrjen e vet është e që ofron për ta luajtur rolin e garanti thjesht dhe vetëm për t'i dhënë më shumë siguri investimeve. Në Kosovë kemi shumë pak ndërmarrje (si Mabetexi) që ka eksperiencë e fuqi për të garantuar partneritet bashkohorë në rrafshin ndërkombtarë. Edhe ne rastin e Mitrovicës dhe Gjakovës prezenca e Mabetexit ishte e domosdoshme.

Komuna e Gjakovës dhe ajo e Mitrovicës të drejtuara nga njerëzit e AKR-së janë garantë të investimeve të huaja apo vendore që janë si oksigjeni për ekonominë e Kosovës. Investimet janë ilaçi që do të ndalë hemoragjinë e ikjeve nga vendi, që po shohim në Kosovë si në ditët e errta të pushtimit serb. Por që këto investime të jenë të shumta, të qëndrueshme duhet të plotësohen të gjithë parakushtet që duan investitorët e huaj. Duhet të ofrohen të gjitha garancitë, ku kryesorja është garancia qeveritare. Duhet të ndalet lufta politike ndaj komunave që s'kanë prejardhje politike të njëjtë me atë të qeverisë. Duhet të ndalet praktika e haraçeve. Duhet bashkëpunim. E lus perëndinë që kjo qeveri mos ti hakmirret Gjakovës dhe Mitrovicës dhe të jetësojë Zonat e lira ekonomike (të cilat i formuam më shumë mund) në keto dy komuna. Mos të privatizoj Trepçen por të trajtojë atë sipas normave të tregut dhe interesit të Kosovës, ashtu siç ne të AKR-së e filluam e nuk mundem me e përkry për shkak të zgjedhjeve dhe mos funksionimit të institucioneve. Dhe mbi të gjitha duhet ta duam Kosovën.

1.3K

69 Comments 25 Shares



Behgjet Pacolli

December 24, 2014 · 🌐

Pas një viti të gjatë dhe të vështirë sot është koha për të festuar ditët e Kërshëndellave. Ato janë festa të vëllezërve tanë të një besimi tjetër, por ne shqiptarët sipas traditës më të mirë bëhemi pjesë e këtyre festave duke i uruar: Për shumë mot Kërshëndellat! Urime u qofshin për jetë e mot!

258

4 Comments 4 Shares



Behgjet Pacolli

December 26, 2014 · 🌐



Nga sot në adresën [www.ngasfidanesfide.com](http://www.ngasfidanesfide.com) do të gjeni në pdf librin tim autobiografik "Nga Sfida në Sfidë". Është një përkushtim i imi për rininë e Kosovës. Është shkruar me besimin se jeta ime, sukseset e mia, dështimet e mia të përballuara si sfida të përhershme mund të shërbejnë si shembull për ta, ashtu si thonë dhe miqtë që kanë shkruar parathënien, ambasadori Uoker dhe ish presidenti i Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Më shkruani rreth librit, pjesë të të cilit keni patur mundësi t'i lexoni në Facebook. Më interesojnë mendimet tuaja. Do të gjeni gjithçka, pa retush, pa zbukurime, me ndershmëri dhe transparencë, me krenarinë për një jetë të jetuar në çdo çast me punë.



NGASFIDANESFIDE.COM

### Nga Sfida në Sfidë - Liber nga Behgjet Pacolli

A keni parë rrathët bashkëqendrorë që krijon rënia e një guri në sipërfaqen e një liqeni? Kështu është jeta ime me rrathët e saj, jetën në Kosovë, shkollimin, ndërmarrësinë, humanizmin, politikën. Gjithë jeta ime e zhvilluar sipas këtyre rrathëve rrëfëhet në këtë libër. Por guri i rëndë peshon në ve...



Zenel Vrajolli and 1.1K others

28 Comments 43 Shares



Behgjet Pacolli

December 28, 2014 ·

...

Shpesh herë në takimet me qytetarët gjatë vitit 2014 kam bërë një pyetje. Çfarë e pengon një vend si Kosova, me rini dhe me forcë pune të kualifikuar, të talentuar, me burime të mëdha natyrore, të jetë i zhvilluar si çdo vend tjetër normal? Është udhëheqësia, janë aftësitë e udhëheqësisë apo mungesa e tyre, vizioni apo mungesa e vizionit që përcaktojnë ritmet e zhvillimit apo ecjen mbrapa.

Gjatë vitit 2014, falë presionit të AKR-së, në fund të mandatit që shkoi, u miratuan dhe zunë fill disa reforma të rëndësishme siç ishte ajo për zonat e lira ekonomike dhe qeveria miratoi shkëputjen e kompleksit Trepça nga Agjencia e Privatizimit. Këto reforma për të cilat unë flisja që nga 2007-a kanë ngrirë. Qeveria e sotme duhet t'i rimarrë ato reforma, ti plotësojë dhe ti ekzekutojë me shpejtësi. Qeveria e sotme duhet të ekzekutojë gjithë ato ndryshime, ato ide, ato projekte që ne kemi propozuar dhe për Unionin Ekonomik Kombëtar, duke gjetur mundësi zhvillimi pikërisht tek bashkimi i forcave dhe energjive të gjithë shqiptarëve kudo që janë.

Pse duhet shpejtësi? Ajo rini që po ikën me arrati nga vendi si në kohërat më të errëta kërkon shpresë. 2015 duhet ti kthejë shpresën rinisë në vendin e vet, pranë familjeve të veta. Nuk presim ndryshime që në ditën e parë të qeverisjes, por partitë që përbëjnë qeverinë kanë rastin gjatë 2015-ës të provojnë vlerën e premtimeve të veta elektorale. Duhet zhvillim ekonomik jo me skema të vjetra, por me vizion modern. Vetëm zhvillimi ekonomik i vullshëm i shërben Kosovës dhe jo ecja me hapa breshke. Pa shenja të këtij zhvillimi, pa frenim të hemorragjisë së ikjeve nuk do të ketë as liberalizim të vizave. Pa liberalizim të vizave, pa zhvillim ekonomik, populli që derimëtash ka treguar shumë durim, do të shpërthejë.

Në kapërcyell të viteve, në prag të vitit 2015, unë i uroj gjithë bashkëvendasve më shumë shpresë, më shumë punë, më shumë begati, më shumë shëndet. Populli i Kosovës ka vuajtur shumë dhe meriton më shumë!



Lumturije A. Morina and 718 others

25 Comments 13 Shares



Behgjet Pacolli

December 31, 2014 ·

...

Presidentit. Thashë sa mirë, dikush po vjen tek ideja ime e mëhershme! Njëkohësisht vrejta sesi ndryshojnë gjërat, mendjet dhe njerëzit. Dikur isha unë ithtar i parë që e mbrojta këtë ide publikisht! Që në 2007 kur u përfshiva në politikën kosovare për të ndihmuar popullin dhe jo për të fituar diçka që e kisha siguruar me punë. Asokohe u sulmova nga të gjitha anët e politikës kosovare, nga mediat, më së shumti prej kësaj gazete që sot mbron idenë e zgjedhjes popullore të Presidentit.

Dhe mu kujtua një thënie e Rilindasit modern, Faik Konicës që doja ta citoja saktë prej Revistës Albania të 1907 e që përputhet me këtë ndodhi:

“Fati im në punëra të Shqipërisë, duket se qenka të vë përpara mendime të cilat më bëjnë mijëra kundërshtarë, në mos armiq;

pastaj t'i shoh këta pakë nga pakë të ftohen, të heshtin, të kthehen në mendime të mijat; më në funt, të nxehen dhe, të tërbuar, me sy të gjaksuara, të më predikojnë ato për të cilat më shajin qëmoti kur unë u predikoja atyreve”



Por s'janë vetëm mediat, është dhe ndryshimi i politikës që të vjen në mend prej kësaj thënie të mendimtarit të madh Faik Konica.

Të gjithëve besoj ju kujtohet marrëveshja e nënshkruar solemnisht, me garancë ndërkombëtare të ambasadorit Dell prej meje, dhe zotërinjve Mustafa dhe Thaçi.

Besoj ju kujtohet se për të shmangur zgjedhjet, pa kurrfarë detyrimi për të dhënë dorëheqje nga detyra e Presidentit, siç e pranoi Enver Hasani në prag të largimit të vet nga Gjykata Kushtetuese, thjesht i bezdisur prej llogjeve të politikës për zgjedhjen time, unë dhashë dorëheqjen. Nuk di që ta ketë bërë ndokush këtë veprim deri më sot në politikën e Kosovës.

Por bashkë me dorëheqjen, unë imponova një marrëveshje ku palët zotoheshin për zgjedhje të presidentit nga populli dhe reformë zgjedhore. Parlamenti e ratifikoi atë marrëveshje nëpërmjet një rezolute të miratuar me shumicë të cilësuar.

- Kush e shkeli këtë marrëveshje dhe këtë rezolutë të parlamentit?

- Kush e gënjeu popullin duke mos e mbajtur fjalën që shpalli publikisht me shtrëngim duarsh së bashku me ambasadorin Dell?

Më vjen keq ta them, por këtë e bënë dhe po e bëjnë dy zotërinjtë Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa me marrëveshjen e tyre të fundit që sot po kritikohet nga mediat.

Unë jam i bindur sot më shumë se kurrë se populli duhet të flasë dhe të vendosë me votë për të zotin e shtëpisë, për Presidentin e vendit!

Zgjedhja e Presidentit s'mund të jetë objekt i lojërave të turpshme të politikës si ato që pamë në fund të vitit që shkoi, ku fjala e dhënë, besa, marrëveshja s'kanë asnjë vlerë. Burrat që duhet të mbahen prej fjale, s'po mbahen prej gjësendi tjetër!

Gazetari ka të drejtë, por duhet të kishte folur më herët. Para meje apo bashkë me mua. Shumë zëra janë më shumë se një! Për më shumë që gazetar



1.7K

86 Comments 25 Shares

